

SOTIR ATHANASIU

Polen gruaje

- Stafetë e dhimbshme e një dashurie parisiene -

Roman

Neraida

Çdo përkim me vende dhe persona realë është rastësor.

Autori

Copyright© Autori

Tiranë, 2014

ISBN 978 - 99956 - 44 - 83 - 3

Shtëpia Botuese Neraida
Rruga e Kavajës, P. 185/1, Shk. 1, Ap. 2
Kutia postare 2407
Tiranë
Tel: + 355 4 2241529
e-mail: neraida_botime@yahoo.com

Fëmijëve të mi:
Helidonit dhe Orjadës

AUTORI

Një takim i bukur, i pazakontë-hyjnor

Me kapelën e kashtës, rrasur mbi fytyrë, e zuri gjumi. Rrezet e diellit, atë pasdite, nuk është se kishin forcën që sjell djegie në trupat e zhveshur, por gjithsesi, nxehtësia e tyre shkaktonte vapë. Madje, djersitja deri në kullim, ishte e pashmangshme, po të përballeshe. Gjë, që kishte guxuar poeti. Ai kishte zëvendësuar me një gjumë të munguar freskinë në det, që bënin të gjithë, çikë e fët, si në një ritual kulturi. Se adhurohej dielli, teksa trupat e lakuriqtë i përkëdhelte uji i kripur. Poeti flinte. Shkak? E kishte tejlodhur nata e shkuar për të zbardhur përkthimin nga frëngjishtja me shënimet e një udhëtari të dytë në gjurmët e të parit, ekspedita e të cilit fatkeqësisht kishte përfunduar në tragjedi, vite më parë në Antarktidë. Pas kërkimeve, ishte me shans që kishte arritur të gjente ditarin e fatkeqit. Në to, njeriu i tragjedisë, shënonte: *“Të përpiqesh, të kërkosh, të gjesh e të mos jesh në gjendje të tregosh. Se koha s’mbafton.”*

Ky duhet të qe, me gjasë, akti i fundit e mbase edhe tabloja e mbrame. Se, si në zgrip, përpara mbarimit, “vdekja si **‘Perëndesha’** Hipotermi’ më erdhi si e dashur.” Kështu e mbyllte ditarin udhëtari në Antarktidë. Këto kishte lexuar një natë më parë poeti dhe, tek po flinte, iu shfaq në gjumë ajo që vite e vite e kishte ëndërruar. Jo akujt e kontinentit të ftohtë, por ikona e një femre, që

mishëronte aktin final në përvetësimin e gjuhës së huaj në mënyrë autodidakte, laurimin e tij.

Marrëdhëniet me frëngjishten ai i trajtonte me kujdesin, vëmendjen dhe durimin e njeriut për të pakapshmen e tejet të vështirën, për të rrokur idealen. Me sa dukej, ai kishte mbërritur në stadin sipëror të saj dhe Poeti nuk e kuptonte se ishte me shumë fat që iu shfaq ky vegim. Perëndesha ishte fotokopje. Po, e tillë ajo qe. Fotokopje e asaj femre të panjohur me të cilën vetëm pas një grimë here do të takohej. Po. Se ai e kishte ëndërruar dhe, siç edhe do ta shohim, kjo do të ndodhte me të vërtetë. Një përmbushje e tillë ëndërrore i tejkalohte të gjitha fluturimet pindarike për mbrëmjen e “laurimit” të tij në frëngjisht. Atë që, sigurisht, gjithmonë e kish parë tepër të paarritshme, tanimë s’e vinte në dyshim aspak njëmendësinë e asaj. Mrekullia ishte duke ardhur. Madje-madje, nimfa kishte zbritur në Tokë pas gjashtëqind e pesëdhjetë vjetësh, tejet solemnisht. Kjo qe *Perëndesha Hipertermi* (dhe jo Hipotermi).

Ajo nuk foli vetë. Dikush (siç ndodh në sallonet mbretërore, por edhe në kopshtet e trëndafilave,) lajmëroi dukjen e saj. Dhe, meqë poeti s’pa njeri tjetër, duhet të ketë qenë jehona që kishte marrë përsipër këtë rol. E shprehur në këtë mënyrë bëhej më domethënëse vërtetësia, si dhe më tronditëse gjasa. Poetit, ato çaste, jo vetëm i qe tharë e rreshkur trupi nga uji i kripur, por më pas kishte ndier rrëqethje e të dridhura për t’u ridjersitur deri në aht. Veçse kësaj here, për një shkak krejt të kundërt me fillestarin. Sepse do të bulëzonin e, më pas, avullonin, palë të tjera djerse. Se, brenda asaj ore që ishte shtrirë si në përballje me diellin në gjumë, shtati i tij sikur kishte udhëtuar në të katër stinët e vitit i... zhveshur. Ja dhe tani Perëndesha. Kuptohet se pas kësaj, baraspesha mendore duhet të qe disi e prishur.

Gjithsesi nuk ishte aspak kundërshtuese ajo që syri i kapi atje tutje, valën që kish mbartur në gjirin e saj hyjninë. Por ai u ndërmend se ishte në gjumë dhe një gjendje e tillë s'duhej të merrej për e vërtetë. Pasi, jo rrallë, e rrejshmja e kishte zhgënjyer. Prandaj mënjanësia e tij ngrinte krye edhe kur ai jetonte diçka tërheqëse dhe të mirëfilltë. Rasti i tanishëm këtu grupohej. Por atij i duhej të shihte farin që të rrokte rrëmbimthi, se ndodhej në rërën e plazhit të Durrësit dhe jo në një breg ishulli të panjohur pranë një varke të shkatërruar dallgësh. Dhe nuk mund t'i shkonte kurrë ndër mend se kopja e kësaj hyjneshe (a vegimi) por tokësore ishte nisur e do të vinte njëmend pas ca çasteve. Mënjanë shakatë. Ai do të njihej me një franceze moshatare me të. Por, le të mos ua shuajmë miqtë e mi, kuriozitetin.

...Poeti dremiste si i nderur mbi varkë.

Por siç ngjet në botën e ëndrrave me çudira, barka u shndërrua në delfin. Se ky (e kush veç tij), e kish ndjellë e më pas, udhëhequr të dilte në sipërfaqe të ujit, të dërguarën e Qiejve, që... Nga deti, si nimfë doli,/ Krifën e saj,/ Si harpën me gishtërinjtë e lirës/ lëmonte.

I lindën këto vargje dhe s'qe në gjendje ta përcaktonte këtë krijesë: ishte hyjni, shtijni apo Hipertermi. Gjithsesi kënaqësia e zbritjes së saj, ndaj-afërsia e një lidhjeje shpirtërore me të, por edhe sepse u kap në befasi, e çoi në një pyetje si të fliste me dikë të kësajbotshme:

-Si ishte uji... Perëndesha ime?

"Kështu ndodh rëndom me të rinjtë tokësorë, -mendoi Qiellzana dhe shtoi: Ata i befason bukuria. U mpin trurin e u merr gojën se e kanë të zhvilluar ndjesinë e sedrës si një ngarkesë vetëtimore. Për ta shkarkuar disi atë tendosje, mbështeten (dhe bëjnë mirë), tek ajo tendë e gjerë me krahë, degë e gjethe, si dhe me një shtrirje të pamatë, me emrin NATYRË.

Ajo buzëqeshi dhimbshëm. Por për një arsye gazmore sa edhe tronditëse. Një shoqe e sërës kishte zbritur për të parë gjendjen ekonomike në këtë skaj të Adriatikut dhe ishte kthyer në Olimp, duke u shkrirë së qeshuri. Kur e pyetën për shkakun, me vështirësi shpjegoi se njerëzit në ato brigje ngriheshin për qumësht që më dy të natës dhe se fustanin e saj s'e kishin krahasuar me bardhësinë e reve në shtegtim, por me bardhësinë e qumështit të paskremuar.

Perëndesha e poezisë kujtonte se gjashtë shekuj e gjysmë më parë, kishte prekur bregun e kundërt të Adriatikut. Se dihet, që dy brigje janë po aq larg e të huaj me njëri-tjetrin, sa edhe zemra me trurin, që s'bëhen kurrë, as motra e as shoqe. Se diktator ishte dhe Çezari. Por njerëzit e bregut tjetër e vranë atë. Shprehja: **“Edhe ti, o Brut!”** mbërriti deri në Olimp, kolege, - do t'i thoshte ajo homologes së saj, kur dëgjoi krahasimin e fustanit me qumështin. Kurse njerëzit e bregut të kundërt të Adriatikut e mbushën me lot detin pas vdekjes së tij, në vend që ta vrisnin atë e ta çonin në Ferr. Dy brigjet janë larg si zemra me trurin, kolege.

Perëndesha e Poezisë, kështu i kujtonte, brigjet e Italisë, kur zbriti atëherë. Ishte koha e Rilindjes Europiane. Qendra e kish nisur me 'mision', për të takuar përfaqësuesin më tipik të kohës: Françesko Petrarkën. Duhet të linte tek ai porosinë për shërbimin që kishte marrë përsipër të kryente.

Kësisoj, atëherë si dhe tani, dy milje para farit, në shkëmb, një delfin i kishte rrëfyer bregun duke çarë tutje ujërat, i vetëdijshëm për 'misionin' e Perëndeshës. Një shkak më shumë ky, për të shfaqur atë hov gëzimi, që e kishte pushtuar të tërin. E quante fat të madh delfini, që në jetën e tij plot peripeci, të qëllonte t'i printe në udhët detare, jo një anijeje me aristokratë, as një suite

mbretërore, por një *Perëndeshe*, madje asaj të *Poezisë*. Pesha e saj, mbi shpinën e tij, s'qe veçse një përkëdhelje hyjnore.

(Tek hedh këta rreshta, më kujtohen dy vargje të një poeti në diktaturë, vlerat e të cilit i nxirrni vetë, kur t'u them se shkruante: **"Jam ushtar e ç'të jem më tepër!"**)

Por le të mos e prishim humorin me "delfin" të tillë të diktaturës dhe t'i kthehemi rrëfimit tonë.

- I bukur, Petrarka, - mendoi ajo, në kontaktin e parë me atë portret. - Por, po kaq i stepur përpara pranisë sime. Nuk më ndërmendet saktësisht pyetja që më bëri, veçse s'ka se si të harrohet që ajo, kishte lidhje me NATYRËN dhe mushkonjat bezdisëse për njerëzit. Afërmendsh që ishte dyplanëshe ankesa. Se me këto kandrra aristokratët e kohës, të zhytur në batakun e përtacisë, ngjasonin.

Gjashtëqind e pesëdhjetë vjet më vonë, Perëndesha me një tjetër poet do të përballej. Por kjo s'mund të qe aspak rastësore. Se, nuk zbritet nga Qiejt, pa ndonjë plan, a qëllim të planëzuar.

Gjithsesi, ajo vërejti se censura kishte bërë të vetën. "Me dhimbje do ta quaja kastrim në tru"-mendoi - se për pak gjë ka shpëtuar".

Petro e quajnë, por tri germa i paskan mbetur, që të vazhdonte si edhe Petrarka, të kapte nga kindi tjetër muzën, që përcjell shalli im i mëndafshtë. Por gjuha, kjo e pafre dëmton. Aq më keq kur është e shkruar. Më kot thuhet për dikë që rrëzohet nga detyra se "*i rrëshqiti këmba*", kur duhet pohuar se së pari atij i ka "*rrëshqitur gjuha*". Kjo aksiomë merr veçanërisht vlerë në këto vende humbëtira.

Prandaj Poeti këmbëu muzën e tij me një gjuhë të huaj. Veç të tjerave, edhe pse gaboi. Iu ngjit dhe ai korit të vargëzuesve, që u thurnin ditirambe... mjelëseve të lopëve. Dhe, meqenëse për to nuk gjeti asgjë poetike,

veç lodhjes dhe kënaqësisë së qumështit, që realizonte mjelësja e kooperativës, krahason gjoksin e rekordmenes me majën e “Kullës Ejfel” (!) Qeshni, o yje, me këto ‘shaka’ tokësore!

Kaq mjaftoi, që Petroja të merrte tatëpjetën e barasvlershme me rënien nga “Kulla Ejfel”. Pallati i propagandës tha se ai ishte dekadent dhe se po të që revolucionar, gjoksin e mjelëses mund ta krahasonte me bajonetat, që kurdoherë i kemi të hapura për armiqtë e vendit. Le të rezervohet i njëjti fat i atij tjetrit, që shkroi tekstin e këngës... nga buzët e saj *pikon era limoni*, kur duhej të thoshte *pikon era barut*.

Pas kësaj, emri Petro u cungua në Pet dhe po ta pyesje ishte shumë i kënaqur me kaq. Si i tillë ai mori një shtysë të re. Muza e tij u bë mësimi i *frëngjishtes*. Kësisoj, ai me shumë kënaqësi mbushte humnerën, ku e hodhi Atdheu. Se mund të merrej edhe si “haraç” për mësimin e gjuhës frënge.

Ja dhe shpërblimi. Në vend të dëftesës së laurimit, Zoti dërgoi nga qiejt Hyjneshën e Muzës e të krijimit.

Mendimi i parë për të ishte:

Dalëzotësi Poet! Do kurajë! Do t’ia jap! Do të paraqitem si muza e tij, ashtu siç dhe jam.

- Më pyetët për ujin, djalosh?

- Po, Perëndesha ime, - u përgjigj instinktivisht. Se, në veshët e tij ende ndërhyenin fjalët që ajo nuk i shprehu, por thjesht i mendoj. Dhe atij i ranë në sy fillesat. Se ato kishin germën “D” dhe ishin katër (DEUX). Pra: atë e kishte dërguar (Zoti). Poeti u mrekullua.

Asaj iu ndërmend vargu që kish lëshuar nga krahu i përtejme i Adriatikut dhe kindin e shallit të saj e pati drejtuar nga brigjet e Jonit. Gjashtë shekuj e gjysmë më vonë, Janis Ricos, si një radist i morsit, e kishte kapur mesazhin dhe e kishte deshifruar atë. Ajo fillonte me

vargun:

Lërmë të vij me ty, djalosh!

Dhe asaj, ndonëse i erdhi ky përforcim, nuk i shkonte ndër mend se ai do të bënte një poezi me këtë titull, madje, poemë. Por mund të ketë ndodhur dhe e kundërta: e dinte jehonën e kësaj poeme në ato brigje, prandaj për të qenë sa më pranë vendit, i pëlqente ta përdorte:

"Lërmë të vij me ty, djalosh" dhe shtoi natyrshëm: *"Të futem në brengën tënde"*.

Poeti hutohet për një çast, ashtu siç ndodh rëndom me njeriun e etur në mes të shkretëtirës. Ndërsa terezit me pikatore rezervën ujore në pagurin e tij, e befason oazi dhe ai, pi ujë të ftohtë sa i bie në krye.

-Nga e dini ju, brengën time, hyjneshë?

-Nga e di? Ju po ma thoni me frëngjishten tuaj.

-Frëngjishten time?!

-Po.

-Nuk po ju kuptoj, Perëndesha ime. Flisni më shkoqur!

-Mundohuni të kuptoni, djalosh. Unë përdor fjalorin tuaj të... kufizuar, në frëngjishten tuaj brilante.

Pas kësaj Poeti mendoi se duhej ndërruar tema. Atë e habiste fakti që ajo ishte tepër e kujdesshme të shprehej, jo pa një vetëcensurë, në përgjigjet e saj. Thua të kenë kaq forcë inkuizitorët tanë sa t'u shkojë mendja t'i kërkojnë shpjegime, pse shkeli ujërat territoriale, e të buburojnë për vizë-hyrëse, që t'ia pengojnë daljen nga ky vend-bunker, për kthimin e saj në Francë? Për Poetin ishte, më se e qartë, se duhej bërë me kujdes biseda. Dhe që të gremiseshin pasojat, lipsej që, nga kjo përballje kaq e bukur, jo vetëm të dilte si 'memec', por së pari, duhej edhe të hynte këtu si 'i shurdhër', nëse nuk e përballonte dot bisedën..

-Ah, të më falni, - tha. - Të më falni hyjneshë! Ju lutem të më ndjeni për hutimin...

Ajo buzëqeshi. Ai vazhdoi:

-Kjo vjen ngaqë tashmë u bënë vite që studioj frëngjishten... Mbërritja Juaj, Perëndesha ime, është fare pak, të thuhet se më befaso. "Bukuria juaj s'mjafton të pohoj se më sosi frymën. Jo për të mbetur i zalisur pa të, por për një rifrymëmarrje ndryshe pas një hukame, atëherë kur kënaqësia kthehet në dalldi. Dhe unë, i pamësuar me të, më duhet të kujdesem për baraspeshën e saj, pa m'u zënë fryma.

Ai ndaloi, për një çast, por kur iu duk se, ndonëse qiellore tjetra kënaqej pas komplimenteve, vazhdoi:

-Trupëzimi i së përkryerës po më shtang. Çudia u përktheka në atë që, vënia në jetë e ideale, qenka mahnitëse dhe paska gjasa të ketë këto trajta. Këtë hijeshi që, mijëfishon gazmendin.

Ajo buzëqeshi lehtë, nën një ndriçim hyjnor: Edhe pse ai po gabonte.

-Po, a nuk ke dëgjuar se, Qiellit (nuk desh të thoshte hyjnive) nuk i dëgjohen lëvdata? Kaq tokësore qenka bërë poezia në atë truall, sa të harrohet ku e ka burimin? Ashtu siç janë braktisur lulet, kurorat dhe blatimet? Kujdes, djalosh, me atë që do të shfaqet pas meje se është tokësore, por as ajo nuk do ta pranojë këtë gjuhë. Kujdes se po vjen bashkë me të ëmën!

Poeti, pas kësaj, duke e marrë për shtojzovalle, a Circën e Odisesë, vazhdoi ta miklonte disi i trembur:

-Me padurim pres të ngopem me ajër kur të puth dorën Tuaj të butë e frymëzuese, deri në harlisje.

Perëndesha, buzagaz, i zgjati, jo vetëm instinktivisht dorën, por edhe me një kënaqësi të veçantë. Çiltërsia me të cilën poeti i parashtrroi ato fjalë, qe tejet bindëse. Veçse ajo s'mund të mos sillte ndër mend shprehjen e Petrarkës, të cilën e kishte përkufizuar si false, kur ky i tha: "Lejomëni të puth rërën, ku ka shkelur këmba juaj!"

Deklarime të tilla ajo i neveriste ngaqë ishin kallëpë dhe s'u linin gjë mangët shprehjeve të të përkëdhelurve e të ashtuquajturve aristokratë.

Ndërkaq, diçka moskuptuese e prishi gjithë logjikën e bisedës. Qe një ndërkëmbim dialogu. Një ngatërresë në kohë dhe hapësirë.

-Ky det është fantastik, mama. Konstantja e tij dallohet lehtë edhe nga studenti më indiferent. Uji i ngrohtë: mëngjes-mbrëmje në një anë, si dhe kthjelltësia deri në tejdukshmëri e kristal, në anën tjetër, plotësojnë kurbën e një ekuacioni relaksues deri në pambarim.

Poeti mbeti i hutuar dhe shqeu sytë sepse i resiti padobishmërisht ato për të kuptuar se nga vinte zëri. Perëndesha kishte mbetur nën ndriçimin e saj hyjnor. Koha për atë e tek ajo, kishte ngrirë për t'u sfumuar e bërë një me... gjithësinë. Ndërkaq, biseda s'kish reshtur me mamane: -Ky det i tejçon edhe trillet e mia, mama. Se mbaj mend, në fëmijëri deti ishte i hirtë, i ftohtë... verior.

-Etret! - thirri poeti instinktivisht. Tashmë ishte i bindur se ligjërimi bëhej nga hyjnesha me mamane e saj. Por e gjitha kjo qe një pandehmë. Sepse, biseduesja s'mund të ishte kurrsesi, e zbritura nga qielli, përderisa ajo, nuk i lëvizte buzët. Gjuha e trupit të saj, ngjante tejet kallkan.

-Perëndesha ime! - mori guximin poeti të pyesë, - me cilin po flisni? Me mua apo me mamane Tuaj, të cilën nuk po e shoh? Apo, ndoshta, bisedën e keni bërë më parë? Jo këtu, por gjetiu dhe... ajo tani doli në rërë?

Asnjë përgjigje veç pllac e pllucose nga një palë këmbë femre të drejta-të drejta dhe një trupi sensual tej e ndanë të ftilluar dalëngadalë e me nge nga shkuma e valëve. Një ndërkëmbyeshmëri figure e Qiellores me Tokësoren. Vërtet mund të ndodhte kjo?

Që po fliste me një *Hyjneshtë*, këtë ai s'e vinte aspak në

dyschim. Se këmbëu me të e veç kësaj, pati fat t'i puthë edhe dorën, që ajo vetë ia zgjati. Tejçues vinte ai shalli i mëndafshtë, që herë-herë atij i dukej se e hidhte mbi krye me dorën e djathtë, të cilën e kalonte nga pas dhe sipër flokëve. Pastaj e lëshonte, në një valëvitje, me një harmoni, çuditërisht vizatimore, vetëm duke e mbajtur në njërin kind.

Qe një rit hyjnor ky, pas të cilit do të zhvillohej një fenomen natyror, apo thjesht një trill Hyjneshash? Dhe me gjasë: asnjëra e as tjetra. Por mbase një tejçim kozmosit mbi bisedat e bëra. Thua të ishte një kod tejdukshmërie protokollare, kur banorët e Olimp, rastësisht dalin në një vend i cili për Analet Olimpke, mban shënimin: 'Tejet të skajuar', apo 'Të vetë-skajuar' dhe grupohen te dosja 'Humbëtira'?

Kuptohet. Me këto nënvizime, ata duan të thonë se vende të tilla e... këto hapësira, janë 'Të vetë-përrjashtuara nga pjesa tjetër e Planetit. Gjithsesi, mbase për gjerësi fekste qëmtimi: "Mëkat! Aty ekzistojnë vende shumë të bukura! Por, pa gjasë, që kësaj përfilljeje t'i kthejë kryet dikush. Aq më pak Hyjneshat. Absolutisht i *Pari i tyre*".

Pas këtyre dikush e stërkali dhe ai u zgjua, disi i trembur. Nuk u shpërgjum siç do të dëshironte. Kjo do të bënte që t'i mbetej një zbrazëti në shpirt dhe aq. Se njihet nga të gjithë ajo çka ndodh me **ëndrrat**. Kur janë sidomos të tilla, gjithsesi do të mundohemi t'i risjellim në mend si diçka të bukur e mirakëndëse. Se nuk shohim dendur Hyjni në gjumë. Djaj po. E, madje, edhe me brirë. Prandaj poetin e përmendi, po ende e hodhi përpjetë një, vetëm një, ama ishte çurg stërkalash.

Kaq do të mjaftonte ta zgjonte këdo, qoftë edhe nga një gjumë hipnotik. Kjo shpërgjumje s'i linte asgjë mangët shqitjes me përdhunë nga një takim i cili, veç të tjerave ish: 'I bukur'-'i pazakontë'-'hyjnor'! Gjithsesi,

pas kësaj poetit i qe rezervuar, siç edhe e paralajmëroi, Hyjnesha: se do të ballafaqohej me një tjetër njëmendësi, po kaq të 'bukur', 'të pazakontë' e mbase edhe 'hyjnore'! Edhe pse shqitja e dhimbshme për poetin ajo do të qe njëherazi. Hollësisht duhet thënë se mendja e vjershëtorit qe fiksuar pas nimfës në ëndërr dhe ende donte ca **imta** të shtendosej e të shtopisej se si hov-prerë, ato çaste, ajo ish. Mund të çudisë këdo, por vegimi i tij me siguri kish xhiruar së prapthi në kohë dhe punonte me logjikën e fëmijës. Dihet nga shumëkush se dhe kur ia zëvendësuan me të njëjtën lodrën e humbur, i mituri sërish kërkonte me të qara të parën.

Ndërkaq, ne me logjikën e të rriturit, le të vazhdojmë rrëfimin tonë: Se ajo që ngutej të kërkonte falje, s'qe aspak perëndesha hipertermi, por mbase një kopje e saj (edhe pse krijesë e kësajbotshme ajo ish). Vërsnike e tij rreth tridhjetëvjeçare. Të qe binjake me të? E pamundur. Atëherë pse e ke bërë aq të ngjashme me hyjneshën apo për të mundësuar pështjellimin që dhe ashtu, tejet e trazuar, ajo ishte? Pse na vë të ngjisim shkallë të tilla, o Zot?

Kështu e arsyetonte me logjikë të ftohtë ato çaste të ethshme poeti, dhe do të thoshte me bindje: E pabesueshme: Sa i shëmbëllen kjo që shoh zgjuar asaj që pashë në ëndërr! Dhe atij do t'i kujtohej patjetër, skulptori i lashtësisë që bëri shtatoren e një femre, me aq dashuri, sa kur e përfundoi, nuk donte ta hiqte atë nga studioja. Aq më pak ta nxirrte përjashta dhe, kurrsesi, t'ia dhuronte tjetërkujt. Prandaj iu lut Zotit ta kthente në jetë atë mermer dhe Zoti përgjërimet e tij i mori parasysh: i dha jetë shtatores.

Diçka e ngjashme po i ndodhte poetit. Veçse, ajo që iu fanit, aty më parë, qe hyjnore dhe dërgoi shëmbëllesën e saj tokësore. E kundërta e skulptorit të lashtësisë. Mos

ndofta, çdo dy mijë a tre mijë vjet, një kapriço Qiellore bën të njëjtin lëshim për t'i dhënë jetë e gjallëri artistit? Se e sipërfaqshmja ishte e njëjtë me ..., të fshehurën.

Për tiparet? Mos më pyesni. Si mund t'i ndërmend ato, kur hyjnesha, gjatë gjithë kohës, shtatoren si edhe portretin e kishte të sfumuar me një shkumë tejendanë të bardhë? Me gjasë i krahasueshëm me vegimin e siluetës në pasqyrën që djersin nga avullimi. Se është pikërisht kjo që të dalldis dhe të bën të psherëtish e, në të njëjtën kohë, të ndiesh dhimbje. Po, nga ato dhimbje që sjell gëzim deri në mospërmbajtje. Të ndizet dëshira tejet magjike, për ta prekur, njëkohësisht me frikën se mos zhduket pas tentativës, si një zog i bukur në dëborë, të cilin edhe e ka joshur prania jote, sepse, për ty edhe ka ardhur, por fluturon sapo ti e zgjat dorën me dëshirën e mirë vetëm për ta përkëdhelur.

Tiparet më pyete? Po ti harron se unë isha herë si zogu në dëborë dhe herë tjetër si adhuruesi i tij, njeriu? Shkurt: herë 'gjuetari' dhe herë 'i gjuajturi'? Nën këtë terror 'sensual' u krye e gjithë biseda, që doemos, s'do të kishte fund tjetër veçse me superterror dhe sadizëm. Se kjo shqitje me përdhunë e bënte gjasën për ta emërtuar ndryshe. E, megjithatë, na duhet të pranojmë se ajo që shihte, s'i linte asgjë mangët asaj që iu zhduk nga ëndrra poetit, ndonëse përshtypja e saj për mua (po ta pyesje poetin ato çaste, siç bëjmë ne që hyjmë në ndërgjegjen e tij) do të thoshte se s'ngrihet më lart se krahasimi me një pirat. Pse të duket çudi! Shih fotografinë e Bodlerit në enciklopedi dhe do të bindesh se përshtypja e saj s'ka të gabuar. Hë? E kuptove tani? Se është për të ardhur keq, por e vërtetë. S'ka dhimbje më të madhe sesa: kur njeriu është në delir dhe ndien vështirimin; në mos përbuzës, shpërfillës të partnerit të tij. Në shpirt, mbetet vrugë nga ato që zor se shërohen. Kjo do të sjellë tërhuajtje. Këtu e

ka zanafillën përçudnimi i një lidhjeje, tatëpjeta e saj, aty fillon. Po a qe personi përballë tij, partnere? Assesi jo! A kishte gjasë të vazhdonte vegimi? Kurrresi jo! Vajza e porsadalë nga uji në rërë, natyrisht që s'ishte nimfë-deti e as peri ajo s'qe. Aq më pak të merrej për hyjneshë. Veçse shëmbëllente me të, gjë që bënte të zmadhohej hapësira e mëdyshjes. Dhe kësaj po t'i bashkoje frëngjishten, gjuhë me të cilën s'reshhte së kërkuari falje, kuadrit, i plotësoheshin gjithë elementët për ta quajtur të paktën: 'dublanten e Perëndeshën në... Tokë:

-Më falni, Zotni, më falni!

E pra, bëhu serioz, poet e zbrit në rërë. Kjo frëngjishtfolëse, tepër e sjellshme dhe e mirë-edukuar, me ngut, më shumë se një herë, po të kërkon falje, ndonëse disi e trembur. Apo falja e përsëritur të kujton fajin? E, ç'faj bëri ajo përveçse të mrekulloi me praninë e saj? Se më pas, gjithçka u ftillua. Prandaj: vuan shpirti dhe ankohet padrejtësisht, trupi. Apo ndodhi e kundërta?

Poeti fërkoj sytë dhe si hoqi edhe kapelën e kashtës, pati shumë kujdes të zbulojë flokët që i binin ballit. Disa shokë, për shkak të vështimit të tij, disi të ashpër, kur diskutonte pozicionin mospajtues me drejtimin e komanduar që përherë e më shumë vërehej se zhvillohej letërsia, por edhe meqenëse e dinin të gjithë se ai ishte një ithtar i thekur i frëngjishtes, gjuhë që në çdo rast do t'ia mbivlerësonte me argumente të reja, e krahasonin me poetin francez, Bodler. Qe një nga zakonet e letrarëve të rinj: Dikë që shkruante fabula për fëmijë, do ta quanin Ezop ose La Fonten dhe, po me këtë logjikë, grupi do të kishte Bodlerin, Mopasanin (dhe mos qeshni) dhe Molierin e Hygonë. Vetëm Shekspirin nuk guxonte kurrkush ta zinte në gojë. Në të vërtetë epitete të tilla, veç shakasë, kishin edhe pozivitetin e tyre. Mbajtësi i ... kësaj nofke të themi më mirë, e synonte korifeun. Kësisoj,

ajo që niste si me shaka e tejet mikluese, vazhdonte më pas me ledhatim joshës që imitimim fillestar e bënte më praktik në mënyrën e të parit të dukurive, thellimi i së cilës kishte dobishmëri të njëmendtë.

Po a nuk kishte prekur edhe fusha të tjera kjo mani? Kazus Klei (Muhamet Ali), imitohej nga gjithë fillestarët e boksit, po kështu edhe Xhon Frejzer, për të mos folur pastaj për Pelen e Maradonën. Por le t'i kthehemi poetit tonë. Sepse ai ishte e natyrshme të mos e pranonte këtë. Veç të tjerave, s'ishte aspak e vërtetë. E vetmja përkese me poetin e Francës qenë poezitë e tij lirike-tragjike të pabotuara, si edhe vizioni i tij mistik mbi Universin. Por këto i përkisnin një rrethi tepër të ngushtë shokësh që, gjithsesi, poeti për t'u mbrojtur nga ndonjë 'sy vigjilent sigurimsi', shmangej duke imituar me flokët e rëna ballit, një tjetër poet rus-sovjetik: Sergej Esenin. Ndaj këtij lloj rebeli të diktaturës, nomenklatura ndihej në vështirësi t'i kushtonte vëmendjen e duhur, sidoqoftë.

Përmbledhtas, poeti, si rregulloi balluket, që i binin ballit, në një hutim tërësor dhe si ndonjë dudum, do ta quanin me shpoti shokët po të ishin aty e ta shihnin, madje ndonjë humorist do të shtyhej edhe më tej e do të thoshte "si në radhën e qumështit, do t'i drejtohej francezes:

-Ju jeni Perëndesha Hipertermi, zonjushë e bukur? Po mamanë Tuaj, për të cilën edhe dëgjova aty më parë se flisnit, kur unë isha ende në ëndërr dhe ju, sigurisht, në brendësi të detit dhe nuk e pashë nga shkoi, ashtu si edhe tani që më duket se u tret në ujë, ku e paskërkoni?

-Jo, ç'thoni kështu, zotëri? Ç'është kjo tirandë llastiku?

Vajzën e hutoi pyetja, gjë që i dha mundësi poetit t'i hedhë një vështrim peshues, nga këmbët deri te koka, si të qe në një tjetër kohë e po kështu në një tjetër vend, i ngjashëm me tregun e skllevërve. Për atë *robinë*, atij si

pirat që ishte, i kërkohej një vlerësim, apo..., një pazar.

Gjithsesi ai kundrim e shtendosi rrethanën e krijuar. Tjetra e kapi shpejt gjendjen. Ajo, përveç që mori një pozicion të tillë, ku i dolën më në pah format tërheqëse trupore, si ndonjë top-modele, vuri buzën në gaz si përpara aparatit fotografik dhe tha e shpenguar: - Hë! Të pëlqej? - ose pas një lëvizjeje: - po tani? Mos ndofta dukem më mirë kështu? - se ndiente përkëdheljen e vështrimit mashkullor. A kishte të drejtë? Po. Më në fund, poeti, u bind në vlerësimin e tij. 'Nimfa' me të cilën po këmbente, s'qe vetëm tërheqëse dhe disi çapkëne, por ajo qe e njëmendtë, Tokësore. Trupi i saj kishte dy "gjethe fiku" në pozicionet delikate të gjoksit dhe shallin e ibërshimtë me të cilin qe mbuluar e treta.

-Atëherë, fatmirësisht s'qenkam në ëndërr, zonjushë e bukur, - munda të shqiptojë, jo pa lëngëzim.

-Faleminderit për komplimentin, zotëri dhe lejomëni t'ju siguroj se jeni, 'i zgjuar', - tha ajo me dy kuptime për të vazhduar, - po shprehni konsideratat tuaja me një frëngjishte për t'u admiruar. Mos harroni veçse, po flisni me një,... - dhe ajo buzëqeshi përpara se të bënte të njohur specialitetin e saj në fushën e fizikës së 'grimcave nënatomike'. Por hoqi dorë në çastin e fundit, ngaqë iu duk krejt pa vend një gjë e tillë dhe e mbylli me një fjali fare të thjeshtë: - Po flisni me një intelektuale, zotëri.

Poetit i kishte dalë plotësisht gjumi, por jo edhe fiksimi për pyetjen. Prandaj dhe këmbënguli që ajo të mos e anashkalonte dukurinë, nëse kishte qenë e vetme në det, apo vetë i dytë.

-Po mamaja, zonjushë, ishte me ju, apo jo?

-Ishte! - u përgjigj ajo prerë dhe jo pa vënë buzën në gaz e, po aq me atë qesëndisje të diktuar nga ai ngulmim aspak etik e tejet naiv. Sepse ajo mendonte që tjetri s'kishte asnjë të drejtë të bënte pyetje të tilla. Megjithatë,

një zë i brendshëm i tha ta toleronte këtë të panjohur të çuditshëm. Ishte 'lëshim' apo... 'trazim'? - Po këmbeja, - shtoi. - Qe një intimitet me nënën time brenda thellësisë, dhjetë-pesëmbëdhjetë metra në det. Edhe tani me të isha, por ajo iku disi më përpara.

Pastaj një tjetër zë i brendshëm u bë nxitës që ta shigjetonte ca, se iu duk zbavitës shkëmbimi me ndonjë kalambur. Karremi ishte hedhur tashmë: gjë që ajo ende s'e ndiente.

-Çadra jonë është ajo e parafundit, - dhe me lëvizjen e kokës i tregoi drejtimin, për të shtuar me ironi: - në qoftë se keni merak ta dini. Se, nuk besoj që ju duhet për të mbushur formularin e mamave të dala nga uji dhe të bëni diferencën me ato që kanë hyrë në det.

Por, për poetin, e gjitha kjo qe si të fliste me valën, që luante ende me këmbët e saj të drejta-të drejta dhe, që sërish po bënin plluc-plluc, ngaqë hidhej për t'u shkundur, në rërën e lagët dhe nuk ecte mbi ujin pranë saj për të bërë pllac e plluc.

-Pra mamaja ekzistonte, - tha ai si i fiksuar.

-Ku?

-Në ëndrrën time, zonjushë, e ku tjetër.

-Çudi! - tha fizikania dhe rrudhi buzët, - unë kujtoja se ishte vetëm nëna ime, - ironizoi ajo.

-Ai që duhet të habitet, në këtë mes, duhet të jem unë dhe jo Ju, zonjushë e singertë.

Për atomisten 'sinqeriteti' këtu ishte krejt i pakuptimtë, si të qe një,... grimcë e panjohur futur nga një dorë po kaq mospajtuese me të dhënat e programit për të ngadalësuar eksperimentin e për pasojë edhe përfundimin.

Njëmend një arsyetim i tillë nuk mund të themi se qe thjesht metaforë e, aq më pak, hamendësim. Se, atomistja, nuk mund ta dinte se kjo 'grimcë',... ishte pikërisht ajo që i shërbente poetit. Hallka e lidhjes së gjërave. Për të

merrte të tjera vlere qenia ose jo e... mamasë së francezes në det. Fakti që biseda ishte bërë në thellësi të tij, madje dhjetë-pesëmbëdhjetë metra, shtoi kësaj dhe erën që frynte e, megjithatë, poeti e dëgjonte, madje në ëndërr a gjysmë i përgjumur, s'mund të shpërfillej, absolutisht.

-Është për t'u habitur! - tha poeti, duke mos qenë në gjendje të jepte ndonjë shpjegim dhe ta kthente në humor të gjithë dyshimin që s'qe aspak lajthitje: - Ende më duket vetja sikur jam në ëndërr. Që të bindem për të kundërtën, domethënë që s'jeni fantazmë se e tillë u shfaqët në jetën time, ndonëse jeni një peri prej vërteti, bëmëni një favor ju lutem!

-Me kënaqësi, zotëri. Se e ndiej që duhet t'Ju dëmshpërblej prishjen e gjumit.

-Të gjumit?! Aspak, zonjushë e bukur.

-Po të kujt?

-Të ëndrës, po. Pafundësisht, po. Deri në iracionalitet, po. Po dhe po.

-Ashtu? - dhe përgjigjja e saj qe tejet shpotitëse, - pse ç'po ju bënte partnerja juaj në gjumë? - dhe fizikania ia shkeli një grimë syrin ashtu si... midis shokësh.

-Asgjë, zonjushë binjake e asaj që m'u shfaq në gjumë. Absolutisht asgjë dhe... absolutisht shumë.

Ajo qeshi me këtë rrëmujë logjike e, madje edhe prishjemendje të çastit.

-Mirë, zotëri. Këtë, tashmë e kuptuam. Më tutje?

Po. Ndonëse e kam të vështirë të flas kaq me ngut për të.

-Pse? Keni frikë?

-Absolutisht jo!

-Atëherë ç'keni?

-S'di nga t'ia filloj.

Ajo buzëqeshi dhe sërish i shkeli syrin në konfidencë.

-Nga të doni. Vetëm nga koha, jo. As për ujin e detit

mos pyesni. Lëreni natyrën.

-E shihni që jeni më shumë se binjake me të?

-Jo, pse?

-Se pikërisht këtë pyetje prej budallai i bëra: *Si ishte uji, Perëndeshë?*

Tjetra u shkri së qeshuri. Në të dyja faqet formoheshin gropa.

-E shihni? Ju keni veti të përbashkëta, sa edhe të kundërta, me dyjaren tuaj. Ma larguat atë që doja të shprehja. Kurse nga ajo, dëgjoja edhe ato që asaj i vinin në mendje, por nuk donte t'i thoshte.

-Ashtu?! - u bë serioze francezja, - në ç'mënyrë?

-Fare thjesht. Ajo e vërtiste atë shall mëndafshi të cilin, siç po më duket, jua paska dhënë juve, aq shumë ngjan dhe, me të... tejçonte porosi, por edhe... biseda.

Francezja dëgjonte e përqendruar. Tek ajo, që deri tani gjithçka fliste për një qëndrim të përkorë e disi thumbues, befas ngriu dhe iu zu fryma. Karremi, me sa duket, ishte hedhur nga poeti dhe i kishte mbetur në grykë.

-Kurse ju, zonjushë e nderuar, e keni shndërruar në një fund krejtësisht të panevojshëm për linjat tuaja femërore, për të cilat deti dhe më pas edhe unë, si pirat i tij, siç edhe keni menduar për mua, do të ndihesha keq.

-Më falni një minutë, përpara se të kaloni më tutje në argumentet tuaja disi të çuditshme.

-Pse?

-Sepse unë nuk ju quajta *pirat*, - protestoi butë ajo.

-Po, zonjushë e nderuar. Se jua ngriu formimi juaj, gjë që s'ju pengon asgjë ta shkrini dhe ta thoni.

-Është plotësisht e vërtetë. Por njeriu...

Dhe poeti nuk e la ta vazhdonte shprehjen. Se, në mos ngaqë ishte ende nën 'rrezën e ëndrrës', nga përvoja e tij idhnake, nuk duhej ta lejonte francezen të shprehej

si në 'botën e lirë'. Tjetra përpara saj, qe hyjneshtë dhe e vetëkontrollonte gjuhën. Prandaj ai s'mund të pajtohej me biseda që mbartnin gjasa keqkuptimesh. Mendimi i francezes formulohej pak a shumë kështu: *Njeriu nuk gjykohet për atë çka ai mendon, por për atë që ai shpreh.*

Domosdo, francezja nuk e dinte që në këtë rërë, ku kishte shkelur dhe hidhte e priste e shpenguar kalambure, edhe kokrrizat kishin veshë dhe akuzonin se robi, jo vetëm që dënohej për çka mendonte me vetëdije, por edhe për atë që ashtu i kishte thënë rradakja e gjyshit të tij dikur, a e një pinjollit të sojit të vet të largët.

Këtu francezja dallonte mjaft nga e ngjashmja e saj në ëndërr, e cila qe e kujdesshme me vetëpërmbajtjen bisedore si të kishte zbritur në bazë një punonjëse e lartë e *Agjitpropit*. Parë nga ky kënd *hyjnesha* ishte më Tokësore, kurse francezja ngjante tejet më Qiellore dhe poeti këtë ndërkëmbyeshmëri e kuptonte. Kjo qe dhe arsyeja që nxitoi të këmbëngulë, kësaj here, jo nga naiviteti, por nga instinkti vetëmbrojtës.

-Zonjushë e bukur, ju lutem silleni atë shall të mëndafshhtë në formë ovale siç edhe po e bënit, dhjetë a pesëmbëdhjetë hapa brenda detit.

-Është urdhër, zotëri?

-Ç'thoni kështu, bukuroshe?! - dhe pas një grime: -Mendoni se e kam atë kurajë sa t'ia lejoj vetes të urdhëroj një krijesë si ju për një veprim jashtëvullnetor, a për një kapricio?

-Në mos qoftë kjo e dyta, çfarë është? Dëshirë?

Ai tundi kryet sa majtas-djathtas:

-Më shumë.

-Kënaqësi?

Ai sërish tundi kryet kësaj here ndryshe.

-Mbase mirakëndje?

Ai s'foli, por përveshi buzët.

-Edhe për këtë s'jeni i bindur?

Ai për të tretën herë tundi kryet, me të cilën as e mbështeste, por as edhe e kundërshtonte.

Për të dy pluskonte diçka e fshehtë e diç e panjohur, lodronte, që s'kishte të bënte aspak me çmbëshjelljen e linjave të poshtme nga ai shall mëndafshi edhe pse tek ai shall, diç mistike fshihej. Jo nën të. Mbase mbi të. Për poetin, ajo ngjante me porosinë që spartanet u dorëzonin shpatën djemve të nisur për luftë. "*I etas, i epitas*", siç thuhej në goftë se e mbante mirë mend.

Për francezen ende s'e dimë. Vështrimi i saj zhbirues diç studionte, por ajo e fshihte qëllimin me ëmbëlsinë e buzëqeshjes. -Ta sjell si dallgë?

-Po, zonjushë.

Dhe ajo, pa ia ndarë shikimin, hoqi karficën, me të cilën sa e kishte ngecur atë shall mëndafshi dhe e vendosi mbi flokët në ballë. Me dorën e djathtë e pruri pëlhurën e ibërshimtë të kapur në një kind me një hark mbi krye, në atë mënyrë që pjesa tjetër dhe sidomos kindi, të formonte dallgë e atë d i a g r a m ë sipas së cilës, vërtetohej *E k u a c i o n i M a x w e l l*. (Dora lëviz përpara valës, domethënë pararendëse e së ardhmes. Lënda që ecën mbrapsht në kohë).

-Kështu? - tha ajo dhe i ndriti buzëqeshja. Për poetin kishte marrë një pozë vizatimore dhe disi të ngrirë që e shkrinte e mbase edhe e ëmbëlsonte buzëqeshja, e cila i kalonte caqet e portretit të saj oval, sepse tentonte të shndërrohej në aureolë.

Po. Mbase këtë donte francezja. Se qe fizikane dhe e kuptonte fare mirë se ç'kishte ndodhur te ky djalosh. Ai s'e kishte fare mendjen të shihte vithet e saj e as kofshët e drejta sensuale e aq më pak vendin e tretë, mbuluar me gjethe fiku. Këtë përfundim ajo e nxori sapo lëvizi me një lojçakëri koreografike dhe vështrimi i poetit ishte

përqendruar te valëvitja e shallit të saj të ndritshëm. Sigurisht, jo për të matur vrullin e as dendurinë e këtij shkëlqimi, sa përkëdhës po aq dhe farfuritës. E as për të parë gropëzat në faqe.

‘Shqisa e gjashtë’ i qe shfaqur në ëndërr dhe ai e kishte kapur bisedën e saj me të ëmën dhjetë hapa në brendësi të detit. Kjo qe për fizikanen: e *j a s h t ë z a k o n s h m e*.

-Si dukem tani? - pyeti tek vazhdonte të mbante të njëjtën pozë, por nga një kënd i kithët. Tejet ngacmues.

-Si nga Normandia, zbrazti nëntë germa si për një ylber të veçantë, se kishte dy ngjyra më shumë, të cilat ishin dy sytë e tij që shprehnin vendosmëri.

-Kjo është fantastike. Përveç që është *abstrakte* dhe konkrete në të njëjtën kohë. Si është e mundur që i keni rënë në të? Mos vallë jeni falltar e mbase edhe *iluzionist*?

Poeti s’foli. Atë çast, u afrua peshkatari dhe dy të rinjtë u mënjantuan ca, që ai të bënte punën e vet me varkën a lopatat e së cilës i futi nën të. Rregulloi edhe diç tjetër dhe, si e ktheu barkën brinjazi, për kullim, u largua.

-Në shqip *iluzionisti* (i skenës)...

Ajo tundi kryet që ta miratonte.

-quhet *ndriçimtar*.

Ajo sërish lëvizi kokën. Poeti vazhdoi:

-Sa mund të jetë ky peshkatar iluzionist, aq kam gjasë dhe unë të jem prestidigjitor apo mashtrues. Absolutisht fallxhor.

Tjetra, ndërsa dëgjonte, merrej me flokët e saj: t’i shkrihonte e t’i praronte që, çuditërisht. ngjanin me të hyjneshës si fijet e mëndafshita nga i njëjti shkul. Si rrallëherë ajo e kryente këtë veprim duke u ndier tejet e mikluar nga vështrimi i poetit, që ia hovëzonte trupin. Se e lidhur kjo me idenë që, te tjetri qe shfaqur ajo për të cilën dhe kishte studiuar madje, eksperimentuar laboratorëve, për vite e vite studimi në gjurmët e

pararendësve të saj, qe konkretizimi i ideale.

Poeti, nga ana e tij, vërejt se ai trupi i brishtë femëror, s'kishte vetëm flokët e hijshëm e as portretin tërheqës me tipare disi tinzare, por sidomos vështrimin që harmonizonte buzëqeshjen e cila sikur lodronte: midis habisë dhe vëmendjes. Se kjo e fundit shndërrohej në vëzhgim dhe për sytë e poetit, një gjasë e tillë është karakteristike e piktorëve ose njerëzve të shkencës. Ndryshe s'mund të shpjegoheshin shigjetat e atij vështrimi zhbirues.

Nga ana e saj, francezja nga Normandia, gjykimin për tjetrin e kishte kaluar në tri përkufizime. Në fillim 'pirat'. Më pas 'misterioz' dhe së fundi 'falltar'. Tani ajo i kishte hedhur poshtë të tria këto përcaktime. Por mbase diç tjetër ai duhet të ish. Po çfarë?

Kjo, sigurisht, mbetej për t'u parë. Vajza fizikane, ashtu siç nuk ngutej në nxjerrjen e përfundimeve apo sintezës, nuk kishte pse nxitohej edhe për të kundërtën. Aq më pak të rrëmbehej dhe kurrresi t'i binte shkurt analizës së dukurisë. Mëdyshja e saj qëndronte në atë që: a, e zotëronte ky frëngjishtfolës *sh q i s ë n e g j a s h t* ë apo ishte krejtësisht i pavetëdijshtë për të?

Dhe fizikania, ato çaste do të donte pa masë të kishte studiuar për psikologji pak më shumë se disa seminare të shkëputura. Gjë kjo, që i përkiste së ardhmes. Tani, tek e shihte këtë djalosh, gjykonte se ai, me atë naivitet në të folur, vështirë se dinte e aq më pak ndiente, se ç'kishte arritur në një gjumë 'hyjnor' do ta quante ajo plot admirim për këtë fat të zbritur nga yjet. Për të ishte klasifikuar si mëkat mendimi i njohur, jo vetëm në rrethet akademike-shkencore, por edhe të fushave të tjera, fakti se shumë njerëz largohen nga kjo botë, pa i kuptuar aftësitë e tyre. Dhe me këtë gjasë asaj iu ndërmend rasti tipik i një komediografi. Ky përmendej më shumë për të

argumentuar atë, kur talenti shfaqet si dhunti natyrore; ku elementët e shqisë së gjashtë zbulohen pak përpara se njeriu të lërë përfundimisht këtë botë. Autori pa një komedi të tërë në gjumë, të cilën e shkroi për tri ditë dhe jetoi vetëm tre muaj pas vënies në skenë të saj brenda një sezoni.

Krejt ndryshe kishte ndodhur me Fernandelin, i cili merrej me financë dhe se u desh të pushohej nga puna që të provonte aktrimin dhe të arrinte krenajën e tij. Njeriun që kam përballë në këtë kategori e rendis. Por ajo kishte të drejtë kur thoshte se duhej të studionte më shumë psikologji. Sepse gabohej për njeriun përballë. Ai qe poet dhe ishte, më se i vetëdijshëm për të. Sa i përket 'shqisë së gjashtë' s'u linte asgjë mangët autorëve që trajtonin këtë dukuri në libra të veçantë, paçka se për të, vështrimi i francezes, tek shtrydhte krifën, me gjasë, mund të përkufizohet në atë që folkloristët do të thoshin:

"Shihe-shihe dreqin, qenka i lezetshëm!" Apo: "Mjaft i këndshëm qenka!"

Poeti, si të përgjonte saktësisht këtë çast, si një djalë çapkën me pistoletë uji, e "qëllon" për ta "asgjësuar": - Mopasani, zonjushë e bukur, ka lindur në Etret, qyteti juaj i fëmijërisë. Kështu?

-Ekzakt!

-Ai, zonjushë e shkencës, e kam mirë?

-Ekzakt!

-Se mund të ishit edhe e artit, pikturës apo skulpturës. E kam mirë?

-Mbase.

-Jo, mbase, por ekzakt. Dhe e dini pse?

-Ju, do ma thoni, - pohoi francezja, jo se nuk e dinte, por i pëlqente një vërtetim siç ndodh me sintezën e një burimi tjetër studimi.

-Mirë atëherë, dijeni se si shkencëtarët, piktorët

a skulptorët, por edhe artistët në përgjithësi, e kanë vështrimin të përqendruar dhe vëzhgues. Këtu hyjnë edhe disa *'të tjerë'*, por për modesti s'po i them, ngaqë në ta bëj pjesë dhe unë, gjithashtu.

-Ku? - buzëqeshi francezja.

-Te *'të tjerët'*, zonjushë.

Dhe fizikania nga Normandia e kuptonte, tashmë, se njeriu i mbështetur te dërrasa e varkës, gjysmë të përmbysur, me gjasë ndryshonte nga të tjerët. Madje kryekëput. Atë çast ajo mori një vendim me rëndësi: s'ishte dhe aq e domosdoshme të studionte psikologji sesa t'i jepte vlerën e duhur njeriut, me të cilin rasti e solli të takohej e t'i kushtonte po atë seriozitet që u blatonte edhe eksperimenteve të saj. Dhe befasi iu ndërmend një bashkëpunëtor italian. Ai tregonte se po kthehej nga Odesa me një vapor të vogël. Kur mbërritëm në Bari, u kujtua të pyesë një nga personeli që shërbente: - Udhëtimi që i shkëlqyer edhe pse kjo anije ishte fare e vogël në krahasim me atë që shkova në Odesë.

Tjetri kishte buzëqeshur:

-Keni të drejtë, zotëri. Anija jonë është e ngarkuar me dinamit, prandaj. Tashmë ura që hedhur dhe italianin nxitoi ta kalonte atë dhe të zbriste menjëherë në tokë i tmerruar.

Fizikanes, pas kësaj, natyrshëm i erdhi për të qeshur. Qe një vetëqesëndisje. Jo aq për ngjashmërinë e gjasave. Se ato qenë: njëra-vjegë e tjetra-hallkë. Por për pangjashmërinë e pakrahasueshmërinë e pasojave. Se dëmi i së parës (mos, o Zot, në rast shpërthimi) do të qe tepër i rëndë por..., gjithsesi lokal. Ndërsa këputja e një hallke në fizikë, do të shkatërronte të gjithë zinxhirin e kësaj shkence. Dhe për këtë s'duhej lutur Zoti të mos ndodhte, por mbase për të kundërtën: që të ndodhte, madje sa më parë, megjithatë. Kishte ardhur, natyrshëm,

çasti që të mënjanonte shpërfilljen dhe gjuhën me shpoti, e cila, çuditërisht, iu duk se qe e detyruar të përshtaste: një të folur më shumë ngacmuese dhe me karakterizime jo dhe aq të ujdisura: ‘pirat’, ‘misterioz’, a ‘falltar’. Se të tria këto epitete jo vetëm që s’e rrisnin shpejtësinë e komunikimit, por përkundrazi. E pengonin atë si tri parzmore të cilat dialogun e shndërronin në *dyluftim* midis të saponjohurve. Aq më keq kur këta janë të sekseve të kundërt. Kurrësi s’duhej në rastin në fjalë kur biseda, me gjasë, parakushtin e kishte të ngrihej në nivelin e një vozitjeje virtuale, kur herë njëri dhe herë tjetri të merrte rolin e varkëtarit. Mbase ky duhet të qe shkaku pse ajo mendoi se i përkiste asaj roli i lundërtarit në këtë rremëtim. Kësisoj, tanimë, dialogu i njëmendtë do të rrafshonte brigjet e panevojshme dhe do të rridhte në një shtrat më të qetë. Përfundimi? Do të ngjisnin kreshtën e këtij ‘mali’, ku i grishi me bujari rëra në bregun e detit.

Era s’reshtte së fryri dhe francezja, si u largua cazë, kapi njërin kind të shallit dhe e ngriti dorën në lartësinë që ajo të valëvitej pas kokës së poetit. Coha e ibërshimtë ia ledhatonte zverkun tek përhidhej dhe, ashtu siç e kishte paramenduar ajo, poeti e kapi dhe e mbështolli fort në dorën e tij dhe e puthi. Pastaj, me një zë si pëshpërimë, tha: - Kur e puthura vjen, ajo duhet nderuar... po me ato mjete.

Era, që tashmë ishte shtruar, me gjasë qe shkaku që tjetra të mos dëgjonte, ose të bënte mosdëgjuesen, se s’qe më shumë se një hap larg, de!

-Për çfarë mjetesh e keni fjalën, zotëri?

Ai qeshi dhe sërish po me të njëjtin ton duke shtuar kësaj radhe edhe ca nota të thekura të të përvëluarit, tha:

-Për mjetet e puthjes, bukuroshe, e për çfarë tjetër?!

-Pyesni nëse kam shall tjetër?

Ai ia plasi gazit. Ajo ose vërtet s'dëgjonte, ose luante shurdhen e njëmendtë. Por, sido që të qe, ai e merrte për të rrejshme 'shurdhësinë' dhe se diçka tjetër ajo, nga ai, priste. Dhe... Poeti vërtet ra në grackën e saj. Ai, me dorën e majtë, i bëri shenjë të qasej më pranë. Dhe ajo, ndonëse atë nojmë priste, s'u afrua menjëherë, se deshi ca imta kinse për të mbështjellë disi cohën, me të djathtë e saj dhe, në vend që të hidhte atë hap të munguar, vendosi njëren shputë të këmbës pranë tjetrës, si të donte ta maste distancën me këtë çapitje, a këtë... 'Hap kozmik'! - do ta quante poeti, kur ajo, më në fund, mbërriti tek ai, pas një duzinë këmbësh. Dhe hundët e tyre thuajse u puguën, ngaqë ishin ballë për ballë. 'Hap kozmik'! Por kësaj here jo për francezen, por për poetin të shkonte tek ajo. Se ai ishte me milimetër larg dhe s'lëvizte dot.

Era, gjithsesi, bënte të sajën. Ajo valëviste pas qafës së poetit, cohën si sharrën ndër pyje, që dy njerëz e tërheqin secili nga vetja për të prerë një lis. Asnjëri nga të dy nuk ia donte mortjen tjetrit. Aq më pak në këtë mënyrë. Fizikania s'kishte arsye. Përkundrazi. Simpatinë nisi t'ia shfaqte qoftë edhe me këtë... kolpo a katekule. Poeti kurrsesi. Por ai patjetër që do të ndërmendte ç'kishte lexuar një natë më parë, gjë që jo vetëm binte ndesh, por e përmbyste qëndrimin afrues e, madje, disi miklues të deritanishëm. Thua të qe paravendosur për poetin një fund i ngjashëm tragjik, veçse me ndryshimin e 'Perëndeshave' nga "Hipo në Hipertermi?

Ajo ia kishte ngulur vështrimin dhe i tha me të njëjtën pëshpërimë:

-Më pyetët a kam shall tjetër, zotëri, apo deshët të zonjën e shallit ta nderonit po me ato mjete?

Dhe francezja ngriu në një përgjigje të kotë. Se, në çast, poetit iu ndërkëmbye figura. Silueta e saj u zëvendësua me atë të ëndrrës: Perëndeshën Hipertermi.

Dhe poeti dëgjoi se ajo po i thoshte:

-Truri ynë, djalosh, ndien objekte edhe kur ato nuk i kemi të pranishme.

Urdhëro, të lutem, e fol pas kësaj. Kjo ndërliksje figurash a nuk mbështeste njëmend, pikërisht këtë tezë, që fizikania sapo formuloi?

Francezja, pas kësaj, u ndie liriplotë dhe nisi të ndërgjegjësohej se një ndjenjë tejet drithëruese, që deri tani lëvizte në mënyrë të papërcaktuar e, madje, kaotike, në shpirt e sidomos në vetëdije, po merrte një sens të caktuar me një hovëzim marramendës.

Ky skajim po e trazonte deri në tronditje. Dhe ajo, një ndjenjë të tillë po e provonte për herë të parë pas gati, më shumë se një dekadë, që i qe përkushtuar tërësisht fizikës së grimcave nënatomike. Me sa dukej kishte ardhur koha të merrte në shqyrtim këtë 'fushë të pastër magnetike', siç do ta quante ajo dhe... të mos e linte t'i shpëtonte nga vëmendja. Dhe jo vetëm. Se ishte zemra që kishte nisur një ritëm të ri fërgëllues. Se ajo vërtet qe një shkencëtare dhe ai një poet pasionant qe. Ishin të dy të rinj, paçka se të zhveshur si dy trupore dhe për ca çaste, vetëm për ca ama, të ngrirë si përmendore.

Për poetin qe i kuptueshëm rezervimi i hapjes. Madje tepër e rrezikshme me një të huaj.

Për francezen shkaku i qëndrimit-lapidar, qe krejt i ndryshëm. Ajo ndodhej përpara një zbulimi aspak shkencor, por mbase biografik, për zhvillimin e njëanshëm të veprimtarisë së saj. Për herë të parë ndjeu se në trupin prej mishi e kocke, lëvizte gjaku i një tridhjetëvjeçareje, dehës si vera. Prandaj ajo vërejti, jo pa kënaqësi e kujdes se, nën atë ballë ku binte floku i zi i poetit, ishin një palë sy të qeshur, të butë, e pak gri që, çuditërisht po e joshnin me ëmbëlsinë e sidomos veçantinë e tyre deri në... dalldi, që një Zot e dinte se si

do ta zhbënte. Veçse... Në ato ninëza një dritë të vogël në shuarje, francezja dallonte. Nuk e kuptoi menjëherë shkakun atomistja. Por dhe nuk u ngut ta bënte këtë. Asaj, hëpërhë, i mjaftonte ledhatimi i atij vështrimi ngasës e tundues deri në lajthitje. Dhe doemos. Nga një botë tjetër ajo kishte mbërritur, ku në diskutim s'ishin, fjala vjen: cila është pjesa më e ftohtë e shpirtit njerëzor. Se me të ajo, pa e kuptuar, po përplasej. Aq më pak të dinte shkaqet dhe assesi mbrojtjen prej tyre. Prandaj dhe ndiente... vuajtje. Në qarqet ku ajo punonte mëkohej me çështje të një lloji e natyre tjetër. Si: ç'ka qenë kozmosi përpara *Bing Bengut*? Apo: ç'është "*teoria e fijeve*"? Ose: a fshihet sekreti i kozmosit në *brimën e krimbit*?

E gjora fizikane: Nuk kishte asnjë gjasë të fantazonte se 'Diktatura' zhbironte dhe... '*brimën e krimbit*' për të zbuluar veprimtarinë e ashtuquajtur 'armiqësore'.

Tani, lexuesi i dashur e sheh sa e thjeshtë është? Ja pse bebëzat e syve të poetit vërtet kishin ende ag. Por ai nuk paralajmëronte zbardhjen, lindjen e diellit, vesën e mëngjesit, çeljen e bimëve, cicërimat e zogjve. Jo. Dhe kjo jo duhet të jetë e fortë, bërtitëse. Ata sy e ai vështrim, ndryshon nga i juaji, zonjushë. Se te ju është drita, tek ai, një perde e bardhë si ... drita. Por ajo nuk lejon që vështrimi ta përshkojë tejmbanë atë. Oh! Po kjo është e rrejshmja, zonjushë nga Normandia. Dhe ju, kurrsesi nuk do të mund ta kuptoni se sa e dhimbshme është për njeriun, që gjithë jetën e tij të jetë i detyruar të... kënaqet me një gënjeshtëri.

Mbase, në më lejoni t'ju pyes se ç'ndien një vajzë që është e detyruar të shohë, gjatë gjithë viteve të rinisë vetëm siluetën e një djali, që lahet i shpenguar në dush dhe ajo,... krenohet me virgjërinë e saj?! Kjo ka gjasë të përafrohet me atë çka dua të shpreh. Merrni me mend se ç'do të thotë për një djalë në rolin për të cilin sapo

folëm dhe kënaqësinë e vetëm të prekjes së femrës ta përmbushë me ... 'vetëshërbim'.

Se s'kishte se si të ndodhte ndryshe në një vend ku amvisa shikon nga vitrina mishin e varur dhe as që afrohet të blejë një copë, sepse nuk mjafton të zotërosh të hollat, por duhet të kesh... edhe 'tolonin' të cilin e ke përdorur një javë më parë. Gjithsesi le të bëhemi më seriozë e të mos i përziejme kërkesat: ato të trupit me ato të shpirtit. Se... Por, Francezja e tërhoqi shallin dhe u largua disi, për t'i hapur rrugën një vogëlusheje e cila me gomonen e saj-varkë, llokoçiste në atë copë vend që kishte zgjedhur për të luajtur e mbase dhe për të imituar lundrimin. Oh, ç'paralelizëm i dhimbshëm! Fizikania si një tjetër çamarroke, me shallin e saj, rifilloi hedhjen. Këndin e kundërt të asaj cohe e la të lirë që t'ia rishpinte poetit. Qe një lëvizje lojcake, por edhe tërheqëse e ngjashme me atë të meraklijeve në gjuajtjen e peshkut me kallam. Se, një rihedhje të tillë bëri ajo, por me ndryshimin që: rolin e kërcellit duhet ta luante era dhe atë të grepit, kindi i anasjelltë, të cilin e kapi menjëherë poeti. Ky, për siguri, u rrotullua bashkë me të si ndonjë grabitqar, duke u kthyer nga i rrëmbyer në rrëmbyes. Fizikania qeshi me shpërthim. Në faqet e saj u formuan dy gropëza.

-Xhulio! - u dëgjua nga larg të thërriste një zë gruaje, të cilin e mori era dhe ia përcolli valës. Qe një thirrje që u shpërfill nga djali. Por mbase nuk u prit kështu nga vajza.

-Xhulio! - u përsërit sërish piskama, të cilën sërish e mori era dhe e përzieu me rërën e ngritur mbi valën në breg.

Zonjusha franceze ndiqte me buzëqeshje valëvitjen e asaj cohe që era, me vështirësi tentonte më kot t'ia hiqte nga duart djaloshit që e shtrëngonte fort. Në të njëjtën

kohë një tjetër zë, gjithashtu femëror edhe ky, por krejt i ndryshëm nga i pari për dy arsye: Fillimisht se nuk i drejtohej Xhulios, ose francezes Julieta dhe, në vijim, se nuk ishte tokësor. Por virtual. Këtë zë, si i brendshëm, e dëgjonte vetëm poeti. Zë që vinte si ndërliksje e figurës për të.

“Truri ynë, djalosh, i ndien objektet edhe kur ato nuk janë të pranishme. Dhe s’është aspak çudi që atij i ikin nga fokusi edhe kur ata bëhen pjesëmarrës.

I tillë është hutimi”.

Ky paralajmërim mund të vatërzonte vëmendjen e cilitdo-tjetër, por jo të poetit dhe pse përsëritej për të dytën herë fjalia e parë. Nuk mjaftonte, megjithatë, ta shkëpuste dot pas asaj dalldie që e kishte zënë me atë frëngjishtfolëse, që përveç kësaj ishte dhe aq tërheqëse. Kjo bënte që të mos shihte zonjën e cila thërriste Xhulio, domethënë – Julieta, e cila qëndronte tërësisht jashtë vëmendjes së tij, ndonëse frëngjishtfolëse, gjithashtu. Por artikulimin e kësaj gruaje, rreth të pesëdhjetave, edhe pse me një ton të ëmbël e një theks gjuhësor-fin, si dhe me një piskamë gjithë politesë, kishin për veshët e tij një përshtatshmëri të përkorë nga forma por..., jo të tillë nga përmbajtja. Lexojeni:

-Zotëri! Të më falni për ndërhyrjen, mbase jo fort të dëshiruar për ju, por më duhet t’i kujtoj zonjushës Xhulio se, në këto çaste e pret një tjetër axhendë e një tjetër punë e ngutshme.

Ndërkaq, i hoqi nga duart kindin e atij shalli duke e çmbështjellë ca nga ca. Shkurt, e rrotulloi poetin si ndonjë çikrik, një a dy herë, derisa ai doli në rrërë dhe fizikania në bregun e detit. Ndërsa vala e të cilit e rrëqethte zonjën duke i lëpirë pak shputat e këmbëve të zhuritura nga vapa.

Kësisoj, ndërsa e reja u shkri së qeshuri, zonja

përkundrazi, sikur po nxirrte ujë nga pusi, kishte mjaft kujdes mos i lageshin këmbët nga stërpikjet e “kovës” dhe e përqethte atë.

-Orvua! - përshëndeti dhe poeti mbeti kallkan. - Eja, bija ime, shkojmë! - i tha zonja zonjushës, kurse shqiptarit i bëri thjesht një përshëndetje formale, por siç duket, me një gjest gjithashtu pendestar, përsëriti fjalën: -Orvua dhe bregu i rërës, si poleni në një livadh u pushtua nga aroma e kësaj zonje. Gjithsesi, kjo nuk e zvogëloi hutimin e tij e jo më të mendohej se një fjalë e vetme, do ta ffillonte atë. Dhe kishte të drejtë. E shkëputi nga ajo, të cilën ai e konsideroi idhullin e tij. Idhulli! Frëngjishtja ishte shkaku dhe fillesa e njohjes. Por ai, që në kërkim të shpirtit binjak dhe atëherë kur iu duk se e gjeti, dikush me edukatë, ia heq nga dora. Kësaj i thonë “heqje stoli”, por litari në fyt është prej floriri: - mendoi poeti një krahasim që e kishte hasur te Hygoi.

Idhulli! Po të që si një gur a guaskë e rrallë-deti e, madje, edhe ndonjë monedhë floriri, qoftë edhe diamant, ai do të ishte mospërfillës për atë që iku sa hap e mbyll sytë. Ato çaste iu kujtua Maria Kyri e ftuar në një ballo aristokrate që gjerdanët e diamantëve, do të dëshironte t’i shndërronte në laboratorë dhe zonjat të çaristokratizoheshin. Por ajo s’që as nimfë-deti e dalë rastësisht në breg. Jo. Absolutisht, jo! Ishte një franceze, pra një tokësore dhe fati, a Zoti, thuaje si të duash, ia nxori në breg dhe të dy gjetën gjuhën e përbashkët.

Nuk që aspak vegim. Ishte e njëmendtë. Po atë që erdhi, mos ndofta e kishte nënë? Se e thërriti Xhulio. Ai nuk besonte në sajësë. Aspak. Tjetër gjë se kjo thirrme i sillte në mend shëmbëllimin me një zë, tashmë të matanshëm kësajbote, ku klithma do t’i shkonte fjalëve të mbrame të një shpirti që thërret për të fundit herë përpara se të ngjitet në qiell.

Poetin e gjeti si Akteonin *, me vështrim nga deti. S'që kohë e përshtatshme t'ia kërkonte përgjigjen hapësirës ujore. As valës e aq më pak zhaurimës së tij. Se poeti e dinte: detit i pëlqen fshehtësia që të jepte përgjigjet e pyetjeve të cilat i binin si çekanë mbi krye. E, mbase për këtë arsye njerëzit e dëshpëruar i tërheq vetëmbytja. Prandaj, ai u kthye nga rëra dhe sigurisht që i vonuar dhe aq i trullusur gjithashtu, sa edhe po ta kish goditur dikush në kokë, vështirë se do t'i sillte diçka më të keqe. Dhe si të mos mjaftonte e gjithë kjo, një ciklon nga ata që shfaqen rëndom në rërë e gllabëroi në shtjellën e vet, si të ishin një tufë çupëlinash, që me shpotitë e tyre hidhnin valle, herë në drejtim të akrepave të sahatit dhe herë në të kundërt...

Gjithsesi në dritaren e katit të parë teknik në brendësi të asaj verande si pistë vallëzimi, u duk zonjusha franceze, e cila sodiste..., me dylbi lëvizjet e poetit.

Një ciklon i dytë, që sapo rinisi dhe e pushtoi thuajse gjithë bregun e rërës e përfshiu tërësisht atë për të vazhduar me rrathët ciklikë, gjë që e detyroi poetin të zhytej në det për të hequr rërën. Kur doli, ndonëse i shpëlarë, shkundej për të larguar disi kripën.

Që një rremendje se në këtë mënyrë do të rivendoste disi baraspeshën e humbur tanimë edhe pse, gjithmonë e më shumë, po i forcohej bindja se atë frëngjishtfolëse, era e solli si *vegim* dhe furtuna e mori si *ndëshkim*.

Dylbitë nga zonjusha i kishin kaluar zonjës atje matanë verandës. Kjo sikur duke analizuar tiparet e djalit, kërkonte të nxirrte një përfundim mbi karakterin e tij.

-Qenka mjaft simpatik, - i tha së bijës. - Plagosja që

* Akteoni: Një gjahtar i ri, që padashur pa hyjneshën Artemis tek po lahej e zhveshur. Si ndëshkim ajo e ktheu në një dre dhe atë e mbytën gentë e tij.

i ke shkaktuar e bën edhe më tërheqës, - por vajza nuk foli. Ajo vazhdoi: - Trishtimi tek disa njerëz shoqërohet me hijeshi. Në këtë kategori futet edhe ky djalosh që duket se është i hutuar ngaqë ka rënë në dashuri.

Julieta sërish nuk foli. - Një aventurier s'do të linte dritare të hotelit pa vëzhguar, kurse ai... Ka pamjen e njeriut të shqetësuar sikur i ka rrëmbyer era kabinën. ... Mos ndoshta merret me poezi? Se i shëmbëllen një romantiku të vonuar që e ka lënë në stacion treni i shekujve të shkuar.

Vajza qeshi dhe midis faqeve iu formuan ato dy gropëza të vogla. Kjo i ndodhte kur ndihej sidomos e mikluar. - Këtë përshtypje mund të kesh edhe për mua, mama. Ti e di shumë mirë që s'merrem as me poezi e as me prozë. Megjithatë më duket se më është mbytur barka e kthimit dhe kam mbetur si *Robinson Kruzo* në një ishull të pabanuar.

Zonja la mënjane dylbitë dhe i hodhi një vështrim së bijës, plot me vëmendje. Gropëzat e faqeve i qenë zhdukur dhe vetullat tentonin të puqeshin:

-Nuk besoj se bën shaka.

-Aspak.

-Mos ndofta u nguta që iu prisha intimitetin?

-Mbase,... por gjithsesi, kjo është një punë që pret e... ndofta, sepse kërkohet një reflektim i brendshëm.

-Pikërisht këtë kisha parasysh. Prandaj erdha për ta ndërprerë atë rast... të nxituar do ta quaja ngaqë, sapo zbritëm në plazh, ti, si ai marinari çapkën dhe jo si fizikane, u ngute nëpër rrëzë të gjeje të dashurin. Apo ishte një ...' *Lëvizje broviane?*

E parë nën këtë vështrim, të tilla dukeshin ato shkrepitima dashurie. Por a nuk është ky tipar dallues i dashurisë me vështrim të parë? Po t'i heqësh këtë çfarë i mbetet asaj? Megjithatë e gjendur disi në pozitën e ...

marinarit, ajo pranoi: -Po. E nxituar, mama. Edhe kështu mbase është si një lëvizje broviane, mund të thuash. Por ti e di se pas teje, të tjerët s'janë veçse të huaj edhe kur mirësjellja e tyre na afron me ta. Qofshin, edhe... të plagosur si romantiku në breg.

U shpreh kështu dhe regëtimi e zemrës e rrëqethi të tërën ngaqë e kuptoi se ishte e rrejtshme ajo që tha. Ishte e njëmendtë, që ajo nënën e barazonte me Zotin. Jo sepse s'qe e zonja ta përballonte jetën pa të. Se ajo ishte lauruar, si edhe e ëma e madje do të merrte gradën shkencore si edhe ajo. Por sepse mjetet materiale s'janë lumturia pa një idhull. E tillë ishte nëna e saj. Por më tepër se s'kishte njohur ende babanë. Brenda e këtij universi ndiente atë... romantikun.

Zonja e pa të bijën me ëmbëlsinë e nënës dhe s'qe aspak e vështirë për të, të kuptonte se te ajo kishin lindur shkëndijat e para që drithëronin zemrën dhe kurmin e çdo vajze në moshën e saj. Madje, disi të vonuar.

-O Shën Mëri! - mendoi ato çaste, - të jetë e thënë që ime bijë të ndjekë rrugën time? Mirë për shkencë, por edhe në dashuri?

-Mami, - e pyeti befasisht e bija, ndërsa po bënte në banjë dushin e shpëlarjes së kripës, - çfarë fustani mendon se duhet të vesh? Desha të them, cili më shkon më mirë?

Zonja qe shkëputur nga dritarja tashmë dhe ktheu kryet: - T'i kam varur me kremastar mbi fletën e dollapit, mjafton ta hapësh atë.

Ndërkaq e bija nisi një këngë nën zë. Ose ndiqte ritmin e saj në nënvetëdije, ndërsa e ëma e kuptonte se e bija pyetjet i bënte që ajo të ndihej e përfillur edhe në jetë si në shkencë.

Por vërshimi i dushit ia zhvendosi këtë ndjesi për një tjetër: Se lotët njeriu duhet t'i fshijë me shaminë e vet,

ashtu si dhe gjembin duhet ta heqë me dorën e tij.

Dhe zonja shihte tek e bija një derë të hapur e i trembej pikërisht baraspeshës: kyçjes një herë e përgjithmonë, mbylljes së portës për të cilën shpresonte vite e vite të tëra. Për të ishte i drejtë parimi i dy brezave që tërhiqen se janë të kundërt, si dy pole. Por dhe e kundërta aty qe.

Ndërkaq një zë në korridor përsëriste

-Autobusi përpara hotelit është gati. Nxitoni se për gjysmë ore nisemi për në Tiranë.

Qe shoqëruesja shqiptare, që trokiste lehtë nëpër dyert e dhomave dhe përsëriste në korridor të njëjtën shprehje.

Në rrugën “Myslym Shyri” dhe një histori tronditëse

Zonjës nisën t’i dridhen duart tek po vishej. Vetëm fjala Tiranë e bëri të kontrollojë çantën me rrota, ku kishte ndërresat e udhëtimit dhe në xhepin me zinxhir, bllokun. Në të ishte shkruar “Hotel Dajti” dhe ... Rruga “Myslim Shyri 28/1. Përbri edhe shënimi: Jo më shumë se njëqind metër larg, kur je me shpinë nga bujtina dhe me fytyrë nga lulishtja. Më tutje-rruga dhe buzë tyre-pallatet. Kthesa e parë-djathtas është rruga “Myslym Shyri”...

Udha për në Tiranë nuk ishte autostradë, por qe thjesht një xhade dykalimshe. Edhe mjetet e transportit ishin të rralla, gjë që e bënte të panevojshme atë.

Për këta turistë të huaj, plepat që shoqëronin gjithë kohës, anës udhës, ishin një kënaqësi e rrallë, e cila prishej herë-herë deri në thartim për të mos thënë baltosje, nga mjetet e shpeshta policore e sidomos ato ushtarake, që lëviznin në të dy drejtimet. Gjë që e vinte në pozitë tejet të pakëndshme ligjëruesen shqiptare, e cila ishte e detyruar të shpjegonte, kuptohet në shkallën sipërore, për fermat e mëdha: të Xhavzotajt e, më pas, atë të Sukthit.

Pyetjes nëse këto ishin private apo shtetërore, ajo u përgjigjej se qenë ‘kombëtare’. Por kishin filluar ekonomi

të vogla të “Perestrojkës” alla shqiptare, të tufëzave dhe arëzave, për të cilat nuk ishte e mirinformuar.

Kësisoj autobusi ecte dhe të huajt kënaqeshin me anën baritore të peizazhit: lopët në livadhe e stallat përbri. Paralelja e udhës hekurudhore, që për fat, atë ditë u has në më shumë se dy raste, shpalosnin një lloj qytetërimi me lokomotivat elektrike dhe vagonët kinezë, ende dinjitozë të ardhur në vendin tonë përafërsisht tri dekada të shkuara.

Të dyja francezet, zonjusha dhe nëna e saj, deri në hyrjen e Tiranës, nuk këmbyen asnjë fjalë me njëra-tjetrën. Madje e reja dremiti pak për t’u zgjuar nga një ëndërr tepër e shkurtër e simbolike. Një berber i moshuar iu përgjigj duke fshirë flokët e një klienti, që sapo doli nga lokali dhe u zhduk në errësirën e natës. Pak më tutje, ndonëse larg, dukej... poeti.

Vajza hapi sytë e trembur. Vështrimi i poetit, edhe pse dashamirës, nuk ia largonte dot ndjenjën e tromaksjes. Ajo ktheu kryet nga e ëma e cila po dëneste mbyturazi dhe po fshihte lotët. U kujtua se qe zgjuar dhe vetëm me të ëmën:

- Ç’ke, mama? Nuk ndihesh mirë apo një parandjenjë e keqe të mundon më shumë se mua?

Zëri i shoqërueses shqiptare në autobus nuk e la të përgjigjej:

-Zonja dhe zotërinj, kemi mbërritur në hyrjen e Tiranës. Ekzaktësisht në vendin e quajtur “Zogu i zi”. Nuk ka për të ndonjë domethënie historike. Është, thjesht, një emërtim folklorik.

Sikur të jetë vërtet kështu, - mendoi zonja Marsejezë.

Përmes zërave gumëzhitës mbi përshtypjet e kësaj hyrjeje dhe kujdesit të shoferit, tek kalonte pranë biçikletave të shumta, të kryeqytetasve tanë, zonjusha iu afrua më shumë nënës së saj dhe thua jse me lot në sy e

ripyeti: - Ç'ke, mami? Bëhu e fortë e mos u ligështo.

Gruaja, tepër e zonja për të përballuar gjendje edhe më të vështira se një parandjenjë, apo ëndërr cingërisëse, por edhe ngashërimin që e pllakosi aty më parë, i ledhatoi flokët me gishtërinjtë e nënës e i tha me buzë në gaz:

-Ishte thjesht si ... 'kushtrimi i të parëve', Xhulio.

Edhe vajza qeshi. I pëlqente ta thërriste Xhulio dhe jo Zhulietë.

-Më habit fakti, mama, se një *attraction* ka lidhur të dyja mendjet tona dhe kjo s'ndodh për herë të parë. Assesi vetëm për të njëjtin sens.

-Se na bashkon i njëjti shqetësim, prandaj.

-Mos, ndofta, dremite edhe ti?

-Jo, isha me sy hapur. Truri im flinte për të pyetur një berber, i cili e njihte dikë dhe tregoi flokët e tij si kujtim.

-O Zot, ç'passe hequr, Pothuajse të njëjtën pashë edhe unë. Prandaj thashë *attraction* ndonëse ëndrra ime që më e zbutur.

Semafori u hap dhe ligjëruesja me mikrofonin në dorë, si dhe me njëfarë krenarie, shpjegoi:

-Jemi në qendrën e Tiranës. Përpara, sahati (nuk tha dhe xhamia), majtas është Muzeu Historik i Vendit dhe djathtas, monumenti i Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu-kalorës i krishterimit.

Semafori u hap dhe autobusi hyri në atë që mund të quhet "Ansambli i ministrive", që linte mënjanë vendin-gropë të ish-shtatores së Diktatorit që, gjithsesi, që e cekët për një varr...

Mikrobuzi u ndal përpara "Hotel Dajti-t". Qe mesditë dhe nuk u deshën shumë minuta që grupi turistik të sistemohej nëpër dhomat e gjumit dhe të zbrisnin në restorant për të drekuar.

Ky program ishte i përshtatshëm për gjithë turistët, por jo edhe për dy francezet. Njëra nga të cilat, të paktën,

kishte një padurim që më kot kërkonte ta fshihte nga tjetra, gjë që, së jashtmi edhe ia mbërrinte. Por lidhjet e tyre, nënë e bijë, kishin mijëra fije të padukshme. Dhe ato e dinin se më parë jemi “Mendje sesa trupa”. Këtë përkufizim pitagorian kishin vite që e përmendnin në bisedat e tyre.

Deri në orën pesë ishin të lira, kohë në të cilën do të grumbulloheshin aty përjashta, pranë mjetit qytetas për ta këmbyer atë pragmbërmeje me një këndpamje nga veranda e malit të Dajtit.

Për zonjushën ky argëtim i papëlqyer që thjesht një ujdi e heshtur krahasuar me kënaqësinë e detit. Si të pranonte llokoçitjen në ujë të cekët ku: as mund të lahesh e, aq më pak të notosh. Për më tepër me një partner si ai frëngjishtfolësi. Gjithsesi të dyja francezet kuturisën të bënin fotografi përgjatë trotuarit dhe të shtynin tutje çastet që, ashtu si rastësisht, të takoheshin me përkthyesen e cila me siguri që do të nisej të pushonte në shtëpi. Dhe funksionoi. Ato kishin shkuar në fund të këmbësorës dhe tentonin të prisnin bulevardin e madh të vijat e bardha, në cepin e ministrisë, kur përkthyesja, Mira, kështu quhej ajo, po ua bënte me shenjë.

Francezet në fillim nuk e njohën, ngaqë ishin mësuar ta shihnin me xhinse dhe një bluzë dekolte të rregullt. Tashti ajo kishte veshur një fustan tafta, bojë-mjalti, që e tregonte më sensuale dhe syze të errëta tepër të mëdha.

Ajo sapo kishte dalë në pjesën e përparme të hotelit ia bëri me dorë, por edhe u foli në gjuhën e tyre, sepse hapësira ishte pa njeri, në atë zhëg-vape. Atëherë, të dyja francezet e njohën cicëruesen e tyre moshatare me Xhulion, ose Zhulietën. Një frëngjishtfolëse për t'u admiruar. Ishte ajo ikonë e qeshur me tipare të zeza: sy e vetull, flokë të prerë shkurt e syze të mëdha, që e tregonin edhe më trupvogël e madje më fine.

-Më duket se e kemi rrugën bashkë, - foli përkthyesja sapo u takuan.

Nënë e bijë buzëqeshën të gëzuara. Bënë fotografi të shumta me të dhe nga ajo, por nuk e zbuluan qëllimin e tyre sa të hidheshin matanë bulevardit të madh dhe të merrnin këmbësoren tjetër, ku hijet e pemëve të larta e zbusnin mjaft atë pisk-vape. E freskonin ajrin.

-Nuk ndenjët për të ngrënë? - tha cicëruesja.

-Mendua të bëjmë një xhiro sa për të shpirë këmbët përpara se të shkojmë në restorant, -tha mamaja. - Në Paris, si dhe shumë të tjerë, që merren me punë, ku lëvizjet janë të pakta, si në zyra apo laboratorë, kur shkoj, por sidomos kur kthehem nga puna, sado e lodhur që të ndihem, kam shumë kujdes, ta parkoj makinën një, ose dy kuadrate më larg vendit të shërbimit apo shtëpisë.

-Dhe të ecni më këmbë? - plotësoi Mira.

-Po. Dhe këtë ia këshilloj edhe sime bije për të njëjtin qëllim. Mbase duket mjaft i papërfillshëm, por nuk e di për ç'arsye u ndodha në një spital dhe më duhej të takohesha me një doktor-profesor katedre. Te ky vinin për të firmosur dokumente pacientë, pas kalimit në komisionin mjeko-ligjor dhe profesori, për çdonjërin do t'i mbante një fotokopje. Ai shkonte vetë në fund të korridorit: njëzet a njëzet e pesë metra larg. Këtë shërbim e bënte me kënaqësi edhe në qoftë se do të ishin pesëdhjetë raste çdo ditë. Madje e gëzonte numri i tyre!

Përkthyesja, Mira, u shkri vërtet së qeshuri. Edhe kësaj, ashtu si Xhulios, faqet i bëheshin me brima kur gazi arrinte krenajën.

-Jo. Ne nuk kemi probleme të kësaj natyre.

Mira s'mund të mos ndërmendte, kur ishte në shkollë të mesme dhe shihte se si, me detyrim, nëpunësit e ministrive, a të ndërmarrjeve të mëdha, bënë gjimnastikën e mëngjesit, sipas modelit kinez. Por ajo

s'mund t'u thoshte ende këtyre perëndimoreve maniera të tilla të kampit lindor. Ndërkaq ishin hedhur në një tjetër këmbësore dhe përkthyesja me zakonet e shoqërueses së grupit tha: - Kemi hyrë në rrugën "Myslym Shyri".

-Ashtu? - dhe zonja franceze, që gjithë bisedën edhe për doktorin, e kishte bërë për të mposhtur atë rikumbim që ndiente sapo lexoi, aty në krye të trotuarit, tabelën me emrin e rrugës. Përsëdyti me habi të shtirur: - Ashtu?!

-Po. Jemi në rrugën "Myslim Shyri", - përsëriti përkthyesja. - Nuk është se ka ndonjë histori kjo rrugë. Emri i tij, po. Ai është një dëshmor i Luftës Nacional-Çlirimtare.

-Myslim Shyri më kujton adresën e një shoku në adoleshencën time, - tha fizikania, ndërsa me vete mendoj: në mos qoftë gjallë s'është e domosdoshme që rruga të mbajë emrin e tij. Ajo është 'pagëzuar' tanimë me një emërtesë. '*Shkatërrimi i një jete nga Diktatura.*' Ja pra, që kjo rrugë nuk është *pa histori*.

-Si quhej shoku në adoleshencën tuaj, zonjë? -pyeti përkthyesja, Mira, me naivitetin e saj, por edhe krejt e shpenguar, pasi kishin ndodhur plot ndryshime dhe u qenë hequr mjaft kufizime marrëdhënieve me vizitorët e huaj. Veçanti përbënte edhe ky shoqërim, që përpara një viti, as që mund të mendohej e jo më të ndodhte, se pasojat do të qenë katastrofike për shqiptaren tonë dhe shpalljen *non grata* për të dyja francezet.

-Luan Majlindi, - shqiptoi ajo dhe menjëherë iu ndërkëmbye figura. Përpara saj sikur kishte moshatarin pesëmbëdhjetëvjeçar të ulur në bankën e fundit në shkollën e mesme në Paris. Trupin e tij të bëshëm krahasuar me vërsnikët e tjerë, sytë e zinj e vështrimin e ëmbël, por sidomos hutimin e saj, kur profesori përmendi emrin e tij dhe ai u përgjigj: Ui. Ndërsa ajo e hutuar gjeti rastin t'i japë dorën poshtë bankës, duke

pëshpëritur emrin e saj: *Marsejeza*.

Ky, pra, ishte prezantimi i tyre i parë. Dhe asaj, patjetër do t'i kujtohej se si me dëlirësinë e një çupëline, do të përsëriste gjithë atë buzëmbremje në lozhën e shtëpisë, emrin e tij, teksa me një dëshirë hovshëm të papërmbajtur, për të parën herë, kishte marrë të ujiste lulet.

Veçse, këtë punë plot kënaqësi e kryente gjyshi. Ardha e tij bëri të ulte kryet e turpëruar. Pasi, përpara se t'i njomte ato, ajo kishte këputur njërrën dhe kish hedhur në tokë petalet e saj, një e nga një, sipas atij riti për të marrë përgjigjen: *më do, s'më do*. E fundit, pas së cilës ajo do të thoshte 'më do', fletëza kishte qëlluar tepër e vogël për t'u vlerësuar si e barabartë me të tjerat.

Pezmatimin e saj idhnak do ta zbuste e, madje, do t'ia kthente në gëzim, gjyshi që sapo hyri dhe e pa si të shtangur.

-Të do, - tha ai.

Ajo kishte sjellë kryet nga porta prej qelqi ende e hapur dhe kishte buzëqeshur:

-Pyetja nuk shtrohej për këtë, gjysh, - iu desh të gënjente.

-Po për çfarë?

-Kaloj apo s'kaloj, - ishte e detyruar të vazhdonte rrenën e ndodhur në një pozicion disi të vështirë. Qe si një nga ato shtirjet që bënte drekave, kur dëshirën për të ngrënë pas saj kos me mjaltë, e paraqiste sikur kërkonte ta përgatiste për gjyshin i cili, në të vërtetë qe edhe nxitësi, pasi ajo e shihte në sy dhe nuk guxonte ta kërkonte.

Prindërit, nuk është se ia ndalonin. Por ata kujdeseshin që ajo të mos merrte shumë të ëmbla. Aq më keq, mjaltë. Kjo qe bërë palë me gjyshin. Ky e pyeste duke ndukur pak cepin e majtë të mustaqes dhe kaq duhej që ajo të thoshte:

-Mami, po ngrihem t'i përgatis gjyshit një kupë të

vogël me kos dhe mjaltë? Qe një haje pas buke, që ajo e kish mësuar nga Aleksandri, shoku i saj grek dhe i pëlqente shumë.

Por këtë radhë gjyshi, jo vetëm s'ishte palë me të, por qe kundër. Mospranimin ai e shprehte në një lëvizje teatrale të vetullës së djathtë. Ai e ngrinte atë lart si drizë. Pas kësaj do të ndukte patjetër, cepin e majtë të mustaqes, sikur donte të thoshte: "Të jetë kjo si shakatë e kosit me mjaltë?", por tha: - Ti je e shkëlqyer në mësimet dhe s'ke arsye ta bësh këtë test. Aq më tepër tani që është fillimi i vitit e jo fundi i tij, kur nis sezoni i provimeve... Megjithatë, *eppur si muove*.

-Që do të thotë?

-Se të do... ose "megjithatë rrotullohet". Pra do të kalosh.

-Nga e di ti, gjysh?

-Se ajo fletëza që të ka mbetur, - dhe kësaj here edhe vetulla tjetër ngrihet në lartësinë e simotrës, si dy shkurre në të cilën një bletë ulet për të marrë hov në ngjitjen për në lulen e synuar, - edhe pse është e vogël, duhet të numërohet ashtu si edhe të tjerat.

-Tani po flet si botanist, gjysh.

-Unë as futbollist nuk kam qenë, por si tifoz i futbollit di të them se "vija është pjesë e fushës".

-Dhe ç'del nga kjo?

-Ç'del, - përsëri poza teatrale e vetullës-drizë, hyn në një veprim të menjëhershëm. - Del se edhe ajo fletëzë që të ka mbetur në dorë si dopio gjashtë e dominosë, është gjithashtu pjesë e kurorës së lules edhe pse është e vogël, llogaritet si e tillë. *Eppur si muove*.

Vajzën e kishte tradhtuar gëzimi i beftë dhe nxitimthi e kishte puthur gjyshin pak më tutje se cepi i mustaqes së tij të përdredhur, për të fluturuar përjashta e ndjekur nga romuzet e tij qesëndisëse: na, moj Marsejezë, po këto

fletë e gjethe, kujt ia le për të pastruar, gjyshit?

Por ajo nuk do t'ia vinte veshin, si gjithmonë “ankesave” të tij. Aq më pak tani që shkëlqente ajo shpotia qesëndisëse, njëkohësisht.

Atë natë gjumi do ta zinte vonë, pasi ishte lodhur së numëruari yjet nën dritën e të cilëve, shihte e shqetësuar edhe ndonjë meteor që shkëputej dhe trembej se mos ky do të ishte medoemos miku i saj nga Tirana, Luan Majlindi.

Vërtet fati i tij qe përcaktuar si ai i meteorëve: ata shfaqen befasisht dhe me shkëlqim për t'u zhdukur po aq papritur e me nxitim.

-Luan Majlindi?! - shfaqti me tepri habinë shoqëruesja Mira, e cila hoqi në çast syzet e diellit si për t'i parë më imtësisht tiparet e kësaj ikone.

Francezja, që gjithashtu bëri të njëjtën gjë për të zbuluar pas atyre qelqeve blu, sytë jeshilë, ku feksi shpresa. Se kështu e rroku Marsejeza leximin e atij vështrimi. Por edhe përsëritjen e emrit Luan Majlindi, në mënyrë të tillë që, veç të tjerave, mund të merrej si një premtim i pashprehur. Dhe, për t'i dhënë kurajë shqiptares që të mos tërhiqej, por të vazhdonte të fliste, siç edhe pohoi befasimin e saj, deri në shtangie, e nxiti: - Mbase diç ju kujton ky emër, zonjushë Mira? Pasi, për fatin tim... rastësor (nuk deshi të thoshte as të mirë, as të keq) keni lindur dhe jeni rritur bashkë me historinë e *mëhallës* suaj *të vjetër e të re*. Kështu nuk është?

-Po, - tha Mira dhe rivuri syzet. - Pak hapa më tutje është lokali i një berberi. (Ajo në frëngjisht tha “salloni i bukurisë për burra”). - Ai, me siguri e ka njohur **shokun tuaj të adoleshencës**. (Nënvizimin nuk e bëme ne që po shkruajmë këtë roman, por përkthyesja Mira me tonin e saj, brenda të cilit ishte ai ngjyrim që kthen shokun në njeriun më të dashur të jetës). - Se ai e ka pasur shtëpinë

pranë numrit 28/1 dhe më kujtohet që, pikërisht, në atë vend, në tërmetin e vitit të largët '67, ajo u kris dhe plani i rregullimit të qytetit e rrëzoi atë plotësisht.

Zonja franceze, Marsejeza, vendosi menjëherë syzet mbi sy dhe rrahjet e zemrës iu shtuan. Nuk do të donte, kurrsesi, të qe me 'të e bija. Për të parën herë, ndiente pendesë që këto pushime në vendlindjen e Luanit t'i kalonte me vajzën e saj. Aq më keq që atje, në plazhin e Durrësit, shihte përsëritjen e historisë, madje me spirale. Për këtë fliste, veç të tjerash edhe fakti që gjithë rrugën deri në Tiranë, s'këmbyen fare me njëra-tjetrën. Ishin bashkë dhe veç e veç. Si edhe tani këtë copë rrugë, po ashtu: të heshtura si në mort.

Megjithatë, zonjusha Xhulio mendjen e kishte te Poeti, që mbeti si i hutuar në plazh dhe qe e gatshme të bënte prapaktheu për të mbërritur në shoqërinë e tij. Sjelljen e saj të njohjes e quante: kapriçio, shpërthyesë e të papërmbajtur. Largimin e vlerësonte si ... harbutëri. E përbuzte kundra-tezën, po ashtu. Harbutëri! Për zonjushën një emërtim i tillë ishte skandaloz e i turpshëm.

Për zonjën Marsejezë, harbutëria ishte shtetërore. Kjo fjalë mund të quhej eufemike. Thënia e vërtetë duhej të qe *terror*.

Zonja i trembej një ballafaqimi. Lajmi që mund të merrte nga njeriu i gërshërëve dhe i brisikut mund të qe si shigjetë, pas së cilës, po të ndiqje drejtimin të shpinte te Luani. Kjo, sigurisht do të qe e pëlqyeshme, ndonëse pak i besonte këtij arsyetimi. Me gjasë mund të qe e hidhur edhe pse shigjetë gjithashtu madje e kthyer drejt saj dukej. Po ende kjo e ligështonte që në mendim, aq më keq krah së bijës.

Gjithsesi me shpresën si me një shok fisnik mbërritën përpara një lokali, ku të zotin e tij bujar e gjetën në një pozicion disi jo fort të pëlqyeshëm për të. Ai, me fshesë

në dorë, po mbledhte flokët e klientit të fundit që përcolli. Dhe, e bënte këtë punë me aq nge e kujdes sa edhe po të ishin të porsarëna flokët e tij nga koka tullace, nuk do t'i kushtonte aq vëmendje.

Mjeshtri ishte një burrë mbi të pesëdhjetat, trup shkurtër e fytyrë qeshur si të gjithë profesionistët kur shohin se në lokalin e tyre vijnë klientë. Sidomos të rinj. Aq më tepër të seksit delikat. Përkthyesja, që për të ishte vajza e shokut, por edhe komshie, ia bëri me shenjë që do të thoshte se kërkonte të fliste me të. Kuptohet. Këtu s'bëhej fjalë për klientelë. Madje në lokalin e tij kishte kohë, afër dy dekada, pa hyrë një femër për të qenë. Atëherë ai qethte edhe ato si djemtë dhe ndiente muzikën në gërshtërit e tij. Po ende me një shoqe që studionte në konservator kishte diskutuar edhe se duhet patjetër të ketë lidhje si *veglat e perkusionit*, harmonia e gërshtërit me krehurin dhe se herë-herë atij, nga kënaqësia, kur u shërbente femrave, i dukej vetja si dirigjent dhe ekzekutues në të njëjtën kohë. Ajo kishte qeshur në fillim, por s'e kishte lënë aty këtë ndjesi. Pedagogët, përkundrazi. Nuk ishin befashuar. Për ta çdo send ka muzikë kur vibron. Kjo risi s'duhet të na habisë. Pasi është e hershme që nga kohët e shoqërisë pitagoriane, kur dimë se edhe integralet në matematikë thuhet se së pari i ka vërejtur një rrobaqepës.

Kjo flet për atë që dikë e shtyn kërkesa për të kursyer (rrobaqepësi) dhe dikë tjetër idealizmi për punën e kryer (ky është mjeshtri i gërshtërëve dhe i krehurit).

Është për të qeshur ajo që u tha gjatë, për këtë berber. Në mbledhjet e lagjes s'para shkonte, megjithëse ishte prind me dy vajza të vogla. I deleguari, përgjigjes së tij se "nuk dija orarin ndaj edhe u vonova" iu kundërvu: pse s'ke një shok që të lajmërojë? Ky mbeti pa fjalë. Dikush nga fundi i sallës, me zë të lartë, qe përgjigjur: E, ku ka shokë Ilmiu, shoku i deleguar. Me punën që bën ai, ka

vetëm shoqe.

Kështu, salla kishte qeshur me të madhe dhe atij iu shtua bindja se kishte arritur kulmin në profesionin e tij... Por lufta kundër liberalizmit qe thelluar. Që atëherë kishin kaluar dy dekada. Koka e Ilmiut qe rrafshuar nga flokët dhe lokali nga njerëz të seksit të kundërt. Kuptohet: Nuk bëhej fjalë për gratë që sillnin fëmijët për t'i qethur dhe që vetë ishin ende të pakrehura, por u kishin kaluar flokëve gishtërinjtë sa për t'i shtruar. Aspak krehër e 'muzikuar' ato. Se dhe veshja ishte si e shtëpisë, a si në radhën e qumështit. Shkurt: asnjë grua për të qenë. Dhe ja papritur në lokal ia behën tri të tilla: dy zonjusha dhe një zonjë. Përkthyesen Mira, ai e dinte se punonte në turizëm dhe e merrte me mend që edhe shoqërueset e saj duhet të qenë të së njëjtës sërë. Dhe kur dëgjoi se ato flisnin vetëm frëngjisht, hutimi i tij bëri që ta humbasë toruan.

Një histori e dhimbshme e shokut të tij të rinisë do t'iu ndërmendej dhe ai si një i përhënur, do të bënte veprim të pakontrolluar.

Në lokal, përveç ndenjësës rrotulluese të klientit, kishte dhe tri karrige ku uleshin ata që prisnin radhën. Këto ishin të zbërdhulëta nga ngjyra ushtarake (jeshile) dhe ai, për të parën herë, ndjeu se qenë plotësisht të papërshtatshme për t'u ulur vizitorë. Aq më pak të kësaj klase. Në qendër, një tavolinë e qelqtë, mbi të cilën kishte gazetën "Zëri i popullit", e detyrueshme për abonim dhe "Sporti", për të cilën ishte dhe tifoz. Kësisoj, pa asnjë kuptim, mori kartonin-lopatezë dhe, si i mblodhi flokët i futi në gazetën "Sporti", që tërhoqi nga tryeza dhe i paktoi me kujdes për t'i vendosur me të njëjtën sajdi e përkushtim, në sirtarin bosh të një komodine, si të kishte të bënte me diçka të shenjtë e jo me flokë. Hutimi qenka njësoj si përhënia: qoftë njeriu esëll, i dehur, a në gjumë.

Pas kësaj berberi do të lante duart përpara pasqyrës dhe tek po i fshinte ato fort, me një peshqir të papërdorur, i ftoi gratë të futeshin brenda. Ishte zagushi dhe ai hapi ajërftohësin për ta ndryshuar disi mjedisin. Por, prania e të triave, sapo hynë dhe u ulën modestisht në ato karrige, u duk se gjithçka ndriçoi dhe freskuesja mbi tavan shpërndante një tjetër erë: aromë zonje dhe zonjusha të hijshme-klasi edhe pse të kësojbotshme.

Berberit iu davaritën kujtimet e trishta për pak çaste dhe iu rikthyen ato vite, kur për lokalin e tij edhe pa ndonjë 'fletë-rrufe' zhurmëmadhe, njerëzit thoshin se aty ishte një sallon bukurie i vërtetë, falë talentit të Ilmiut.

Dyqanet enkas për gratë, tabela e të cilave shkruante "Ondulacion", shërbenin më shumë për të dredhur flokët sesa për t'u dhënë formë, prerje dhe hijeshi femre atyre. Flokëprerësi, me mençuri, gjente "kapriçon" e flokut dhe argëtohej me të. Por, mbushej me virtyt kur krijonte gëzim te klientët e vet. Gjithsesi, përkthyes Mira dhe dy francezet, ai besonte se s'kishin ardhur për t'i përtërirë berberit sallonin e dikurshëm të bukurisë. Aq më pak t'i sillnin atij ndonjë medalje pas kaq kohësh. Por mbase për t'i rifreskuar kujtesën lidhur me shokun e tij të adoleshencës, që shkoi në Francë. Kthimin e tij dhe kalvarin e vuajtjeve, më pas. Dhe vërtet kishte goditur në shenjë se për këtë qe fjala.

-Zonjat, - nisi bisedën Mira, - saktësisht njëra zonjë e tjetra zonjushë, janë turiste nga Parisi, siç edhe mund ta merrni me mend.

Tjetri u ngrit menjëherë nga ndenjësja rrotulluese e klientit, mbi të cilën qe ulur pas përshëndetjes fillestare dhe u puthi dorën të dyja parisieneve, me shumë mirësjellje e kënaqësinë e delfinit, kur kërkohet shërbimi i tij.

Vështirimeve tejet të hutuara të damave, ky iu

përgjigj me buzëqeshje e, madje, si me përkëdheli, duke u përqendruar në portretet e tyre. Jo si profesionist i krehërit dhe gërshërës, por ashtu siç sheh miku-mikun. Se francezet kishin ardhur me gjasë nga larg, enkas për të takuar një të tillë. Shorti i ra atij. Dhe nga ky prag, ato duhet të mos largoheshin të zhgënjyera nga sinqeriteti. Mira, sërish, e mori fjalën: - Zonja, - dhe ajo bëri me shenjë nga Marsejeza, - në... adoleshencën e saj, ka pasur një shok në shkollën e mesme në Paris, që e quanin Luan Majlindi.

Tjetri tundi kryet në shenjë miratimi gjë që tregonte në të njëjtën kohë se s'qe gabuar aspak në hamendësimin e tij mbi vizitën e damave. Por edhe ato kishin trokitur në portën e duhur për të marrë përgjigje. Dhe ajo më e rëndësishmja: kishin gjetur kohën e përshtatshme. Se përpara një viti çdo gjë ishte krejt ndryshe.

Sidoqoftë, Marsejeza ishte e bindur se takimi me këtë shok të Luanit do t'i hapte horizont. Ajo diç do të mësonte mbi fatin e tij të mëtejshëm pas largimit, me përdhunë nga Franca. Prandaj edhe ky lokal, tepër i zyrtër, në krye të herës, i zhveshur nga çdo reklamë, përjashtoj një flamur sportiv për "17 Nëntori-n" e Tiranës, nisi t'i dukej i ndriçuar e, madje, i freskët, jo aq nga mekanizmi në tavan, por nga përfillja dhe mikpritja e të zotit të tij. Edhe mungesa e flokëve, në kokën e mjeshtrit, sikur e bënte të domosdoshme zhveshjen nga teprimet për të merituar një mirëkuptim qoftë edhe anekdotik. Se si lokali dhe i zoti këtë e kishin të përbashkët.

Sidoqoftë, Marsejezës, një regëtim edhe pse deri diku i zbutur pas këtyre mendimeve, që i vetëtinë në tru, ia drithëronin zemrën dhe ajo mundohej edhe me teknikën e frymëmarrjes, ta shkarkonte disi, atë trazim të brendshëm, që nisi t'i rritej nga sekonda në sekondë. Se i trembej mospërmbajtjes dhe ndonjë shpërthimi të menjëhershëm në dënesë.

-Luanin e kam pasur shok në shtatëvjeçare, vitin e fundit, se ai dy të parët i pati bërë në një qytezë buzë Vjosës. E them këtë se ishte një notar i shkëlqyer. Falë atij, gjithë grupi ynë mësoi notin.

Marsejeza do të merrte frymë thellë dhe do të bindej se njeriu që po fliste kishte qenë vërtet shok i Luanit. Ajo kishte një përvojë, sa të hidhur aq edhe të lumtur, buzë Senës... Por për këtë lexuesi do të mësojë më vonë. Edhe për mjeshttrin e krehërit e të gërshtës do të qëndronte si konstante e gjithë historia e ndarjes me të, që mund të përmbledhej në të përbashkëtën me atë të zonjës Marsejezë. Pra: sa të lumtur, aq edhe të hidhur.

-Zaten e gjithë shoqëria jonë e zilepste fatin e tij, që iu dha mundësia të kryejë të mesmen në Paris, ashtu siç do ta përbuzte fatkeqësinë pesë-gjashtë vite më pas.

-Gjashtë, - korrigjoi Marsejeza, kur dëgjoi nga Mira përkthimin, zëri i së cilës, në shqipërim përmbante dukshëm atë hutim që të sjell befasimi me ngjarjen. Asaj, sigurisht, që s'i kishte shkuar mendja se do të ndodhej e pranishme në një histori, ku mbase zinte fill, një roman dhe se vetë do të qe personazh, si cicerone, për të shpjeguar, ndoshta përplasjet e protagonistëve të dy botëve. Në njëfarë mënyre, pa vullnetin e saj, po futej në një dramë. Por a mos e tepronte me hamendësimin e saj, apo thjesht parandiente diçka të trishtuar, brengën e së cilës, me sa dukej, koha ende s'e kishte mbyllur dhe udhëtonte si një shoqëruese e keqe qoftë edhe mbi shpatullat e një intelektualeje si ajo?

-Kur vinte me pushime të viteve shkollore, më duket në katër raste...

-Tri, - e korrigjoi sërish, po me ëmbëlsi zonja Marsejezë, përkthimin, - se të katërtin erdhi për të mos u kthyer më kurrë në Paris.

Pas kësaj zonja rivendosi syzet për të mbuluar vesën

në sytë e saj jeshilë.

-Zonjë, - tha mjeshtri tullac, duke parapëlqyer të shkarkojë një herë e mirë nga supet barrën e dyshimit mbi personin me të cilin po fliste. Mendimi se edhe për tjetrën do të që më e dëshirueshme të që më e drejtpërdrejtë, bëri pyetjen direkt:

-Mos ndofta quheni Marsejezë?

Francezja tundi kryet pa mundur dot të shqiptojë emrin e saj. Diç mbytëse po i shtrëngonte si me thonj, grykën, por nuk mundi t'ia zërë frymën. Thjesht e pengoi t'i dilte zëri. Tani, ajo me vështirësi, arriti të shmangë ngashërimin e gulçimave të dënësës. Por mjeshtri s'e la. U ngrit sërish nga poltroni:

-Më lejoni, zonjë e nderuar, t'ju puth edhe një herë dorën tuaj me respekt si idhull i shokut tim. Ajo, gjithashtu u ngrit dhe ia zgjati atë.

-Kam qenë në sallën e gjyqit, - vazhdoi mjeshtri, -kur shoku juaj, zonjë, tridhjetë vjet më parë, mbrojti veten e tij nga akuzat e pabaza, por edhe dashurinë ndaj jush si diçka fisnike. Të pastër si qielli, të lakmuar nga yjet, të nëpërkëmbur nga... disa njerëz të këqij në tokë. (Ai nuk tha nga shteti i diktaturës se ende kishte frikë ta shante atë dhe të shprehte urrejtje ndaj tij. Hija e kalit, edhe potkonj-rënë të frikëson). Vërtet gjërat kishin ndryshuar, por pikat s'ishin vënë ende mbi "i". Në pushtet sundonin ende komunistët. Prandaj mjeshtri u rezervua cazë për të thënë më shumë: pra u tërhoq. Por edhe përkthyeses me vështirësi i artikulohej frëngjishtja.

Marsejeza hoqi syzet, fshiu sytë me shami dhe i rivuri ato. Por edhe kështu trishtimi i lexohej në ikonën e saj.

E bija, zonjusha Juliet, ose Xhulio, siç i pëlqente ta thërriste e ëma, u shtrëngua pranë saj dhe u përlot pa bërë asnjë përpjekje t'i fshihte ato, por dhe asnjë pyetje.

Zezona

Kishin udhëtuar gjatë për të ardhur deri këtu dhe e shkurtuan mjaft rrugën drejt qëllimit, kur hasën në një shoqëri të tillë. Por mbase kishin mbërritur në fund të saj.

-Zonjë, - nisi sërish të flasë i zoti i dyqanit, - shumëkush ju ka krahasuar me Elenën e Trojës, se u bëtë sepse që ajo familje të zhdukej plotësisht. Shtëpia e tyre të pësojë zezonë.

Përkthyesja nuk e dinte në frëngjisht të barasvlershmen e këtij kumti dhe kërkoi nga mjeshtri t'ia shpjegonte me fjalë të tjera.

-Edhe unë s'e kam ditur më parë, - sqaroi Ilmiu.

-Por një shoku ynë student në histori-filologji na tha: sapo na nxorën nga salla për të mos dëgjuar protestat e fuqishme të Luanit, se zezona është shuarja me gjithsej e familjes si dhe e gjithçkaje. Gjëmën e tyre njerëzit nuk ia dëshironin kurrkujt, as hasmit.

-Domethënë?

-Prindërit, thuhet se u vetëhelmuar.

-Po Luani?

-U dënua 22 vite burg dhe katër të tjerë internim.

-E tmerrshme! Po pse?

-Se ju kishte dashuruar ju, zonjë e nderuar.

-Pse dashuria qenka e ndaluar? -pyeti Xhulio.

-Po, domethënë, jo, zonjushë, - dhe pas pak do të shtonte... -Po shqiptar me shqiptar e jo edhe me franceze.

-Qesharake, - tha zonja.

-Qesharake, por e vërtetë, dikur.

-Pse tani ka ndryshuar? - u interesua zonjusha.

-Akoma jo, por s'ka ku të shkojë. Do të ndryshojë patjetër.

U bë një heshtje e gjatë, të cilën e prishi një çunak, ndonja pesëmbëdhjetë vjeç, që vinte e ndihmonte mjeshtrin, por edhe mësonte zanatin të fëmijët e vegjël, të cilët i qethte me gjysmë çmimi. Ilmiu, duke iu drejtuar përkthyeses Mira, tha: - E kam për ofezë në qoftë se nuk do të pranoni të qerasurën time me një ekspres dhe nga një arançatë të ftohtë. Koka kola tek ne s'ekziston ende.

Vapa, por sidomos mënyra e propozimit të gostitjes bënin që të prejvinte ideja e cila mbërriti bashkë me djaloshin, në momentin më të përshtatshëm si ta kish thirrur mikpritja. Ustai nxori një kartëmonedhë dhe ia dha të riut, i cili fluturoi se nuk e bënte për herë të parë atë rrugë.

-Dolëm nga tema, - tha Mira, së cilës i cingërinte vijueshmëria e dramës. Por edhe për ta lehtësuar, disi, pozicionin e zonjës Marsejezë.

-Sa të vijë djali kemi kohë ta zbulojmë vazhdimin, - tha berberi i cili vijoi të shpjegojë:

-Nën zë shumëkush i jepte të drejtë dashurisë së Luanit me... një franceze. Kështu e emërtonin ata, për të cilët Marsejeza nuk ishte Helena e Trojës, por një franceze. Ndonjë i keqkuptuar thoshte se: kështu të ndodh po të pretendosh *Marsejezën*. Dhe e kishin fjalën për simbolin e LIRISË e BARAZISË. Por, ndonëse, në heshtje, të gjithë u bindën, kur në mesin e viteve gjashtëdhjetë ra një tërmet dhe u gjet sebepi që shtëpia njëkatëshe të shembej dhe aty të binte plani rregullues i qytetit.

Kjo qe *zezona*. Prishja me gjithçka për të cilën, mjeshtri i gërshtës i përdori mirë ato për t'ia shkurtuar rrëfimit të tij. Hamendësohej se ky, ose nuk kishte dijeni se ç'kishte ndodhur më pas me Luan Majlindin, gjë që ka shumë të ngjarë, ose e kurseu ndonjë trishtim edhe më të madh për zonjën dhe zonjushën e saj.

-Me sa di, zonjë, Luani ka pasur dy dajallarë, thujse moshatarë me të. Njërin kostumograf me inicialet S. M. në Gjirokastër dhe tjetrin, piktor në Krujë, me inicialet K. M.

Atë pasdreke, përkthyesja Mira nuk do të shkonte të drekohej në shtëpinë e saj. Ajo u kthye në hotel së bashku me dy francezet, nënë e bijë.

“S’ka as Zhulietë as Dezdemonë. Ka vetëm zjarr dhe det”

Cikloni kaloi. Edhe era në det pushoi njëkohësisht. Zagushia u rikthye në rërë. Ndërsa poeti shkonte e vinte, nëpër të, kryeulur, sikur kërkonte prej kokrrizave të saj shpjegime. Një i dehur, tek kalonte para kabinave, për të gjetur vendin pranë të cilit zhvishej çdo mesditë për t’u freskuar apo për t’u çtrullosur nga rakia, bënte me shenjë nga poeti dhe thoshte:

-Ja një njeri që po cakton mesin e botës. Aty është. Vetëm ai s’e di. Kush nuk e beson le të shkojë e ta matë.

Zjarri i kënaqësisë që përjetoi Poeti në këmbimin me francezen, zgjati sa flaka e kashtës. Dhe ai nuk është se kërkonte mesin e botës, por mbase aty qenë shfaqur dy kampe të kundërt. Madje, për këtë arsye edhe tërhiqeshin drejt njëra-tjetrës. Për t’u bashkuar apo për t’u ndarë? Ndërsa i dehuri që zhveshur më në fund dhe e kishte gjetur më lehtë se herët e tjera shtyllën pranë kabinës, ku i linte teshat. Ndaj rifilloi një recitim të ri:

-Atë që s’e shëron ilaçi, e shëron thika. Por thikën e kishte vetëm Romeo. Ashtu, si shaminë-vetëm Otello. Prandaj s’ka as Zhulietë, as Dezdemonë. Ka vetëm zjarr dhe det.

Pas kësaj ai u krodh në ujin e tij për t’u freskuar a për

t'u çtrullosur.

Kishin kaluar dy ditë dhe poeti s'kishte njohur ende komshinjtë e kabinës. Në të majtë, një çift të moshuarish, të cilët ai do t'i quante 'afërndenjës' ngaqë ata ishin fjalëpakë e telegrafikë dhe se pyetjes: si po kaloni, ata i përgjigjen: *ditojmë*. Por edhe këtë e përdorte më shumë plakun, se plaka thoshte *beharojmë*.

Në të djathtë kishin "**beharuar**", jo pak, por katër djem zhurmëmëdhenj njëzetvjeçarë, që e linin kabinën në mëngjes dhe, një zot e di se ku "**ditonin**", për t'u kthyer në mbrëmje me trupa të skuqur e plot energji, tek kërcisnin dominonë. Poeti u detyrua të verë pambuk në vesh që të zvogëlonte, disi, valën goditëse të gurit fitues në përplasjen e tij. Zhurmat e shqetësonin dukshëm. Pleqtë e kabinës në të majtë, sa fillonte dominoja, mblihdeshin në dhomën e tyre. Plaka edhe thoshte, ndonjëherë, natën e mirë se nisën djemtë "akshamimin".

Por të gjitha këto i përkisnin turnit të kaluar, ku ato tri ditë poeti i kishte për llogari të një shokut të tij.

Ky turn kish hyrë pak më ndryshe: Në të majtë-një familje me dy fëmijë të vegjël, pesë dhe dymbëdhjetë vjeç. E vogla-vajzë, i madhi-djalë. Babai i tyre punonte në turnin e natës në një nga hotelet turistike në Tiranë. Me trenin e parë mbërrinte pranë kabinës, pasi i kishte lëshuar një zë nga larg të birit. Ky, sikur priste nga pas portës, e hapte menjëherë atë dhe i hidhej në qafë. E shoqja, një brune tridhjetë vjeçe, mjaft tërheqëse, ashtu flokëshpupurisur me gishtërinj, që mbase do t'i pëlqente të dremiste dhe pak, por po aq e gëzuar sa edhe fëmijët e saj, nxitonte ta lehtësonte të shoqin nga duart. Se ai, gjithmonë, do të kishte dy çanta: njëra me dy shishe qumësht dhe tjetra me bukë, gjalpë dhe katër bërçolla të skuqura. Por edhe diç tjetër, të cilat gruaja i vendoste mbi tryezë, në cep të parahyrjes së saj. Shkurt, ai kishte

sjellë kështu, çfarë duhej për mëngjesin e fëmijëve si edhe drekën e darkën për familjen, e cila kalonte lehtëshëm, pasi njëri nga shishet e qumështit, ajo grua, si amvisë e shtëpisë, e zinte kos. Pas kësaj burri merrte çadrën, djali-shkopin dhe, të dy, me vrap si në një garë, shkonin me vrull ta ngulnin në rërë. Kish filluar kështu, “beteja” e një pushimi aktiv.

Gruaja, që ngutej edhe ajo të përgatiste vogëlushen, e nxiste atë të mos mbetej pas dhe bënte gjithçka, që t’i zgjonte shpirtin e garës me fjalët: “Shpejt se na kaluan ‘të tjerët’, e ngritën çadrën!” E vogla përgjigjej po me atë ngut: Ata s’janë ‘të tjerët’, moj mami; ata janë babi dhe vëllai im, - dhe pas kësaj tërhiqte karrocën me kukulla dhe lodrat e saj të cilat përmbyseshin në rërë dhe duhej të ndalej që t’i mblidhte herë pas here.

Çadra, ndërkaq, që ngritur dhe burri do të fuste kokën brenda saj për të marrë një sy gjumë, një a dy orë pa ndërprerje. Gruas do t’i duhej edhe ndonjë çerek ore për të përgatitur mëngjesin, përpara se të thërriste fëmijët të vinin në trapez për të ngrënë.

Ky ritual, ditën e parë, që i vetmuar. Por më pas u bë shtysë dhe u kthye në zakon për gjithë sërën e kabinave të “Hekurudha”, në plazhin e Durrësit. Mbarë hapësira, si me kubikë, mbulonte rërën dhe që poeti, mbase do ta krahasonte me një cergë shumëngjyrëshe. Ky ishte ngritur një orë më parë dhe ishte futur në ujë, që andej vështrimin e mbante nga “Hotel Adriatiku”. Se, atë vit, ndryshe nga tradita e ardhjes së turistëve si me kokrra, kishin vërshuar truma-truma. Kjo fliste për një erë të re, vrulli i së cilës që nisur pas ngjarjeve të Rumanisë. Diktatura tek ne, në përpjekje për ta shtyrë jetëgjatësinë e saj kishte filluar një lloj “hapjeje”, era e së cilës mund të kthehej në furtunë. Këtë e ndiente Poeti dhe mbushej me kurajë, që të mos tutej e të ngulmonte në përpjekjen

e tij, për të gjetur francezen që i humbi e u zhduk pa lënë gjurmë. Prandaj, rituali i mëngjesit tek ai kishte këtë motiv. Dhe futja në det, s'kishte si qëllim parësor thithjen e jodit, sesa aromën e lirisë që mbartnin me vete bujtësit e zbarkuar nga matanë detit. Por deri tani s'kishte gjasë. Një e tillë iku sapo ajo u shfaq. Ishte zanë a shtojzovallë? Një zot e di. Prandaj ai kishte shkuar te lulishtja pas hotelit, gjë jo fort normale për shqiptarët, zonë që vërtet s'kishte tabelë, siç ndodh kur është *ushtarake*, por ia kalonte për nga zarari po të shkelej. Guximi i poetit e kish nëpërkëmbur frikën, sido që pa sukses. Ndërsa lulishtarit i kishte kërkuar një karafil dhe prova i kishte dalë për së mbari, se ai i kishte buzëqeshur para se t'ia jepte. Gjë që u kthye në motiv për poetin. Ndërsa për lulërritësin karafil shkante te e dashura e këtij djaloshi. Bukur! Le të mendojë kështu, - thoshte poeti me vete. Se unë për të e marr, ndonëse ajo mungon. Kësisoj, çdo ditë, poeti, kinse për karafil, kalonte nga ai se mos ndoshta, rastësisht, takonte dikë tjetër frëngjishtfolës, por më kot. Në dy raste kishte dëgjuar të flitej gjermanisht dhe tri të tjera në anglisht. Ky merrte karafilin dhe gjente, kështu, një lloj prehjeje e qetësie shpirtërore nga ankthi dhe padurimi të takohej sa më parë me dikë që parandjenja i thoshte se do të qe frëngjishtfolësja. Pra 'idhulli' i tij në këtë Botë.

Hovëzohej kur, tek lahej në det, në mëngjes herët, hidhte sytë nga ajo hijëza e asaj familjeje të vogël, që dukej e gëzuar, e mbledhur nën atë çadër. Se ëndërronte ta kishte një të tillë. Madje e merrte dhe si model. Prandaj shihte që larg atë tendë ngjyrë jeshile dhe i dukej brerorja më e lumtur në gjithë atë brez rëre. Veç të tjerave, ajo çadër qe për të edhe si pikë orientimi. Se burrin do ta sillte treni më shtatë, e tepërta, më shtatë e pesëmbëdhjetë. Gjë, që do të thoshte se poeti kishte bërë

pak më shumë se një orë banjë deti. Kaq mjaftonte. Dilte nga uji dhe kthehej me karafil në dorë, të cilin e fuste në një kavanoz me ujë për ta zëvendësuar ditën pasardhëse. Rastësia i kishte rezervuar edhe një kënaqësi tjetër: atë që kur përgatiste bukën me reçel nxitonte ta bënte këtë, mbasi vogëlushja në kabinën ngjitur ishte tejet nazemadhe dhe e ëma për ta motivuar të hante reçelin, që ajo me vështirësi e pranonte, i thoshte:

-Ja e shikon, edhe xhaxhi komshiu me reçel e qumësht e ha bukën. Eja shpejt se na e kaloi.

Duhej thënë se jo vetëm “xhaxhi komshiu”, por tërë sëra e kabinave, e madje mbarë lagjja e pushuesve, reçelin kishin për bazë në ushqimin e mëngjesit, si dhe qumështin që kishin filluar të sillnin fshatarët. Perestrojka alla-shqiptare e tufëzave dhe arëzave kishte përmirësuar diçka. Se një pako gjalpë për familje s’dilte gjekundi. Pra që të ndodhte gara me vogëlushen, poeti do të nxirrte nga sirtari dorëshkrimet dhe do të hante ngadalë, duke e pasur mendjen edhe në to. Në të vërtetë ai kishte dy palë dorëshkrime. Një të përfunduar, tashmë, dhe një tjetër të cilit nuk guxonte dot t’i rikthehej për shkak të dramacitetit që përcillte materiali. Çuditërisht të dyja, ndonëse të shkruara në kohë të ndryshme e nga njerëz të tjetërlllojshëm, kishin të përbashkëtën se qenë radhitur nga dy njerëz në vetminë e tyre: njëri-drejtues ekspedite që kishte humbur ekipin e tij dhe tjetrit i qe bjerrë gjithçka: Shokët, studimet, e dashura e tij dhe LIRIA, kur qe vetëm njëzet e dy vjeç. Kusurin e mbetur të jetës e kishte kaluar në burg e në internim në një humbëtitirë. Sidoqoftë, gara me vogëlushen, disi e qetësonte poetin.

Në krahun e djathtë të kabinës ishin tri vajza të reja të cilat, përpara se t’i kishte bashkuar mosha, i kishte puqur pesha trupore. Njëra më e shëndoshë se tjetra dhe po aq e llastuar dhe tekanjoze. Shpërfillja e treguar

nga poeti, për to, i bënte edhe më të pakujdesshme në fjalorin e tyre, që përveçse ishte gricës, qe dhe thumbues, e madje edhe ngatërrestar. Se ato nisën të shprehen, fjala vjen: Ç'u bë aksh send që e lashë mbrëmë mbi trapez, pa thënë gjë, kur përgjigjej tjetra: e futa unë brenda. Por kjo, s'i shtonte e as i pakësonte kurr gjë shpërfilljes së poetit. Ky vazhdonte të lyente bukën me reçel, gjithmonë me atë ngadalësi që kërkonte mosfitimin e garës me mituraken në kabinën tjetër. Ndërsa sjelljen e këtyre "buallicave", siç i quante, me gjasë ai, e priste. Se njëra nga ato duhej të ishte vajzë-teze me Ortepin, me të cilin kishte qenë së bashku në shtëpinë e fëmijëve në të mesme. Kujtesa e poetit ishte e freskët, ndërsa e tjetrës-shterpë. Se ajo kishte ardhur në shkollën e tyre me dhjetëra herë me të ëmën. Por edhe mund ta hiqte veten si harraqe. Ritualin i mëngjesit tek ato vajza qe krejt i ndryshëm. Pa hapur ende sytë nxirrnin televizorin, e vinin në parahyrje dhe kërkonin ndonjë stacion italian. Befas kanali dha një tufë beduinësh në shkretëtirën e Saharasë. I pari i tyre kishte zbritur dhe tërhiqte për kapistalli gamilen. Karvani, që edhe ai sapo kishte mbërritur, kishte ndaluar. Njerëzit në ekran, ngaqë ishte ditë, s'dalloheshin mirë, veçse si ca njolla të pakuptueshme, që të jepnin idenë e një baltovine, a një moçali. Ekranin ishte me front nga kabina e poetit dhe e fqinjës së tij të vogël. Njëra nga vajzat, tek shihte drejtuesin e hutuar beduin dhe pavendosmërinë e tij për t'i dhënë drejtim gjithë karvanit, lëshoi një batutë sipas parimit "bjeri pragut që të dëgjojë dera":

-I shkreti, duket si *Sokrati i vujtur!*

Bufalaqet shpërthyen në gaz. Ndërkaq vogëlushja që i kishte sytë nga ekrani, pyeti të ëmën:

-Mami, çfarë janë ato njolla të errëta?

Poeti, që e kishte kuptuar se për ku qe nisur shigjeta e trashaluqeve e kishte kapur në ajër atë dhe rastin priste

e ky i doli më shpejt, në mos i menjëhershëm, falë asaj së voglës që pyeti. Prandaj pa i lënë kohë mamasë së saj të kthejë kryet e të përgjigjet tha:

-Duhet të jenë buallica të ngopura, vogëlushe.

Vajza shpërtheu në gaz. Edhe e ëma qeshi, ndonëse bënte përpjekje, duke kafshuar buzën e poshtme që të ishte sa më e përkorë. E qeshura plasi edhe midis buallicave gjithashtu. Ajo përfshiu të paktën dy syresh. E treta s'e deshi veten. Se duhet të qe ajo që lëshoi batutën e, madje, duhet të qe ajo dhe e zonja e televizorit. Dhe, në pamundësi për të thënë një gjë më të mirë, e fiku aparatin duke treguar hapur, jo vetëm pronësinë mbi të, por edhe pakënaqësinë ndaj shoqeve. Për poetin ajo qe vajza e tezes së Orthepit. Një "buallicë" pa emër.

-Sa mirë e bane, o goce, - foli një grua e moshuar tiranase, matanë trashaluqeve. - Na bane të na binin veshët rehat. Se sun e kuptoj dot moma at' taliançen.

Pas kësaj poeti do të zhytej në dorëshkrimet e tij edhe për rreth dy orë, derisa iu kotën sytë, por s'e la veten të flinte. Shkoi e u zhyt në ujë. Ndërkaq vajzat e ... majmura, që gjithashtu ishin kredhur në det, e madje, kishin bërë edhe banjë dielli, u kthyen në kabinë. Ato s'ishin dhe aq trashaluqe sa i përket kërshtërisë dhe nisën të hedhin e presin një top llastiku, i cili patjetër që duhet të binte, si rastësisht, në territorin e kabinës së "*Sokratit të vujtun*". Ato shtinë "kompanjeshti" për të vendosur atë që do të shkonte e ta merrte topin edhe pse kishin të tjera rrugë. Njëra nga të cilat, t'i thoshin vogëlushes, që po lozte me lodrat e saj në rërë. Risku apo hileja që të ndodhte i ra Ortepëzës, pra kushërirës së Ortepit, e cila duke pasur kujdes zbritjen e shkallëve prej dërrase nuk mund ta shmangte kërcitjen e tyre si të qe ndonjë lopë që ecte mbi to. Kur mbërriti, u ul dhe e mori topin. Ashtu si rastësisht lexoi me zë të lartë atë që i kapi syri: "*Ditar për*

një ekspeditë tragjike".

-Qyqja! - tha njëra nga të dyja vajzat, duhet të jetë patjetër përkthim.

-Po. Përkthim qenka, se ja ku është dhe fjalori i frëngjishtes, - tha Orthepeza.

-Qenka përkthyes, - kuturisi njëra nga vajzat e kabinës.

-I paskam rënë në të për "*Sokrati i vujtun*".

-Po, por ne na boni "*Buallica të ngopura*".

-Dro s'e kishte për ne llafin ai.

Por e para nuk i ktheu përgjigje. Ajo, përveç që ishte thelluar të lexonte diçka më shumë nga përkthimi, me mjaft tinzëri, hapi sirtarin e trapezës dhe po kontrollonte një kapelë, tip berete, por vajzash. I bëri, sidomos përshtypje rrethi i tij në një krah, që ishte i fortë e metalik si krehër. Nxori përfundimin se ai duhet të ishte magnetik, pasi mbi të qe një biçak, të cilin me vështirësi e shkëputi. Dhe, që të mbulonte vëzhgimin lexoi:

Vdekja, si perëndesha Hipotermi, si e dashur po më vjen...

- dhe s'mundi ta shpjerë më tutje leximin, se shoqet panë të dukej në rrerë "*Sokrati i vujtun*", që po kthehej nga deti. Vajza me topin në dorë zbriti shkallët e kabinës dhe, nga ngutja, që të mos e kapte tjetri *me preshe në dorë*, tundi tavolinën dhe bëri që të rrëzohet e të derdhet mbi tryezë, vazoja që mbante karafilin e kuq. Për fat të mirë gjithë uji rrodhi pa dëmtuar dorëshkrimet. Por të gjitha këto veprime ai i pa nga larg dhe, natyrisht, që e dalloi Orthepezën. Vuri qelqen në vendin e vet, i hodhi ujë nga kana që mbante në cep dhe vendosi karafilin. Ndërsa "*Buallicat*" nisën të hanin një shalqi duke përplasur buzët sikur ishin strukur në llucë dhe ripërtypnin. Poeti pa dhe kuptoi shumë dhe, meqë s'mungonte gjë, i shpërfilli. Veçse, gjatë atyre ditëve, vëmendjen e kishte pasur pikërisht te ky person: Orthepi. Ose më saktë: Ortep. Dhe jo se kishte ndonjë mall për të, ndonëse

shokët e fëmijërisë gjithmonë kur i kujtojmë, ata s'vijnë pa një trak në zemër e jo rrallë pa një vuajtje shpirtërore. Por, në rastin në fjalë, përkundrazi: kjo shndërrohej në duf, ndonëse disi i zbutur, për shkak të melhemit-kohë. Gjithsesi, inati kësodore nuk është se zhduket. Ai kthehet në një kujtim idhnak, pezmi i të cilit mbetet edhe më gjatë, me dekada, për të mos thënë gjithë jetën. Se kishte në dorë fletoren e një njeriu që në moshën njëzetedyjeçare, fati i mbrapshtë e udhëhoqi në një drejtim që diktatura do t'i shkatërronte të gjithë jetën. Prandaj kontaktin me të poeti e shihte përherë të lidhur edhe me Ortepin. Në atë ditë të paharruar, alpinizmi, kur rrëshqiti në shkëmbinj, për t'u braktisur nga ky njeri dhe për t'u ndihmuar nga ai, që kishte kaluar kalvarin e vuajtjeve trupore, por që kishte një shpirt të madh bujar, po ashtu.

Poetit kaq i duhej që të kujtonte tinëzitë e Ortepit. Ditët në konvikt dhe sidomos drekat, të cilat asnjëherë nuk i ngopnin e, megjithatë, ishin mësuar me atë gjendje të cilën s'mund ta ndryshonin, gjithashtu. Kurse Ortepit ndonëse jo shpesh, por sidoqoftë i vinte kumbari dhe i sillte për të ngrënë të paktën pesë-gjashtë herë në muaj. Ky, jo se ishte kryengritës, por se qe skuth. I pillte mendja vetëm për tinëzi, të cilat, kur ia kuptonin shokët, nishnin dhe e tallnin: Orthi-milorthi/ çimi-çimi torthi/ pesë e dy sa bëjnë? Me këto fjalë pa ndonjë kuptim e të rimuara, ata e tallnin, por kjo s'e pengonte Ortepin të shkonte në kuzhinë dhe të kthehej që andej me një pjatë të dytë me makarona ose pilaf orizi. Në fillim të gjithë mendonin se kuzhinierja kushedi se për çfarë arsye ia kishte dhënë. Por, pas një jave, dikush e kishte përgjuar dhe doli hileja. Ortepi, pasi i kullufitte makaronat, këpuste një qime nga favoritët e tij dhe ia ngjiste pjatës. Me të në dorë, i shkonte pa pikë turpi kuzhinieres së moshuar dhe i

thoshte plot seriozitet: -Shoqja kuzhinierë! - më duket se të ka ardhur koha të dalësh në pension. -Pse? - e pyeste ajo gjakprishur. - Se ja. Dhe Ortepi i tregonte pjatën me qime. - Kjo është e shokut tim të bankës. Erdha unë, se atij i vinte turp dhe u mjaftua me derdhjen e makaronave në banjë. Kuzhinierja, për ta mbyllur këtë, ia mbushte sërish. Por Ortepi e përsëriste vazhdimisht se tavolina ishte prej tetë vetash, dhe atij në emër të grupit s'i vinte aspak zor ta rifillonte avazin.

Poeti i kishte thënë disa herë që të hiqte dorë nga ky maskarallëk. Se kuzhinieren e kishin parë duke qarë prej kësaj, sa herë që ti, ose dikush tjetër si ti, bën të njëjtën. Se sheh rrushi-rrushin dhe thartohet. Se ajo e ka burrin invalid dhe se po e pushuan s'ka as djalë që t'i ndihmojë. Por Ortepi përgjigjej:

-Nuk më duhet! Edhe unë s'kam nënë.

-Ne kemi nënën Parti, - provokoi poeti dhe Ortepi lëshoi një *mendere* me gojë dhe shtoi: - **që s'na ngop dot as me bukë.**

Kësisoj, puna u trash aq shumë sa e mori vesh kujdestari, i cili ia ngriti çështjen drejtorit. Ky, atë donte për kuzhinieren, korrektësia e së cilës s'bënte pjesë në ato që i kishte ves drejtori, i cili darkave ndryhej bashkë me kujdestarin dhe rrëkëllenin faqoren e rakisë pa një copë mish, se gjellëbërësja ua kishte kundërshtuar. Kësisoj vjega u gjet. Ky ishte i pangopuri dhe i pashpirti Ortep. S'qe e vështirë të zbuloheshin edhe dy tipa të tjerë, sipas rekomandimit-Ortep dhe fatkeqes së kuzhinës iu gatua një gjyq shoqëror i sindikatës. Përfundimi: Pushim nga puna. Shkaku? "Mungesë mprehtësie shikimi". Vendin e saj e zuri një gjellëbërëse më e re në moshë, mikeshtë e drejtorit dhe ky tani rakinë, në mbrëmje, e pinte me copa mishi, të skuqura për meze. Madje, akçesha, i shkonte drejtorit darkave dhe merrte *udhëzime* për drekën e

nesërme. Në këto raste, gjithmonë, po gjithmonë ama, në paradhomën e zyrës së drejtorit do të gjeje kujdestarin që ..., priste të dilte ajo palo gatuese nga *udhëzimet*. Për pushimin e kuzhinieres së moshuar, të gjithëve iu erdhi keq. Por fëmijët s'mund të bënë spiunin. Kurse Ortep-i, në fillim rrinte si mbi gjemba dhe, me kalimin e kohës, zuri pozicionin e atij për të cilin merr kuptim shprehja, "kujdes! S'bëhet shaka me zjarrin". Dhe ai u bë me të vërtetë zjarr e shkuar zjarrit, "thëngjill i mbuluar".

Në prag të maturës, kërkesat për shkollën e lartë duhej të kalonin patjetër te operativi i zonës. Poetin e thirri ai dhe i propozoi të bëhej bashkëpunëtor i sigurimit të shtetit. Ky s'kishte aspak dëshirë të merrte rolin e Ortepit dhe nuk pranoi. Ca, që u ndodh i papërgatitur dhe ca ngaqë s'ishte mësuar t'u përbishtej gjërave, por edhe sepse nuk mund ta quante me emrin e tij të vërtetë spiun, u ndodh bosh për të argumentuar kundërshtinë.

Operativi u hodh menjëherë në sulm:

-Shiko se... ti si shok banke me Ortepin, nuk mund të më shitesh mua më i mirë se ai... "orthi-milorthi", që bënte veprimin e ulët për të përparë ndonjë pjatë gjellë. - E ke ditur dhe s'ke treguar në drejtori për këtë akt të ulët. Pra, ia ke mbajtur të fshehtë Partisë. Apo e kini ndarë të dy atë pjatë gjellë?

-S'është e vërtetë.

-Thua ti. Por ç'thonë faktet? Kuzhinierja u pushua nga puna dhe ti duhet të përgjigjesh për mosdenoncim.

-Mosdenoncim se shikoj pjatën time kur ha bukë? Kjo është çmenduri! - dhe pas kësaj poeti u ngrit dhe doli nga dhoma ku e kishte thirrur operativi. Ky lëshoi, si predhë, kërcënimin: - Qaje të drejtën e studimit!

Kjo jargavitje do të mjaftonte që edhe revolta e djalit të shpërthente në një mllef të pakontrolluar. Rrëzohej,

kështu, ëndrra e tij e madhe: Ajo që donte të vazhdonte për gjuhë-letërsi. Përmbyseshin, kësisoj, të gjitha planet e tij për jetën. Humbiste kuptimi i saj. Dhe kjo s'duhej të ndodhte assesi. Aq më pak prej këtij njeriu të sigurimit e të shigjetës së tij helmuese.

Ato çaste, këtij djaloshi jetim, një zë i largët, mbase ai zë që, vështirë se ndodhte te çdo njeri, por i *rezervuar* vetëm për genet e jetimit për të mbijetuar e për ta frenuar nga ai provokim, ia ndali shpërthimin vetëshkatërrues.

Ashtu siç ia ndal shkopi të verbrit përplasjen me objektet. Se zemra vërtet i rreh të ndjekë drejtimin e ëndrrës, por mendja duhet t'i tregojë udhën. Dhe ajo, lipset në çdo rast, të jetë e përzgjedhur.

Ai s'kishte pse përgjigjej për një faj të pabërë. Madje fare të kotë. Kurrresi të shkatërrohej gjithçka për kapriçio të këtij palo operativi, të cilin duhet ta kërcënonte po me atë parti, në emër të së cilës iu bë presion. Se ishte jetim dhe "*nëna-parti*", duhej të luante edhe rolin e babait. Gogoli-parti patjetër duhej të vlente për të dy. Kësisoj rihapi derën po me atë vrull që doli dhe, pa e ulur aspak hovin, u mat të fliste. Por operativi vijoi tragën e tij:

-Po vazhdove me këtë kryeneçësi, kokën tënde do të thyesh, se miniera e Spaçit të pret. Tipa si ti atje e kanë vendin. Mos kujto se nuk të dimë. Ti kështu ke qenë gjithmonë.

-Po, - tha djali. -Mbaj mend kur isha bebe. Unë kështu bërtisja kur ma hiqnin biberonin se nëna që e dobët e, megjithatë punonte përkrah tim ati dhe, për fatin e keq u vra bashkë me tim at, kur shkonte ta ndihmonte atje, rrzëzë malit, tek nxirrnin gurë për të ngritur një shkollë në fshat. Por nuk u ktheva për këtë. Por për t'ju falënderuar për kërcënimin. Si dhe për t'ju thënë që të keni kurajën, që këtë kanosje të ma përsërisni në komitetin e partisë. Se unë atë kam edhe nënë edhe babë. Atje do t'i pyes

shokët e partisë se kujt duhet t'ia di për faleminderit për të drejtën e studimit: *Partisë, apo juve dhe shokëve tuaj, shoku operativ*. Dhe nuk do të harroj t'i pyes se kur njeriu ha bukë duhet të ketë mendjen te pjata, apo duhet të shohë se ku e fut lugën shoku i tij: në gojë apo në vesh. Përndryshe akuzohet për mosdenoncim. Pas këtyre fjalëve, ai doli po me atë vrull që edhe hyri, aty më parë pa pritur përgjigje nga njeriu që duhej të kishte të paktën moshën e të atit të tij, nëse ai do të qe gjallë. Thua të kenë familje kjo sërë gjallesash me emrin **sigurimi i shtetit?**!

Këto i shkuan nëpër mend, në ato çaste, atij djaloshi dhe përgjigjen ia dha vetes kur u ballafaqua në komitetin e partisë. Atje shkathtësia e këtij myteberi u nguros. Ajo, që keni dëgjuar të thonë se “edhe zoti duhet frikësuar”, këtu gjente zbatimin më praktik. Se këta “farë trimash” e kishin një vend ku faleshin dhe dikë që u jepte udhëzimet, i peshonte nga veshët sipas parimit: “*me se e ke potisur gomarin*”? Gjithsesi nuk duhej rrëzuar puna e këtyre sigurimsave. Por një kryeredaktor gazete kishte ndërmjetësuar se ky talent duhej mbështetur dhe për të shpënë në vend këmbënguljen e eprorit të sigurimit, e dërguan djalin në dyvjeçaren e Shkodrës dhe jo për gjuhë-letërsi. Më pas u emërua arsimtar në një gjimnaz province në rrethin e Durrësit. Po Ortepi, shoku i tij i bankës? Është e kuptueshme, që ai do pranonte ta kryente me rrogë atë që e kishte bërë pa shpërblim. Prandaj edhe firmosi. Ironia ishte se ai përfundoi për gjuhë-letërsi, pas së cilës u fut në një kurs disamujor, të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për t'u bërë hetues, Poeti s'e dinte më tutje fatin e tij. Por s'është se e njihite më mirë të kaluarën e largët. Thua të qe paracaktuar risku i tij, apo ishte përzgjedhur që herët për t'i shërbyer një qëllimi tejet djallëzor?

Kompleksi i Edipit

Fëmijëria e Ortepit s'kishte asgjë të pazakontë deri në moshën pesë vjeç, stad në të cilin iu pre gjuha e komunikimit. Shqetësimet e prindërve të tij, ngaqë nuk fliste fare, rriteshin mbase po aq shpejt sa edhe veshët e këtij djali, sytë e të cilit gjithmonë po vazhdimisht, shihnin nga babai dhe e shponin tej e tej atë si një ndëshkim tërësisht i pamerituar.

Ç'kërkon nga unë ai vështrim sfilitës? - pyeste veten i ati dhe gërmonte së brendshmi për ndonjë dëshirë të tij të paplotësuar nga moskuptimi. Dhe të mendosh se kishte lindur i tillë, do të qe gjysma e së keqes. Por ai, derisa mbushi pesë vjeç, fliste. Pas kësaj i iku goja. Ç'kishte pësuar xhanëm? Për të qe asgjësuese pyetja, nga se vuan dhe sillte brengosje gjithashtu. Sa më shumë meditonte për të, aq më tepër diçka ia digjte shpirtin e pafajshëm. Më keq se prushi zhuritës, këmbën zbathur të vënë mbi të nga pakujdesia. E kishin shpënë, këtu e atje, në mjekë dhe, përveç ngritjes së supeve, doktorët s'qenë në gjendje të thoshin ndonjë gjë më shumë. Madje, kishin provuar më kot të shkonin edhe në vende të shenjta. Ortepi s'kishte pikë dëshire të lozte përjashta me moshatarët e tij, edhe kur ndodhte kjo nuk shoqërohej fare. Qëndrimin armiqësor e shprehte me vrazhdësi të fytyrës dhe agresivitet. Po, ende, godiste gjithkund dhe

këdo që do t'i shtrinte dorën për ta ledhatuar (nga të rriturit), ose për të luajtur nga vërsnikët. Asnjëherë nuk iu përgjigjej me gojë pyetjeve. Atë nuk e hapte fare. Grushti po. Mbase në të që kruspullosur edhe 'nyja' e tij. Këtë ia kishte nënvizuar ndonjë pediatër prindërve. Sidomos, i fundit, që thelluar më tepër dhe kishte këmbëngulur që të takohej detyrimisht me një psikiatër.

-I gjithë defekti i kësaj 'krijese' (ai s'kish thënë i këtij 'fëmijë' e as i këtij njeriu), duhet kërkuar te 'kruspullimi' i tij i panatyrshëm dhe...

Mjeku pediatër, paksa gjinkallë nga natyra, por tejet i aftë e pasionant në punën e tij, e kishte ndërprerë bisedën për të mos vazhduar në sy të fëmijës. Pasi, ky vërtet që s'fliste, por kjo nuk do të thoshte se edhe nuk dëgjonte. Aspak. Aq më tepër, që vështrimi i tij nuk i pëlqente fare doktor 'gjinkallës'. Se kur gjallesa hesht, atëherë lindin edhe probleme. Se nuk njohim kodin e saj. Është mençuri apo djallëzi.

Kështu ai kishte gjetur një fjongo për të mbështjellë e, madje, paketuar bukur, këtë send shpërthyes, siç do ta quante me të drejtë dhe e kishte larguar bashkë me të ëmën. Se donte t'i thoshte që sjellja e fëmijës ishte e gënjeshtërt, false. Pra: djallëzore. E shtirë dhe po kaq edhe neveritëse. Vizita te një psikiatër duhej të bëhej urgjent. Natyrisht kjo e kishte befasuar prindin, por aspak pediatri, i cili kishte vazhduar gumëzhitjen e gjinkallës:

-Janë dymjekëmeemër, i dashur. Kreshtani dhe Fotjani. I pari ka mbaruar në Perëndim, që përpara çlirimit. I dyti në Lindje. Ky merret edhe me kriminalistikë. Unë do të parapëlqejë këtë të dytin. Për një arsye shumë të thjeshtë se defekti i krijesës suaj, i kësaj natyre shfaqet....

Tjetri çakërriti sytë: Mendoi në çast të kundërtën: - E thoni seriozisht, doktor? - dhe mospranimi i tij që pranë

rebelimit.

-Shakatë nuk janë për ne, i dashur.

-Dhe si na e thatë emrin e këtij të dytit, doktor? - e uli ai tonin.

-Fotjan e quajnë, por do të jetë fat ta gjesh pasi ta ketë përfunduar debatin me kolegun e tij, Kreshtan, i cili ka mbaruar në Francë. Në mos bëhej fjalë për dy stile si për dy shkolla, 'Perëndim-Lindje', në mund t'i themi kështu, këto krijesa fatkeqe kërkojnë një trajtim, cilido qoftë kahu i tij, ashtu si dhe emërtesa 'pacient' apo 'klient'.

Njëmend, kur shkuan në spital, të dy prindërit, me Ortepin për dore, infermierja u tha se mjekët ishin futur në një konsultë dhe ata duhej të prisnin. Në të vërtetë, po vazhdonin një diskutim pikërisht për rastet e kësaj natyre. Doktor Kreshtani mendonte se këta fëmijë (jo krijesa), duhet të trajtohen si 'klientë' dhe se, me ta, terapisti duhet të mbajë qëndrim *empatik*, për të kuptuar ndjenjat dhe perceptimet e tij. Një qëndrim të pakushtëzuar. Që do të thotë ta pranojë klientin ashtu siç është. Si qenie njerëzore. Madje, duhet t'i krijohet një mjedis që të mbërrijë ndryshimi. Po ende lipset pozicionuar në rolin e tij. Të mendojë e të ndiejë si vetë klienti. Kështu mund të shohë te fëmija, qartësisht kapriçon e tij.

Krejt kundër kësaj teorie 'perëndimore' do ta quanim për shkak se doktor Kreshtani kishte mbaruar në Paris, qe doktor Fotjani.

Së pari, ky, fjalën "klient" e përbuzte se me të tillë merren berberët e jo doktorët (duke harruar që edhe avokatët, të cilët nuk qëndronin më poshtë për nga hierarkia, përdornin fjalën 'klient'), prandaj duhet të quheshin 'pacientë' edhe këto raste, si edhe të tjerët në mjekësi. Për doktor Fotjanin, këta tipa duheshin mbyllur në klinika psikiatrike, në qoftë se ishin vërtet të tillë, ose pas hekurave të burgeve në qenqëshin simulantë.

Se ti e di se mua më thërrasin dendur në ekspertiza kriminalistike, për të përmendur një copë nga biseda e tyre.

Tjetri tundi kryet se kishte dijeni për këtë të vërtetë, ashtu siç kishte dijeni edhe për qëndrimin e tij antizjarrdurues e të pamëshirshëm, larg humanes e pranë sadizmit.

-Dëgjo, - tha doktor Fotjani, - rastësisht u ndodha në një komision ushtarak për lirim nga ky detyrim atdhetar e një ushtari të plagosur "aksidentalisht" me armën e tij. Gishti e madh, por sidomos treguesin e kishte të varur. Mjekët kirurgë, aspak nuhatës se këtu kishin të bënin me një hileqar, po përgatiteshin të mbushnin formularët dhe të firmosnin çmobilizimin e tij nga shërbimi ushtarak. Unë, me bluzën e bardhë, si dhe ata, s'mund ta lija këtë faqezi ta hidhte lumin pa u lagur. Prandaj u ngrita dhe i vajta pranë,

-Dëgjo këtu ti, - i thashë. - Të dy gishtërinjtë të janë dëmtuar keqas. Cilin do të pëlqente që ta shpëtoje? Mos ndofta gishtin tregues? Se duhet ta pranojmë që jemi shqiptarë dhe e kemi si merak pushkën. E, ajo, pa gishtin tregues nuk vlen... - Jo, - tha simulanti. - S'më zë hiç meraku mua nga kjo anë. -Vërtet? - e pyeta, të sigurohesha se ai po të mos ishte i vetaksidentuar do të përgjigjej: -Ç'thua, doktor?! A nuk po flasim për gishtat e dorës, a nuk duhen ata njëlloj ashtu siç edhe na dhembnin?! Por jo, pohoi se nuk e hante meraku. Atëherë i këpus një shpullë sa më hëngri krahun. Sytë i nxorën xixa ndërsa faqja iu bë flakë e kuqe. Iu ktheva anëtarëve të komisionit, mbasi krisma e pëllëmbës i kishte tulatur si bufërit në kënetë: -Kolegë të dashur! Njerëz si ky e kanë vendin në Spaç ose Bulqizë.

Krejt ndryshe gjykonte doktor Kreshtani.

Dinakëria e Fotjanit ngjasonte me ato të dhelprës, por

doktori kishte parë në Paris se dyqanet ishin të mbushura me lëkurët e tyre, ashtu si edhe burgjet e Spaçit e të Bulqizës me deviatorë të tillë,... dhelparakë.

-Që ia flakërive surratit me shpullë bëre mirë,-tha ai, - se edhe fëmijëve tanë kur gabojnë nuk ua kursejmë atë. Por nuk i fusim në burg, ama. Përse ky çunak duhet të themi se e ka vendin në burg? Për më tepër, në galeritë e Spaçit? Pse t'ua nxijmë jetën këtyre... aguridheve? Ja ky është ndryshimi midis ne të dyve, miku im, - përfundoi doktor Kreshtani.

-Se je ledhatues e liberal prandaj, - tha në formë proteste, por edhe për t'u shfajësuar disi Fotjani, që po i digjte buzën kapuçi i cigares.

-Se je antihuman i skajshëm dhe ekstremist i papranueshëm, - tha doktor Kreshtani, që atë çast futi në gojë një karamele

-Nuk mund të hidhet tjetri në rrugë siç pështyn kapuçin e cigares, - shtoi ai..

Pas kësaj Fotjani doli nga konsulta për t'u rifutur sërish në të javën e ardhshme në një tjetër takim, ku do të përplaseshin dy metoda shkencore, që niste me emërtimet: 'klient'-'pacient', për rastet e tilla. Do të vazhdonte me ledhatues e i pakujdesshëm për të përfunduar deri në liberal. Ashtu si tjetri përgjigjej se qe absolutisht kundër trajtimit si 'pacient' të rasteve të ngjashme pas të cilave do të vinte patjetër edhe një emër diagnoze, aspak për t'u mburrur. Për të përfunduar me epitetet skaj dhe ekstremizëm me brirë. Por edhe me pështyrjen e kapuçit të cigares që po i digjte buzën doktor Fotjanit dhe futjen e karameles në gojë nga doktor Kreshtani. Gjithsesi, pavarësisht dallimeve, ata ishin të dy komunistë dhe kishin një bindje të përbashkët...

Prindërit e Ortepit, më në fund patën durim të presin përfundimin e një debati shterpë të quajtur 'konsultë'

dhe të takohen me doktor Kreshtanin si rishtarët me zellin e neofitit dhe jo me doktor Fotjanin, i cili **s'kishte kohë t'i priste**.

Doktor Kreshtani s'e pati aspak të vështirë të vëzhgojë se Ortepi, si ndonjë kërraç-gomari, kishte ngritur veshët përtpjetë. Prandaj i kishte thënë infermieres të merrej me kontrollin rutinë të fëmijës: laring-faring apo veshët dhe të dy prindërve, ua kishte bërë me shenjë, që të prisnin në korridor. Kur dolën përjashta i pyeti: - Thatë se e quajnë Ortep? Kështu?

-Po.

Dhe mjeku, pesëdhjetëvjeçar, tejet pasionant për punën, s'e kishte kursyer aspak qesëndisjen therëse: - Nuk besoj ta keni pagëzuar?

-Jo, doktor. Ne jemi myslimanë.

-E kuptoj se edhe po të ishit kristianë kisha nuk do ta kishte lejuar kurrë një emër të tillë. Por këto janë kërshtëria e rinisë sime të hershme.

Atëherë, përveç që kishim një bindje, secili në fenë e tij, por rendnim edhe në atë që thuhej për *predestinatën* e emrit. Dhe pas afërsisht, tri dekadave përvojë, e shoh të sendërtuar atë.

-Që do të thotë? - pyeti plot ankth e ëma.

-Të vënë në jetë.

-Ku e shihni, doktor? - u shqetësua babai.

-Në atë që ai është shumë vëzhgues. Por...

-Por?

-Edhe shumë i rrezikshëm në familje.

-Ç'thoni kështu, doktor? - pyetën në të njëjtën kohë të dy prindërit. Pastaj ai i tha gruas të ecte dhjetë hapa në korridor. Kur ajo u kthye, para se burri të kryente të njëjtën gjë, doktor Kreshtani i drejtoi një pyetje që, përveçse tejet intime, ngjante si hetim, hulumtim a zhbirim, madje, aspak etike, deri asgjësuese. Ta lexojmë

atë:

- Sa s'është kthyer ende yt shoq, mos, aksidentalisht, babai i djalit tuaj është kumbari Petro? Po apo jo?

-Po, - ishte përgjigjja e saj dhe koka iu var me dëshpërim. Pastaj pa nga mjeku dhe, me dhëmbë të shtrënguara, shtoi: - E kam njohur përpara tim shoqi. Por nuk mund të bëhej bashkëshorti im. Kurrën e kurrës! Edhe pse ...

Doktor Kreshtani, me vështrim nga burri i saj ligjor, që sapo u kthye, tundi kryet si i pakënaqur për këtë përimtim të lëvizjeve. Atë çast kujtoi "Kompleksin e Elektrës"* dhe tha: Sa mirë që është djalë!

Ndërkaq, hyri infermierja e alarmuar. Klithi:

-Nuk bindet me asgjë, doktor. M'i përplasi skatulat në fytyrë.

Doktori u hodhi një vështrim kuptimplotë prindërve dhe i tha infermieres:

- Mirë, po vij unë.

Ai i flakariti një shikim të rreptë e tejet të përqendruar fëmijës dhe i tha infermieres të afrohej. Me refleksin e stetoskopit i 'verboi' sytë e djalit, duke pëshpëritur në frëngjisht ca fjalë. Pastaj i vuri dorën në ballë kërriçit, si të donte ta shtynte dhe ai ra në pëqinë e infermieres. Kjo e vuri mbi shtratin portativ të klinikës. Doktor Kreshtani tha: - Përgatit barnat e të sëmurëve në pavijon, - dhe ua bëri me shenjë prindërve të Ortepit të afroheshin. - Mos u shqetësoni, hipnoza bëri punën e vet. Ai po fle tani si pulë. Kur të zgjohet, kthehet në gjel. Infermierja u nis në detyrë. Doktori pyeti të atin: - Kush ia ka vënë emrin?

-Një shoku im i punës.

-Dhe ç'punë bëni ju? - vazhdoi ai, kinse kërkonte diçka.

* Ndjenjat e ndrydhura të një vajze për babanë.

-Në sigurimin e shtetit.

Doktor Kreshtani ngriti kryet dhe i hodhi një vështrim tejet zhbirues. Pastaj uli sytë dhe shtoi: -Unë mund ta bëj të flasë në gjumë. Por është më mirë që “ngërçin” ta kalojë zgjuar... Pas kësaj nxori nga sirtari bllokun e recetave dhe ia vuri përpara: -Shkruaj këtu emrin e djalit. - Dhe kur tjetri e shkroi, doktor Kreshtani shtoi: -Lexoje së prapthi! - dhe ai lexoi: Petro.

-Mos ndoshta e quanin Petro atë që këmbënguli t’i vinit emrin Ortep?

Të dy prindërit tundën kryet të verdhë në fytyrë e të budallesur në mendësi. Doktorin e pushtoi një ndjenjë e dyfishtë: ajo profesionale dhe ajo humane. Ky dyzim qe midis kënaqësisë në njërën anë mbi pasionin profesional dhe humanizmit, nga ana tjetër.

-Pas tridhjetë vjetësh kujtoj hapat e mi të parë. Atëherë mësonim se çdo gjuhë është njeri. Unë kam studiuar në Francë. Një shoku im, arab, thoshte: fjalët janë simbole. Frazat janë sipërfaqe valore përmbi një rrjedhë të lëvizshme. Dhe një tjetër, shok, këtë thënie e mori si tezë për doktoraturën. Nuk di se ç’bëri ai se plasi lufta dhe unë u ktheva në atdhe. Psikologjia ime vlejti vetëm për hipnozën. Kirurgët e luftës bënë operacione pa narkozë. Ja pse duhej aftësia ime gjumëdhënëse. Por le të kthehemi te problemi juaj. Në mendësinë e djalit tuaj, diçka tejet djallëzore ka mbuluar ‘*sipërfaqen valore*’, e ka ngurtësuar atë. Ajo ka gjasë të shpërthejë se vetëm ashtu mund t’i vijë gjuha. Dhe si çdo shkrehje, kryhet kur objekti del përpara. Ose shihet shtegu i së keqes. Ruhuni nga ai. Mos i besoni për asgjë që s’është qytetare. Sidomos ju, - i tha ai babait. -Se me ju e ka mllëfin.

Por ishte tepër vonë.

Qe dita e parë që Ortepi foli. Një shok i babait të tij, sigurims si i ati, kumbari i djalit me emrin Petro e takoi

Ortepin, plot njëzet e pesë hapa larg shtëpisë, se kaq ishte distanca nga shkolla.

-Babai në shtëpi? - e kishte pyetur ai me djallëzi.

-Po, - ia kthen Ortepi, që foli për herë të parë dhe shkurt.

-Çfarë po bën?

-Po flet me tokën, - përgjigjet, duke u zgërdhirë ai, në një fjali të plotë.

Kaq do të duhej që sigurimsi të bindej përfundimisht se ai ishte një agjent i dyfishtë siç edhe kishte dyshuar që përpara “pagëzimit”.

Gjysmë ore më pas, një xhip me ushtarakë shkoi në shtëpi. Ai, thuajse i zhveshur, vetëm me kanotiere, po transmetonte me tastë dhe kufjet në vesh. Ashtu siç qe, i lidhën duart prapa shpinës dhe e futën në mjetin e zbuluar. Kur kaloi përpara shkollës, i ati vuri re Ortepin, që qeshi për të parën herë. Kalimthi e pa, megjithatë, por nuk i pëlqeu ajo nënqeshje kënaqësie dhe kuptoi se gjuha i qe zgjidhur. Ngërçi po ashtu.

“Frazat janë sipërfaqe valore, - qenë fjalët e doktorit. Paralajmërimi i tij. Në mendjen e djalit tuaj diçka tejet djallëzore ka mbuluar këtë sipërfaqe valore. E ka ngurtësuar. Ajo ka gjasë të shpërthejë. Se vetëm ashtu mund t’i vijë gjuha. Dhe, si çdo shkrehje, kryhet kur objekti del përpara, ose shihet shtegu i së keqes.

Dhe makina kaloi pikërisht përpara këtij përbindëshi ende të parritur. Sigurimsi ia bëri me dorë atij, në shenjë falënderimi. Ky ishte dhe kumbi i Ortepit, i cili po e shpinte të atin drejt ‘krezmimit’, që do t’i jepnin njëzet e pesë vjet burg. Pra, *drejt ferrit*. Kur shkuan ta merrnin edhe të ëmën e Ortepit, ajo kishte rënë përmbys e pajetë, mbi një pellg gjaku. Se kishte prerë damarët e të dyja duarve. Zgjuarsia e saj kishte përfunduar këtu. Këtë tragjizëm, psikiatri hipnotizues, siç ndodh shpesh me

mjekët pasionantë, do ta merrte vesh e do të shkonte në shtëpinë e fëmijëve për të parë ecurinë e Ortepit. Ai do t'ia rekomandonte një studenti për doktoraturë me temën:

Lindja dhe rritja e një përbindëshi, që urren të atin se, rastësisht e ka parë atë me të ëmën duke bërë dashuri, të cilën ai e dëshironte vetë. 'Kompleksi tipik i Edipit'.

Ai dyshonte, gjithashtu, se kjo mund të ishte një nga ato format e përgjimeve, huazuar nga KGB-ja sovjetike, sepse sigurimi Petro kishte mbaruar në Bashkimin Sovjetik për këto gjëra. Por,... doktor Kreshtani s'merrej me to. Aspak. Të tilla, praktika, për të, qenë 'antihumane'.

Poeti, e tepërmja, kujtonte ndarjen prej tij, pak më shumë se katër a pesë vjet më parë. Atëherë, kur si një grup alpinistik, kishin shkuar në atë organizimin e gjerë të zonave të Shqipërisë së Mesme e lart. Vendi quhej "Pllaja e Bergos" rreth pesëqind metra mbi nivelin e detit.

Poeti, për shkak se Ortepi, kishte "ndrydhur këmbën", por edhe pse aty qe një goxha shkurre e mbushur me manaferra dhe ky, si hamës i deklaruar, s'mund ta linte, kurrsesi, këtë rast fatlum t'i shpëtonte nga duart, pa mbushur mirë barkun, qëndroi bashkë me të. Kjo bëri që grupi të largohej dhe ata të mbeteshin mjaft larg. Të mos harrojmë se poeti tashmë kishte dalë mësues, që prej dy vjetësh, ndërsa Ortepi ishte në përfundim të fakultetit për gjuhë-letërsi dhe aty i kishte bashkuar sërish ky aktivitet programor i shkollës dhe studentëve.

* * *

Ajo ditë mbahej mend edhe pse qe e diela e votimeve për në Kuvendin Popullor. I gjithë fshati, me daulle e me curle, që në pikë të mëngjesit, si të alarmuar, por jo për ndonjë bëmë natyrore, por për një gëzim tejet

të madh, që votën e tyre do ta hidhnin në kuti, ashtu symbyllur dhe mezi prisnin hapjen e qendrës së votimit. Vërtet pllaja quhej Bergo, por kjo përbëhej nga dy kooperativa simotra: Bishtajë dhe Bishtuk, që ishin në garë me njëra-tjetrën. Jo kush të rriste mirëqenien, por kush të shkurtonte kohën e hedhjes së votës në kutinë e votimit. Dy vite më parë, Bishtaja e kishte përfunduar votimin në orën tetë e tridhjetë. 'Rekord', që ishin zotuar ta thyente Bishtuku. - Si na doli nga mendja, xhanëm, i... "çmenduri" lart, rrëzë kodrës? - tha sekretari i partisë, një i rënë 'nga fiku', në Komitetin e Partisë të Rrethit, - se ligji socialist edhe një njeriu të tillë ia njeh të drejtën e votës. "Humanizmi" pa cak mbërrin deri këtu, fatmirësisht dhe ia njeh të drejtën e votës çdo njeriu të përgjegjshëm, derisa nuk ka një raport papërgjegjshmërie, - përsëriti ai, siç e kishte zakon. Ora po shkonte nëntë e gjysmë. Durimi ia kishte lënë vendin nervozizmit. Ky, ashtu si dora-koburen, kishte gjetur ndëshkimin. - Që nesër do t'ia heqim të tria delet dhe të vijë këtu ai beu (!!!) i vogël i kooperativës e t'i bjerë shatit se..., si shumë përpjetë po e hedh, - tha kryetari i Frontit. S'e kishte mbaruar ende fjalën, kur dikush e pa 'votuesin e vonuar'.

-Ja tek po vjen! - tha një i ri, që rrinte te porta dhe priste njerëzit që vinin e pyesnin nëse e kryen plotësisht detyrën e votimit karshi Partisë, apo jo. - Duket i lodhur dhe po lidh qenin te plepi, - plotësoi djali, - është ndonja njëzet metra tutje.

-Aty, ku duhet varur vetë! - shfryu sekretari i partisë dhe shtoi, - kujto qenin dhe bëj hazër shkopin.

-Kujdes, shoku sekretar se, në qoftë se qeni i tij nuhat 20-30 metra larg, në atë distancë, ai dëgjon.

Të gjashtë anëtarët e komisionit qeshën më shumë për të lajkatur sekretarin sesa për të vlerësuar ato që tha. Sa për vërejtjen e dikujt..., do të kujtoheshin më vonë.

Kur mbërriti i “çmenduri”, era e krehabishtasve kishte pushuar. Budallepsja qe ende në lulëzim. ‘Votuesi i fundit’ u ndal përpara djalit, vështrimi i të cilit qe shumë dashamirës. Plaku me uror e strall i kishte vënë zjarrin llullës, që e mbushi në çastin kur lidhi qenin.

-Mirëmëngjes, djalosh! - tha dhe tymin e lëshoi nga salla.

-Mirëmëngjes dhe... mirë se erdhët, xhaxha.

-Kishe të drejtë, aty më parë, kur the se ‘dukem i lodhur’, - tha ‘votuesi i vonuar’ dhe s’priti përgjigjen e tij që mbeti gojëhapur. Por, me vështrimin te sekretari i partisë, ia drejtoi letërnjoftimin kryetarit të frontit.

-Siç e shihni jam njeri. Dhe njeriu për njeriun duhet të jetë mik. Prandaj populli ynë thotë: “*Kujto mikun dhe bëj gati sofrën!*” dhe jo “*kujto qenin e bëj gati shkopin!*”. Se ligjet edhe një asketi si unë, ia njohin të drejtën e votës. ‘Humanizmi pa cak’ mbërrin deri këtu, fatmirësisht, shoku sekretar, apo jo? -Instinktet nuk shmangen lehtë.

Budallepsja u zverdh. Tjetri vazhdoi:

-Me sa di unë, shoku Enver, është akoma Sekretar i Parë i Komitetit Qendror. Kur ta heqin dhe në vend të tij t’ju vënë ju, atëherë në çdo plep varni nga një njeri, siç dëshironit ta bënit për mua. Por dije, kjo Parti kështu mendoi se më bëhet mirë. Të jem atje me ato tri dele, shoku Kryetar i Frontit. Në qoftë se i do për familjen tënde, hajde merri. Unë jetoj edhe me lakra. Se beqar jam. Por në kooperativë s’kam të drejtë të punoj. Se ajo është e atyre që kanë **bashkuar jo vetëm krahët e punës, por edhe mjetet e prodhimit**. Ky është kolektivizimi. Dhe Partia e ka bërë mirë këtë punë.

Të gjithë mbetën të patakshuar. “I çmenduri”, që jetonte tutje vitin e katërt të internimit, quhej Luan Majlindi. Kishte ardhur këtu, në fshatin Bishtuk, pasi kishte kryer njëzet e dy vjet burg. Ky, përveç operativit të zonës, që

për momentin ndodhej te dashnorja në Bishtajë, s'qe takuar asnjëherë me askënd nga ata të cilët folën pa praninë e tij. Gjë që befasoi këdo më shumë se mençuria e kundërpërgjigjes.

Luan Majlindi mori fletën e votimit në dorë dhe kërkoi "dhomën e fshehtë".

Komisioni s'e priste këtë pyetje.

Në fillim panë njëri-tjetrin dhe, kur 'paria' nisi të çuqurisë, kryetari i frontit tha:

-Shumë gjëra lëshove këtu,... kjo e fundit i kalon të gjitha. Duket se të pëlqen shumë radakja jote. Ja ku është perdja. Futu pas saj në daç. Fjala ishte për perden e kuqe te dritarja në krah.

-Këtë që kam mbi shpatulla, quaje si të duash. Unë e dëgjoj se ç'më thotë **se është thinjur kur isha vetëm njëzet e dy vjeç.**

Mori stilolapsin nga trapeza dhe, për gjysmë minute, bëri si i tha kryetari i frontit. I vuri një kryq të madh fletës dhe pati shumë kujdes ta paloste më katërsh para se t'i drejtohej kutisë. La, gjithashtu, stilolapsin mbi trapezë dhe, pa përhëndetur, mbërriti te porta, ku djaloshi ende e shihte si një të zbritur nga yjet. 'Paria' nisi çuqurisjen, kurse gjyshi thithi sërish llullën, si për t'i thënë djalit, ende statujë, se qe i kësajbotshme. Ndaj shprehu:

-Partia i drejton armën armikut, ballazi e jo pas shpine. Këtë zakon e kanë vetëm tradhtarët.

Qeni, te plepi, nisi të rebelohet dhe ai vajti e zgjidhi. Së bashku u nisën për në kasollen e tyre. Qe ora dhjetë dhe kishte ende ditë si për qen, njerëz, miq dhe armiq. Gjithsesi, daullja dhe curlja buçiti atyre gërxeve. Gjindja gëzonin. Të shkretët njerëz!

Aksidenti dhe ndihma e plakut me qenin e tij

Ora, në dorën e poetit, shënonte dymbëdhjetë pa dy a tre minuta. Po të vareshin në një kep atje më tutje, do të zbrisnin pak me vështirësi, por do të zvogëlonin goxha nga ajo largësi, ku në një pozicion krejt tjetër, do t' u duhej një a dy orë ta zinin. Aty do të kishin mundësi edhe të shihnin, si në tepsi edhe çadrat e kampingut.

Ata e rrahën dhe Ortepi, i cili e miratoi kuturu idenë, duke mbushur gojën me një grusht manaferra. Duart dhe buzët ia tregonin çehrenë si maskë nga bluja e errët.

Poeti u kacavjerr dhe, ... këmba i shkau. Ose më mirë të themi se, këpucët e tij alpine, dhuratë e një shkolle ushtarake, ishin nga poshtë si me nallça dhe ato, kur hasën në një copë shkëmbi, si të qe dru i prerë me një goditje shpate, qenë ngjitur me të, si të ishin salduar në metal.

Poeti ndjeu diçka që e rrëqethi të tërin. Se fillonte me dridhjen e dhëmbëve dhe përfundonte te gishtërinjtë, të cilët tentonin të shkëputeshin nga këmba. Ndaj shtrëngohej fort. Atij, menjëherë i shkoi mendja te ndonjë linjë ushtarake tensioni, ku ca më tutje, ata kishin parë një tabelë, për një zonë të tillë, por e kishin shpërfillur. Prandaj lëshoi një zë.

-Ortep! Më duket se rashë mbi korrent...

Dhe s'pati kohë të thoshte më tepër se i duhej të bënte përpjekje të jashtëzakonshme për t'i shpëtuar këtij kurthi të çuditshëm natyror. Tjetri, nga ana e tij, e harroi 'ndrydhjen' e këmbës dhe ia mbathi me të katra nga një shteg lepujsh. Poeti besonte vërtet se s'qe korrent. Ndryshe, me ato hekura në këpucët e tij, do të qe kthyer në një skelet të djegur e shkrumbuar, si plot drurë të përzhitur në forma të frikshme, aty rrotull. Korrenti do të shkaktonte ndonjë shkëndijë, por edhe një lloj zhurme në çastin kur bëhet masë. Prandaj, me gjithë forcën, shkuli këmbën e djathtë, e cila iu duk se qe salduar. Sa keq, trupi u shkëput dhe u rrokullis. Në fillim ra mbi një kaçube. Nga frika apo nga tronditja, i humbi ndjenjat. Më pas, për shkak të inercisë, por edhe mbase të vrullit që të jep lartësia, erdhi e u plandos si një thes me kashtë në një lëndinëz, bari i së cilës, mbase edhe për të njëjtin shkak, ishte ende i paprekur. Faqja e djathtë i ra, së pari, mbi një kashturinë. U përmend pakëz dhe ndërroi disi vend. Kur u shtriq koka iu mbështet në një nënkresë guri, sipër së cilës bari ishte tërësisht si i thatë. Ai qe ende i pavetëdijshëm. Tabani i këmbëve, në çastin që u shtriq, sikur kishte marrë forcë e shtytje. Këtë ia kishte dhënë mbështetja mbi atë gur, me këpucët alpine. Ose më mirë, hekurat si potkonj që rrethonin tabanin e alpineve, ishin ngjitur pas këtij guri dhe për t'u çliruar prej këtij çarku, gracke a merimange të hekurt magnetike, që e kishte mbërthyer, ai përpiquej në gjendje-gjumi, a me ndërgjegje të fjetur. I dukej vetja si peshk i zënë në rrjetën e një vozitësi dhe trupi i dridhej ethshëm. I tillë do t'i shfaqej në ëndrrën e parë, një plak mjekrosh me rrjetën e peshkut hedhur supeve. Më pas, një qen, ndonëse me pamje ujku, sikur i erdhi pranë dhe i merrte erë nga të gjitha anët. Madje, me turinj i binte te këmba e majtë, që ta shkëpuste nga guri-stol. Pastaj kur e pa se nuk ia

mbërriti, vajti i futi feçkën nën zverk. Por kjo qe edhe më e vështirë për të. Njeriu me rrjetë iu paraqit me një trastë shajaku, i cili nxitonte për te poeti. Por edhe s'mundej për shkak të moshës, se me vështirësi ngopej me frymë. Prandaj përkëdheli qenin-ujk, që kishte pranë dhe i tha: -Vrapo te miku ynë. Lëpije në faqe që të zgjohet, se unë, dua edhe një cazë të gjatë kohe të mbërrij deri aty dhe kam frikë se do të bëhet vonë. Ndihma e vonuar kthehet në peng të përjetshëm, kur nuk është tradhti, por vërtet e tillë.

Qeni u nis gjuhëjashtë me nxitim. Kur arriti te poeti, vajti menjëherë te këmba e majtë. Ia futi mirë dhëmbët cepit të pantallonave dhe e tërhoqi. Sakaq këpuca u shkëput nga shkëmbi-stol. I gjithë trupi sikur u shqit, por edhe për shkak të një energjie të brendshme rrotullohet. Koka u zhvendos nga copa e gurit nën atë bar të thatë. Poeti ndjeu t'i dridhen sërish dhëmbët e të bjerë në qetësi. Qe shkukur përfundimisht nga të dy: shkëmbi-stol dhe guri. Ata sikur ia shtrëngonin kryet me tërheqje nga poshtë. 'Elektroshokut' imagjinar i qe hequr priza. Qeni tejte i kënaqur, që ia mbërriti ta çlirojë këtë njeri, u ul dhe me gjuhë lëpinte pëllëmbën, krahun, gjithë dorën. Djaloshi, edhe ashtu në ëndërr, e ndiente shpëtimtarin dhe nisi ta përkëdhelë kafshën te zverku. Langoi, i kënaqur, jargëzonte, por edhe angullinte duke tundur bishtin, ashtu rrafsh me njeriun e shtrirë, i cili qe ende në kllapi.

Plaku, kësaj here, iu shfaq djalit në gjumë, ashtu siç edhe ishte në të vërtetë: me një mjekër si babagjyshi i Vitit të Ri dhe me një torbë lëkure, hedhur mbi sup, nën të cilën kishte një veshje shajaku. Edhe pse gjithë kjo qe një vegulli, djalit s'iu duk aspak e frikshme. Buzëqeshja e tij i shëmbëllente një filxhani të palarë nga kafeja e sapombaruar dhe dhëmbët mund të trembnin këdo.

Kurse buzët, si të përlyera me kafe, dukeshin edhe ato. Por njeriu ka vështimin. E, ky qe shumë paqësor, madje sikur kërkonte falje për vonesën, edhe pse vetullat i kreshpëronin një pezm të vjetër e idhnak si i njeriut që i është prishur gjumi i mesditës nga një shkak që s'ka të bëjë fare me të. Por mund të qe edhe vështirimi i një njeriu, që kishte mbajtur mbi trupin e tij një dënim për një faj që s'e kishte bërë kurrë. Apo nga një arsye që vetëm ai e dinte se ashtu si tejlo dhja e vazhdueshme trupin kërrus, shtypja e pandërprerë, shpirtin ndrydh. Dhe shikimi vrenjtet doemos.

Ky qe Luan Majlindi, që lexuesi e pa kur votoi.

- Më duket se këtë behar do të ndahemi, babushi im besnik, - i tha qenit. Kafsha u ngrit nga pozicioni dhe vajti i lëpiu këmbët. Pastaj u shtriq, si edhe më parë, me fytyrë nga i aksidentuari. Me bisht përkëdhelej duke e tundur në këmbët e plakut, i cili u përkul dhe me pëllëmbën e dorës i përkëdheli feçkën, zverkun, trupin për të nënqeshur dhimbshëm: - E kuptova. Ti s'je dakord, - dhe tundi kryet.

Qeni lëvizi bishtin si të qe kjo shenjë miratimi. Plaku vazhdoi: -Domethënë do të vish me mua? Qeni lëvizi, sërish, bishtin si të qe dakord me një plan të fshehtë, që u përkiste vetëm atyre të dyve. - Të lumtë! - tha plaku, - e paske kthyer si duhet. Ai tani lipset të lihet i qetë se jam i sigurt, që i dëgjon, si në ëndërr, bisedat tona. Dhe këto ia mundësojnë qielli dhe yjet me të cilët është lidhur. Ç'thua ti, miku im? Por langoi nuk tundi bishtin. Thjesht bëri një të lehur me kryet drejtuar qiellit. Kjo do t'i thoshte plakut se ai s'qe aspak i një mendjeje.

-Dakord, miku im. Bëj atë që të duket më mirë ty, - dhe hapi trastën e lëkurës. Nxori aty, një faqore të spërdredhur si qafë gjarpri me kokën e tij. Ia hoqi tapën dhe ia vendosi pranë hundës, vetëm për një a dy sekonda

dhe pastaj e largoi. Sa u mënjanua ta mbyllte grykën e petashuqes, djali jo vetëm që u përmend, por edhe u ngrit menjëherë në të ndenjura me teshtima. Aspak i trembur. Assesi i befusuar. Për të qe një vazhdim ëndrrë, sido që në një dyzim, po ndiqte tragën e vegullisë, apo ishte zgjuar gjatë gjithë kohës, ndonëse disi i pamundur për t'u futur në kontakt me këtë plak babaxhan dhe qenin e tij?

I moshuari i hodhi një vështrim të ëmbël:

-Është pak i rëndë ky lëng, - tha, - ka erë të ndyrë. Por një erëimim të tillë ka edhe fara që ngjiz një jetë. Këtë erë duhet të kishte patjetër edhe ky kundërmim, ndryshe s'do të ta risillte ymrin. Se e barrshme dhe dëshpëruese ishte dhe ajo që të zuri e u shkëput falë këtij langoi të zgjuar.

Djalit iu duk me mend kjo thënie, por s'u përgjigj menjëherë. E ndiente se ishte më i matur e fjalëkursyer se aty më parë, kur u var te ai kep dhe përfundoi në këtë lëndinëz. Kjo për hir të së vërtetës, ngjante paksa e çuditshme, për të mos thënë si përrallë. Hodhi sytë rreth e rrotull dhe gjithçka i shëmbëllente e pazakontë. Se qe behar dhe ai s'shihte flutura të tundnin krahët. As lule aty rrotull s'kish. E, aspak cicërima zogjsh. Edhe gjinkallës zërin s'po ia dëgjonte. Apo s'jemi në kohën e tyre se s'është vapë, por ç'kohë është dhe ç'muaj jemi? Pse bimësia duket si e djegur nëse s'jemi në zhegun e gjinkallave? Po bletë që të gumëzhijnë se shoh bimë dhe s'i njoh në këtë copëz disi të veçantë të kësaj lëndine?

Tek-tuk syri i kapi djegësi të bimësisë dhe nuk e bindte arsytimi se qe punë e rrezeve të diellit. Aspak. Ideja, se bari që, vende-vende, dukej si i zhuritur, vështirë se qe moskundërshtuese për atë, që këtu flitej për të pazakontën. Veç kësaj diçka e veçantë duhet të vepronte aty. Po çfarë pikërisht?

Atë çast iu ndërkëmbye pamja. Plaku iu zhbë nga sytë dhe një si mjegull, a si vegulli, që zëvendësoi figurën e tij e nxiste, që ai të hiqte dorë nga arsyetimi mbi çka po shihte dhe çka dëshironte të shprehte duke parakaluar në mendje si në algjebër: të njohurat në një anë e të panjohurat, në anën tjetër. Pikërisht kjo nuk i lejohej të bënte. Të arsyetonte mbi fenomenin. Atë turbullirë tejet joshëse për diçka më tokësore, për diçka të rëndomtë dhe të shmangte detyrimisht arsyetimet e thelluara darviniane. Kështu e mori poeti mesazhin e asaj shtojzovalleje dhe u bind plotësisht, kur i hodhi, disi tinëz, një vështrim sahatit të dorës. Vjedhurazi pa akrepat e tij: tregonin orën gjashtë, kur donte dhe dy minuta të shkonte dymbëdhjetë, në çastin e rrëshqitjes nga ai kep. Dhe duhet pranuar: u tremb aq sa s'guxonte të pyeste nëse ora kishte shkuar përpara, apo që kthyer prapa në kohë. Fshehtas i hodhi një sy sekondëmatësit: ai ecte rregullisht në fushën e tij. Poeti nuk që në hapësirën e lejuar për njerëz të zakonshëm. Natyra, këtu kishte, me sa dukej, të tjera ligje. Edhe tiktakun ia dëgjonte sahatit kur çoi dorën pranë veshit, ashtu si pa dashje. Por ai s'e dinte që në tëmthin e djathtë që gjakosur.

I moshuari, atë çast, nxori nga torba një tufë lesh si ato të furkave të plakave dhe ia fshiu ballin. Pastaj i tha: - Mos u tremb. Por lëre qenin të ta lëpijë, që plaga të mos mahiset.

Djali u bind. Përkëdheli zagarin në zverk dhe ky, duke qëndruar mbi të dy këmbët e pasme, ia lëpiu plagën me gjuhë. Vendi jo vetëm u pastrua nga gjaku, por vraga më shumë kishte gjurmën e nxirë nga përplasja me gurin, sesa atë të së çarës. Veç kësaj, atij i doli plotësisht frika qoftë nga i moshuari, apo edhe nga qeni i tij.

- Të prisja, - tha plaku.

-Mua?

-Po, ty.

Djali ngurroi ta pyeste për shkakun. Aq më pak edhe se si quhej ky vend dhe kush ishte ky njeri. Frika e ndërlikjes së figurës e largonte nga pyetjet e rëndomta. Shprehu: - Duhet të keni ndonjë shkak bindës për këtë dhe..., nuk e di nëse jam i denjë dhe i zoti për shërbimin që mund t'ju kryej. - Edhe pa shkak s'jam. Por ndihmë s'dua se s'më mungon kuraja të bëj vetëm me qenin tim, atë që dua, - tha plaku.

-Atëherë çfarë prisni nga unë, gjysh?

-Të lë amanetin.

Djali hapi sytë i hutuar. Plaku shkundi kryet. Atë çast iu kujtua prindi me të njëjtën diagnozë si të tijën i një shoku burgu. Mjekët e dërguan në shtëpi njëzet e katër orët e fundit. Por atij Zoti i dha edhe një javë jetë ngaqë kishte merak mbjelljen e ca fidanëve. Po mua?

-Të lë amanetin po pres një vit kohë, - tha.

-Nuk ju kuptoj, o shpëtimtari im.

-Nuk do që të më kuptosh. Se... po ta vrasësh pak mendjen, pas asaj që t'u përplas koka në atë gur dhe këmbët t'u tendosën, në atë 'Fron Qiellor', - dhe plaku tregoi me krye të dy pozicionet, - sytë mund të të bëjnë xixa, por atje ku re ti, edhe pesë minuta të qe vonuar qeni, tani ti nuk do të dije çfarë të kishte ndodhur. Do të flisje e flisje pa mbarim duke nxjerrë gjithë mllëfin, karshi dikujt e të gjithëve se, do të kishte ikur mendja dhe nuk do të kontrolloje dot fjalët. Mendimet gjithashtu.

Poeti shqeu sytë.

-E kuptoj, gjysh. Ky qen, - dhe djali zgjati dorën ta ledhatojë kafshën, - më tërhoqi nga pala e pantallonave dhe trupi im, menjëherë u rrotullua.

-Ekzakt, - e ndërpreu plaku, - por nuk ndodhi kështu

me atë tjetrin.

-Cilin?

-Një moshatarin tënd.

-Vitin e kaluar, mbase?

Plaku shkundi, sërish, kryet përpara se të përsëriste: -Ekzakt... Edhe një vit i vajtur dëm. Peshqesh i padëshiruar nga Petrua, adashi yt... Si koha e fidanëve.

-Pse? Ç'ngjau me të? - pyeti djali pa dashur t'i japë rëndësi emrit, ndonëse tejet i befasuar për këtë përkese me emrin e tij.

-Qe rrëzuar si dhe ti. Se qe i gjatë sa një lis, por mendjeshkurtër sa një dhi.

-Si dhe unë.

-Jo. Se ti s'je sa një lis. Ty të rrëshqitën këmbët nga ai kepi-kurth, ngaqë këta potkonj u thithën si magnet nga ai copë shkëmb, ku deshe të vareshe poshtë. Adashi yt nuk kishte këpucë të tilla. Por ai s'kishte as mend që të mbahej fort për kaçubesh.

-Thatë për kepin-kurth? Po. Ashtu ishte. Unë me vështirësi u shkëputa.

-Ekzakt. Po u shkëpute, ama, - pranoi plaku dhe shtoi, - nuk duhet mallkuar Kepi. Se nuk është dhe aq kurth. Qielli mbase do të gjente tjetër formë që të sillte dikë këtu. Duhej përfituar nga të mirat e këtij guri si dhe fuqia e atij copë-shkëmbi, që unë e kam quajtur "*Fron Qiellor*". Se nga kupa e qiellit duhet të ketë rënë, për të na thënë ne, të vdekshmëve, se: *sa lart aq edhe poshtë*. Se ka bërë që arabët ta shprehin te numri 8. Dy zero, njëra mbi tjetrën, duan të thonë, ekzakt këtë që po dëgjon. Por nuk u kuptuan nga romakët. Ndryshe qenë helenët. Nuhatja e tyre s'mbërrinte më kot në caqet e Odisesë.

Djali mbeti i befasuar. Plaku nxori kutinë e duhanit dhe e mbushi llullën. Me strall dhe uror vuri zjarrin. Era e këndshme e eshkës, sikur i freskonte mendjen. Ndërsa

djali ktheu kokën nga ai copë shkëmb, që dukej se qe me kreshtë edhe pse gjembat e shumtë e mbulonin dhe ia hiqnin shëmbëllimin me majën e një mullari.

-Fantastike! - tha djali.

-Ekzakt, - përforcoi mjekroshi. -Është i tillë që të mos ulet dot njeri. Fuqinë le t'ia marrë kush të jetë i zoti, por vendin e Perëndisë të mos e zërë. Se Qielli s'ka vrima, por megjithatë diç rrjedh në tokë prej tij për njerëzit.

Djalin e befasonte niveli i këtij plaku.

-Mendja jote, tani e tutje, bir, do të punojë më me vrull e do të marrësh vesh edhe për gjëra që s'i ke mësuar. Po si? do të pyesësh ti. Po ja: di unë diçka dhe s'kam ndër mend të ta rrëfej? Ja se s'kam besim te ti, se nuk e flet me të tjerë bisedën; ja se s'është për t'iu treguar kujtdo, ngaqë është nga ato sekrete, që përcillen gojë më gojë e jo me të shkruara. Se edhe në u hedhshin në letër, fshihen me ca sekrete, ashtu si bravat e shtëpisë, që s'mund t'i hapë çdo çelës. Se ç'u kuptua pastaj! Kurse ti, me zgjuarsinë tënde, me shpejtësinë e mendjes, e nuhat si të kishin një shqisë që s'e kanë të tjerët. Dhe..., pyetjet që do të më drejtosh do të jenë të tilla që unë vetë do ta nxjerr në shesh atë që mbaj të fshehur. Ose: një vështtrim t'u hedhësh librave duke i lexuar me vëmendje ato, do të të mjaftojë që t'i mbash mend. Se e thamë: mendja jote do të punojë shumë më shpejt se e kujtdo me të cilët do të kesh të bësh. Askush nuk do të jetë në gjendje të të mposhtë me forcën e argumentit dhe plaku thithi llullën para se të shtonte: -Ti, edhe me heshtjen tënde më bën të të hapem. Domethënë të mbjell atë që do të korrësh ti. E, që ta ngas muhabetin, kur isha në shkollë të mesme, se atë e kam bërë në Francë, ekzaktësisht në Paris, kisha një shoqe. Por qemë me të shok e shkuar shokut. Shokë për kokë. Se kështu më quante edhe ajo. Të tillë qemë për njëri-tjetrin. Jo si ai shoku yt, që ia mbathi sapo u

rrezikove.

Bashkë rrinim në bankë, tok dilnim edhe pasditeve e shoqërisht edhe dëfrenim. Një herë u rrezikua keq të mbytej. Se edhe s'dinte mirë not. Edhe u fut, menjëherë, në lumë, pa mbërritur akoma ne të tjerët. Unë, se kur niset të bëhet e keqja, mbase edhe ti duhet ta kesh vënë re, krijohen kushtet. Është djalli që përgatit rrethanat, ose siç e kërkon shkenca: rastësia dhe domosdoshmëria. Unë, rastësisht, si asnjëherë tjetër, isha ndonja gjashtë a shtatë hapa pas saj, i ndalur të dëgjoja ç'më tregonte një tjetër shok, kur Marseli, se kështu e thërrisnim të gjithë Marsejezën time, bërtiti: -Lu... an! Mua m'u ngjeth mishi dhe, pa kthyer ende kokën, u turra me vrap në drejtim të lumit. I ulërita që t'i jap kurajë: -Mbahu, Marselë se erdha, - dhe largësia më bëri mirë. Sena nuk është det. Është lumë që rrjedh. Dhe unë, atë sekondë, vrapova në drejtim të saj, siç edhe ishim mësuar me Vjosën tonë, kur isha akoma në fillore dhe përgatiteshim t'i vinim në ndihmë njëri-tjetrit, duke ngarendur në drejtim të rrjedhës. U hodha, siç isha, me gjithë rroba. Se vrulli im s'përmbahej me asgjë. Më vonë, me habi rikujtoja, se si në fluturim përshkova tre metra në brendësi të lumit, me një kërcim. Mbërrita përpara se ajo të fundosej dhe e kapa nga shpatullat për ta nxjerrë, në fillim mbi ujë dhe pastaj, ata tre metra, nuk i kisha të vështirë, që njëren dorë të saj ta mbaja mbi zverkun tim.

Kështu, noti i mësuar te Vjosa e gjyshërve të mi, e shpëtoi-paq dhe ajo, më shumë nga frika sesa nga ndonjë pasojë, qe zbehur në fytyrë. Por shakatë e të tjerëve ia skuqën faqet, vesh më vesh dhe ia ngjyrosën fytyrën paparunë. Ata më bënë edhe mua të skuqem më shumë se një lulëkuqe, po të them. Pse? - do të thuash ti. Po sepse ata djem e vajza bashkë, thoshin si në korr: Pu-the, pu-the, pu-the! Dhe nuk është se më drejtoheshin mua,

por Marsejezës. Ajo, siç edhe do ta mësoja më vonë, më donte siç e doja edhe unë, por s'ia kishim thënë njëritjetrit. Ajo kishte menduar të ma shfaqte pas një jave, që do të festonte ditëlindjen. Ky qe edhe shkaku i ngurrimit.

Të thirrurat për puthje vazhdonin pa ndërprerje, kur ajo u qas pranë meje. Ishte e veshur. Edhe unë gjithashtu. Por isha qull dhe që të mos e qulllosja edhe atë, e mora përpara duarve. Brohoritjet u shtuan e u kompletuan me duartrokitje të zjarrra.

-Marsejeza, - i thashë, - ti je jeta ime!

-Edhe ti je imja, Luan. Por, që tani e mbrapa do të të thërras "Tigër" se si tigër u hodhe të më shpëtoje jetën.

Pastaj, doemos, që më puthi. Edhe unë do t'ia ktheja të puthurën dhe, nga nxehtësia, që më hipi, m'u duk se u thanë rrobat në trup. Këtë e ndihmuan edhe duartrokitjet e shokëve. Turpi i atymëparshëm, qe kthyer në kënaqësi. Ka qenë dita më e gëzuar e jetës sime. Më e ngrohta, edhe pse isha bërë i gjithi qull. Sena, atë ditë, për mua qe kthyer në rrymën e ngrohtë: Gollf-String.

Edhe për Marsejezën ka qenë dita më e lumtur e jetës së saj. Familjen e kishte në gjendje të mirë, prandaj organizoi në mbrëmje, një festë, ku ftoi gjithë shokët e klasës sonë, si dhe prindërit e mi, që ishin personel në ambasadën tonë në Paris. Para mbarimit të mbrëmjes, Marsejeza më tregoi sekretin e suksesit të saj në mësim. Ajo kishte një kapelë tip 'berete', që ndonjëherë edhe e mbante mbi flokë, në krahun e djathtë. Këtë e bënte më shumë në pushimin dhjetëminutësh. E nxirrte nga xhepi i pasmë i pantallonave dhe e vinte, jo më shumë se dhjetë minuta, për ta futur në xhep përsëri. Askujt s'i shkonte ndër mend se ç'efekt magjik fshihte ajo kapelë. Ndonëse të gjithëve na kishte rënë në sy fanatizmi, që rrëfente, kur dikush kërkonte t'ia merrte me shaka. Qoftë edhe kur ajo e harronte në bankë dhe dilte me ne në pushim.

Do të kthehej vetë të shkonte ta merrte. Edhe unë s'bëja përjashtim për atë kapelë dhe pse i kisha kërkuar ta ndihmoja. Përligjja për 'beretën' kishte këtë shpjegim: e kam kujtim nga gjyshi, ashtu siç kam edhe emrin. Ai ka qenë partizan me De Golin. Unë, në intimitet e kisha pyetur: - Dhe gjyshi ka qenë i shkëlqyer në trigonometri? Ajo pati vënë buzën në gaz, duke e kaluar me këtë mënyrë përgjigjen. Se kur njeriu s'do të tregojë të vërtetën, duhet patjetër të gjejë një formë të butë rrugëdaljeje, gjë që Marseli im e zotëronte me buzëqeshjen e saj dritëplotë. Me të unë kuptoja se në qoftë se 'bereta' sillte fat, s'kishte arsye që ajo ta hiqte nga koka e saj për ta vënë në një tjetër kokë. Dhe unë kuptoja se gjyshi i saj partizan, me atë beretë i shpëtoi luftës dhe ia mbërriti ta pagëzojë edhe mbesën e tij, Marsejezën. Kapela dhe emri ishin muza, kënga e parë e menduar, mbase përpara ngjizjes. Fati i saj i dytë ishte kënga e përditshme: avazi.

Marseli im ishte nxënësjë më e mirë e klasës. Librat, edhe pse i merrte me vete në çantë, i shfletonte vetëm në kohën e pushimit midis orëve. "Sa t'u hedh një lexim të shpejtë", thoshte kur e pyesja nëse e kishte mësuar lëndën. Këtu bëhej fjalë për histori, gjeografi, latinisht, a diçka tjetër të kësaj kategorie. Se, sa i takonte matematikës, gjeometrisë a fizikës apo kimisë, për të mjaftonte shpjegimi i profesorit. Ajo ia thithte nga goja, kaq e përqendruar ish. Madje, qe gati ta përsëriste në tabelën e zezë gjithçka u shpjegua në orën e mësimit. Ç'i shihte syri e fiksonte mendja. Memoria vizuale qe e shkëlqyer tek ajo. Një herë, profesori i trigonometrisë ngriti dikë dhe i tha të zgjidhte në tabelë problemin që na kishte dhënë si detyrë shtëpie për ta zbërthyer. Nxënësi u ngatërrua: ca nga hutimi e ca se ushtrimin asnjë nga klasa nuk e kishte "shkopsitur", siç thoshte profesori, që e uli në vend me një notë pakaluese.

Profesori, në këto raste, nevrikosej shumë dhe nisi t'i ngrejë nxënësit sipas regjistrit e ata ktheheshin në bankën e tyre me notë negative. Marsejeza shtrinte dorën për t'u ngritur e për ta shpëtuar klasën nga kjo kasaphanë vlerësimesh poshtëruese. Por më kot, derisa i erdhi radha e saj. Ajo e zgjidhi problemin duke shpëtuar të tjerët që vinin pas saj. I pari isha unë. Mbiemri im, Majlindi, siç dihet, vjen më pas Fini-t që kishte ajo.

Kështu, që ta ngas llafin, u zgjata se ti po jeton çdo ditë me ata djem e vajza, që nesër do të bëhen gjimnazistë, aty ku edhe është shoqëria më e pastër në jetën e njeriut. Se të japësh mësim me adoleshentë është si të jesh fyelltar dhe culja duhet të jetë në mëngën tënde, ashtu si dhe ajri në mushkëritë e tua. Po kënaqësia do të mbushë shpirtin tënd... Atë ditë, Marsejeza më tregoi sekretin e 'beretës'. Në tegelin e saj kishte një copë gur-magnetik. Jo metal. Gur i nxjerrë nga një shkëmb i tillë: magnetik. Tamam si ky copë-gur që të ra koka ty, biri im, por edhe si ai që të mbërtheu për këmbë ty. Marsejeza më shpjegoi se ajo qe: sa e mirë, aq dhe e rrezikshme. Se njeriu po ta mbajë gjatë në kokë, më shumë se dhjetë-pesëmbëdhjetë minuta, mund të shkallojë fare nga trutë. Prandaj, biri im, disa gjëra nuk bëhen me të shkruara.

- Që të mos imitohen?

- Ekzakt!

Djalin e ngriti peshë ky episod, a ky idil gjimnazisti dhe, po ta pyesje ato çaste, patjetër se do të pohonte zilinë për fatin e këtij plaku, në rininë e tij të hershme. Dhe, si për të kërkuar se ku kishte nisur plasaritja e asaj që dukej se kishte ardhur ashtu, pa asnjë shkak nga ato, për të cilat jemi mësuar të themi: ja ku është fillesa e kësaj apo asaj të keqeje, sytë i shkuan te gjembat e atyre shkurreve të '*Froni Qiellor*'. Në çast iu kujtua se ç'kishte lexuar në vitin e shkuar, kur ra zjarri në një librari, e

cila qe ngjitur me një tjetër objekt të braktisur. Se kish qenë gjithashtu librari, por private. U shqyen dyert nga policia zjarrfikëse, e cila arkat me libra të vjetër i largoi duke i flakur tutje, pa vlerë. Poetit i ra në dorë vetëm një fashikull, në krye të të cilit shkruhej ‘Alchera’.

Si ta kishte lexuar një ditë më parë, poetit i kujtoheshin edhe tipi i germave dhe, sigurisht, përmbajtja. Aty flitej për një periudhë kohore, mitologjike. Mjedisi natyror ka marrë trajtë dhe qeniet mitike nisën të ecin mbi Tokë. Disa mendonin se ishin krijuesit e jetës njerëzore, e cila ka po atë fuqi jetike si edhe krijuesit e saj dhe gjithë natyra. Aborrigjenët australianë këtë periudhë e kanë quajtur ‘koha e ëndrrës’. E, mbase edhe titulli ‘Alchera’ e shpreh këtë në australishten autoktone. Dhe atij i kujtohej se ‘koha e ëndrrave’ nuk kishte ndonjë fund të parashikueshëm, por ai sillte gjithashtu ndër mend se: qeniet mitike, të kaluara tashmë në një tjetër substancë dhe të metamorfozuara në trajtë natyrore si shkëmbinjtë, vrella uji ose objekte rituale, janë të përjetshme.

Por le të kthehemi te ‘Froni Qiellor’ dhe nën dritën e kësaj mendësie. Shkurt: majat te ‘Froni Qiellor’ nuk duhej të ishin aspak gjemba. Të tilla mbase i bënte ngjyra e tyre si në të verdhë. Pra, qe një rre-mendje se mund të ishin shpuese. Një kësodore ai e kishte prekur, kinse, rastësisht, me dy gishta dhe ajo s’i qe dukur gjëkund thumbuese. Veç kësaj ai vërejti folenë e këtyre “gjembave”. Ata, me gjasë, afroheshin me vendin e kicave që kanë dhëmbët e qumështit të fëmijëve. Mosha e tyre e jetës, siç dihet, është shtatë vjeç. Gjithashtu trashja s’tregonte aspak kohën se ata duhej të zëvendësoheshin.

Përmbledhtas: Ato “kërcënonin” këdo që mund t’u afrohej dhe këtë e bënin me ngjyrën e tyre. Tipar ky shpirtëror e psikologjik e assesi lëndor.

Plaku, pa u thelluar në ato që thamë, sipas intuitës

së tij, e kishte quajtur “Froni Qiellor”. Dhe për poetin i tillë ai qe. Se ishin po aq befasuese edhe rrënjët. Se ato vërtet zbrisnin në drejtim nga toka, por s’e mbërrinin atë. I përdridheshin shkëmbit si të ishte trung peme, a kade vere. Poetin e mrekullonte sidomos shtrirja e tyre përgjatë trupëzimit: shëmbëllimi me kordonin e këpucëve të tij alpine qe krahasimi më i gjetur për të. Dhe... e pabesueshme, por e vërtetë: numri i tyre, dyzet e tetë. Ç’përfaqësonte vallë kjo shifër? Plakut, natyrisht, nuk mund t’i shkonte në mendje të vërente gjembat në ishin shpues apo jo. Aq më pak të shihte rrënjët e tyre nëse arrinin në tokë apo jo. Dhe, kurrsezi t’i numëronte e t’i krahasonte me vitet e tij që përkonin plotësisht.

-Më duket se mediton për “Fronin Qiellor”?

-Po, - tha djali.

-Mendja jote tashti do të ketë tjetër mprehtësi gjykimi. Ajo do të punojë më me vrull dhe nuk do të lejojë të kalojë asgjë jashtë filtrit të arsyetimit e pse jo? Edhe të filozofimit mbi sendet, fenomenet dhe zhvillimin e tyre. Do të të mprihet edhe dinakëria. Veçse mos e përdor për keq e përfitim, por vetëm për t’u mbrojtur. Se edhe miu, në këtë botë, është qerrata: atë që s’e merr dot me gjuhë, e merr me bisht; mos u bëj tinëzar si shumëkush në këtë rruzull. Gjithashtu duhet të jesh syçelë dhe, para se të pranosh një gjë të mirëqenë, lipset të bësh pyetjen: si është e mundur? Për shembull, çfarë ka të veçantë për ty ai ‘Froni Qiellor’, përveç asaj që është magnetik si dhe ai copë-guri në atë bar?

-Dy gjëra, gjysh.

-Po.

-Shkurret e tyre nuk duhet të jenë gjemba.

Plaku shqeu sytë. Djali u ngrit dhe shkoi pranë shkëmbit. Vuri pëllëmbën e dorës në majat e tyre, që sigurisht ishin thujt të gjitha të njënjëshme dhe tha: -

Nuk të shpojnë.

Plaku ra në mendime. Tundi kryet i befasuar. Djali vazhdoi: -Edhe rrënjët, gjysh, nuk i ka në tokë.

Plaku u afrua dhe kur pa se ato e rrethonin trungun, gjetiu i shkoi mendja, si në kohë dhe hapësirë. Pikërisht në vitet e rinisë së tij në Paris.

-Se këto, ndryshe nga bimët e tjera, rreth e rrotull, - vazhdoi djali, - janë edhe si ngjyrë më jeshile. Gjë që tregon se duhet të jenë edhe më të ushqyera. Kush i mëkon këto? Ku e gjejnë energjinë për të qëndruar në këmbë, përderisa rrënjët nuk i kanë në tokë?

Ajo, që për djalin shihej si e jashtëzakonshme, për të mos thënë mrekulli, për plakun analizohej në funksion të jetës së njeriut. Se ishte i dyti rast që ndeshej me të njëjtën dukuri, 'të jashtëzakonshme'.

Rasti i parë, i kthente në kohë kujtesën...

Kishin mbaruar vitin e dytë në fakultet. Marsejeza në *fizikën atomike*, Luani, domethënë plaku, në *mjekësi*. Ky u kishte dhënë fjalën shokëve se do të kthehej pranë tyre, me pushime, për të kujtuar fëmijërinë bashkë me ta, buzë Vjosës, veçse e kishte shtyrë këtë udhëtim pasi që ndodhur përpara një të papriture. Gjithsesi edhe ajo që një përudhje e cila do të bëhej në Greqi.

Gjyshi i Marsejezës, partizan i De Golit, ishte teolog. Ai kishte një besim të verbër te mrekullitë. Edhe pse vazhdimisht përsëriste si fjalë të urtë: *misteri, në fillim, bëhet histori dhe historia kthehet në mister*. Megjithatë kërshërinë e kishte të madhe. Këshillën e tij e dëgjonin vazhdimisht dhe, meqenëse shëndeti nuk ia lejonte udhëtimet e gjata, iu lut të birit, domethënë babait të Marsejezës, të shkonte te Shën Theodhora. Ky vend ndodhej në Greqi. Diku në Sparta, para se të mbërrije në Kallamata. Pra, adresa ishte e saktë. Organizimin e një grupi besimtarësh që ishin të interesuar për të, do

ta përgatiste gjyshi. S'mbetej vetëm dakordësia. Nga ana tjetër, babai i Marsejezës nuk qe mësuar t'ia bënte-dy fjalën të atit. Edhe pse, që kur ishte kthyer nga lufta 'lutjen' për diçka e thoshte për edukatë, por ajo duhej marrë si fjala e butë për një kërkesë të fortë. Shkurt: urdhër për veprim. Dhe kishte edhe të drejtë. S'hynje në zakonet e tij të urdhëronte për një gjë të cilën mund ta kryente vetë. Përfundimisht, prindërit e Marsejezës biseduan, madje edhe parapaguan biletat. Luani, që konsiderohej si i shtëpisë, tashmë u ndodh i befasuar, para faktit të kryer. Këmbëngulja e Marsejezës, për t'iu bashkuar prindërve në këtë turizëm, qoftë edhe... 'teologjik', u mjaftonte atyre që të ishin së toku dhe ta shijonin atë. Për më tepër, nën këtë petk 'hyjnor'. Nga ana tjetër, në qoftë se për gjyshin e Marsejezës e gjithë jeta e mbetur s'qe veçse një dëshirë, për Luanin jeta e saponisur, kjo dëshirë i kalonte caqet e një udhëtimi 'teologjik'. Qe plotësimi i një ëndrrë të kahershme fëmijërie: ai ngjitej me shokët në atë që quhej "Qafa e Evgjitkës" për të parë dritat e makinave të Kosturit dhe përfytyronte një botë krejt tjetër: "monarkofashiste", por ama me shumë vetura.

U tha dhe u vu në veprim përgatitja e valixheve. Prindërit e Luanit do të pushonin në gusht.

-Po ambasada?

-Do të raportojmë se është një udhëtim i praktikës mësimore në... Normandi, - tha babai, i cili e shikonte me shumë kënaqësi këtë lidhje.

-Po Beladin Gorishta, që është në të njëjtin fakultet me djalin, ndonëse një vit më përpara?

-Mbase nuk e merr vesh, ai ia kalon edhe peshkopit në mësim.

-Se kërkon të bëjë karrierë, prandaj.

-Mua më duket se më shumë bën zhurmë.

-Ky është hapi i parë i karrieristit. Do të na djegë,

burrë!

-Lëre Kasandrën, grua.

Kështu u mbyll biseda atë natë, si dhe valixhja e Luanit që të nesërmen do të fluturonte për në Greqi, si zog i lirë me të ngjashmen e vet.

Gjithsesi atij nuk mund të mos i ndërmendeshin etapat e atij pelegrinazhi turistik. Vizita në Akropol, fotografitë në Parthenon e më pas në Monastiraq. Suvllaqet, për të përfunduar te Sintagma. Para atyre rojave me veshje karakteristike greke, ku xhufkat ishin në kapelë apo edhe në këpucë. Sidoqoftë, Marsejeza nuk harroi t'i filmojë e fotografojë të gjitha këto.

Më tutje, hoteli "Hilton" dhe e nesërmja me një autobus turistik drejt Spartës. Gjyshi i Marsejezës kishte të drejtë kur thoshte se Kallamata ishte më tutje.

Rruga për në Shën Theodhora kalonte përmes maleve të veshur me ullinj si dhe zbritje në një gropë. Aty, një guvë e gjitha e gurtë. Poshtë saj rridhte një burim. Brenda ishin ikonat e shenjtores, si dhe vend për ndezjen e qirinjve. Sipër guvës kishin mbirë shtatëmbëdhjetë pemë, të cilat simbolizonin moshën e shenjtores në çastin e flijimit për *një faj të pabërë*.

Ciceronia nuk dinte të thoshte se çfarë pemësh ishin ato. Se për frutore as që bëhej fjalë. Edhe lisat përjashtoheshin. Plepat gjithashtu. Sidoqoftë ishin goxha të lartë si të donin të shprehnin një zemëratë me atë egërsim rritjeje. Për Luanin ato ishin mështekna. Mrekullia qëndronte te fakti që pemët, mbi atë gur shkëmbor, rrënjët i kishin në pjesën e gurtë të guvës. Autori i këtij libri ka qenë personalisht në këtë vend dhe është befasuar kur i ka parë dhe numëruar, të shtatëmbëdhjeta pemët, të cilat, çuditërisht, rrënjët i kishin në pjesën e ngurtësuar të guvës-shkëmb. Lëvoren nuk e kishin të bardhë. Pra, nuk mund të ishin mështekna, siç iu dukën Luanit të

dashuruar. Legjenda:

Në kohën e Perandorisë Osmane çdo shtëpi ishte e detyruar të nxirrte për nizam një djalë. Në familjen e saj, Theodhora shtatëmbëdhjetëvjeçare s'kishte vëlla. Për të shpëtuar prindërit nga dënimi i rreptë, i cili mund të qe fatal, vendosi të vishej si djalë. I lidhi mirë flokët, që të mos binin edhe aq në sy, ndonëse edhe burrat mbanin leshra të gjata për t'i shtuar ca pikë burrërisë. Vajti ushtar.

Në rrethana të pashpjegueshme, mbase kur njësia e saj ushtarake vepronte në një truall ku u lipsej një sjellje tejet korrekte, ndodhi një përdhunim. Gishti i dyshimit ra padrejtësisht mbi Theodhorën. Përbetimi i saj për pafajësi qe i kotë. Egërsia, me të cilën u soll, sidomos komandanti i saj më i afërt, me gjasë, e kishte shkakun te një dëshirë e tij e paplotësuar. Se ajo, si vajzë, kish fytyrën më të bukur në atë mori ushtarësh, përgjithësisht të egër. Dhe, nuk ishte i panjohur seksi mashkull-mashkull në ato kohëra. Madje, në lashtësi, një veprim i tillë, jo vetëm qe i përhapur, por trumbetohej si diçka që ndikonte në mbrojtjen e njëri-tjetrit, në luftë nga dëshira për kënaqësitë seksuale. Kështu, u mor dënimi më i rëndë. Ai fatali. Zbatohej kësisoj parimi; kur s'më përmbush qejfin tim, të heq të drejtën për të jetuar. Dhe dënimi niste me demaskimin përpara ushtarëve. I pari, komandanti. Ky, atë që s'kishte mundur ta puthte, e pështynte. Pas tij, të gjithë ushtarët, sikur s'ishin ata që më shumë shihnin prapanicat e njëri-tjetrit dhe i vriste pamja-ikonë, e këtij **ushtari**, i verbonte ajo. Prandaj kaluan, një nga një, përpara asaj bukurie stoike, për të shprehur më shumë përbuzjen për fisnikërinë, sesa urrejtjen për veprimin. Se e kuptonin që ishte hakmarrje e komandantit dhe shtangeshin përpara qëndresës përbuzëse të saj. Stoli kjo krejt e huaj për ta, që gjithsesi nuk e shpëtonin dot Theodhorën-nizame. Përkundrazi.

E lidhën me zinxhirë dhe e tërhoqën zvarrë, deri në atë gropë tërësisht të bokërimtë ku, edhe përfundonin dënimet e kësaj kategorie. Në prag të agonisë vinte edhe tortura më çnjerëzore: tredhja, duke i shtypur kokrrat me gurë. Kur e zhveshën, shtangën nga befasia. E akuzuara ishte vajzë dhe jo djalë. Por qe tepër vonë për ta ndrequr gabimin. Theodhora po jepte shpirt. Të paktën të dëgjonin amanetin e saj:

Varrosmëni nën këtë guvë. Flokët e mi (të cilët asaj i qenë shpleksur tashmë), le të bëhen shtatëmbëdhjetë pemë. Gjaku im le të kthehet në ujë për t'u shuar etjen shtegtarëve dhe vendi të shndërrohet në një oaz çlodhës për të gjithë endacakët e kthyer nga luftërat e humbura në rrugën e tyre të gjatë, për në shtëpi. Priifti, gjithmonë i pranishëm në këto raste, kreu shërbesat e tij dhe kur u kthye për të dyzetat, mbi guvë pa se kishin dalë, si fidanë të mbjellë me dorë, shtatëmbëdhjetë të tillë. Do të vinte gjashtëmujori dhe viti që të bindej se ajo qe një e shenjtë. Fjalën e saj e dëgjoi Zoti dhe e përmbushi.

Poetit iu ndërmend sërish alchera (koha e ëndrrave sipas aborrigjenëve australianë.

...Plaku s'kishte si të mos e vlerësonte vëzhgimin tejet domethënës të djalit. Ashtu siç nuk duhej qortuar vetja për këtë pakujdesi të tij. Se e kuptonte që kishte mbetur larg vrojtimeve të kësaj natyre edhe pse ato, dikur, ishin pasioni i tij.

Ndihej i pezmatuar për më tepër se fenomeni përkonte me rastin Theodhora. Nuk është nevoja që njeriu të jetë çudibërës e as i jashtëzakonshëm. Aq më pak shenjtor. Jo, s'duhet të jesh i tillë që të krahasosh fatin e vajzës Theodhora, që i ulet dinjiteti faqe të tjerëve, e zvarritur derisa jep shpirt, me qindra e mijëra gjyqe, ku vlera e njeriut jo vetëm rrëzohej përtokë, por atë e prisnin të tjera tortura galerie, ku **vdekja në mos të 'dhurohej'**,

luteshe për të.

Parë nga ky prizëm, plaku (flokët e vajzës Theodhora, për një faj të pabërë që shndërrohen në një pemë për çdo vit të saj) shtyhej të mendonte se: pyje të tëra duhet të jenë ngritur për shokët e tij të burgut, dënuar për faje të pabëra. E, shkallëzimi i kësaj mendësie e çonte te qindra pallate. Te miliona vagonë me krom. Te dhjetëra kanalizime e bonifikime. Të gjithë këta shokë të tij s'kishte gropë që i nxinte. Dhe paguximi për kundërshtim nuk duhet parë gjithaq te frika nga diktatura, sido që edhe kjo qëndronte. Pasi djallëzia e saj fshihej pas kurtheve të tilla që të mos i krijoheshin kushtet ku parimi "dy duar për një kokë" të gjente zbatim.

Amaneti

Gjithsesi plaku hapi çantën dhe nxori që andej një fletore të shkruar në frëngjisht. - Ky është amaneti im! - tha pa ndonjë hyrje të veçantë. Djali i hodhi një sy, duke e shfletuar, faqe më faqe. - Qenka e gjitha në frëngjisht.

-Ekzakt! - u përgjigj plaku, - sepse s'duhet të bjerë në duart e paditurisë. Ashtu siç nuk duhet të shihet nga sytë e shpifësit a spiunit. Se, pas kësaj, s'është aspak mirë të pyesësh, ç'janë këto krisma e as të habitesh nga vijnë këto britma e ulërime.

Djali hodhi, sërish, një tjetër vështrim. Jo gjithaq për të parë bukurshkrimin, sesa apostrofat, shenjat e pikësimit e, madje, rrokjezimin e fjalës në mbarim të rreshtit. (Pas disa vjetësh, Petroja, me frëngjishte të mësuar, do ta kishte vazhdimisht pikë referimi atë fletore si një metodikë saktësie, gramatike po ashtu).

-Sidoqoftë e gjithë kjo më ngarkon me përgjegjësinë e mësimit të frëngjishtes dhe ju jap fjalën si shpëtimtarit tim, se do ta bëj, madje me shumë kënaqësi. Por... ç'keni shkruar në këtë fletore?

-Atë që mezi prisja ta dorëzoja.

Plakut nisi t'i dridhej llulla ndër dhëmbë. Prandaj nxitoi ta heqë se e ndjeu, por nuk është se ky veprim e përmirësoi gjendjen. Përkundrazi. Fërgëllima e tij i ngjethi kurmin djalit dhe fjala nisi t'i dalë si e valëzuar

nga goja.

-Juuu, mbase keni shkruar historinë tuaj?

I moshuari tundi kryet dhe thithi sërish llullën. Por ajo s'kishte më duhan, veç hi dhe shpuza e saj e mbante ende të ngrohtë drurin, si shpirti i të zotit brengën.

Ai e shkundi, më në fund, atë tym thithës, por tani s'kishte aspak dëshirë ta mbushte sërish, ndonëse, instinktivisht, po e ngjeshte me gishtërinj për ta rrafshuar se e kishte rimbushur pa e kuptuar. Në të vërtetë, të dy u befasuan nga shpejtësia me të cilën mbaroi së djeguri duhani. Qe një pakuptueshmëri mbi kalimin e kohës, apo një nxitim në shndërrimin e kësaj gërxhalle në hi?

-Pak e çuditshme, gjysh. Unë s'mbërrij ta kuptoj. E pitë shumë shpejt, me dy a tri të thithura? - e pyeti djali më shumë për ta ndryshuar klimën, por s'mund të mos shtonte edhe: -apo vendi këtu e djeg ndryshe atë gjethe të grirë?

-Ekzakt! - sqaroi plaku. - Shoh se ke filluar të arsyetosh edhe për atë që s'më ka vajtur mendja. Edhe pse e di fare mirë se këtu kot nuk ka rënë ky gur. Më duket se jemi në një vijë me kryqëzimin e meridianit, në mos qoftë ai stol që mua më ka vajtur mendja ta quaj "*Froni Qiellor*".

Për poetin këto arsyeime qenë jashtë interesimeve të tij, për të vetmen arsye se i mungonin informacionet e duhura dhe për t'iu shmangur temës vërejtë: - Megjithatë, mua më duket se ju e pini shumë.

-Ekzakt, xhanëm. Është e vërtetë se e pi dhe prapë s'mund të më helmojë akoma i mallkuari. U bë gjatë që e kërkoj këtë. Por siç shoh s'qenka dhe aq me të thirrur. Fati i mirë m'u qas në vitet e pjekurisë dhe s'di se ç'pa tek unë që iku. Por mbase s'qe nisur për mua dhe erdhi tek unë për të kaluar tek ti. Se më shpuri në Paris, kur isha ende çunak. Pse, do të thuash ti? Që të njihesha me Marsejezen dhe të dashurohesha me të ashtu siç pëlqeva

dhe dashurova një jetë të lirë, në një shoqëri të hapët. Të mësoja shkencë, por edhe ca gjëra të tjera si sekretin e gurit magnetik dhe të vuaja më pas gjithë peripecitë e Odisesë. Por ky, më në fund, u kthye në Itakë. Kurse unë do ta mbyll në këtë humbëtirë. Itakën time do ta ndjekësh ti. Mos u çudit! Mbas katër, e shumta pesë vjetëve, do ta takosh Marsejezën time. Ajo është gjallë. Ma thotë zemra mua, - tha tek po e ndizte duhanin. Thithi sërish llullën dhe tymin e hodhi si mjegull drejt fshatit:

-Ata atje poshtë, - dhe zëri, sërish, mori dridhje më keq se hallakatja e atij tymi me shtëllunga, - se, jo për faj të tyre, s'njohin asgjë përveç stallave të lopëve dhe ahurëve të gomarëve, megjithatë, mua më quajnë të çmendur... Dhe mirë më bëjnë se nuk janë në gjendje të kuptojnë çmendurinë e tyre pas cilit shkojnë.

U mor sërish me llullën duke dashur ta mbushë edhe pse s'qe e nevojshme. Iu dogjën pak gishtërinjtë ndonëse edhe ashtu tejet të përcëlluar ata qenë dhe vazhdoi: -Ta ngisja llafin te ylli, bir: Ty, për shembull, të bëri mirë takimi ynë. Mua më bëri keq mostakimi në kohë me adashin tënd. Pse, do të më thuash ti? Se më la edhe një vit të zvarritesha bashkë me qenin tim, këtyre gërxheve e të prisja të vije ti. Po, mbase qe më mirë për të dy.

Djali gjeti rastin ta pyesë për emrin. Se ai, njëmend, quhej Petro, ashtu si pararendësi i tij, fatligu i vitit të shkuar. Por i dukej e çuditshme kjo përkesë. Madje mund të merrej edhe si përzgjedhje për të dy drejtimet e kundërta të fatit.

-Po emrin tim nga e mësuat, gjysh?

-Ma tha Ortepi.

-Cili, cili? - shqeu sytë Poeti.

Shoku yt, Ortep, - tha plaku, duke e kthyer përgjigjen në një formë të tillë që të ishte i pashquar emri: Ortep.

Djali s'donte t'u besonte veshëve, ashtu si aty më parë

që s'donte t'u besonte syve, kur pa atë lingua në ëndërr dhe një plak më pas. Se të dy do të ishin po ata... që po shihte në jetë. Kjo fliste për diçka që s'i kish ndodhur kurrë më parë dhe, që tani e më pas, këto të pangjara s'duhet ta habisinin më.

-Kur erdha në këtë fshat m'u desh t'u shpjegoj njerëzve se ç'është bari i brengës. Se për këtë kishin më tepër nevojë ata, pas barkut që ngopet dhe me bar. Dhe u tregova se është një barishte me gjethe si të shëlgut e me lule të imëta si të trëndafilut. Se trishtimi dhe vuajtja nuk i janë ndarë njerëzimit që kur është krijuar bota. Filloi me "*Kompleksin e Edipit*" derisa erdhi tek... unë. Domethënë tek ne. Se barin e djathit, ai që është baxhoxhi, në mos sot nesër, do ta gjejë vetë. Ato barishte me gjethe të çara edhe rreth baxhos së tij mund të kenë mbirë. Por puna është të kesh qumësht e jo të jetë me recetë doktori e vetëm për gra me fëmijë... pa gji.

Ti më pyete për emrin tënd, do të dal edhe atje, por dua që të përpiqesh ca vetë. Logjika jote, thamë që tani e më pas, duhet të ketë tjetër kapacitet të cilin ti ende s'po përpiqesh ta shfrytëzosh.

-Unë po mbetem pa gojë me gjithë këto njohuri dhe s'më besohet që ju keni mbaruar vetëm të mesmen në Paris.

-Ekzakt. Është e vërtetë, bëra dhe nja dy vjet për mjekësi. Por s'deshi fati ta mbaroja se erdhi dhe shkatërrimi. Përfundova këtu, siç më sheh. S'më lanë të bëja as punën e infermierit, edhe pse ky vend ka pasur shumë nevojë për një të tillë. Se këtu gjeta shumë kafshë. Që të mbarështoheshin ato kishin sjellë një ndihmës veteriner. Kurse njerëzit duhej të bënin njëzet kilometër për një vizitë te doktori. Po kështu edhe për të bërë një gjilpërë. E... përsëri ata njerëz, atje poshtë, duartrokasën.

Në këtë fletore do të gjesh, aty nga fundi, edhe

ndihmën me barëra që u kam dhënë njerëzve, të cilët i kam dashur ashtu siç janë e i kam mbështetur në lëngatën e tyre. Se njeriu duhet përkrahur edhe kur nuk e njih të mirën, a i lig. Se nuk të ndih Qielli, kur ti në Tokë nuk i shtrin dorën njeriut që ka nevojë për të.

Ti, biri im, u gremise dhe thirre në ndihmë shokun tënd, Ortep. Ky ia mbathi nga sytë-këmbët. Edhe pse rrezikove të drejtën e studimit për të. Unë shihja në ëndërr se është drekë e jam mësuar të dremis pak sa për të copëtuar ditën, që më duket shumë e gjatë. Po shihja atë ikanakun që ia mbathte. Ty, që thërrisje emrin e tij, Ortep, Ortep, ... dhe s'e kisha, hiç të vështirë ta gjeja emrin tënd, që është njeriu i vërtetë. Kurse ai - e përmbysura jote. Ktheva së mbari emrin e tij dhe e kuptova emrin tënd. Emri i tij, ç'ironi therëse për atë të mjerë, mund të quhet me refleks. Prandaj thuhet edhe ajo tjetra: jo çdo gjë që reflekton është flori. Ai është hekur i ndryshkur se dhe zgjyrosja ndrit.

Djali, ashtu siç nuk i kishte shkuar mendja kurrë, renditi së prapthi germat e emrit Ortep, sapo ky plak mjaft i ditur shpjegoi një anë tejet të panjohur në analizën e gjërave, po ende edhe të emrit.

-Kam katër vjet plot që pres dikë t'i dorëzoj amanetin, përpara se të lë këtë botë dhe ja, më në fund, mbërrite ti.

-Të më falësh, gjysh, por pse kërkon të ikësh nga kjo botë, të cilën jam i bindur se nuk ka qenë e mirë me ty, sidoqoftë...

-Sepse... - tha ai dhe buzëqeshi kinse kur shtoi: -Në periudhën e burgut-ferr më ka mbajtur gjallë '**shpresa-shok**', se dikur do të takohem me Marsejezën dhe Julietën, për të cilat jam i sigurt që më presin. Por ky '**shok**'përgjatë këtij kalvari, pësoi krisje si qelqi dhe më la në rrugë si potkoi kalin me tendinit.

Dhe plaku ndaloi cazë për t'u mbushur me frymë. -E

di, - tha përmes një kolle tejet të thatë. - Kjo **dispne**, - dhe ai përdori një fjalë mjekësore, - do të më marrë shpirtin. Por s'ka për t'ia arrijtur...

Dhe ai përplasi llullën për guri. Vështtrimin e ngriti lart si skllavi pas hekurave që kundron lirinë në... përjetësi.

Djali, tek shihte atë vështtrim, i dukej se lexonte shumë më tepër nga ajo çka dëgjoji dhe atë çast mendoi se te ky njeri qe vulosur një vendim i tmerrshëm dhe ai vuante ballafaqimin me të. Dhimbja, që si një virus (le të përdorim edhe një fjalë mjekësore) s'kishte se si të mos e prekte edhe atë.

Llulla e përplasur qe gremisur mbi hirin e mëparshëm. Qeni, me putrat e tij e mori dhe ia solli të zotit. Kjo 'harmoni' i ra në sy djalit dhe sepse atë çast mendoi se edhe fati i këtij plaku të mirë duhet të jetë përmbysur nga një gjasë e përkundërt: 'dis-harmonia' shtazore.

-Nuk ma copëtuan trupin kur më shoqëruan në avion, ndonëse pistoletat e tyre në hijet e mi e kishte grykën. Dhe jo një, por dy, sikur të isha kriminelin më i madh i kohërave.

-Cilët? - e ndërpreu djali.

-Ata që s'dinë të bëjnë gjë tjetër, përveç kësaj pune. Se, edhe po të ndodhte që njëra nga pistoletat, rastësisht të shkrepëj, ata do të dinin ta gjenin rrugëdaljen se ato grykëgjata pa zhurmë qenë. Po më copëtuan shpirtin se këtë nuk e njohën në kontrollin që më bënë. Për ta shpirti ishte përherë, një fqinjë e munguar dhe e panjohur. Porta e saj qëndronte mbyllur për t'u hapur ditën e fundit të jetës së tyre kriminale. Pra: më pyete për cilin? Po të them se qenë dy kufoma të armatosura, që përcillnin një trup në agoni, që ecte me kokën e kthyer pas.

Plaku vari, për një çast, kryet mbi gjoks dhe ashtu si somnambul mbushi sërish llullën; ritualin me strall e uror dhe, si të donte të ndizte flokë e mjekër bashkë,

thithi duhanin dhe u përfshi nga tymi si të qe një trung, ku sapo kishte shkarkuar rrufeja mllëfin e saj idhnak.

Gjithsesi për sytë e djalit, pamja e plakut kryeulur, mbi mjekrën e tij, seç kishte diçka të përbashkët me atë shkëmbin që ai e quante "*Froni Qiellor*". Mbase gjembat e mbirë *mbi të*, rrënjët e të cilëve qenë *nën të*, apo maja e këtij shkëmbi, që s'të lejonte të uleshe *në të*? Sidoqoftë vetë përqasja me një shtëllungë që ngrihej nga tymi i llullës, të bindte për një vetëndezeje dhe, natyrshëm, për një vetëshkatërrim.

Megjithatë, ai do të ngrinte më në fund kryet dhe djali do të dallonte, pas atyre fjollave, një dritëzë që po zvogëlohej dhe dy sy të njomur e të skuqur si dielli i dubluar nga refleksi perëndimor mbi ujin e detit. Ky paralajmëronte një natë pa mbarim. Djalin e digjte dëshira për të lexuar tani në shqip, atë që ky njeri i mirë s'e kishte shkruar në gjuhën amtare. Mbase sjellja e disa njerëzve të këqij të vendit të tij, e kishte ftohur edhe me gjuhën e nënës, apo brenga për francezen e kishte detyruar ta shkruante në gjuhën e saj. Se qe amanet e ky për djalin merrej edhe si një *testament*. Po kujt i lihej? Është ende herët për të gjykuar. Poeti duhej të mësonte gjuhën frënge. Dashur pa dashur i riu pyeti: -Amanetin mund ta linit edhe në shqip, si i thonë, në gjuhën e nënës.

-Po, bir, por kujt nëne, asaj që e detyruan të helmohet bashkë me tim atë, kur e kuptoi se do ta arrestonin për spiunazh të trilluar.

Djali heshti i befasuar. Luani vazhdoi:

- Apo asaj, që do t'i jepja mundësinë çdo zabërhani, pushti a zuzari, që ka kryer kursin e analfabetizmit apo diç më tepër, sa për të ditur të lexojë e të zgërdhihet me to? Ndryshon puna me ty. Se kur njeriu gjen vullnetin, ka edhe durimin të mësojë një gjuhë të huaj, pa qenë në atë vend. Një njeriu që di të bëjë gajret, mbase mund t'i

besohen edhe sekrete, si ato që do të gjesh në fletore të shkruara frëngjisht.

Kanë thënë, biri im, se gjuha e huaj është një dritare dhe s'kanë gabuar. Por kur kjo gjuhë është frëngjishtja, bëjnë mirë të thonë se ke pushtuar një planet të ri, si: Marsin, Jupiterin, Saturnin e këdo tjetër.

Dhe nuk e teproj po të shtoj se përveç Volterit e Hygoit, do të gjesh edhe Floberin e madh e Mopasanin, gjithashtu. Dhe, po të të them se ti do të zotërosh edhe teknikën e gurit magnetik, gur që ka rënë nga qielli në Francë, do ta ndiesh veten, jo vetëm që s'ke ardhur kot në këtë botë, por do të kuptosh se lartësinë tënde do ta rrokë vetëm binjaku yt shpirtëror dhe mendor. Nuk duhet të jetë e vërtetë thënia se, shkenca ia than shpirtin njeriut. E kundërta - po. Ka shumë të ngjarë. I jep më shumë hapësirë shpirtit. E zgjeron atë në një përmasë të re. Në qoftë se për mendjen flitet si për një *shqisë të gjashtë*, kjo do të duhet të pranohet edhe për shpirtin si një *ndijesë ekstra*.

-Ç'ndodhi me adashin tim para një viti, gjysh? - pyeti djali jo aq për të shuar kuriozitetin sesa për të zgjeruar njohuritë lidhur me gurin magnetik.

-U prish nga mendtë.

Djali u drodh. -Nga ai copë gur, - tha ai dhe për të disatën herë u mor me ritualin e llullës: zbrazjen, mbushjen, ndezjen. -Ai qe goditur rëndë në tëmthin e djathtë. Jo se kishte këpucë alpine me hekura si të tuat. Por se, siç të thashë, s'e kishte mendjen për të parë *larg*, si trupin që shihte *lart*.

Thokët e mi: kthu-kthu-kthu!

Vendin e kërshërisë te djali tani e kishte zënë fillimisht habia, e cila qe vendosur në një sheshpushim, ku do ta përfshinte një panik i pashmangshëm, sikur plaku të mos sqaronte:

-Atë ditë unë kisha zbritur në fshat, se më qe sosur kripa. Kur pashë se makina-‘korriere’, qe aty e shkonte në lokalitet, thashë me vete: jam që jam nuk shkoj te doktori, të më shohë se ç’kam që më zihet fryma, këtu e dy vjet rresht? Se jetoj i vetmuar e pa lidhje me kërkënd, ndaj as ditët e javës nuk i di. Kurse muajt hyjnë e dalin e orientohem më shumë nga qesja e kripës, që zgjat tre, apo dhe katër muaj ngandonjëherë.

Qëlloi të qe e enjte, dita që ‘korriera’ shkonte, siç thashë, në lokalitet dhe kthehej në fshat në të ngrysur. Dhe ashtu bëra. Një shoku im i fëmijërisë qe radiolog në poliambulancë. Ndenja cazë, nën ballkonin e laboratorit të tij, që ishte në katin e dytë dhe, sapo i fërshëllej sinjalin, kur ai më doli atje dhe nuk besoï që isha unë. Dhe jo se nuk më njihte. Por pikërisht se më njohu. Ato çaste mua m’u kujtuan ata vitet e fëmijërisë, me shumë mall e dhimbje dhe këto do ta kenë trazuar kujtesën e tij dhe doli në ballkon që të shohë se cili është ky, fërshëllima e të cilit ngjan me shokun tij të fëmijërisë. Se kot s’ka thënë Pitagora: *“Më parë jemi mendje sesa trupa”*. Ja pse u duk

për një ajër në ballkon dhe s'u zinte besë syve, kur më pa.

-Thi Lu-a-a-n je? I mbahej goja të shkretit që në vegjëli. Se ndryshe është puna me sytë. Vë gjyzlykë dhe e rregullon shikimin, se ato drejtojnë edhe strabizmin. Kurse gjuhës s'ke ç'i bën

Lavdoshin, kështu e quanin radiologun e sotëm, kur luanim 'Luftash', përherë e vazhdimisht e vinin në rolin e komandantit. Dhe e di pse? Ngaqë na pëlqente pa masë kur me seriozitet duhej të na thërriste: "Shokët e mi: këtu, këtu, këtu dhe shqiptonte:

"Thokët e mi: kthu-kthu-kthu!" Dhe ne për këtë arsye s'ia thoshim emrin e vërtetë, por i flisnim **"Thokët e mi"**.

-Thi Lu-an je? - u befusua nga lart. Dhe unë, si ish ushtari i tij: -Si urdhëron, shoku komandant! Dua të më shikosh se s'i kam mirë punët me mushkëritë, po bëhen dy dimra. -Tha? (Sa?) - shprehu habinë ai. - Dy vjet, - përsërita. Ai më bëri shenjë. -Ngjithu larth.

Te kreu i shkallëve, që mezi i mora, sikur po i qepesha malit nga shtegu i dhive, kish dalë e më priste Lavdoshi. Që poshtë, mbi kokën e tij ndriste një llambë, në ngjyrë blu, që e futur brenda një kutie drejtkëndëshe kauçuku, mua më ngjau si arkivol. "E paskam të hapur gropën", mendova atë çast me vete. Më mirë, do të shpëtoj".

Kur mbërrita lart, ai më përqafoi, megjithëse iu shmanga, ngaqë s'isha për një rrokje të tillë, qafë më qafë, kurse ai jo. Ndenjëm ashtu, siç nuk desha, por s'qe e mundur të mos përimalleshim për gati dy minuta. Doemos. Na u kujtuan vitet e fëmijërisë, prapësitë e asaj moshe e ajo përkrahje dhe mbështetje që i jepnim njëri-tjetrit në lojërat si: *"Djemtë e rrugës Pal"*. Skuadrën tonë e kishim emëruar **"Thokët e mi, kthu-kthu-kthu"**. Kur na zinin gafil prindërit e, sidomos, mësuesit, radiologu i

sotëm, ishte ai që e errësonte edhe më tepër të vërtetën, kur i duhej të shpjegonte duke futur më shumë se ç'e pengonte gjuha, shqiptimin e atyre "thë-ve" të tij, për të mbrojtur gafabërësin.

Ky ishte shoku im i fëmijërisë, biri im. Bëheshim copë për njëri-tjetrin dhe kështu duhet të jetë në çdo kohë. Prandaj edhe u përmallëm e u përloëm me shoshogjin. Kuptohet, ai për fatin tim të keq, që të ma këmbente me një më të mirë sikur t'i thuhej se ajo mund të bëhej duke ia prerë fare gjuhën, jam i bindur se do të pranonte sakrifikimin, si për çdonjërin nga ne, të skuadrës së tij: **"Thokët e mi, kthu-kthu-kthu"**.

Kur u shkëputëm, kishim hyrë në dhomën e errët. Unë isha ende nën vegimin e asaj shoqërie të diamanttë dhe radiologjia më dukej e ndritur. Më vinte keq, vetëm që s'mund të shihja vëmendjen me të cilën do kontrollonte mushkëritë e mia. Por ai ende s'kishte filluar. Më tha të zhvishesha deri në kanotiere, nën atë ndriçim manushaqe, petalet e së cilës sikur i shihja për herë të mbrame në fushë.

Më në fund largova të gjitha vegimet me anë të mjeshtërisë së frymëmarrjes dhe i thashë:

-Doktor! E di që s'jam mirë e diç përfundimtare pres. Dua të kuptoj sa larg stacionit të fundit jam. Se më ka lodhur kjo jetë, jashtë mase. Nuk dua të më rraskapitësh duke futur ato "thë-të" e tua për të më shfajësuar.

Nuk më dha përgjigje, ndoshta dhe pse u patak nga ajo që kishte parë në mushkëritë e mia. Se e shoi dritën për ta ndezur sërish, ashtu siç bëjnë shoferët në rrugët malore, që s'habit kërkënd, një popël guri në mes të xhadesë dhe që ata, ngaqë s'duan ta besojnë, bëjnë hap e mbyll dritat për ta riparë përmes errësirës a mjegullës.

Qe përqendruar në mushkërinë e majtë. Në atë krah që ndieja më fort dhimbje dhe më dukej se prej saj do

të mekesha e do të shuhesha në çast. Më në fund, ndezi dritën. Tha: -Vithu. Unë u vesha shpresëprerë se do të më thotë të vërtetën. Ngaqë e dija se doktorët kanë bërë betimin e Hipokratit dhe nuk u lejohet të dorëzohen përpara çdo sëmundjeje e kujtdo njeriu. Por ato çaste unë harrova se kisha ardhur së pari te shoku i fëmijërisë, pastaj te mjeku. Se kishim ende atë besën e skuadrës “**Thokët e mi, kthu-kthu-kthu**” e ky ishte komandanti. Si mund të harronte ai betimin tonë se kush i shmanget kërkesës së shokut quhet “tradhtar”?

-Erdha të të pyes, shoku im, si është e vërteta në trupin tim? Dhe ai m’u përgjigj: -Ke akoma dhe, të paktën, dy vjet. Për ormisje ke kohë.

Por unë përgatitjet i fillova që në zbritje. Nuk pranova të më shoqëronte. Se drejt shkatërrimit s’më la shteti kohë, as t’i telefonoja Marsejezës. Tani, drejt fundit, s’kish kuptim përcjellja edhe nga shoku e komandanti im i fëmijërisë. Takimi me të, edhe pse rastësisht, më përmalli goxha, gjë që më dobësonte e më priste ato pak forca edhe kështu.

Kishte triumfuar betimi i fëmijërisë mbi atë të Hipokratit. Kaq mjaftonte. -Faleminderit dhe lamtumirë, o komandanti im! Ai buzëqeshi. Tha me dorën e vënë mbi zemrën e tij:

Tho-ku im! Kthu-kthu-kthu!

Ia bëra me dorë dhe ai ma ktheu përshëndetjen, por s’u largua deri sa këmba ime preku edhe shkalloren e fundit, ku bëri shenjë se e kishte marrë lamtumirën time me këtë botë dhe... u fut brenda me një tjetër pacient. Porta u mbyll. Por jo.

Sërish, ajo dritë e zbehtë, pas peçikllasit i jepte atij drejtkëndëshi pamjen e një varri të hapur që, çuditërisht, më dukej se nuk qe në tokë. Po ku? Dola jashtë dhe dëgjova një zë: -Tho-ku im!

Ishte doktori, që ma bënte me dorë nga ballkoni. Prandaj nxitoi të futej brenda ato çaste, - mendova. Sfondi blu i errët i radiologjisë m'u shndërrua në qiell dhe ai, si i shenjtë që miqësisht më tregonte rrugën për atje. Edhe unë ngrita dorën:

-Lamtumirë, fëmijëria ime e largët! Lamtumirë! Lamtumirë... **“Thokët e mi!**

Një parandjenjë aspak ogurmire s'më linte të prisja orën e pasdites për t'u kthyer me 'korrierën'. Ç'të jetë vallë? Qenin e kam të siguruar në një familje, kopshti i së cilës ka një buçe, gjithashtu. Një detyrë e paplotësuar më mundonte dhe s'isha në gjendje ta kujtoja se çfarë. Në këto raste vijnë edhe të papriturat.

Kuturisa të nisem kalldrëmit. Në vend që të numëroja hapat, sheshtoj edhe fundin tim: e pres apo i paradal? Se edhe jeta, një rrugë është. Ka një fund. S'ka rëndësi si e ke bërë: me këmbë apo kaluar. Në fund do të zbresësh dhe do të futesh në dhe, sa hapësira e katër këmbëve të kalit, apo edhe të gomarit. Kaq.

Kisha ecur goxha, se s'qe punë dhe ajo të rrija e të prisja 'korrierën', kur u ndal te opingat e mia, karroca që kthehej me bidona bosh, në stallat e kooperativës. Më dha dorën një djalë i ri, karrocier dhe unë u rehatova pranë atyre enëve të zbrazura, të cilat përplaseshin njëra me tjetrën, në një zhurmë monotone, që megjithatë, më vunë në gjumë për të cilin kisha shumë nevojë. Aty do të gjeja edhe pengun që më mundonte... Isha shtrirë paq dhe s'di sa kishim udhëtuar, ashtu siç edhe s'merrja vesh se sa kisha fjetur, kur në ëndërr m'u shfaq një djalë i ri, që më kërkonte ndihmë. Ai, herë përpëlitej në atë vend, ku u gremise edhe ti e herë vinte pranë kasolles, ku thërriste: "O, i zoti i shtëpisë!" Mirëpo aty, jo vetëm që s'isha unë, por as qeni im. Se kur ika, nuk e dija që do të përfundoja në lokalitet dhe meqë langoi këmbënguli të më ndiqte pas

për t'u takuar me buçen; s'ia prisha: Ia plotësova dëshirën. E mora, por e lashë pa ndihmë, orëziun Petro, që kishte rënë, thamë, si dhe ti. Dhe duhet të kishin kaluar disa orë, që djaloshi Petro kishte dremitur mbi atë gur e atë stol kurth. Kur vajti langoi im, sapo u lëshua nga kasollja e mikut në fshat e, në shoqëri të buçes, qe mjaft i mënuar. Vërtet, ai më vonë, i shpëtoi jetën, por tjetri fliste përçarë një gjuhë krejt të pakuptueshme. Dhe këtë e rrokja vetëm unë që kisha dëgjuar në Paris për raste të ngjashme. Se në genet e një njeriu është regjistruar e gjithë trashëgimia e brezave. Ai fliste një gjuhë jo europiane. Mbase arabe. Por le të kthehemi tek ajo që do të pyesësh ti: nga e mora vesh unë? Nga qeni im e nga kush tjetër do ta merrja vesh? Ai, rrëmbeu çantën e fatziut, me dhëmbë dhe u zvarrit deri te kampingu. Atje ku e ngrenë gjithmonë nxënësit. Dhe... langoi im përpara dhe shokët e djalit pas, e gjetën Petron dhe e shkulën të trembur nga ajo grackë. Por, kur ai nisi të flasë një gjuhë të pakuptueshme, ata thanë se ishte shkalluar. Kjo s'qe ashtu. Por fatziu Petro përfundoi në çmendi.

-Po, - tha djali, - edhe unë kam dëgjuar të flitet për të në shkollë. Na thanë në këshillin pedagogjik të bënim kujdes me nxënësit në këtë alpinizëm, por plaku shkundi kryet.

-Ai djalë mund të qe kthyer në **diamant** për shkencën. Dhe e mbyllën me të shkalluarit në vend që ta vizitonin në një klinikë të përparuar të Europës.

-Thatë, aty më parë, "edhe një vit i shkuar dëm". Pse?
- pyeti djali.

-Se do t'i kisha lënë amanetet atij djali dhe mua do të më kishte dalë bari mbi sy. Por çdo pengesë, për të mirë thuhet se vjen. Se do të bëhej fjalë të shpëtoja një jetim, siç edhe je ti, që do të rrezikohesh pas një viti. Se edhe rrufeja nuk mund të bjerë dy herë në një vend.

Poetin e befasonte gjithë ky informacion.

-Edhe palo sigurimit iu lidhën duart që të të pengonte edhe pse u grindët e u shamatuat goxha. Se bëhej fjalë për të drejtën e studimit. Kështu?

-Po. Po ju nga e dini, gjysh?

-Ma the në gjumë kur fole për Ortepin.

-Pra, po thosha, se dje, ndaj natë, m'u shfaq në ëndërr për herë të parë, mbas shumë kohe, nëna. Më tha vetëm një shprehje si fjalë të urtë: "E pive detin? Bravo! Tani ruaju nga zjarri.

....

Kishin mbërritur, kësisoj, në atë copë lëndinëze, rrëzë atij shpat-mali, ku qe kasollja e plakut. Ngjitur vatha me hije të sajuar me gjethe shtogu. Tre delet ripërtypnin me kryet e kthyer nga fshati me një qëndrim si prej lamtumire. Plaku i pa me dhimbje dhe si hapi trastën e lëkurës, nxori prej saj, një tip portofoli, petashuq, i ngjashëm me një këllëf syzesh. Në të qe sa një krehër flokësh dhe po aq i hollë, një gurë plloçak.

-Këtë e kam mbajtur në kapelë, në anën e djathtë të kokës, në lartësinë një a dy gisht mbi majën e veshit. E vija kur ma thoshte truri se duhej ta vishja kapelën. Por nuk është se e mbaja gjatë. Vetëm dhjetë minuta, aq sa të pija duhanin e një llulle.

Plaku nxori një bixhak nga xhepi i shajakut dhe e vendosi pranë gurit, i cili e thithi sakaq dhe atij iu desh pak forcë ta shqiste:

-Siç e shikon është magnet - tha dhe ia dorëzoi me gjithë këllëf, të cilit s'i kishte mbetur asgjë nga ajo ngjyrëmjalti, që mund të kishte pasur kjo copë meshini në 'rininë' e vetë. Gjurmët e saj mund të shiheshin disi te rripi i trashë, në të cilin qe mbështetur dhe mund të qepej në kapak. Gjithsesi, ai gur duhej të qe mbajtur me një tjetër mbështjellës, ngaqë nuk kishte të rrjepura, siç

edhe ndodh rëndom në këta lloj këllëfësh, për më tepër se kishte kaluar pak më shumë se një çerek shekulli.

Djali e mori dhe e futi në xhepin e pasmë të pantallonave...

-Bravo! - tha plaku. Ai është vendi më i përshtatshëm, se jo vetëm s'dëmton, por u bën mirë kockave kundër reumatizmit. Edhe diçka tjetër. Se do të thuash ti, Marsejeza ma dha mua gurin dhe mbeti për vete pa gjë? Jo. Ky gur ishte dyfish i trashë. Shkuam në një sharrë-mermeri dhe ata e dinë se ç'hoqën ta prisnin tërthorazi pa e thyer dhe të dilnin dy copa të njëjta. Si dy binjake. Ne nuk u treguam se për çfarë e donim. Sekretin edhe ti nuk duhet t'ia rrëfesh askujt. Kjo, veç të tjerave shkallon të paditurit. Edhe diçka tjetër. Tharja e kënetave zhduku ethet tropikale. **Diktatura** doli më e fortë se **malaria**. Por **tharësit** ishin të **shtypurit**. Në mushkëritë e tyre të tjera '**mushkonja**' do të sillnin një sëmundje vdekjeprurëse. Më duket se ka ardhur koha që kjo ta zbojë diktaturën.

Pas katër a pesë vjet, siç edhe vetë do ta kuptosh, do të hapen rrugët. Po vajte në Paris, merr një taksì dhe ndalu te rruga "Viktor Hygo", është në bulevardin "Aragon". Kontrollloji të gjitha emërtimet e saj. Në ndonjë hotel, a dyqan, reklamat e të cilave do të kenë emrin "Fini", futu në të dhe pyet për Marsejezën. I ati i saj quhej Zhan. Mbase e gjen edhe atë. Se ata jetojnë gjatë. I thuaj se e kam kujtuar dhe e kam dashur për gjithçka bëri për mua duke pranuar edhe shpërfilljen e njerëzve të Ambasadës, që e detyruan të priste me orë të tëra ambasadorin tonë "të zënë" deri sa i humbte durimi për të shkuar pas një jave, ku do të ndiqte të njëjtin ritual neveritës "pritjeje".

Kurse për Marsejezën, jam i sigurt. Ma thotë zemra se është gjallë. Veç në mos qoftë në Paris. Mos më merr për të rrjedhur nga trutë, pasi kam bindjen se ajo do të ketë lindur vajzë dhe ajo vajzë duhet të jetë fëmija im.

-Vërtet e thoni këtë, gjysh?

-Po, bir, vërtet. Ajo duhet të jetë e bukur se e tillë ka qenë, por ç'them dhe unë. Është akoma, se ajo rron, Marsejeza ime. Mua më shfaqet në gjumë sa herë që i vjen ditëlindja. Se e ka më 6 maj 1940. Nuk e dija, e kam gjithnjë këtë aftësi që quhet 'dimension i katërt'. Se njeriu, në planin e tij fizik ka tre dimensione: lartësi, gjatësi dhe trashësi. Por ai ka dhe një të katërt. Kjo është aftësia e mendjes së tij për të parë brenda një sendi, të cilit syri i sheh vetëm anën e jashtme të tij. Unë këtë e kam përjetuar gjithmonë në ëndërr. Sytë e mi, përherë kanë parë gjëra (vazhdimisht në ëndërr) që, ose kanë ndodhur, ose do të ngjasin më vonë. Shtegu i lindjes së Marsejezës është nga më të mirët. Në qoftë se do të jetonte kohën e Pitagorës, do të qe nga të përzgjedhurit e tij. Ne jetojmë kohën pas Ajshtajnit dhe ajo është e përzgjedhura e dishepujve të tij: prandaj pëlqeu fizikën e grimcave nënatomike.

Çdo gjashtë maj, unë do të marr culen dyjare, edhe i sëmure po të jem. Do t'i bie e do të kërcej bashkë me qenin tim. Në fantazinë time nuk do të jetë langoi, por Marsejeza ime. Ajo do të lodrojë deri sa të joshet dhe unë do t'i bie fyellit deri sa të mos kem më frymë.

Kështu, në njëzet e dy vitet e parë, nuk kisha mundësi t'ia festoja se isha në burg. Më pas, po. Ka plot katër vjet që ia kremtoj. Prandaj dhe më quajnë të çmendur, se ka raste që edhe qeni im nuk është mirë dhe jam i detyruar të sillem vërtet si i marrë rreth tij dhe vetes sime. Por gjithnjë me mendjen te Marsejeza dhe vogëlushja Julietë.

Kështu, bir, besoj se e kupton që duhet të kesh me vete edhe fletoren time. Frëngjishten do ta kesh mësuar e do të dish ta plotësosh edhe me përshtypjet e tua mbi takimin tonë.

Guri, i futur në këllëfin e vet, me dorën e saj, do ta bindë dyfish, pas atij shkrimi që do ta njohë patjetër. Se

qe dashuruar me të si me çdo gjë tjetër timen, përpara se të më donte mua, apo mos është e kundërta, mor bir? Se mua më ra një herë në dorë kur qemë ende paramaturantë, një faqe fletoreje e mbushur e gjitha në bukurshkrim, ku shkruhej: *Luan Majlindi*. Ishim në orën e matematikës dhe profesori kontrollonte fletoret e detyrave. Unë i thashë, i ke bërë mirë ushtrimet, por i mungon rezultati i *iksit*...

Plaku u gëlltit, që të mos i shihte djali-lotët, para se të thoshte: -Shko e çoja kur ta takosh dhe foli edhe për rezultatin e *iksit* dhe nuk donte të shtonte asnjë fjalë tjetër, prandaj zgjati dorën: -E po...

Edhe poeti shtriu, instinktivisht, të tijën se mendjen e kishte ende te poetika e atij sinjali dashurie si dhe... shkatërrimi i **iksit**. Gjithsesi do të kujtohej se ata po ndaheshin pakthyeshmërisht me njëri-tjetrin, prandaj ia lëshoi dorën për ta përqafuar plotësisht e nxehtësisht dhe ndjeu erën e djersës së tij.

Qenë çastet kur iu ndërmend ajo çka i tha plaku, ndërsa e risolli në jetë me atë erën e akridit, ilaçit për fërkimin e tendinave të kalit, për riaftësim. Se të tillë erë të rëndë ka edhe fara që ngjiz një jetë. Mbase këtë erë të rëndë e shoqëron çasti i lamtumirës, i asaj dekike e përmalljes përpara ndarjes në rrugën për plotësimin një amaneti. Dhe djalit besimplotë iu shtua shpresa se ai, njëmend do të gjente dhe takonte në Paris, gruan dhe vajzën e këtij plaku-shpëtimtar të jetës së tij. S'qe e domosdoshme t'i shihte me admirim lotët e këtij njeriu të vuajtur, kur në gjoks ndjeu drithërimën e një zemre, që përpëlitej si në agoni, dhe u rrëqeth i tëri. Kjo bëri që poeti ta lëshojë veten dhe t'ia plasë të qarit. Se..., **pa lotët e një plaku** të rridhnin dhe kaq do të mjaftonte që t'i dridhej i gjithë trupi e të shpërthente në lot, që binin si gjethet e trishtimit.

Të dy u ngashëryen si të qenë babë e bir. Më në fund 'babait' iu mehën gulçimet e u shkëput. Edhe lotët iu shterën. Te ky shpresësuar ekzistonte ende forca magjiplotë. Ajo që s'gjendet lehtë te shumëkush.: forca që mposht vetveten.

-Nxito, bir, të bashkohesh me shoqet dhe shokët se jeta shëmtohet e përbuzet pa 'to. Është keq të rrish vetëm. Por është akoma edhe më keq i vetmuar.

Poeti nuk u përgjigj: E kuptoi se ai njeri e kishte fjalën për vetveten. Se ndiente një lloj dhimbjeje për shtegun e detyruar të jetës së tij..

Poeti u ngut të zbriste tatëpjetë edhe nga frika e ndonjë ndërkëmbyeshmërie figure, siç edhe ndodhi, sepse para syve iu shfaq Ortepi.

U ndal se po shihte një skenë të pabesueshme. **Ajo vinte nga e ardhmja**, që ai do ta quante '**ëndërr me sy hapur**'. Ortepi ngrinte supet dhe bënte të paditurin, teksa shokët e pyesnin për Petron. Sepse Ortepi s'kishte mbërritur ende në kamping, kur Petros iu shfaq fytyra e tij përpara shokëve, duke ngritur supet sikur s'qe ai që bishtnoi dhe ia mbathi, nga sytë-këmbët, duke e lënë turpin e tij në... majë të malit. Ky do të qe tamam agjenti i sigurimit të shtetit.

Petroja zotëronte, kësisoj, aftësinë të shihte '*nga e ardhmja*'. Në rastin konkret kësaj i druhej...

Thuajse kishte mbërritur tanimë, kur dëgjoi borizinin që, me sinjal alarmi, thërriste mbarë kampionët, ardhur nga të gjitha rrethet e vendit.

Shokët po mblidheshin te sheshi i rreshtimit dhe sytë i drejtuan nga kasollja e vetmuar, rrëzë malit, e cila sapo qe ndezur dhe flakët e zjarrit ishin ngritur frikshëm në kupë të qiellit.

Poeti vërejti plakun që kishte hequr atë veshjen e shajakut dhe e vërtiste si flamur kushtrimi, duke thirrur:

-Marseeel, Marseeelëëë! Më dëgjon?!

Pas asaj shtangieje të parë, Petroja e mbloodhi veten dhe, menjëherë, e hoqi këmishën dhe e vërtiti edhe ai që ta shihte plaku i mjerë dhe ta kuptonte që Petro-Marsel-Marsejeza, po e dëgjonte: -Po të dëgjoj, shpëtimtari im?

Plaku e kapi sinjalin dhe thirri, me sa kishte në kokë:

-*Zhëtemë, Marsejezë, zhëtemë! Zhëtem, Xhulio!* - që do të thoshte Julieta.

Pas kësaj, poeti s'donte t'u besonte syve. Ai plak babaxhan u hodh në flakë dhe, sakaq, iu zhduk nga sytë.

-U zhbë, për besë! - tha një nxënës i ndodhur pranë poetit dhe u mbështet me dënësë mbi gjoksin e tij.

-U farua për atë dritë, - tha një tjetër nxënës përmes lotësh.

-Katër gjëra kam parë përherë rrëzë asaj kodre: Kasollen, qenin dhe plakun me hallin e vet. Tani që shoh flakën, më duket se s'ishin pak, por shumë dhe në harmoni, - tha një jugor.

-Këqyre, këqyre langoin e vet, ç'ashtë tuj ba! - tha dikush tjetër.

Të gjithë u përqendruan të shihnin qenin, që si bëri ca lëvizje rrotulluese e të hutuara duke lehur, mori vrull dhe u hodh mbi flakë pa kthim, si të donte ta kapërcente atë, tej e tej, a si të përpiqej ta tërhiqte mbrapsht nga ai vendim asgjësues, të zotin e tij. E, pse jo. U fut në zjarrin e besnikërisë, ku do zhbëhej bashkë me pronarin e vet.

Plaku e kishte shpirtin e djegur që prej njëzet e gjashtë vjetësh, gjë që s'kishte gjasë ta dinte kurrkush. E, për pasojë, edhe vendimin duhet ta kishte marrë prej kohësh. Tani ai s'po bënte gjë tjetër, veçse zbatimin e tij. Dhe duhet të kishte moshën e të atit, i cili helmoi trupin. Ky 'plak' dyzetetëtvjeçar që gjithashtu e kish të pikëlluar e të përvëlur shpirtin, tani po digjte edhe mishin.

Qe kohë inkuizicioni.

Pasqyrimi

Në atë fshat të gjithë e njihnin këtë njeri për të çmendur dhe vetëdjegien e tij, si çdo gjasë të pazakontë, pas tri ditësh do ta harronin. Por kjo s'do të ndodhte, assesi, që poetit t'i fshihej nga kujtesa. Jo vetëm se ky njeri 'i çmendur' s'qe aspak i tillë. As sepse ai i kishte shpëtuar poetit jetën. Por sepse te ky njeri rrihte një zemër e madhe si edhe një mendje e zgjuar, po ashtu dhe... ai e ndiente se ishte bërë skllavi i kësaj mendësie.

Mungojnë fletët e fundit

Sigurisht që kishin kaluar për afërsisht pesë vjet. Poeti e kishte përvetësuar, tashmë, frëngjishten dhe mund t'i kthehej 'fletores amanet', që e mbante ende të maskuar, diku mes librave të shumtë dhe fletoreve të seminareve studentore. Por kishte dhe frikë të merrej me të.

Natyrisht, shumëçka ai e dinte nga goja e vetë plakut. Ndonjë gjë, si ajo për të cilën mund të vlerësohej si kërshtëri e parë, koha në mos e kishte mënjanuar si dallga-valën, të paktën duhet ta kishte fashitur disi. Por kjo s'kishte ngjarë, kurrsesi, me poetin. Tek ai mund të kishte ndodhur ajo, që hiri kishte mbuluar prushin dhe ai qe kthyer në djegës. Se aq moskuptues ishte edhe vendi i asaj fletoreje. Qe përzier me udhëzimet e shkruara dorazi, me rregullat e mbrojtjes, që skuadra antizjarr duhet të dijë. Skajshmëria e atij akti vetëflijues edhe pas kaq vitesh, hutonte cilëndo mendje të shëndoshë, në arsyetimin e papërputhshëm, kurrsesi, me çka do të pësonte mishi si dënim edhe në qoftë se ky mund të qe nxitësi a ngasësi për mëkat.

Mëkat! Në fjalorin e gjuhës sonë kjo shpjegohet me shkeljen e rregullave të fesë. **Mëkatim** thuhet më poshtë, është një veprim i turpshëm. Domethënë, të përmjerrësh në derën e kishës apo të xhamisë. Sipas kësaj logjike, duke bërë dashuri me një të huaj ai kishte përmjerrë

në derën e **Partisë**-kësaj feje të re, e cila ndryshe nga të tjerat që, megjithatë edhe këtë *mëkatim* ta falin, Partia të ndëshkonte. Madje atë e përmbushte me rreptësinë e inkuizicionit. *Turrën e druve* e kërkonte vetë shpirti i atij, që s'i duronte më trupi. Prandaj ai vendim që i lartë e i madhërishëm. Se që marrë nga një njeri krenar e fisnik deri në ndriçim. I papenduar për dashurinë e tij. E, mbase mëdyshas që s'gjeti forca ta mbronte atë me çdo mjet. Por a mund të luftonte i vetëm me atë përbindësh që quhej *Diktaturë*?

Gjithsesi kjo zgjidhje me djegie, si mjeti i fundit i beduinëve, mbase fliste edhe për diçka tjetër, që poeti ende s'qe në gjendje ta shkoqiste, ndërgjegjësimi, po ashtu. Kjo përgjigje duhej të gjendej në tërësinë e atij materiali të fletoreshkruesit. Poeti, edhe pse e kishte kaluar kënaqshëm thujtë të gjithë lëndën, me fjalor përpara e, pak e nga pak i ngjante se, në damarët e tij, kishte hyrë e qarkullonte në krejt trupin, një bulëzë. Ajo do të mugullonte deri në shpërthim, të asaj qelize, që në shpirtin e tij do të piqte revoltën.

Ky duhet të ketë qenë edhe pengu i atij plaku. *Plak???* Por çfarë moshe pranojmë ta quajmë të tillë dikë, i cili në vitin '60 të shekullit të shkuar, që njëzet e dy vjeç dhe plotësisht, njëzet e gjashtë vjet më pas i dha fund jetës së tij me vetasgjësim? Plak në moshën dyzet e tetë vjeç? Ç'paradoks! Ç'kontrast bërtitës deri në ulërimë.

Kështu, poetit që tashti e zotëronte mjaftueshëm frëngjishten, nuk i dukej me vend që t'i kthehej nga e para, rileximit të saj tronditës, faqeve makabër të hetuesisë, apo edhe atyre të një gjyqi qesharak e banal. Nëse djali bënte dashuri me vajzën që e kishte njohur në bankat e shkollës, apo që 'korrier' i të atit për të përcjellë mesazhe spiunazhi, sepse, ky ishte shifrant në ambasadë dhe dinte mjaft sekrete. Por, që fatkeqësisht gjykata, s'i

merr dot dëshmi ngaqë ai, i vetëdijshëm (!!!) për krimin e tradhtisë së lartë ndaj Atdheut, vetëhelmohe bashkë me të ëmën e të pandehurit. A duhet dënuar sipas këtij neni, apo sipas atij tjetrit...?

Rrëfimi i tij, në atë fletore kishte një natyrë që turpëronte një gjeneratë të tërë për heshtjen. Se qe pranuar ndrydhja deri në ndjenjën e dashurisë. Në fletore drejtohen pyetje të karakterit: dashuria është *njerëzore*? Partia, në qoftë se e ndalonte këtë, ajo s'mund të qe veçse *çnjerëzore*!

Por, dy a tri fletët e mbylljes mungonin. Mbase edhe për këtë arsye, poeti e la të papërfunduar punën me të dhe u kthye të përkthente ditarin e një ekspedite të dytë, në kërkim të së parës në Antarktidë.

Një mace zbulon fundin e dorëshkrimeve

Ritualin e ngritjes herët edhe atë mëngjes ai s'e prishi. Edhe pse që e diel dhe plazhi gumëzhinte nga pushuesit që, si ortek i zbriste treni i Tiranës. Shumica zhvisheshin në rërë, a pranë ndonjë çadre të kabinave stinore. Ata u luteshin bujtësve të tjerë t'u hidhnin një sy teshave. Një pjesë merrte çadër ditore te pika e shpërndarjes së tyre, kundrejt dhjetë lekëve të vjetra dhe lënies peng të letërnjoftimit. Këta, përgjithësisht, ishin të rinj, që grumbulloheshin, pesë a gjashtë shokë e shoqe dhe shtriheshin në rërë, duke futur vetëm kryet në çadër, se trupat ia 'dorëzonin' diellit, ashtu të bardhë e të pafajshëm. Që rrezet e tij të bënin ç'të donin me 'ta, deri në mesditë, kohë kur të gjithë grumbulloheshin në qendër të çadrës të mbledhur, tanimë, këmbë e duar për t'u mbrojtur nga rrezet e pamëshirshme të tij. Se provonin 'goditjen' ashtu si pendimin që vinin njëkohësisht.

Familjarët në përgjithësi, burrë-grua, me një ose dy fëmijë, afroheshin pranë kabinave të pushuesve për t'i lënë plaçkat dhe çadrën, që në pjesën më të madhe e kishin të vetën, e ngulnin dhe zinin vend diku. Por në plazh shiheshin, ndonëse tek-tuk, edhe familjarë nga fshati. Këta dalloheshin jo vetëm se u vinin gratë e tyre

nga prapa, por edhe sepse pas shpinës varnin çadrat e zeza të shiut. Gratë e tyre, ndryshe nga qytetaret që mbërrinin gjysmë të zhveshura që në tren, ose të paktën, rrugës duke ardhur përgjatë rrës, mbulonin kokat me shami të bardha dhe bluzat e tyre ishin ende me mëngë të gjata. Dhe, vështirë se do të hiqeshin në moshat e mëdha, në kundërshtim me të rejat, që gjithashtu, do të zhvisheshin e zbrisnin në det me një tip palaçetash e jo kostum banje, që i ngjasonte me një tufë pinguinësh.

Të tjerë fshatarë çatisnin me gomerë për tregti të vogël dhe shpesh përplaseshin me njerëzit e rendit, sepse pakkush prej tyre, kishte vënë në prapanicën e veshgjatit mbajtësen e bajgave. Ndaj nguteshin t'u shisnin pushuesve domate e kastravecë, apo fiq e rrush si dhe shalqi e pjepër. Peshimi bëhej me zigj të vjetër me kokërr kandari. Këta ishin të paktë dhe mbinin thuajse rrzë kabinave, ose pas tyre, ku bari jeshilonte edhe pse aty gjithashtu kishte pushues ditorë e kryesisht familjarë të vonuar, të ardhur me trenin e dytë e të tretë, apo edhe më vonë.

Por le t'i kthehemi tregimit tonë:

Si çdo ditë, poeti nisi programin e tij, zgjimin në gjashtë dhe futjen në det. Ai vazhdoi banjën duke i rënë pash më pash atij uji, thuajse të vakët. Në rrëzë ishin ende të rrallë pushuesit. Më tepër shihje fshatarë që afronin shërbimet e tyre. Qoftë me fruta-perime, qoftë edhe me ndonjë shishe qumësht.

Qe, si të thuash, një baraspeshë qetësie: midis detit dhe njerëzve në rrëzë. Zërat e këtyre të fundit ishin ende të ulur se druheshin mos e prishnin këtë harmoni të natyrshme, deri sa vinte treni i parë dhe burri i familjes në krah të majtë të poetit.

Ai thërriste të birin, me emër, dhe kjo për Petron emërohej 'pikë e hapësirës fonike'. Shkurt, në varësi

të pikëndodhjes. Kjo, që në artileri përcaktohet nga koordinatat e quhet: 'pikë trigonometrike'. Në këtë rast, pas zërit të cilin edhe mund të mos e dëgjonte, se nuk qe edhe aq i lartë, 'pika... fonike', ai do të shihte atë prind të kujdesshëm, me çadër në dorë dhe pas tij, djaln me bishtin e saj, në këtë veprim aq të këndshëm.

Nisi kështu një ditë e re e, për pasojë edhe një javë e re, ngaqë ishte e hënë dhe ngritjen e çadrës së parë e merrte si fillësë ogurmire.

Poeti doli nga deti i ndezur, me zemrën e çuar peshë. Qe çelur kështu, një tjetër ditë për pushuesit. Në të djathtë, tri vajzat e shëndosha, të cilat, për t'u çuditur, poetit nuk iu dukën aspak 'buallica', por e korrigjoi përcaktimin me fjalën 'disi të shëndosha'. Nxorën dhe ato televizorin dhe nisën përgatitjet për t'u mëngjesuar. Kavanozi me reçel edhe këtu qe i pranishëm. Qumështin e siguronin nga fshatarët, me shishe njëlitërshe, se dalloheshin ngaqë ishin të mbyllura me kaçarum misri. Dhe, lavdi Zotit, merrnin katër të tilla, dy nga të cilat t'i përdornin për t'i kthyer në kos. Fshatarët nisën të sillnin edhe djathë e, më rrallë, gjalpë.

Thuhej se "tufëzat e arëzat" po përmirësonin, disi, atë që i mungonte tregut, por kjo kuptohej se qe më shumë propagandë komuniste sesa hapja drejt një tregu të lirë, që kish filluar më tepër si një përplasje midis rendit dhe 'fshatarësisë prodhuese' për të shmangur... bajgat.

Gjithsesi edhe për poetin qe diçka e volitshme, praktika e psonisjes te fshatarët. Atij i mjaftonte një shishe qumësht, gjysmën e së cilës e kullonte në një kavanoz të zbrazur me napë, duke e lënë deri në mbrëmje në diell, ai qe zënë kos.

Cipa e mbetur nga e djeshmja, në fund të qelqit, i mjaftonte të luante rolin e farës. Një praktikizëm i tillë kursente gjysmën e kohës, diktuar kjo nga jeta e tij prej

beqari, **gjë** që, s'e habiste aspak nënën e dy fëmijëve, kur shihte komshiun e saj, në darkë, të hapte kapakun e kavanozit me kënaqësi. Veçse një gjë e tillë s'ndodhte aspak me vajzat 'disi të shëndosha', në krahun tjetër, të cilat kishin dështuar, kur të dy shishet e lëna në diell, jo vetëm s'u zunë kos, por u prishën e u bënë hirrë, në dy raste. Habinë e kësaj gafe nuk e shihnin te domosdoshmëria e farës, të cilën e ditka ai beqari i staxhionuar dhe s'e ditkemi ne?! Me siguri do ta ketë fajin ai katundari që 'e ka shti qumështin në shishe të palame'.

Gjithsesi ka ekzistuar gjasa se është më e lehtë që faji të kërkohet jashtë vetes. Këtë bënë edhe të tri vajzat. Por ditën tjetër, se s'mund të rrinin pa një lugë kos në darkë, ngaqë edhe ishin fryrë me shalqi, lanë mënjanë sharjet për katundarin dhe iu lutën nënës së dy fëmijëve për pakëz farë kosi. Gruaja, me shumë takt, u tregoi edhe se ku kishin gabuar. Deri sa s'bëhet fjalë për 'frymën e shenjtë', që të zihet kosi, duhet patjetër fara, - përfundoi ajo.

Kaq mjaftoi që llomotitja të shndërrohej në një të qeshur rraskapitëse. Se beharonin dhe shpirtin duhet ta kishin të blertë.

... Poeti diç kërkonte sa mbi trapezë, brenda në kabinë dhe në një dalje e befasoi rrëmuja mbi dorëshkrime, atë pasdreke, kur ushqimet ishin sistemuar në vendet e tyre në dollap. Një pezm i panevojshëm, në thellësi të shpirtit, rritej.

Komshija e vogël, ngjitur, e kuptoi dhe i tha:

-Xhaxhi shkrimtari! Një mace kaloi në të gjitha kabinat dhe letrat e tua i shkarraviti.

-Faleminderit, vogëlushe, - dhe atë, ndonëse e "cingërisi tejet lëmshi", por kur ia gjeti fillin u gëzua së tepërmi. Fletorja e plakut që çmbështjellë dhe ishin

zbuluar ato, tri a katër faqet e fundit, të cilat enkas qenë futur në një mbështjellëse dyfishe. Poeti u gëzua dhe tha me vete: Në qoftë se nderi është thesar, kjo mace qenka xhevahir. Kjo thënie qe fluturim pindarik.

Kësisoj u zhyt thellë në vazhdimësinë e asaj përmbajtëse tejet tronditëse. Ndjeu që në rreshtat e parë, nga të rrahurat e zemrës, por edhe nga ajo frymëmarrje pezull, kurthin e ngritur nga fati. Dinakërinë e tij tinëzare. Kjo nuhatje bëri që poeti, me një përgjërëm të brendshëm, të përsëriste, zëulur.

-Mos, o Zot! Mos e lejo të ngjasë ajo që kam frikë se është e pashmangshme!

Trupi iu rrëqeth dhe djali shkrihet e bëhet njësh me ankthin, që përcjell fletore-shkruesi. Me dhimbjen e tij. Me revoltën. Me shpërthimin e pakontrolluar të tij. Shtysën shkatërrimtare.

Shkurdisjen e mekanizmit të ndërgjegjes për të shkallmuar me gjithsej strukturën mbajtëse të ndërgjegjshmërisë ngrehinë. Por mbase ishte tringëllimi i orës gjenetike? Kambana e alarmit. Se në çdo seancë gjyqësore me shumë përpjekje ia kishte mbërritur të mbante baraspeshën gjykuese me anë të teknikës së frymëmarrjes, ndonëse asnjëherë nuk e kishte ndier veten në ato kushte qetësie, për të cilën mendonte se duhej quajtur 'gjendja alfa'.

Tërë kohën e udhëhiqte një ndërkëmbim figure. E, ai shihte vazhdimisht portretin e Marsejezës, për të cilën edhe akuzohej. Prindërit i kishte humbur, tashmë, dhe i dukej se bashkë me ta qe helmuar i gjithë atdheu. Po ende këto shembëlltyra e bënë të habitej që kishin edhe gjuhën e tij, të vendit të tij, që e bindnin se qe bjerrur plotësisht.

Prandaj dhe i ndodhte ndërkëmbyeshmëria pamore. Marsejeza qe shndërruar në një shtrojer, ku

ai domosdoshmërisht kërkonte të mbështeste kryet e të merrte forcë si në pëqi të nënës. Të derdhte lot e të mbushej me kurajë. Kjo, natyrisht e bënte më të fortë. Por a duhej treguar agresiv ndaj diktaturës? A ishte e nevojshme çjerrija e maskës?

Këto qenë pyetjet që e pengonin risjelljen e asaj, që ai e quante 'gjendja alfa': fillestare. Duhej mbrojtur familja e tij: Nëna dhe babai të cilët, krenaria për të shpërfillur përballjen me inkuizicionin si "tradhtarë" (!!!) i vetëhelmoi.. Ky kumt çnjerëzor i kishte shpëtuar a me gjasë thënë si presion psikologjik nga një hetues, kishte bërë që djali të hiqte dorë nga shpërfillja. Nga ana tjetër e shqetësonte edhe Marsejeza. Përpyekjen e saj për lirim e tij, ai e kishte marrë vesh nga hetuesi i dytë, një tip llafazani, që për të treguar mungesën e tolerancës apo murin e pakalueshëm të pengesave, i kishte thënë prerazi: "Ajo zuska franceze, që pret një vajzë, shpresonte më kot takimin me ambasadorin tonë në Paris, se s'ka për të ndodhur kurrë".

Kështu që, mospërfillja e treguar deri tani nuk i vlente askujt. Aq më pak flijimit të prindërve të tij. Kurrsesi Marsejezës, nënës së vajzës së tij, ende të palindur. Ja pse s'duhej krenuar vetëm me mospranimin e akuzës edhe pse mbi trupin e tij u përdorën tortura. Kjo s'mjaftonte. Lipsej demaskuar inkuizicioni. Po si? Së pari të zhvlerësohej e ashtuquajtura inteligjencë e tyre, e cila s'qe tjetër, veçse përsëritja papagallçe e disa paragrafëve dhe neneve nga ata përbindështa me vështrim të ngrirë. Duhej shkrirë dhe më pas, rritur temperatura në ata sy, që të nxirrnin jo vetëm xixa, por tym nga tërbimi. Se, si një lukuni njerëzish, me prokurorin në krye, i qenë turrur një djaloshi vetëm njëzetedyvjeçar.

Shtegu i lindjes

Kryetari i gjyqit, për të disatën herë, i bëri thirrje që ai të ngrihej e ta merrte fjalën. Doemos: lipsej që në shkresat e tij të plotësoheshin dy gjëra: pranimi i fajit dhe kërkimi i mëshirës, si rezultat i pendesës. Kësisoj edhe farsa merrte një tjetër kuptim. Vallja kërkonte daullen. Apo tamtamja-kërcimtarin?

Dhe djali nisi të flasë. Jo se e bindi zëri i atij kryegjyqtarit me gjasë, si sharra që pret hekurat, për kafazin ku ndrynte “fajtorët” e tij. Por si njeri që kishte jetuar gjashtë vjet në një vend të lirë, siç qe Franca, mori shtysë:

-Po, zotërinj. Do të flas, meqenëse ngulni kaq shumë këmbë, ju zoti kryetar i trupit gjykues. Dhe, më lejoni t’i drejtohem me një pyetje njeriut që kam përballë.

-E keni fjalën për prokurorin?

-Po.

-Patjetër, është e drejta juaj, i pandehur.

-Faleminderit, zoti kryetar.

Pastaj djali i drejtohet prokurorit:

-Kë përfaqësoni ju në këtë gjyq?

-Shtetin, e kë tjetër?

-Po unë?

-Ju, - dhe tjetri, si kloun-cirku, shikoi një herë nga kryetari, pastaj edhe nga salla, me një habi të tillë që do

të thoshte: “është në rregull nga trutë e kokës ky njeri?!” Por vuri pak buzën në gaz... se s’qe gaz. Qe skërmitje dhëmbësh që donte ta shiste për qesëndisje, por i doli si shëmtimi i hienës. Tha: - Ju, kuptohet, i pandehur, përfaqësoni veten tuaj.

-Faleminderit, zotëri! Mund t’ju pyes diçka?

Prokurorit i ndritën sytë:

-Më në fund e hapët gojën. Flisni, i pandehur! Pyetmëni çfarë të doni.

-Faleminderit, zoti prokuror, mund të më thoni cili është ‘shtegu juaj i lindjes?’

Prokurori, që kishte ende pamjen e hienës, u shndërrua menjëherë në origjinën e tij gjakësore. Mori trajtën e një çakalli dhe, i kthyer nga trupi gjykues, ngrihet me vrull:

-Protestoj, shoku kryetar!

-Për ç’arsye? - i doli, me gjasme, në mbrojtje të pandehurit, kryetari. Ky s’kishte kuptuar asgjë nga kërkesa e beftë.

-Sepse pyetja është provokuese me tendencë diskriminimin e kuadrove të partisë!

-Unë s’shoh ende këtu asnjë motiv që të më bënte të mendoja se ka prapavijë diskreditimin, - tha ai dhe u kthye nga djali: - Vazhdoni, i pandehur.

Prokurori ndërhyri:

-Si s’shihni, shoku kryetar?! Kur themi ‘*shtegu i lindjes*’ nënkuptojmë, patjetër, fëmijët jashtë martese, që natyrisht lindin nga gra pa moral dhe, sipas këtij arsytimi, del se edhe nëna ime është e tillë dhe edhe unë jam i atillë: për pasojë, ilegjitim. Këtë fyerje s’mund ta pranoj dhe në bazë të “kodit civil”... - dhe prokurori shfleton librin përkatës, por kryetari e ndalon.

-S’është e nevojshme, shoku prokuror. Po të jetë e domosdoshme, do ta rishohim edhe atë. Pas kësaj, me pamjen e një idioti, rikthehet nga djali: -Shpjegojani

më shkoqur gjykatës çfarë doni të thoni me.. *Shtegun e lindjes?*

Djali tundi kryet. -*Shtegu i lindjes*, zoti prokuror, është një përkufizim i Pitagorës për klasifikimin e inteligjencës njerëzore, sipas teorisë së numrave, por edhe një kusht që...

-Unë kam bërë juridikun dhe s'mund të di tezat e Pitagorës, ndërhyri prokurori pa e lënë të mbarojë shpjegimin.

-Gjynah, zoti prokuror! Edhe unë kam mbaruar dy vjet për mjekësi në Paris dhe di se *shtegu i lindjes* ishte kusht nga Pitagora për të marrë në shkollën e tij, studentët që kishin lindur në *shtegun e shtatë*. Pra, me një shkallë inteligjence të lartë. Por, meqë kjo pyetje godet në një prag krejt të panjohur për ju, po ndryshoj trokitjen:

-Mund të më thoni, si quhen në latinisht kockat e ballit, kokës dhe prapa kokës?

-Protestoj, shoku kryetar, protestoj!

-S'keni pse protestoni, zoti prokuror, se po jua them unë: ato quhen: Frontale-Parientale dhe Oksipitale.

-Protestoj! E kthjem seancën në mësim mjekësie, shoku kryetar.

Por kryetari ende s'kuptonte se ku do të dilte i pandehuri, prandaj nuk ndërhyri që t'ia priste fjalën. Djali vazhdoi: -Keni plotësisht të drejtë, zoti prokuror. Sepse ju, siç pohuat pak më parë, keni bërë juridikun ashtu si dhe unë vetëm dy vjet për mjekësi.

Prokurori u ul. Djali, me butësi, vazhdoi: -Po ju s'keni të drejtë të protestoni se unë, paditurinë tuaj në fushën e mjekësisë, nuk kërkoj ta dënojnë me pesëmbëdhjetë vjet burg, siç po bëni ju me mua që s'e kam haberin e "Kodit penal". Ju kërkoni të më dënoni, - dhe ai këtu jo vetëm e ngriti tonin, por iu kthye të pranishmëve në sallë, - dhe më akuzoni padrejtësisht për "tradhti" vetëm se

kam dashuruar një vajzë franceze. Në cilin Kod Penal të Europës dënohet njeriu për një gjë të tillë, zoti prokuror dhe ta etiketojnë “tradhtar të Atdheut”?

-Pro... Por, kësaj here, kryetari, i cili ishte pak si i përgjumur, sepse qe ngritur në dy të natës për të zënë radhën e qumështit, u përmend, madje i tronditur nga ajo që i dëgjuan veshët. Se këtu shtrohej problemi i avokatit si dhe tjetra që kishte lidhje me akuzën: Baza ligjore mbi të cilën ngrihej ajo.

Jo. Kjo s’mund të lejohej, absolutisht. Ndryshe, humbja e vendit të punës ishte më e vogla. Por ai do të përfundonte si edhe ky fatkeq, që paska moshën e të birit. Gjaku i hipi në ... **oksipital**, domethënë prapa kokës.

-Ndal! - bërtiti plot mllef. - Dhe të bjerë rrufeja, - u shpreh kuturu kryetari, në vend që të thoshte, - Seanca mbyllet. Njëra nga dy anëtarët femra e korrigjoi: - Salla të lirohet! Trupi gjykues tërhiqet për të marrë vendimin.

Mendjemprehtësia e djalit zbuloi se ata ishin tejet të rëndomtë dhe i vuri në pozita qesharake, gjë që e tregoi salla. Ky s’që gjyq, ishte farsë groteske. Të shtypurit, me kryet lart e zbrazën ... estradën.

-Ky është inkuizicion, - akuzoi djali. Por pas kësaj, një pëllëmbë gardiani ia vulosi gojën dhe kur e pa se ai ende vazhdonte të përsëriste *Inkuizitorë*, pëllëmbët u dy e trefishuan. Megjithatë fjala si rrjedhë dilte ende, e madje shoqërohej si nëpër dhëmbë edhe nga të tjerë, që po lironin arenën me të shtyrat e policëve. Dhe kjo s’bënte askënd për të qeshur, ndonëse qe një klounadë. Komikja përzihej me tragjiken.

Djalit iu përplas koka, dy a tri herë, mbi bankë. Në ballin e tij u formua një goxha xhungë, në qendrën e së cilës, një e çarë nisi të rrjedhë gjakun, në çastin kur nga errësira hynë me radhë anëtarët e trupit gjykues.

Kryetari, me një vështtrim të papërcaktuar, urdhëroi të gjithë të ngriheshin në këmbë. Edhe të pandehurin, të cilit ato çaste i liruan duart nga hekurat e shtrënguara deri në kockë. Ky, instinktivisht, çoi një pëllëmbë mbi atë bullungë. E çara e saj rridhte gjak, që ngjante me një gojë, që mezi thoshte pika-pika fjalën: *-In-kui-zi-cion*. Gjithsesi, kjo s'e pengonte kryetarin të përmendte emrat e trupit gjykues, nën drejtimin e **Abedin Gorishtës** dhe... emrat e anëtarëve të tjerë.

Abedin Gorishta! Djalit iu kujtua emri i **Beladin Abedin Gorishtës**, tek paraqiteshin në ambasadë, kur bëhej apeli i detyrueshëm dhe e kuptoi se nga i kishte ardhur denoncimi. Qe, pikërisht, djali i këtij gjyqtari ai, **Beladin Gorishta**, që studionte një vit më lart, në të njëjtin fakultet me të dhe që, patjetër kryente dhe detyrën e përgjimit të shokëve.

Inkuizicion!

Vetëm kjo fjalë të mos thuhej. Se, fill pas kësaj, trupi gjykues, si pa gjë të keq, i shtoi dënimit edhe pesë vjet të tjerë dhe e shpuri dënimin në njëzet vjet, duke kaluar pretencën e prokurorit, si një rekord të ri. Veç kësaj edhe dy vjet, sipas "Kodit Civil", për fyerje të prokurorit. Kështu, përfundimisht, kryetari e shpalli fajtor, djalin dhe e dënonte me njëzet e dy vjet burg. Dhe ishte njëzet e dy vjeç.

Student në vitin e tretë të mjekësisë. *'Shtegu i tij i lindjes qe i shtati'*. Do të kishte qenë një nga të përzgjedhurit në shkollën e Pitagorës...

Kryetari e komunikoi vendimin duke mbledhur dy numra. Kaq dinte nga Pitagora: njëzet e dy vjet burg. Aq sa ishte mosha e këtij djaloshi, që së bashku bënë numrin dyzet e katër. Vitin e çlirimit të Atdheut. Po a qe i tillë ky vit? E tregoi edhe ky dënim se ç'qe. Vit i fillimit të një inkuizicioni. *'Zëri i kryetarit'* do të shkruante djali

në fletoren e tij, ashtu i çjerrë, po të qe shpatë, se kështu binte mbi kokat e njerëzve (këtë përcaktim mos e merrni kurrësi për metaforë sesa një gjasë të njëmendtë). Një plakë shkodrane do të thoshte përmes lotësh: -Ku-ku, për këtë djalosh, që dënohet fare kot, ku-ku! Fletoreshkruesi do të shpjegonte:

-Sa e dëgjova këtë kumt, të nxjerrë nga goja gjithë jargëzim e atij gjyqtari, që e kënaqte shkrimi i vet, fillova të ndiej dridhjen e dhëmbëve, si atëherë kur mbi mua, për herë të parë, përdorën elektroshokun që të pranoja akuzën. Më pas më kapi një drithërimë e përgjithshme, siç ndodh kur përvëlohem me ujë të nxehtë mbi krye, për t'u qetësuar pa e kuptuar se ç'kishte ndodhur me mua.

Sekretarja, një grua e thyer në moshë, prag pensioni, tek mbledhte letrat e shkruara, që gjatë gjithë kohës më hidhte ca vështrime të buta, ngriti edhe një herë shikimin nga unë, se ajo s'qe më shumë se dy metra larg, lëshoi një klithmë dhe i ra të fikët mbi karrigen e saj. Unë s'e kuptova shkakun. Trupi gjykues qe ndalur para asaj porte, pas së cilës vinte një korridor i errët, si të gjitha punët e këtyre shëmbëlltyrave. Qëndroi një apo dy sekonda dhe pa shprehur as më të voglën habi e përfillje, vazhduan të futen një e nga një, në atë portë prej qelqi të lyer në të zezë, si vendimet e errëta të asaj mesoreje.

Një polic më prangosi dhe në xhamin e errët të portës së zezë, më tha përpara se të ngrihesha: -Shikoje veten në pasqyrë që të kuptosh se ku të shpuri kundërvënia jote.

Bëra si më tha dhe nuk u çmenda.

Flokët e mi ishin zbardhur plotësisht. Sytë m'u mbushën me lot. Ata, sikur ranë mbi xhamin e zi vetëm për një sekondë, se polici e shtyu tutje për të dalë dhe mua më ngjau se deshi t'i mbronte ato qelqe nga nxehtësia e atyre dy pika lotëve në dy sytë e mi. Atëherë kuptova

pse i ra të fikët sekretares, aty më parë, kur ngriti kryet e më pa.

Gardiani më hodhi një vështrim, qëllimin e të cilit as sot nuk e kam të qartë, më tundi kokën duke vënë dorën në mjekrën time dhe lotët më ranë mbi pranga.

-Kokë-lakër, më ndiq! - dhe u nis në korridorin e errët, pas të cilit më prisnin vetëm gjëra të zeza.

Atë çast mendova se kishte filluar numërimi mbrapsht. Duhet të përgatitesha për ta zgjatur sa më shumë atë. Nuk dija që fundin e kisha në moshën e tim-ati. Tani që po shkruaj këta rreshta, janë të ditës sime të mbrame. Fletorembajtësit i kam shpëtuar jetën dhe ai do të të takojë patjetër. Jam i bindur. Besojeni: Lamtumirë, Marsejezë! Lamtumirë, Julieta!

Një karafil dhe një lule e trishtuar

Dhimbja që ndjeu poeti, tek përkthente këtë fletore i qe shpërndarë në të gjithë trupin, në “çdo grimcë të qenies së tij”. Se ajo ishte futur në damarë e kishte shkuar në zemër për t’u shpërndarë kudo. Dhe ndihej si të qe, pa sy, pa veshë, pa këmbë, pa krah, pa duar, që ta mbërthente djallin e këllitur, në ata ligje-kurthe, ku censurohen ndjenjat, kuptimi i jetës. Dashuria, ky veprim hyjnor i nëpërkëmbur në emër të kujt, që e marrtë djalli, e marrtë!? Kodit penal? Kësaj paçavureje shejtani? Se tjetri jetoi parajsën e një shoqërie evropiane dhe dashuroi për t’u kthyer me përdhunë e për të humbur jo vetëm dashurinë, por edhe prindërit, që ishin idhujt e tij, dashuria e parë për botën.

Tradhti ndaj atdheut:

Akuzë kaq e lehtë për t’u ngritur ndaj kujtdo në diktaturë. Diçka si pluhuri në një rrugë të pashtuar. E, aq më tepër, kur në dimër kjo rrugë bëhet me baltë. Sidomos kur mbi të kalon një mjet ushtarak tepër i rëndë, se ai ngutet të mbërrijë e të asgjësojë një “komplot imagjinar”. Në diktaturë, tërësia e këtyre së bashku, lipsen për ta varrosur të baltosur në burg, njeriun e shënuar si viktimë.

Për ta nisur të... motivuar në galeritë e kromit, ku në mos iu mbylltë aty jeta, nga ndonjë “aksident”, kur

të dalë, pasi ka bërë kokërr më kokërr vitet e caktuara, njëzet e dy, në rastin e djalit të studiuar në Paris, e pret një surprizë: Internimi në një humbëtitirë. Këtu Partia “kujdeset” ta veçojë si lebroso apo të çmendur.

Poeti tek lexonte tashmë në shqip, përkthimin nga frëngjishtja, ç’kishte hedhur në ‘të fletoreshkruesi, që përmbledhej në një fjalë të vetme *Inkuizicion*, i shtoej inati dhe i rritej pezmi. Këto, të mbledhura shuk, si të dilnin nga gryka e një topi, dhanë një krismë të thatë:

-Mos! Mos, o Zot i Madh! Mos, që e marrtë djalli e marrë këtë jetë të keqkuptuar e keqmpleksur! - dhe flaku tutje fletoren me një zemërim, po aq të pakontrolluar e të beftë, sa edhe ajo shkrepimë e thatë dhe shurdhuese e, në sekondë iu ndërkyembye figura. Për herë të parë, pas afro pesë viteve, i ndodhte e njëjta gjë. Atëherë, kur u përmend nga ajo shkarje, gati tejet e pandreqshme. Përpara i doli shpëtimtari i tij. Por jo babaxhan si atëherë. Aspak. Kurrresi për ta ndihmuar poetin e aksidentuar që ta risillte në jetë, siç edhe ia mbërriti. Se ai dërgoi së pari, langoi e tij e pastaj, duke u çapitur, ndonëse me vështirësi, mbërriti edhe vetë. Jo. Kjo pamje qe krejt ndryshe. Mos ndofta, vagullim? Atëherë ai ishte gjallë. Tani, jo. Atëherë shfaqej në ëndërr lëvizja e tij mbi tokë. Tani, që trupi i tij ekziston skelet nën tokë, duket me gjasë, fantazma e tij. Dhe këto, siç kemi dëgjuar se thonë, shpërfaqen kur kanë një merak, a një kumt për të shprehur. Çfarë konkretisht? Mbase një kujtesë e cila nënkupton një takim? Me kë? Mos ndofta, ka të bëjë me amanetin? Të jetë kaq pranë një përballje me përmbushjen e tij? Apo ishte dëshira ajo që, ashtu si çdo përpjekje tjetër, në jetë, qenka përfshirë si në çdo mendim tonin? Se... “*jemi mendje, përpara se të jemi trup*”. Apo jo, miqtë e mi?

Mbase asnjëra nga këto fluturime.

Thjesht ai lexonte atë, që ai fatkeq kishte shkruar përpara se ta përjetonte fundin e tij tragjik. Por, nuk është se po bënte të pamundurën për të shpëtuar një jetë. Jo. As të tijën, po ashtu. Përkundrazi. Kishte marrë një vendim të pakthyesëm për ta humbur atë, ose më mirë për ta dorëzuar me vullnetin e tij. Se donte t'i jepte fund, një herë e mirë, **kalvarit** të vuajtjeve. Dhe s'ishin pak, njëzet e dy vjet burg dhe katër në internim.

Poetit iu veguan gjuhët e flakës që kishin përfshirë kasollen. Madje, ndiente edhe kuisjen e atij langoi, që plotësonte shkrirjen e figurës me zërin ku lartësohej kuraja për çka do të ndodhte. Bëhej fjalë për një veprim të pazakontë dhe për një vetëflim të jashtëzakonshëm, gjithashtu. Një vetasgjësim e një largim nga kjo botë si... triumfator. Të tillë e morën ata sinjalin e mbramë të lamtumirës bashkë me veshjen e shajaktë, tek e vërtiste në drejtim të kujt? Shoqes së tij, në atë moshë të pastër të adoleshencës së largët. Asaj, me të cilën kishte kryer gjimnazin në Paris, në parajsën tokësore. Rruga "Viktor Hygo". Marsejezës me të cilën, vite më vonë, do të ngjiznin së bashku një fëmijë. Një vajzë, që besonte se quhej Julieta dhe që ata e thërrisnin Zhulietë, ose Xhulio.

Poetit i qe fiksuar ajo pamje thërritëse për shokun, mikun, shpëtimtarin. Se s'kish tjetër njeri në këtë botën tonë humbëtarë. Dhe klithma: Mar-sel, Mar-sel! Sikur i drejtohej universit të depozitonte në kujtesën e vet dhe t'ia përcillte më pas parajsën njerëzore mbi Tokë, atje ku kishte: shoqen-gruan-vajzën. Trininë e tij të shenjtë. Dhe, si për t'u siguruar në dërgesën e tij dyfishe, lëshon pyetjen tjetër: - A, më dëgjon?

Patjetër që e dëgjonte poeti, i cili e kuptonte se ky mbinjeri, në atë humnerë s'ishte *asgjësend*. Jetonte në... *asgjëkund* të kësaj bote dhe s'kishte *askërkënd*. E, megjithatë, ishte *gjithçka*.

Prandaj poeti i ngritur në këmbë instinktivisht si përpara asaj të vërtete, afro pesë vite më parë; u mat të hiqte këmishën dhe t'i jepte një shenjë, por e pengoi një zë fëmijëror. Një zë i pafajshëm, gati engjëllor që, në gjithë atë vegim e atë rishfaqje të shkuar, vinte i njëmendtë, tokësor.

-Xhaxhi shkrimtari!

Qe ajo vogëlushe që e risolli në vete. Ktheu kryet dhe dëgjoi: -Me mua je zemëruar që derdha gotën e qumështit?

Po kush do të guxonte qoftë edhe t'i rrinte buzëvarur, a kryemënjatë kësaj vogëlusheje, që ishte gazi në sërën e kabinave. Aq më pak të pezmatohet me të. E, assesi të zemërohet prej saj. Kësisoj, poeti i kthyer nga miturakja shihte ikonën e saj si të ngrirë, ndërsa në vesh i gumëzhinte ende zëri i atij fatpërmbysurit, që shqiptonte për herë të fundit dashurinë: *Zhëtem, Marsejezë! Zhëtem, Xhulio, Zhëtem! Lamtumirë!* - dhe hedhja e tij në flakë, si kreshnik, për të shpëtuar shpirtin.

Poeti ishte midis dy botëve: në njërën, vetëm me zë dhe në tjetrën, vetëm me figurë. Në botën jolëndore, por me gjasë shpirtërore. Dhe në botën tjetër, të njëmendtë, trupore, fizike. Të dyja këto mjaftonin të fliste si me vete, zëulur: -Marselë?!

Një e qeshur dhe më pas korrigjimi:

-Nuk jam Marsel, - ishte vogëlushja, që ende qeshte. - më quajnë Marcela. - Jam vajzë nuk jam djalë.

Vërejtje plotësisht e drejtë për hutimin e poetit.

Duhej kjo vogëlushe, që ta kujonte atë, se këtë emër ai e kishte dëgjuar dhjetëra herë këto tre ditë. Qoftë kur i fliste e ëma. Apo dhe kur e merrte përpara duarve i ati, sapo ai vinte çdo mëngjes. Në daç edhe kur ankohej i vëllai tek e ëma se... Marcela ia kishte marrë dhe nuk ia jepte lodrat e tij. Të gjitha këto ishin të mjaftueshme

për një kërkim ndjese, ndaj vogëlushes. -Më fal, Marcela!
Unë e di që ti je një vajzë e mirë. Por nuk e kuptoj përse
duhet të zemërohem me ty?

-Për gotën që... - dhe vajza uli kokën e nisi të qajë.

-Çfarë i bëre ti asaj?

-E derdha, - tha ajo përmes lotëve.

-Po ti nuk e deshe, një gjë të tillë, apo jo?

-Jo. Por mami më ka thënë njëqind ... - dhe ajo s'mundi
ta plotësonte dot fjalinë nga të qarat.

-Të lutem, mos qaj që unë ta kuptoj se ç'gabim ke
bërë. Ç'janë ato, njëqind, që mami **të ka dhënë**, lekë apo
kavanozë reçeli?

Vajza qeshi me shpërthim.

-Po, jo, xhaxhi, jo. Nuk **më ka dhënë**, por **më ka thënë**.
Prandaj s'janë as lekë, as kavanozë reçeli.

-Po çfarë janë?

-As njëra nga këto.

-Atëherë?

-Po thosha se derdha gotën me qumësht.

-Pse ti, ku e kishe mendjen?

-Po të shihja ty, që t'u mbushën sytë me lot kur po
lexoje, se burrat nuk qajnë.

-Ashtu është, moj xhane. Por ai që po lexoja unë, që të
mos qante se kishte bërë gabim, nga ngutja, në vend që
ta ndreqte lajthitjen, kreu një tjetër edhe më të rëndë e të
pakorrigjueshme.

-Vdiq?

-Jo-o-o-o! Se nuk duhet të vdesë njeriu pse gabon. Por
duhet të ketë kujdes të mos e përsërisë më gabimin dhe,
aq më keq për të, të bëjë një të dytë.

-Dhe ç'bëri?

-Në vend që të vriste egërsirën, qëllloi qenin e tij
besnik. Se ai ishte gjuetar.

-Kaq?

-Kaq.

-Budallai. Po ti ç'e kishe atë që t'u mbushën sytë me lot?

-Asgjë. Por, qeni i tij dhe më pas edhe ai, më shpëtuan jetën, kur mua më shkau këmba në një shkrep të thepisur dhe rashë në një vend nga ku s'dilja dot i vetëm.

-Domethënë se ishte njeri i mirë?

-Po.

-Domethënë se edhe të mirët gabojnë?

-Po, Marcela dhe kjo histori mbyllet këtu. Mirë?

-Mirë.

Poeti e ndiente veten të pazot që ta vazhdonte më tej bisedën. Fantazia s'i punonte më. Ai s'harronte se ajo qe thjesht një fëmijë dhe për ta zbutur disi klimën shprehu:

-Do të hamë bukë tani?

-Po, - tha vajza, - por unë do të pres mamin. Se ajo ka shkuar të lajë gushoren që bëra unë pis, bashkë me përparësen.

-Mirë, atëherë unë po vete te lulishtari i turizmit t'i kërkoj një tjetër lule, por kësaj radhe të trishtuar dhe këtë karafilin, kur të kthehem, do të ta fal ty, në qoftë se të pëlqen.

-Po. Më pëlqen, si s'më pëlqen!

-Ti, sa të vijë mami yt, ha. Mirë?

-Ëhë, - u përgjigj Marcela.

Dhe poeti ashtu bëri. Doli, jo dhe aq për të marrë një tjetër lule sesa për të freskuar fytyrën me ujë të ëmbël nga zorra e lulishtarit, nga ajo përlotje e beftë.

Pas dhjetë-pesëmbëdhjetë minutash shkoi në librari dhe në kthim për në kabinë, kishte një zambak lejla bashkë me gazetën "Drita" në dorë.

Në tryezë, pranë vogëlushes, qe mbledhur e gjithë familja për të marrë mëngjesin. Poetit iu desh, që për shkak të gazetës, të kthehej nga një rrugicë, që binte,

thuaje, pas kabinave. E komshies së vogël qe e para në gjithë atë sërë të gjatë. Ai ecte ngadalë duke shfletuar shtypin dhe lexonte, në tituj, shkrimet e botuara si dhe autorët e tyre. Veshi i kapi zërin e vajzës, që po i thoshte të atit: -Po jo, mor babi, jo. Ai qante. E pashë mirë unë. Ti, mami, kishe shkuar të më laje gushoren.

Ndenji pak ashtu, pa lëvizur, jo për të dëgjuar, por sepse i vinte për të qeshur, kur Marcela shtoi: -Ja: do ta shohim kur të vijë me një lule të trishtuar!

-Si the, si the? - e pyeti e ëma.

-Të '*trishtuar*', domethënë të mërzitur.

Poeti me vështirësi e mbante të qeshurën, që të mos i shpërthente. Por ata, ende, s'ishin njohur për shkak të natyrës krejt të ndryshme të pushimeve. Megjithatë i pëlqente kjo bisedë, kaq e çiltër e bërë me vajzën. Sepse i dukej se askush nuk do të qe në gjendje të kontrollonte sjelljen e tij dhe të rrinte serioz përpara asaj dëlirësie fëmijërore. Mbase për këtë arsye ai duhet të kishte zbuluar zambakun nga fleta e gazetës, që ishte porosi e lulishtarit për të larguar ndonjë merakli tjetër lulësh. Kurse poeti, që të mos e nxirrte gënjeshtare vajzën, e cila po i thoshte të atit një të vërtetë, ndryshe nga ç'mendoj, u kujdes më tepër të kruajë zërin për të paralajmëruar kthimin e tij.

Bisedat u prenë dhe ai i ngjiti, ato dy-tri shkallë të kabinës së tij: -Ju bëftë mirë, komshin!

-Urdhëroni! - folën të katër njëherësh fqinjët me vështrim të përqendruar nga '*xhaxhi shkrimtari*'. Ky, la mbi tryezë gazetën dhe ajo u shpalos vetiu për të zbuluar zambakët lejla.

Në çast, te komshinjtë plasi e qeshura:

-Marçela kishte të drejtë, babi, - tha vëllai i saj, një brun me tipare të ngjashme me të ëmën rreth dymbëdhjetë vjeç.

-Mua asnjëherë s'më kanë pëlqyer zambakët lejla.

-Ashtu është, - përforcoi e ëma, një grua rreth të tridhjetepesave, me tipare të theksuara të zeza, flokët të prerë shkurt e sy të bukur. - Ato mbartin mall e trishtim njëherësh. Prandaj edhe është bërë zakon kur i shohim të futura në kurorëzat për të ikurit e kësaj bote.

Poeti sistemoi lulen në kavanozin me ujë dhe u ndie pak ngushtë. Qe zbuluar kështu, në njëfarë mënyre, intimiteti i bisedës dhe, si të mos mjaftonte kjo, vajza tha: -Ai, te letrat e xhaxhi shkrimtarit, nuk iku. Qeni i tij iku.

-Pse?

-Sepse pas gabimit të parë, bëri një tjetër faj edhe më të rëndë.

-Çfarë? - pyeti sërish i ati, një burrë rreth një dekadë më i madh nga e shoqja, biond si e bija e me flokë të krehura me vijë. Tepër i përkorë e po aq i ëmbël në sjelljen me fëmijët, por sidomos me të shogën.

-Në vend që të vriste egërsirën, se ishte gjuetar, vrau qenin e tij besnik.

-Pse? - pyeti e ëma, - nuk e pa? - Vajza ngriti supet. Poeti vazhdoi shpjegimin, në vend të miturakes:

-Po, ashtu është. Nuk e pa se atij i qenë thyer syzet kur u ul të hante bukë dhe ky duhet të ketë qenë gabimi i tij i parë, që unë e anashkalova. Por më duhej të shpjegoja të dytin, për të cilin edhe më shpërthyen lotët. Më dhembti shumë vrasja e atij qeni.

-Se ju kishte shpëtuar dikur jetën, bashkë me të zotin e tij. Prandaj dhe do të merrnit një lule të trishtuar, - nënvizoi ajo.

-Ekzakt! - tha poeti, përmes të qeshurave të të tjerëve, por më pas iu desh të zëvendësojë këtë fjalë të frëngjishtes me tonën: *saktësisht*. - Po. Saktësisht thashë se do të shkoj t'i kërkoj atij xhaxhi lulishtarit një lule të trishtuar dhe karafilin do të ta dhuroj ty, në qoftë se të pëlqen. Kështu?

-Po, më pëlqen.

Poeti u nda për t'i dhënë vajzës karafilin.

-Faleminderit! - nuk harroi të thoshte vogëlushja.
Falënderuan edhe prindërit në të njëjtën kohë.

Pas një pauze të shkurtër, poetit, iu desh që, mbase me një çiltërsi thuajse të njëjtë si të së voglës, të shpjegojë:
-Po merrem me përkthimin nga frëngjishtja të një ditari.

-Kush e ka shkruar? - tregoi menjëherë interes i ati i së voglës.

-Nuk është autor francez, ndonëse ka bërë të mesmen në Paris dhe diç më shumë. Veç kësaj zotëron gjuhën në një mënyrë të përsosur, do të thosha. Pra, është i yni. Por tani po vë re gazetën "Drita", në parvazin e dritares suaj dhe...

-Po. E mora në Tiranë para se të nisesha, - ndërpreu tjetri. Është një zakon i hershëm rinor, i kthyer, tanimë në sëmundje. I ngjet pak atij të të martuarit që, kohë pas kohe, në mos kaloftë nga ballkoni i dashurisë së parë të dështuar, në rrugën e shtëpisë së saj këmbët do ta shpien.

Poetit i bleroi një buzëqeshje.

-Diçka të ngjashme thoshte Çehovi kur e pyesnin për dallimin midis mjekësisë dhe letërsisë. Nuk më kujtohet ekzaktësisht (Përsëri fjala 'Ekzakt'). Më është ngjitur kjo thënie nga mania që kam në mësimin e frëngjishtes. Pra, po thosha se diçka të përafërt përdorte Çehovi.

-Po. Se ishte mjek nga profesioni, të cilin e krahasonte me gruan e tij, kurse letërsinë me të dashurën virtuale.

-Ekzakt! - tha sërish poeti dhe e qeshura jeshiloi të dy tryezat në një gazmend hareje.

-Forcës së zakonit është më mirë t'i hapet rruga sesa t'i ngresh barrikadë, - tha mamaja e vogëlushes.

-Ekzakt! - përsëriti instinktivisht poeti, si të donte ta mbante në lulëzim të qeshurën, e cila vinte edhe si baraspeshë pas atij çasti të mëparshëm, tejet trishtues.

Kuptohet, në këtë dallgëzim të qeshurash s'përrjashtoheshin edhe fëmijët. Përkundrazi, Marcela tha: -Unë, xhaxhi shkrimtarin do ta quaj *xhaxhi Ekzakt*, - ndërsa djali, domethënë vëllai i Marcelës ta vuloste: -Marcela disa gjërave ua gjen më mirë se kushdo emrin.

-Ekzakt! - tha, kësaj here qëllimisht poeti, si të donte të vinte karafilin në gjoksin e vogëlueshes. Gjithsesi, kjo shkrirje jo vetëm i kënaqi të gjithë, por sidomos ia nxori gjumin babait të fëmijëve, që vinte nga turni i tretë.

Ata vazhduan të 'mëngjesohen' (për të përdorur një fjalë zhargon). Poeti, që i kishte vënë detyrë vetes të hante ngadalë, që të mos ia kalonte Marcelës, tha: -Të prezantohemi, miku im: Mua më quajnë Petro. Jam arsimtar në një lokalitet të Durrësit.

-Mua më quajnë Shpëtim. Punoj hotelier në hotel "Tirana". Im shoqe-Meri dhe djali-Klejdi. Vajzën po e dini, tashmë, ajo quhet Marcela.

-Gëzohem shumë! - tha poeti.

-Gjithashtu! - u përgjigj tjetri.

Dhe gjithsecili iu kthye ushqimit në tryezën e vetë.

Në kthinën e krahut tjetër, tri vajzat e shëndosha, emrat të cilave tashmë i dinte e gjithë sëra e kabinave të pushuesve. Ato flisnin zëllatë dhe s'qe e vështirë të fiksoheshin: Sanie, Mirije dhe Xhevrije. Atë mëngjes nuk e kishin hapur televizorin. Madje nuk e kishin nxjerrë fare tryezën e veçantë të tij, se qe mbi rrota. Kurse në të vërtetë ato vetë nuk ishin tamam mbi shina. Shpërfillja e poetit për to qe njëra anë dhe jo për faj të tij. Nga ana tjetër të dyja vajzat e fqinjës plakë tiranase, për 'to ishin "hundëpërpjeta" e "fodulle". Në të vërtetë ato qenë vërsniket e tyre, por njëra luante me volejbollin dhe tjetra me basketbollin e "17 nëntorit" të Tiranës, shkurt: krahu *sport*, si dhe lidhja e krijuar këtë mëngjes, aq bukur midis dy kabinave të krahut..., *art* (le ta quajmë) se bisedat u

kryen zëlartë, bënë që vajzat jo vetëm të xhelozohen, por edhe të shohin brenda vetes së tyre.

Mbase kjo duhej të qe edhe arsyeja që ato ranë në një heshtje të beftë. Por kuptimin e kësaj shurdhërie do ta jepte fakti, që njëra nga vajzat shkoi te lulishtari i turizmit dhe u kthye prej andej me një zambak-lejla, të cilin e vuri gjithashtu, në një kavanoz të zbrazur reçeli. Ky veprim, si çdo imitim, solli të tjera të qeshura..., shpotitëse.

Marcela, kur po hanin drekë, tha:

-*Xhaxhit Ekzakt* i ka ikur qeni, dhe vuri zambakun-lejla. Po atyre tetave, mos u ka ikur macja që vendosën atë lule në vazo?

E ëma e qortoi vogëlushen ndonëse ato vajza e kishin një mace të murrme, që e kalonin dorë më dorë dhe që askush nga të tjerët s'e kishte vënë re deri tani, ngaqë ajo qe dukur vetëm ditën e parë. Macja, që shqeu mbulesën e fletores së poetit, e dinin të gjithë se ishte një kalimtare e largët, që gjithashtu u përbishtë në një skaj të përtëjmë.

Poeti drekohej në restorant. Tek po kthehej, pa se te Marcela ishin ulur dhe po hanin, gjithashtu. U rikthye, nxitimthi, te lokali dhe mori dy birra të ftohta, njërën nga të cilat e vendosi mbi tryezën e komshiut. Ky, kur e ngriti pijen e ardhur në kohën e duhur, tha:

-Me ç'rast?

Poeti nuk e priste pyetjen ndonëse e kishte arsyen:

-Edhe të njohjes, -tha. Por më shumë për,... si t'ju them. E ndiej veten të lauruar në gjuhën frënge. Sot lexova në frëngjisht një *fletore*, e nënvizoj, *fletore* se ndryshe është libri, që përveç germave, që janë më të dallueshme në krahasim me shkrimin e dorës, ka edhe redaktorë e korrektorë letrarë. Ajo qe shkruar nga dikush, për të cilin do të kemi rast mbase të flasim më vonë. Paraprakisht mund t'ju them se jetoi... parajsën dhe më pas ferrin në Tokë, përpara se t'i fluturojë shpirti në Qiell.

-Interesant.

-E jashtëzakonshme ngjarja, por edhe stili i të shkruarit: unik në llojin e vet. Lëre pastaj gjuha që ka përdorur. Tepër, po tepër e gjallë. Kur ta zbardh plotësisht (në shqip) do t'jua jap ta lexoni dorëshkrimin.

-Jua kanë porositur përkthimin nga shtëpia botuese?

- Absolutisht jo. Është një punë që më shtyn përveç dëshirës, një lloj detyrimi moral, për të mos thënë amanet.

-Ju kuptova.

-Mund t'ju them dhe diçka të veçantë. Ka pasur një fat të trishtë dhe një fund tragjik, që e zgjodhi vetë mënyrën krejt të beftë sa edhe ,... - dhe ai uli zërin: - fare të padëgjuar.

-Vetëvrasje? - pëshpëriti tjetri si nën zë.

Poeti tundi kryet:

-Edhe më keq?

-Vetëdjegje, - dhe poeti shkundi kryet.

- Ç'flet?!

-Vetasgjësim, nuk thua?

Pasoi një pauzë.

-E kam njohur kur jetonte i vetmuar, por jo për shkak të asketizmit. Por sepse shoqëria e kishte mënjanuar dhe e gjykonte padrejtësisht, jo normal.

Ndërkaq fëmijët kishin mbaruar së ngrëni. Edhe nëna e tyre, gjithashtu. Burri i bëri me shenjë që të mblidhej trapezi dhe të vegjlit të sistemoheshin për gjumin e vapës. Gruaja u ngrit menjëherë dhe nisi nga detyrat. Burrat trokitën shishet për të vazhduar të shpenguar bisedën.

-Thatë se jetoi parajsën dhe më pas ferrin dhe se e gjitha kjo për shkak të një fati të mbrapshtë. Kështu?

-Saktë.

-Domethënë se ka provuar vuajtjet dhe duroi si hekuri

papërkulshmërinë. Kështu?

-Saktë.

-Thatë se mori një vendim të beftë?

-Saktë.

-Që do të thotë se ka pasur rezerva dhe se nuk ka dashur t'ju hapet plotësisht. Mbase edhe pse në atë fletoren e tij i kishte hedhur ato që i munguan bisedës me ju. Se burri, miku im, është po aq i mbyllur sa edhe një shkëmb, për dy gjëra: E para për emrin e asaj që dashuron, të cilin e thotë vetëm në amanet dhe të atij ose atyre që urren, me të cilët do të përballet edhe sikur të jetë dita e fundit e jetës së tij.

-Saktë.

-Sa për befasinë e vetasgjësimit, mund të them se diçka tjetër, mbase shëndetësore e ka rënduar në shpirt dhe, për ta shpëtuar, se burri është gjithashtu delikat si lulja, me dorëzimin e amanetit, hoqi dorë nga jeta përfundimisht. Pra, amaneti, dashuria dhe jeta bëhen sinonime. Pastaj vjen... pasjeta.

Poeti u befasua.

-Po të kishit lexuar fletoren në frëngjisht, nuk do t'i shtonit asgjë arsytimit tuaj, miku im. Si të mos mjaftonin njëzet e dy vjet burg dhe katër të tjerë në internim, i shpifet edhe një diagnozë në mushkëri, që i dha shtysën e fundit.

Poeti mbërtheu shishen e birrës dhe e trokiti me tjetrin përpara se të thoshte:

-Dritë t'i ketë shpirti!

Shpëtimi vuri buzën në gaz:

-Nuk trokiten gotat, as shishet në një rast të tillë, - dhe e uli në trapez, për ta ngritur pas një çasti: - Dritë t'i ketë shpirti atij njeriu, mirë e thatë, miku im. Amin!

Në qiell, në qoftë se ka mbërritur, është sosur si i barabartë me *inkuizitorët* e tij. Shën Pjetri, me siguri, do

ta ketë përcjellë për në parajsë ndërsa inkuizitorët e tij i ka çuar patjetër në shoqërinë e Pont Pilatit, që kryqëzoi Jezu Krishtin.

-Fantazia juaj më habit. Mos keni shkruar prozë? - u interesua poeti.

Tjetri vuri pak buzën në gaz.

Qe një nga ato buzëqeshjet, për të cilat kishte dëgjuar fletorëshkruesin të fliste për Marsejzën, kur donte ta shmange përgjigjen. Një buzëqeshje dritëplotë që thoshte shumë dhe, njëkohësisht, fshihte gjithçka. Nga ato buzëqeshje pas të cilave nuk lejohen të bëhen pyetje të tjera. Por që kishte edhe bukurinë e enigmës. Kësaj porte, për të cilën, s'është lehtë t'i gjendet një çelës. Prandaj bëhet histori për t'u kthyer sërish në enigmë. Qe ende koha e mistereve. Apo, më mirë të themi, ishte mugëtirë dhe koha e zbardhjes së tyre, por ajo ende dukej e pabesueshme, ndonëse shenjat i kishte dhënë. Në Shkodër, për shembull, prifti katolik, nën mbrojtjen e myslimanëve, dha meshën e parë. Diktatura nuk e quante më arratisje, por 'kalim të kufirit pa pasaportë', shkeljen e tij. Në Ambasadën Turke, me një makinë të rëndë, ishin futur tri a katër të rinj, që kishin kërkuar strehim politik.

Gjithashtu, fluksi i të huajve për më tepër, lënia e tyre të lëviznin të "lirë" nga *kalecat* (punonjësit e sigurimit), siç i quante populli, bënte shumë përshtypje. Madje i mbushte me guxim, sidomos të rinjtë. Sidoqoftë frika ende ekzistonte. Gojët, në mos mbaheshin të mbyllura, akoma s'flisnin: buzëqeshnin. Kjo do të thoshte se njerëzve kishte filluar t'iu kthehej disi dinjiteti. Kalldrëmi i intimitetit kishte nisur drejt tij asfaltimin.

“Nuk ka rëndësi sa pengesa janë deri
te shtëpia e Lejlasë. Vendos hapi
i parë që është i çmendur”

Edhe ajo ditë, si e mëparshmeja, nisi për poetin me ritualin e mëngjesit, si zakonisht: futjen në det, fërshëllimën e trenit dhe ngritjen nga komshiu të çadrës. Për të vazhduar njëtrajtshmëria me vërdallosjen në lulishten pas hotel turizmit, ku shpresa për të këmbyer me ndonjë frëngjishtfolës, shuhej te kërkesa e karafilit për vogëlushen Marcelë, të komshiut dhe lulen e trishtuar për vete.

Kthimi në kabinë, ku keqtingëllimi i kavanozëve të reçelit jo vetëm që e shtonte mërzinë, por acaronte nervat e cilitdo e jo më të poetit, që shëmbëllente me atë që rëndom kishte dëgjuar se thuhej për ata, që as vetë s’dinin se ç’kërkonin në fjalët: *më lër të iki, ndryshe do të ulërij, më mbaj fort, ndryshe do të rrëzohem...*

Por as ulëriti dhe as u rrëzua. Thjesht vendosi kryet mbi tavolinë dhe dremiti për të parë në gjumë një ..., **Qiellzanë**. Po. Është e vërtetë. Por **Qiellzana** kishte portretin e nënës së tij dhe qe krijesa më e bukur që i kishin zënë ndonjëherë sytë. Ishte e qeshur, veçse me pamjen e amvisës së shtëpisë. Në sy i lexohej gëzimi e lumturia...

Ajo kishte njëzet e pesë vjet e larguar nga kjo botë dhe qe e natyrshme që ai ta pyeste për gjithçka. Por ajo s'e la:

-M'u rrite, bir!

-Nanë...

-M'u rrite e m'u bëre për nuse, - tha ajo tejet e zënë si zonjë e shtëpisë.

-Nanë, të lutem kthema vështrimin. Pse më largohesh. Unë kam mall, nënë!

-Edhe unë, bir, - dhe ajo më në fund ktheu kryet. - Jam njëzet e pesë vjet-dritë larg. Por më parë përgatitjet. Nusja për ty vjen edhe nga më larg. Nga Parisi, - dhe ajo u tejbart me të gjitha sendet që kishte nëpër duar për t'u kthyer sërish në... **QIELLANË**. Djali hapi sytë.

Në qiell, një re të bardhë, poeti gabimisht e mori për pëllumbeshë dhe ai u ngrit si të qe vërtet e tillë dhe se diç priste prej saj.

Sidoqoftë ajo re do të bëhej shkak që ai të hidhte vështrimin bregut dhe do të befasohej, kur vërejti se një femër sapo doli nga uji e nisi të këmbejë me varkëtarin plak. Mënyra se si e lidhi shallin e saj të mëndafshtë pranë belit për ta kthyer në fund, madje mënyra se si shtrydhte flokët mënjanë, kuptoi se ajo nuk duhej të qe shqiptare. Jo. Ajo duhej të qe franceze. Vërtet kostumi i banjës qe paksa i ndryshëm nga i saj. Por ishin po ato gjeste. Po ajo hijeshi në lëvizje. Dhe këtu s'mund të kishte asnjë pasiguri. Krejt ndryshe kishte qenë dyshimi i djeshëm. Madje, në dy raste, e po ende te varkëtari.

Për këtë të sotmen çdo mëdyshje qe e kotë. Po ta pyesje poetin ato çaste kur nisi të mblidhte me ngut të gjitha dorëshkrimet dhe sendet në tavolinë e sirtar për t'i rrasur rrëmujshëm në kabinë, do të thoshte se ia ndiej edhe aromën (!!!) e rrobave e të trupit të saj edhe pse jam kaq larg. Një hovëzim më në fund e hodhi përpjetë si ta kish flakur dikush përjashta, ku kish hyrë gabimisht në

kabinën e tjetërkujt. Sidoqoftë që i vonuar. Ish tenori i operës do të deklamonte:

“Nuk ka rëndësi sa pengesa janë deri te shtëpia e Lejlasë. Vendos hapi i parë që është i çmendur.”

Ata dhjetë çapat e parë, ngaqë iu lëbyrën sytë, ca nga dorëshkrimet e ca nga dielli, ndërsa po i afrohej bregut, në mos tregonin se ishte vërtet i çmendur, gjysmëmarak ai do të që. Se buzë-detit s’pa njeri. Prandaj i lindi kjo poezi:

*Te bregu luleshumë Juljeta s’qe
as femër tjetër tutje-tëhu,
vegimi mbi varkë kurthe ngre,
me pulëbardhë e skifterë gjithashtu...*

Zhënjimi që i plotë. Kjo bënte që të ndërdyhej, se e gjitha s’ishte veçse një rremendje. Preku ballin për të kuptuar nëse kishte temperaturë dhe dora që e lagur nga djersa, por aspak e nxehtë. Mbase bëhej fjalë për një vetëdije të ... plagosur. Ai vendosi të zhytej në det dhe, me siguri do të freskohej. Por plaga e ndërgjegjes nuk shpëlahet me ujë, aq më pak kur ky është i kripur. Të shkretët poetë sa dede janë!!!

Kur doli nga uji, të tre ‘buallicat’ të kapura dorë më dorë, përvijoheshin si një vagon dhe ai, jo që të mos e shtypte vagoni, por sepse ngaqë i dukej se gjithkush ia dinte merakun që e kishte zënë me francezen, sidomos këtyre vajzave të rëndomta, u shmangej me hijeshi.

Ato u futën në ujë dhe ai e hoqi veten sikur nuk i pa se po trandej duke bërë ca hedhje në vend siç ndodh përherë me djemtë kur duan të çndryshken. Më në fund, ktheu kryet nga e majta.

Ai kish parë se pas ‘vagonit’ të treshes dikush mundohej të fshihej, por se do të që francezja. Po. Mirë

e lexuat. Francezja. Ajo ishte: Po me atë buzëqeshje që në faqe i formoheshin gropëza. Po ai shikim i ëmbël. Po ai shall i mëndafshtë. O Zot! Ajo! E tëra! Siç edhe e ëndërronte!! Por edhe siç e paralajmëroi në gjumë. **Qiellzana** e tij e **Madhërishme: NËNA.**

Poeti fërkoi sytë për t'u siguruar. Kishte përpara Perëndeshën Hipertermi apo fizikanen e grimcave nënatomike? Cilado të qe, ai pranonte të shkonte pas saj edhe përpara gijotinės (për të folur me gjuhën e dashnorëve kalorësiakë të Dymasë). Tenori kishte të drejtë. Më rrëmbefshin ujërat e Vjosës po ju them! (Për të folur me gjuhën e Luan Majlindit po të qe në atë çast).

Vështimet e tyre u përplasën dha ata, si të ishin marrë vesh që më parë mes tyre, siç ndodh përherë mes të dashuruarve, që komunikojnë më shumë me intuitë e hamendësime dhe e humbasin kuptimin, a vlerën e fjalës, lidhën nxitimthi e, njëkohësisht, duart dhe vrapuan së bashku në ujë si t'i priste mjeti fluturues dhe stjuardeskati që të ngrihej shkalla dhe të nisej hidroplani. Shkuma, por edhe një dallgë ngasëse, nisi të mbulojë kurmet e tyre, si të qenë dy delfinë në një balet koreografik. Si të tillë dolën mbi sipërfaqen lulesapuni nga shkumëzimi. Dhe, në pamundësi për të ndjekur dëshirën e zemrës, arsyetuan se duhej të anasillnin trupat e tyre për t'u çlodhur mbi ujë, ndaj kthyen kryet nga njëri-tjetri. E qeshura, pas ngopjes me frymë, nuk u ndahej dhe, befas, ashtu siç ndodh kur hyjmë në ujë, plasi dueli i fjalëve me akuza të ndërsjellta. Ta shohim atë.

I pari nisi poeti:

Ai: Pirate!

Ajo: Unë pirate?

Ai: Po, ti pirate!

Ajo: Gabohesh, madje rëndë. Ti je pirat.

Ai: Unë për ty mbase kam *namin*, kurse ti ke '*takamin*'!

Ajo: E, ç'na qenka ky *ta-ka-mi*?

Ai: "Takami"... Mbase janë mjetet për të kryer një punë.

Ajo: (Me djallëzi) Cilën punë? (I shkel syrin dhe e mbulon dallga)

Ai (i zënë pak ngushtë): Po, ja atë, që u kapëm për dore dhe u zhytëm në det së bashku.

Ajo: Dhe ku është këtu **grimcëza** e ashtuquajtur 'TAKAM'? Unë kisha vetëm dorën time.

Pas kësaj poetit i ndërmendet diçka me shumë vlerë. Fjala 'grimcëza', ndonëse doli ashtu instinktivisht, mjaftoi që të ndërkëmbejë figura. Qe plaku i pesë viteve më parë, ai që i dha fletoren-amanet, në frëngjisht. Ai që i fliste për gabimin në vitet e rinisë me atë parisienne, që studionte për '**Grimcëzat atomike**'.

-Pse heshtët? - e pyeti francezja. - Apo s'keni se çfarë të thoni?

Ai s'kishte vërtet se çfarë të thoshte. Se ndërkëmbimi qe një pengesë për të. I kishte ndodhur dhe tjetër herë dhe harronte çastin e mëparshëm.

-Nuk e dëgjova mirë se për çfarë po flisnim, -gënjeu ai dhe nisi të shprehet menjëherë me "Ju", si dhe ajo?

-Po flisnim për *grimcëzën 'Takam'*. Ju thashë se unë kisha vetëm dorën time.

-Ekzakt, - miratoi poeti, - por rrëmbyet edhe timen. Pirate!

-Ti ma përlave si ndonjë *tigër* timen. Pirat!

Ja dhe ngacmimi tjetër, i dyti. Kësaj here krahasimi me 'tigrin' i sillte menjëherë ndër mend çastin kur plaku, i ri atëherë, duke kujtuar stërvitjen në Vjosën e tij, edhe pse ishte në lumin Senë, u hodh për ta shpëtuar nga thonjtë e padukshëm të valëve të ujit, vajzën që ai dashuronte, e cila do ta quante '*Tigër*' dhe pse kishte emrin *Luan* dhe se ajo do të studionte për fizikë nënatomike. O Zot! Ç'i

ke përgatitur kështu vargëzuesit? Mos ndofta tragjedi shekspiriane?

Pas kësaj afrohet poeti dhe cazë pranë saj, si për t'i thënë një të fshehtë, mes shokësh, ndonëse misteri midis brezave nisi t'i përvëlojë kraharorin. Ajo e kapi atë vështrim e, madje edhe e lexoi si dëshirën e tij për ta puthur. Dhe, s'do të kishte asnjë kundërshtim sikur poetit të mos i mungonte kuraja, gjë që ajo e zotëronte, madje, me tepri. Se një Zot e di sa shumë e dëshironte këtë njeri dhe pse sa pak dinte për të.

-Vështrimi juaj është kaq nxitës saqë unë pranova me bindje dhe në heshtje sfidën.

-Cilën sfidë?

-Atë të dashurisë.

-Dashuria qenka 'sfidë'?

Dhe poeti qeshi me çiltërsi për atë çka përfaqësonte ajo. Një botë krejt të kundërt me realitetin e vendit që kishte zgjedhur për të kaluar pushimet turistike. Se ishte diametralisht e mbrapshtë, po aq dhe e ndryshme sa edhe liqeni me një moçal. Por, për poetin, s'qe aspak çasti e assesi vendi për shpjegime. Veçanërisht tani që ndërkëmbimi i figurave e këshillonte të ishte tejet i përmbajtur. Po sikur qëllimi i pushimeve të saj të kishte një prapavijë tjetër? Natyrisht, jo për atë për të cilën mendojnë vetëm *sigurimsat* për të trilluar grupe bandash e spiunësh. Aspak. Por për diçka tjetër që edhe lexuesit i shkon pak a shumë në mendje. Se nuk mund të jetë njeriu kaq naiv, sa të mendojë që shortas, a krejt rastësisht, vjen kjo fizikane e 'grimcave' bashkë me nënën e saj në këtë humbëtirë edhe pse ka det, bukuri e vende të gjelbëruara. Por njerëzit? Portretet e tyre të ngrysurat e po aq edhe të vyshkura si fletët e vruguara të duhanit me të cilat do të kesh të bësh? Apo pikërisht për këto ajo ka zbritur këtu?

Pas këtij arsyetimi atij zemra nisi t'i rrahë në një tjetër

mënyrë. Se donte, së pari, t'i bënte disa pyetje, nga të cilat shpresonte jo vetëm të befasohej, por edhe të lumturohej pas tyre.

-Pse ratë në mendime e s'po flisni, kur pak më parë prisja fjalën magjike "*zhëtem*"?

-Po. Magjik është ky kumt, prandaj edhe u ndala përpara se t'u thosha *zhëtem*, si te shkallët e një tempulli ku, para së gjithash, lipset sinqeritet.

Ky kumt shpërtheu si bombë midis tyre që tani, pa e kuptuar, i qenë afruar bregut në një drejtim tepër anësor, pranë këmbëve të pistës "Iliria". S'kish më kuptim të notonin dhe u ngritën e nisën të shtrydreshin nga uji e kripa e tepërt.

Zjarri i atyre ditëve, që ajo mungoi, mos ndofta e kishte djegur tejet së brendshmi dhe i qe kthyer në hi? Jo, përkundrazi qe rritur. Se zjarrin nuk e shuan prushi. I tillë qe bërë ai.

-Zonjushë! Cilido që të qe emri juaj: Kostanca, Natali apo Marie, unë ju dashurova me vështrim të parë, por kam një merak e, pas tij, rëndon edhe një amanet.

-Nxirreni! - tha francezja dhe zemra nisi t'i rrahë aq fort sa e tregonte dhe vështrimi i saj, ku ankthi i përzier me dyshimin ishin në një prag, si dy hije që s'dalloheshin se çfarë bartnin. Ishin vegime ndjellmirë, apo përkundrazi-ndjellakeq?

Portreti i saj u bë menjëherë hijerëndë, tek kullonte ende dhe flokët i la ashtu: si dy gërsheta të çmbështjella, që i binim mbi gjoks dhe që shëmbëllenin me një shall të zi të hedhur mbi krye.

-Nxirreni! - përsëriti francezja, që kësaj here padurimi i kishte lëshuar vendin, në njëfarë mënyre, zhgënjimit.

Poeti, që mbante ende në dorë atë shaminë e mëndafshhtë ngjyrëmjaltë, ia hodhi me ëmbëlsi mbi krye dhe tha:

-Mua më quajnë Petro, moj ikonë e kadifenjtë.

Ajo, sapo ngjiti shkallën e pistës *Iliria* si për t'u shkundur e shtrydhur disi dhe ndaloj e u kthye nga ai me ribuzëqeshje. Ishte gati të thoshte gjithashtu emrin, por poeti nga frika se mos, pa ndonjë shkak, edhe mund të mos e shqiptonte emrin e saj të vërtetë, siç ndodh rëndom në njohje të tilla kalimtare, si edhe për ta befasuar për atë çka mendonte i tha: - Kurse ju, zonjushë e ëmbël, mos ndofta quheni Zhulietë? Drejtpërsëdrejti e kishte pyetur për emrin edhe berberi dy ditë më parë dhe ajo kuptoi se qenka karakteristikë shqiptare pyetja pa doreza.

Befasimi, ashtu si dhe pritej, për poetin, qe tejet i madh. Kurse për francezen, i jashtëzakonshëm, për të mos thënë i mahnitshëm. E, për këtë fliste dhe ajo ngrirja me njëren këmbë në shkallinë, në një gjysmë profili, pa qenë e zonja të hedhë edhe tjetrën në bazamentin vijues. Se donte t'i pohonte shumë fjalë njëherësh ato çaste. Se qe i veçantë, ashtu siç kishte vërejtur qysh në krye të herës e prandaj edhe e pëlqeu. Por kjo thënie i ngatërrohej keqas me fjalën 'i papërsëritshëm'. Prandaj edhe e braktisi, ndonëse me dhimbje, për tjetrën: i 'veçueshëm', por dhe këtë s'e linte sinonimi 'i ndashëm'. Dhe kur e pa se të tria këto motërzime, si të futura në një ngushticë, s'i linin njëra-tjetrës përdhjen, iu ndërmend një fjalë e vetme, të cilën e shqiptoi: -Je fantastik!

-Zhëtem Julietë, se në shqip tingëllon më bukur germa që dhe shkruhet "J", sesa ajo që lexohet në frëngjisht "Zh".

-Zhëtem, Petro! - tha francezja.

Ishin të dy ende thuajse në atë pozicion të mëparshëm, me të vetmin ndryshim se ajo, tashmë, qe kthyer tërësisht nga ai, ndonëse sërish qëndronte një shkallare më lart tij, si të donte të zëvendësonte atë që do të bënin takat për t'u barazuar me të në një sallë vallëzimi.

-Zhëtem, - përsëriti dhe u nda ta puthë lehtë.

Ca fërshëllima të largëta, nga rëra, në shenjë miratimi e pse jo edhe kënaqësie, e përcollën këtë bashkim të nxehtë buzësh, se ata nuk e dinin se po putheshin dy botë, krejt të kundërta. Përndryshe kuraja në këtë përballje me diktaturën do të lexohej si bashkëfajësi në krimin '*tradhti ndaj Atdheut*'. Kodi penal do t'i mbyllte pas hekurave të burgjeve.

-Zhëtem, Pet! Mirë e kam emrin?

-Po, - ishte pohimi moskundërshtues i poetit, ndonëse kjo qe vetëm gjysma e emrit, por e thënë kështu, si miklim, tingëllonte bukur. Veç kësaj në një anë ajo i tregonte edhe pajtimin me atë që kishte dëgjuar t'ia shqiptonin të paplotë emrin ca *redaktorë*. Në gojën e saj merrte një tjetër kuptim. Këta, atë që i hiqnin fundores së emrit, kinse e '*zhdëmtonin*' me parashtesën: *njëfarë*. Për poetin kjo qe kthyer, njëherazi në një bindje, tashmë. Por dhimbjen më të madhe e kishte ndier kur i hoqën të drejtën e botimit. Provoi pseudonimin dhe përjetoi cungimin e emrit. Pastaj shkrimet e tij nisi t'i botojë me emër të tjetërkujt. Të gjitha këto praktika nuk ngjanin me atë që ndodh me drurët kur u priten ca lastarë të tepërt. Aspak.

Mbase nuk do të ndihej më keq po t'i kishin damkosur në shpatull atë që thuhet se u kanë bërë dikur prostitutave. Me ndryshimin se aty nuk do të shkruhej *Call girl*, por i *deklasu*ar.

Diçka naziste kur u vihej izraelitëve në shpinë damka: *Judë*. Pak rëndësi kanë krahasimet. Mospërfillja ia kalon çdo formulimi përbuzës. Shoqëria, fatkeqësisht, qe molepsur me këtë virus, tanimë. Prandaj mësonte Poeti frëngjishten. Dhe shpërfillte botimin në emër të mosvënies së talentit në shërbim të një sistemi të cilin e përbuzte se qe *Diktaturë*. Gjuha e puthadorëve të saj e

torturonte më shumë se thundra e pushtetit, përgojimi gjithashtu.

... Fërshëllimat e largëta, në atë puthje të lehtë që mori poeti nga kjo franceze atomiste e grimcave, jo vetëm që s'e shkuraJuan, por përkundrazi ia shtuan guximin. Se ato ishin shenja miratuese për vazhdimësi.

-Julietë, të dashuroj! - dhe atë çast bëri me shenjë nga qielli. Fjalët i tha shqip. Tjetra u hutua dhe e pyeti.

-Pet, ç'do të thotë në frëngjisht: **Të dashur-oj?** - dhe rrokjezimi që u soll aq bukur i kësaj fjale shqip, nga fizikania e Francës, bëri që poeti të kridhet në fushën e vet për të shpjeguar se:

-*'Të dashur-oj'* do të thotë *të dua* deri në dhimbje. Se dashuria ime ngjitet lart në qiell.

-Kurse imja zbret nga lart-poshtë?

-Ekzakt. Se është hyjnore. Sa *lart, poshtë*:

Dhe ata u puthën sërish. Kësaj here më gjatë, nën ato fishkëllima, që në veshët e tyre vinin si një simfoni dhe poetit iu ndërmend një shprehje nga Shekspiri të "*Nata e dymbëdhjetë*: Aty Viola thotë: ... *se si muzikë sferash do të më dukej*. Dhe sigurisht, ajo e kishte fjalën se melodia vjen nga planetet e prandaj është, si dhe dashuria, hyjnore, pra: *si muzikë sferash*...

Ata u ngjiten më kot te pista se, ashtu si hynë edhe dolën. Karriget e kthyer kryengulthi tregonin se lokali nuk shërbente edhe pse qe i hapur. Grupe çiftesh, tek-tuk, dilnin të zhgënjyer dhe s'kishin kujt t'i shfrynin mllefin e tyre, a pezmin në rritje deri në acarim. Dhe kishin të drejtë, s'mund të freskoheshin as edhe me një shishe-birre, a qoftë edhe me një arançatë të ftohtë. Personeli, pa dëshirën e tij, punonte me orar të kufizuar. Shkaku? Dihej nga të gjithë edhe pse nuk guxonte ta thoshte askush. Mungonte furnizimi. Industria e vendit, edhe me këta dy artikuj, nuk mund të përballonte kërkesat

e përdoruesve. Koka kola dhe prejardhjet e saj ishin të huaja sa edhe jashtëtokësorët. Importi i tyre as që mund të mendohej, absolutisht.

Gjithsesi, poeti s'u fut në atë pistë as të freskohej me diçka flladitëse dhe as të diskutonte për arsyet e mungesës së tyre. Për të, thjesht, hapësira e pistës që diçka që e mbushte me frymëzim individualisht. Aq më tepër, që edhe deti, nga ai pozicion, e kënaqte më ndryshe.

Sidoqoftë ata moskokëçarës, ashtu siç ndodh përherë me çiftet e dashuruar, nuk kishin domosdoshmërisht asnjë kërkesë për asgjë. Atyre u mjaftonte dashuria e tyre. Prandaj zbritën plot kënaqësi nga ajo hapësirë vallëzimi, jo vetëm duke u kapur dora-dorës, por edhe duke u tundur se... ajo ecje, tanimë mbi rrëzë e më pas edhe në ujë, tre-katër metra brenda detit, si *muzikë sferash po iu dukej*.

Sërishmi, tek luanin me pllaq-plluqet e këmbëve të tyre në ujë, poeti mori ca guriçka në rrëzë dhe i ndau me fizikanen. Ajo, në fillim, u befasua se para ca çasteve ata kishin garuar me ujë. Qëllonin njëri-tjetrin duke i bërë pëllëmbët si lopatë dhe, natyrisht, ndeshjen e kishte fituar atomistja e grimcave. Ai donte t'i merrte sa më parë hakun, ngaqë ndihej kinse i mundur. Gjë që dhe ishte dhe s'ishte e vërtetë. Se, përgjithësisht, në këtë lloj përballjeje, djemtë humbnin, ngaqë kanë padurimin t'i afrohen sa më pranë 'kundërshtares' dhe duke përfituar nga përparësitë që ka kjo lojë, të kenë mundësinë, ashtu si me të qeshur, ta 'përfshijnë' edhe me të prekur në vendet e saj delikate: si gjoks a vithe. I kësaj kategorie ishte edhe poeti. Ky vërtet e nënvlerësoi ngaqë e kishte mendjen te trupi i saj si delfin dhe donte ta shtrëngonte sa më parë dhe sa më fort atë. Kurse për fizikanen, *fushat magnetike* kishin kohën e tyre të studimit. Lufta me ujë, të vetën.

Prandaj dhe fitoi gjykimi brenda logjikës së gjërave. Të shohim se si do të dalin në këtë tip të ri gare, ndonëse qe mashkullore. Bërja e harqeve me një hedhje guri mbi sipërfaqen e detit. E provoi poeti dhe arriti shtatë të tilla. Fizikanes iu kujtua, me këtë rast, *Ekuacioni Maxwell* që paraqiste një diagramë të tillë, por mendoi të provojë lojën, pastaj të fliste për të. -Radha juaj, zonjushë.

-Në këtë lojë djemsh, ë?

-Është lojë. Pak rëndësi ka se e kujt është autorësia.

-Unë pranoj, - tha ajo me një kusht.

-Po iu dëgjojmë *a s p i r a n t e*.

-Meqë është lojë djemsh dhe unë e bëj për herë të parë një veprim të tillë, të më lejohet të provoj hedhjen e gurit me të dy duart.

Poeti qeshi.

-Pranoj, - tha, - por unë s'kisha faj kur të thashë aspirante. Ti ke një lakmi të dukshme që të fitosh. Pirate!

-Mirë, e pranoj përkohësisht epitetin, si ti kodin.

-Kjo është shenjë e tërheqësit.

-Mbase. Por dua të më tregosh se si ta mbaj gurin përpara se si ta lëshoj në ato kapërcime me pengesa.

-Me kënaqësi, - tha poeti që kërkesën e saj e quante 'autogol', ngaqë do t'i jepej edhe një herë mundësia që në rolin e lakmuar të 'trajnerit' të kishte mundësi ta shtrëngonte në kraharorin e tij në rastin më të mirë dhe ta çikte në njëfarë mënyre, si kalimthi, gjoksin e saj, në rastin kulmor të joshjes. Në të dyja 'trajtesat' ai dilte i fituar.

Kësisoj iu afrua plot *h a r e*.

-Mbaj vetëm një guralec në dorën që do të qëllosh dhe merr pozicionin, - tha ai dhe u tendos në dorën e djathtë t'i tregonte se si duhet ta shtrëngonte atë përpara sesa ta lëshonte. Atë çast ajo, në mos për ta nxitur që ta mbërthente mirë poeti për mes, bëri sikur po i merreshin

mendtë dhe lëshoi një psherëtimë. Ai, menjëherë, e përfshiu për beli. Fizikania qëndroi ashtu për një a dy sekonda me trupin e saj, gjysmë të përkulur nën këmbët e hapura të poetit dhe kur u ngrit, kokën e vuri në gjoksin e tij leshtor, ku siç doli, ishte edhe shënjestra e buzëve të saj. E puthte pa mbarim me një afsh të çuditshëm.

-Ky është vendi im i parapëlqyer tek ti. Se dua të ta ha këtë gjoks që të puth atë zemër të cilën, një Zot e di, sa e dua dhe e ndiej se është imja, pa guriçka, - dhe i hodhi ato.

-Merre! Kanibale! - tha ai që i dështuan të dyja mundësitë.

Gjithsesi edhe pse e pasuksesshme sprova e tij, e gëzonte dinakëria e saj. Nuk thuhet kot se kurthet i krijojnë burrat, por i zbulojnë gratë me kundrakurthet e tyre...

Ashtu, pa e kuptuar, i qenë afruar zonës së bllokut të udhëheqjes së shtetit. Rrethimi i tij, natyrisht që binte në sy për cilindo pushues, por jo për ata të dy që përfaqësonin përjashtimin nga rregulli. Dy puthjet e bëra në një 'publik' edhe pse disi të largët, i cili praninë e tij e kishte shprehur me ato fërshëllima të muzikuara, i kishin ngjitur ata në piedestalin e 'të dashuruarve': Madje dikush nga 'spektatorët' me radion portative "Iliria" në dorë, që transmetonte ato çaste diçka nga serenatat korçare, e kishte ngritur në kupë të qiellit dhe ecte buzë rërës, paralel me çiftin tonë. Francezja nisi ta shoqërojë këngën me tra-lala dhe t'i sillej poetit, sa para, anash e prapa, me ca lëvizje koreografike që të kujtonin tangot karakteristike spanjolle.

Gjallëria e lëvizjeve, jo vetëm e kishte lënë 'pranë këmbëve të urës' së pistës garën e guralecëve, por ato bënë që poeti, për herë të parë në jetën e tij t'i kryente atë kapjen e bukur të kavalierit balerin fizikanës së

grimcave. Njërën dorë, në mënyrë të shpejtë dhe rrokëse, ia vendosi fuqishëm mbi njërën kofshë, për ta mbajtur të gjithë trupin lart dhe, me dorën tjetër, vendosur në gjoks. E rrotulloi atë disa herë, teksa ajo ende vazhdonte këngën së bashku me lëvizjen e këmbëve e të duarve derisa dëgjuan një fishkëllimë të rreptë. Radioja “Iliria” u fik. I zoti u fut në një çadër çfarëdo.

Roja i postbllokut, në një kënd, dyzet e pesë gradë me detin, sepse ai ishte në rërë dhe i lumtur tek shihte lodrat, gëzimin dhe harenë e tyre, fërshëlleu kur ata s’ishin vetëm dy a tre hapa larg telit rrethues. Fishkëllima që e fortë, e rreptë dhe e pushtetshme. Poeti e zbriti menjëherë mbi ujë francezen dhe pati shumë kujdes t’i dalë përpara saj. Jo në lëvizjet aq të bukura të kërcimtares, por në atë që ta mbronte nga ajo egërsi që bartte fishkëllima. Se... **si krismë sferash ajo ngjasonte.**

Ushtari bëri me shenjë që ata të ktheheshin mbrapsht dhe nojmën e shoqëroi me një lëvizje të kapelës, që ata të kuptonin pikëmbërritjen dhe të niseshin në të kundërt. Me gjuhën e porosive ushtarake, kjo do të thoshte se ata klasifikoheshin, në rastin më të mirë, te ‘të hutuarit’. Dhe, se kishin dhe aq keq. Por çifti hynte tek ‘të dashuruarit’ dhe për këta s’flitet në asnjë rregullore. Aq më pak ushtarake. Kurrresi nën diktaturë.

Ata vërtet ishin si të dehur. Por jo nga pija. Se po të që verë, do t’i ngazëllente; ajo fishkëllimë do të binte si ca pika benzine në gotat e tyre ende të mbushura dhe atyre do t’u përzihej edhe ajo që i kishin hedhur në mëngjes stomakut. Sidoqoftë, ata tentuan të mbanin lart atë gëzim, që u hovëzua e arriti krenajën, me atë lëvizje koreografike, që në gjuhën e saj më duket se thuhet: ‘padjeshka’. Por, në mos u thye, diçka në kristalitetin e vet u plasarit. Prandaj edhe ata që ngritën këtë ngrehinë joshëse filluan ta kenë mendjen te krisja. Të vetmit që

kundërvepruan, deri në rebelim, qenë fishkëllyesit, të cilët, si të ishin në platenë e shfaqjes, kërkonin përsëritjen e kërcimit. Sidomos të padjeshkës. Këmbëngulja e tyre e ndiqte çiftin edhe kur truproja ushtarake kish mbetur, tashmë, tutje, në vrazhdësinë e vet. Dhe, ndofta është për të qeshur, por e kishin marrë këtë veprim si kundërgrimcë tejet të hijshme që, jo vetëm përqasej, por edhe e shuante disi kënaqësinë e munguar mbrëmjeve, të zhveshura nga argëtimet, qoftë edhe të këtij karakteri.

Nga ana tjetër duhet thënë se pranohej nga të gjithë se kishte ardhur një stad më kurajoz. Kishte mbetur, ku e ku më pas, koha kur të rinjtë e dëshiruar për pak muzikë të freskët dhe vallëzime të gjalla, me lëvizja moderne e dama të veshura me sqimë, uleshin mbrëmjeve në rërë, aty ku nuk arrinte ndriçimi i dritave të pistës përpara hotel “Adriatikut”. Turistët e huaj, por sidomos diplomatët perëndimorë në uikendet e tyre ardhur nga Tirana, gozhdonin vështrimet nga errësira të dhjetëra e qindra të rinjve.

Diktaturës së vëmendshme nuk është se i kishte shpëtuar kjo dukuri, por në pamundësi për ta mënjeluar butë, i raportoj, aty pas telave me gjemba, se njerëzit uleshin kësisoj për të thithur jodin e detit. Shumëkush, që ka moshën e autorit të këtij libri, kujton me trishtim vërsnikët e tij që pamundësinë për diçka më aktive e joshëse ia zëvendësonte soditja, tek shihte, në një kërcim drithërues, damën e ambasadës turke.

Interesimi për të ia kalonte kujdesit e vëmendjes për të mos humbur serialin e radhës, që sot, me aq tepri, shteti i asaj zonje ka pushtuar ekranet televizive ballkanike e, mbase, jo vetëm. Se vërehet një ... ‘riotomanizëm’...

Era, që nisi të shtojë vrullin e saj, valëviste shallin e hedhur në qafën e francezes, e cila, kinse e shpenguar, por me një qëllim të fshehtë, ndihmonte fillesën e saj me

kindin që ajo shtrëngonte nën sqetull. Ndërsa skaji tjetër i dallgëzohej përpara fytyrës së poetit, për të përfunduar pas veshit të tij të djathtë.

Iu ndërmendën dy gjëra që lidheshin me një të tretë: 'Amaneti, ekuacioni *Maxwell* dhe shprehja 'sa lart-poshtë': Të pathënat dhe francezja priste rastin ta pyeste poetin së pari ç'ishte 'amaneti'.

Petroja, nga ana tjetër, diç dëgjoi, ndryshe s'kishte arsye përse bënte lëvizje të tilla që mënjanonin një përpjekje të padëshiruar. Por edhe i hakërruar e mezipritur të ish kjo gjendje transi, nuk mund të thuhej se qe e panjohur për partneren. Me vazhdimin e saj ajo tregonte jo vetëm se e ndiqte atë, por edhe se ishte e bindur në atë që, kur poeti vononte përgjigjet, bënte përpjekje për ta kapërcyer rrethanën kalimtare. Dhe fizikania kishte plotësisht të drejtë. Qe për poetin një çast dëshpërues. Një zë i vrazhdë njoftonte, diku, një zë që i dukej si i njohur që thoshte: *Objekti u zhduk në det bashkë me subjektin gollomesh.*

Si dhe një tjetër zë:

Stakohu. Akoma s'kanë vajtur në djall cullakët?

Kësisoj atij i ndërmendej se kish mësuar nga ditari i fletoreshkruesit, që duhej të numëronte frymëmarrjet e tij për ta kaluar atë gjendje, aspak normale. Se mundet që këto shprehje që ai dëgjonte të mos qenë të njëmendta, mbase formulime të tilla vinin edhe si ...etyde psikologjike. Lufta për të kapërthyer kë? Përndjekësin. E kë tjetër? Se atij, edhe në ndonjë rast të ngjashëm i kishte ndodhur dhe e kishte mënjanuar duke përsëritur me vete një fjalë të vetme për çdo frymëmarrje. Por, gjithsesi, kryesorja ishte që të mposhtte frikën, grimca të së cilës i linin përshtypjen se kishte mbetur në një skutë të errët. Prandaj edhe kumte të tilla atij i vinin në vesh si paralajmërime ogurzeza që tregonin se diktatura, qoftë

edhe për inerci, s'i kishte shkrehur armët edhe pse ajo, tashmë i ngjiste hienës dhëmbërënë.

Gjithsesi poeti kishte synuar. E, kjo kurajë i kishte ardhur që kur kishte takuar atë plak të mjerë, të cilit diktatura i shkatërroi jetën. Që atëherë ai vendosi të lërë shkrimet dhe të mësojë një gjuhë të huaj, siç qe frëngjishtja e bukur, zotërimin e saj ia kishte mundësuar ditari i fletoreshkruesit. Se kishte guxuar të këmbente me një frëngjishtfolëse, fizikane të grimcave nënatomike e të dashurohej me të. Guxim për dashuri?! Po. Guxim për dashuri. Se kështu e kishte përcaktuar zgjedhjen diktatura. Edhe kur shikimet e një të riu përthitheshin nga një e re 'e huaj', duhej larguar prej saj. Se ato mund të ishin peri, por qenë si shtojzovallet e të tilla prishin mendjen për shkatërrim. Larg hireve të saj. Loja e Odisesë me Circen qe mbartur si në kohë dhe në hapësirë. Ajo njihte tashmë, për ideator vetëm diktaturën. Dhe poeti e kishte sfiduar atë.

-Pet! - foli francezja dhe e shkëputi nga... zymtësia. -Vështrimi yt se ç'merr një pamje të veçantë pas së cilës vjen ngrysjja dhe në finale, nata.

-Terri.

-Nuk desha të mbërrij deri aty, ndonëse në të vërtetë, kjo më tërhoqi më shumë tek ti.

-Errësira?

-Jo. Ajo që fshihet pas saj. E panjohura.

-Dhe çfarë mendon, zonjushë, se mund të ndodhë atje?

-Për mua një copë jetë brenda së cilës ka pasur një dramë. Se gjithmonë e kam urryer atë vështrim vetëkënaqësie, në thelbin e së cilës është mirëqenia, që s'të thotë asgjë, kur mungon shprehja. Është krejt tjetër terina në sytë e tu, e cila flet mbase për... - dhe ajo iu kthye ballas, përpara se të thoshte: -dramë ndarjeje, - dhe

i shkeli syrin me një çapkenëri për të cilën ndihmonte edhe tundja e kokës.

Poeti e kuptoi shakanë dhe ndoqi rrjedhën e saj:

-Po. Me një mjelëse.

-Fermere?

-Thjesht, mjelëse lopësh.

-Pra, fermere.

-Jo, e dashur. Ve-tëm mje-lë-se lo-pësh.

-Çudi! Ç'të shtyu deri te një argate fshati? Të paktën të kishte qenë bareshë dhe ti t'i këndoje serenatë me fyell, - u tall ajo, se e kuptoi që Petroja fliste me figura.

-Ç'më tërhoqi, thatë?

-Po.

-Gjoksi i saj.

-Volumi?!

-Jo, ndonëse duhet të pranoj se ishte shumë i bëshëm. Më magjepsën thithat e saj.

-Unë besoj, se në Francë, në dhjetë poetë fillestarë, tetë prej tryre gjoksin e femrës e krahasojnë me majën e Kullës Ejfel. Edhe ti si romantik që dukesh, duhet t'i kesh krahasuar me majën e kullës Ejfel. Kjo figurë e bën lexuesin thjesht të buzëqeshë.

-Mua, pikërisht kjo më ngriu buzëqeshjen. Dhe...më hoqi edhe dritën nga vështrimi im.

-Pse?

-Sepse... - dhe ai bëri me gisht të drejtuar lart.

-Zoti?

Poeti tundi kryet në shenjë mohimi. Sërish e drejtoi nojmën lart. -Shteti, - shqiptoi me zë, disi më të ulur.

-Dhe ç'hyn këtu shteti?

Ai hodhi një vështrim tejet dyshues.

-Mos e ke fjalën për censurën?

-Ekzakt.

-Ju keni këtu censurë?

Poeti tundi kryet.

-Mua kjo më kujton kohën e Galileut.

-Edhe mua, por jo për censurën.

-Po për çfarë?

-Për yjet që zbuloi ai, - dhe poeti u afrua pranë saj. E rroku për beli plot vrull. - Janë dy sytë e tu si dy yje, - tha.

-Më duket se kërkon të ndreqësh vargun poetik, me të cilin u dogje. Është kështu?

Ai pohoi me krye dhe tinëzisht pandehu se gaboi me atë dorën e shtrirë që e hodhi rrëmbimthi. Deri këtu mund të qe e vërtetë, por ai s'do të guxonte ta tërhiqte dhunshëm në qoftë se ajo, si në kërcimet e saj koreografike, të mos kishte përfunduar me një hijeshi cingërisëse, ngjeshur me gjoksin e tij. Jo për ta puthur në kraharor, siç i pëlqente asaj, por e dorëzuar për t'u puthur siç dëshironte ai. Dhe poeti e kuptoi këtë dorëzim pa kushte, veç të tjerave, edhe nga ai vështrim aq i ëmbël, tundues e njëkohësisht epshndjellës. Poeti e afroi me të dyja duart pranë vetes dhe për një a dy sekonda pa rreth e rrotull.

Kishin përfunduar në krah të pistës, hija e së cilës i mbronte nga sytë e plazhistëve. Trupi i francezes, sikur të kishte ftohtë, i fërkohej pas kurmit si një mace. Dhe ai, me buzë, e largoi tirandën e majtë të gjimbjatësës, që dukej si bisht grifshe dhe e puthi *majën e Kullës*. Në fillim fare lehtë, si të qe diçka e ëmbël dhe pse ajo kishte shijen e kripës, por edhe me kujdesin e atij që kërkon ta zgjasë sa më shumë kënaqësinë. Kështu, si një ketër që s'ngopej së ngrëni qershi dhe luante me bërthamat, ai kishte përfshirë me finesë fushën e atij gjiri për të mbërritur, herë pas here te maja e *Kullës Eiffel*. Dhe gjithmonë e kishte merakun ta shijonte edhe simotrën në krahun tjetër. Aty, ku rrihte me drithërimë një zemër, të cilën e ndiente se ishte vërtet e tij. Prandaj u mat të kujdesej

për ta mbuluar gjoksin e djathtë e për t'u hedhur te simotra e saj, por s'qe e domosdoshme. Francezja, me një lëvizje supi, e shpuri atë në vendin e vet. Dhe ndërsa ajo qe përkulur mbi qafën e tij, duke i ledhatuar flokët, s'e kishte kuptuar fare se ai, në krahun e zemrës, s'ish gjë tjetër, veç një ketër, tejet i pangopur me bërthamat e qershisë. Prandaj, fizikania lëshoi një 'oh' kënaqësie dhe poeti i dalldisur hoqi gojën nga maja e kullës dhe tha:

-Unë mund të mos di të them se ç'ka zbuluar Galileu në Univers, por që majat e Kullës Eifel, në gjoksin tënd, di t'i krahasoj me dy yje që do të më frymëzojnë. Prandaj edhe kënaqësia që mora nga ato është hyjnore.

“Gjithmonë, po gjithmonë, po ju them
se janë pranë e pranë tragjikja me
komiken”

Era, që në rërë ndihej së tepërmi, përmbysi disa çadra, që, si të vëna në garë, rrokulliseshin sa në një drejtim në një tjetër. Gjithsesi pa ndonjë pasojë te pushuesit. Pamja qesharake i gëzonte ata që hidhnin e prisnin batuta, në distancë, me njëri-tjetrin.

Në det, përkundrazi. Nga shtimi i dallgëve dikush qe rrezikuar të mbytej. Era, si klithmë, kishte sjellë në rërë thirrjen e fatkeqit dhe shumë pushues ishin turrur në drejtim të ujit, duke u përplasur me çadrat. Sidoqoftë rrokopuja s’i pengoi shumicën e tyre të zhyteshin në ndihmë të një jete, që ndofta mbahej nga një fije peri.

Varka, që tashmë qe shfaqur në breg, me dy palombarë, u nis. Ata që ndiqnin rrjedhën e këtyre skenave, gati sa s’duartrokitën për këtë përkim, se e kuptonin që palombarët ishin veshur më parë se të dëgjohej thirrja e fatkeqit. Sakaq, varka u shmang në të kundërt me vendin e të rrezikuarit. Duartrokitjet për të, jo vetëm që u prenë, por u zëvendësuan me fërshëllima e të shara, fare pa etiketë. I dehuri kronik, për të cilin ata që e njihnin, besonin fort se ai trembej të futej në ujë ngaqë rakia i thoshte se deti qe një kazan, ku valohej uji

për të prodhuar kripën, s'mund të mos përfshihej në atë teatër, të cilin ai e quante absurd. Me shishe në dorë deklamoi si në tragjeditë greke:

-Gjithmonë, po gjithmonë po ju them se ... janë pranë e pranë tragjikja me komiken. Ngë - qe gromësima e tij e vazhdueshme si dhe e pështyra si refren i një avazi - jo rreziku i mbytjes, po ju them. Se ai do të shpëtojë. - Dhe si u shty më tutje ngaqë donte të kthehej në drejtim të një çadre, e cila i kishte ardhur te këmbët dhe atij iu desh të rrotullohej që ta shmangte dhe ky t'i fliste varkës. - Se rreziku është fundosja apo groposja. Ph! -Ai palla, domethënë pallom-**bari**, nuk u nis kot. Dhe kjo është tragjikja shokë. Pas kësaj u kthye nga pushuesit në rërë. Tregoi, si gjithmonë me shishen e rakisë, nga kabinat.

-Këtej është komikja. Në të kundërtën e palombarit.

Këmbët e kishin shpurë, pothuajse, para hotel Adriatikut dhe askujt s'i shkonte ndër mend se ç'kishte komike në atë bujtinën e frekuentuar vetëm nga të huajt.

Ky qe i dehuri i dytë për të cilin, kur puqej me të parin, njerëzit i barazonin me një pendë qe. Por s'ishin aspak ashtu. Të dy ishin marrë dikur me art. I pari punonte në komunale, siç dhe e kemi parë. I dyti qe edhe më i talentuar edhe me emër, që 'lufta e klasave' e kishte shpurë në një fermë për 'të njohur më mirë bazën'.

Ai punonte natën në sistemim mullarësh, deri në të gdhirë, dhe aty afër drekës vinte në plazh, thuajse çdo ditë i dehur. Kush e njihte nga afër pohonte se nuk pinte më tepër se një teke. Kur thoshte ndonjë profeci, si kjo e tanishmja për komiken, në drejtim të turizmit, duhej të kishte rrëkëllyer patjetër dopion. Me 'adashin' puqeshin në një shkak dramatik: *Lufta e klasave*.

Përpara se të largohej u kthye nga drejtimi i varkës:

-Ai palombari, - dhe e ndërpreu fjalën për të përplasur pëllëmbën e majtë mbi dorën e djathtë, bërë grusht se

shtrëngonte shishen, - e ka tjetërkund punën dhe s'e ka me gjasme... Por... komikja, - dhe drejtoi faqoren nga hoteli, - e kush tha që është me ... gjas-me?

Në grumbullin e njerëzve u përfshinë edhe poeti me francezen, që tashmë s'dallohej aspak siç ranë në sy kur hynë në det. Ato çaste të gjithë kthyen kryet për t'i parë.

Nuk i tërhiqte gjithaq rinia e tyre, ndonëse duhet pranuar se edhe ajo qe lakmuese. As ai vrulli i tyre me të cilin u zhytën në ujë. Aspak. Gjetiu e kishin mendjen banjzuesit: Te aroma tejet këndellëse që karakterizonte rrobat e turistëve si dhe çdo të huaji që vinte në vendin tonë. E veçanta në ato vite të shkuara, parë nga ditët që po hedhim në letër këto mbresa edhe neve na befason: si jemi pajtuar me këtë marrëzi.

Sot nuk habit kërkënd, aq më pak një amvisë që përdor çdo ditë larëset e rrobave.

Poeti ynë e kishte kuptuar se pluhuri u hidhej teshave në procesin e larjes dhe ai, në pamundësi ta arrinte atë se s'kishte larëse ndërresash (si nëntëdhjetë e pesë për qind e popullsisë) i nxirrte mbathjet e tij të plazhit të lara e të rifutura në shkumë me sapun venus dhe i linte të thaheshin pa i shtrydhur. Veç kësaj edhe vetë shkumohej me të njëjtin sapun dhe kthehej në diell që trupi ta mbante gjatë aromën e këndshme. Por ai përdorte edhe kremin antidjegje, sido që ishte nxirë mjaftueshëm për të mos u përcëlluar.

Francezja e pëlqente pambarimisht ngjyrosjen e lëkurës së tij. Kësisoj edhe ia përsëriste shpesh: do ta ha këtë gjoksin tënd-çokollatë. Prandaj dalim nga uji. Kam frikë mos shkrin, - dhe pas kësaj ajo i guduliste kraharorin si kredharaku kur zhytej në ujë për të gjuajtur peshk. Ndërkohë, rrëmuja për alarmin e njeriut të rrezikuar nga mbytja kish përfshirë gjithë plazhin. Si ata që ishin në ujë dhe të tjerët shtrirë në shezlongë, a thjesht në rërë me

kryet e futur në çadra ... shiu.

-Rast ideal, - tha francezja kur dolën nga uji.

-Për çfarë?

-Të shkojmë në dhomën time.

-Mos u çmende?!

-Aspak! - dhe ajo iu var në qafë si ndonjë kunadhe pishe, duke e përkëdhelur pemën me kthetrat e saj e duke kërkuar të ngjitet në një pozicion më të përshtatshëm.

Poeti kuptoi se ai kishte zënë vend të sigurt në zemrën e saj e që ulur këmbëkryq atje. Gjithsesi për të ky propozim që sa trandës po aq edhe jashtë mundësisë sonë shqiptare.

-E di ç'do të thotë të hyj unë në dhomën tënde pa dijeninë e 'receptionit'? - dhe ajo ngriti supet.

-S'është njëlloj si t'i ngjitesh Ejfelit pa kaluar nga biletaria, ndonëse do të të duhen krahë fluturimi. Më keq akoma: Është e barabartë me futjen në ambasadën tuaj në Tiranë dhe të kërkosh strehim politik, - por ajo sërish nuk foli.

Nga shtypi francez kish dëgjuar se flitej për një hapje të vendit tonë drejt perëndimit. Dhe shpresonte ende për diçka të pathënë. Ndërkaq po mbërrinin te çadra e parafundit pa folur fare edhe sepse propozimi që tronditës, por edhe sepse riskimi që tejet dramatik për të parashikuar suksesin. Për më tepër pa një plan veprimi. Por nuk thuhet kot se femra ka futur shejtanin në shishe. Në këtë kategori hynte edhe fizikania, kur tha me një zë gati si shkrepim:

-Kam një ide të shkëlqyer.

-Ta dëgjojmë, - gjegji poeti dhe në tonin e zërit të tij lexohej e kundërta e asaj që tha dhe përkthehej në: Kot që ta shprehësh!

Ishin futur nën hijen e tendës së fizikanës, ku qenë të shpalosur dy shezlongë pranë e pranë dhe dy veshje

femërore të cilat ai s'dinte t'i emëronte dhe mendoi se pikërisht njëra nga këto mbështjellëse do të maskonte trupin e tij për të kaluar 'receptionin', vijë kufiri:

U mat t'ia thoshte asaj, por s'mbërriti ngaqë ajo ia vulosi gojën me një të puthur me afsh, gjë që tregonte se ishte e bindur në suksesin e planit të saj. Edhe poeti nuk iu shmang. Çadra e kthyer, tashmë, në brerore nuk lejonte trupat të dukeshin nga brezi e lart. Kur u shkëputën ajo tha: -Më shkopsit pak gjimbajtësen, - dhe i ktheu shpinën.

-Tjetër çmenduri! - gati klithi poeti.

Ajo bëri me nojma në drejtim të detit, pa u kthyer nga ai vazhdoi:

-E vërteta është se ata janë të gjithë të dalldisur pas asaj që,... mos o Zot! Por unë shpresoj se më shumë është panik sesa rrezik i njëmendtë. Se aty pranë, dikush që luante me fëmijën e hipi atë në zverk dhe gomën, me të cilën koloviste i mituri si në varkë, ngaqë ishte goxha e madhe, ia hodhi vetëtimthi fatkeqit.

-Vërtet? - befasohet poeti. - Unë si nuk e pashë?

-Ti po merreshe me gomat e vogla të gjoksit tim. Zbërthema gjimbajtësen!

-Tani po, se me këto s'kam mbaruar ende punë dhe ai nisi të merrej me dy kopsat metalike që ishin mashkull-femër të futura te njëra-tjetra dhe, si i shkopsiti vetëtimthi, i hodhi ato mbi telat e tendës, të ndera për kullim. Dhe me të dyja duart e futura nën sjetulla i zaptoi gjinjtë dhe e mbajti ashtu për disa çaste, si të donte ta shtrydhte të gjithë kraharorin e saj për t'i prekur më në thellësi, zemrën. Por s'që e domosdoshme. Aspak.

Francezja, tejet e këndellur në gjithë qenien e saj edhe për shkak të një zjarri si i ardhur nga shkretëtira, do të donte shumë që ky çast të zgjatej sa më shumë. Se e shihte këtë edhe si një proces fiziko-kimik dhe donte që

reaksioni të mos ndërpritej. Por, fatkeqësisht, ai kishte filluar në një kohë të papërshtatshme. Prandaj ai do të këputej e nuk do të vazhdonte. Ndaj ktheu kryet.

Njeriu i shkretëtirës me kapakët e syve të ulur, s'ngopej së shtrënguari. Ai nuk e pa se ajo vuri buzën në gaz përpara se të kërkonte buzën e tij... dhe për të ribuzëqeshur sërish. Kjo ngjante me një vazhdim ligjërata që s'merrej vesh: ishte e drejtë apo jo. Natyrshmëria e saj mbulonte çdo prapamendim, që me gjasë, kishin të bënë me ironinë e ironizimin që kthehej në gajasje. Se kish një lojçakëri ai vështtrim, i cili po të përplasej me partnerin do të lulëzonte dukshëm edhe për shkak të finesës së një megjullimi. Pakuptueshmëria që si tis i gjithçkaje.

Disa fotografi, sidomos portrete, megjullohen enkas për t'u bërë më të bukura pikërisht nga përdorimi i teknikës të këtij errësimi që e përfton, sidomos ikonën, më të freskët, si agun pranveror me brymë.

Prandaj francezja doli nga vetja, ose më mirë u ngrit mbi të. Mbi çfarë? Mbi ironinë e saj. Se ky djalë nuk vinte nga shkretëtira, por nga një vend me gjelbërim edhe pse diktatura e kishte kthyer në humbëtirë. Për pasojë: shkretëtirë.

Atomistja nga Franca, gjithsesi, ashtu e dashuroi me shikim të parë. Për botën e tij, për formimin, për gjithçka. Dhe këtu s'kishte vend assesi për paragjykitime. Absolutisht.

Prandaj ajo, me mjaft butësi, dorën e saj të majtë ia kaloi së pari me ata gishtërinj, në flokë me lehtësinë e kujdesin kur preket një harpë. Se zërin e dytë kjo melodi kërkonte. Po. Pas kësaj ai i çeli sytë. Buzët e tij i pa se ato po shuanin etjen në një tjetër oaz, ku shija e kripës nuk pengonte të që tejet i kënaqur, për më tepër se dora e saj, aq ledhatuese, ia mbante të shtrënguar kryet, derisa ai arriti tejngopjen.

-Kjo qe ideja jote? - pyeti ai kur u shkëputën.

-Sa naiv që bëhesh. Atë unë, ende, s'e kam shprehur, - dhe ia hodhi burnuzin nga shezlongu. Pastaj u zgjat, e tërhoqi të sajën me të cilin nisi të pështillet. Në çastin kur ngriti kryet për të ulur peshqirin e varur lart, pikasi në një cep të tendës parukën e së ëmës, zhubravitur, disi, nga era. Gëzimi që ndjeu atë çast, i shkrepiti edhe gjetjen e njëmendtë të rrugëdaljes. Kjo hollësi ishte vjega e ganxhës e ngjitur lart.

-Mamaja ka dy të tilla. Merre, - i tha dhe ia vuri mbi krye. Ia rregulloi mirë dhe u mrekullua nga harmonia me portretin e tij:

-Shkëlqyeshëm. E di si dukesh?

-Si mamaja jote, - u përgjigj ai më tepër për të mposhtur trazimin që ndjeu, sapo ai flok fals iu vu mbi krye si kupola e një bunkeri mbuluar me fier.

Atij do t'i pëlqente, ato çaste, ta shihte veten në pasqyrë, sepse thjesht do të shuante një kuriozitet, për të cilin nuk iu duk se qe koha për të dhe as vendi, njëherazi.

-Fytyrë më të shpifur në të gjithë plazhin, vështirë se mund të gjesh dhe të shtirur po ashtu.

-Për mua i ngjet Moxartit.

-Kaq torollak dukem? - u përgjigj menjëherë ai se s'mund ta përfytyronte veten muzikant. Aq më pak si Moxarti dhe përmendi anën më të papëlqyer të tij: cektësinë.

Francezja, për t'u siguruar se përafrimi s'qe i çartur dhe me dëshirën e mirë për ta bindur sadopak, u vu në pozitën e tregtarit, që kërkon të gënjejë klientin për mallin, i cili s'ta mbush dhe aq syrin dhe do ta japë të tërin gjoja pa... peshë.

Këto mendoj poeti dhe tha:

-Më duket se do të më shesin ashtu... toptan.

Ajo shpërtheu në gaz se i pëlqeu figura dhe e kuptonte

se në të dy rastet, njëra duhet të qe më pranë përqasjes. Tërhoqi kutinë e tualetit dhe nxori, që andej, një pasqyrë të rrumbullakët me kornizë varaku të verdhë e të ndritur.

Ia vuri përpara fytyrës:

-A nuk kam të drejtë, ë?

Poetin e befasoï shëmbëllimi. Sigurisht s' ishte fjala te përsosja, ashtu siç nuk mund të flitej për shëmbëlltyrë. Francezja kishte të drejtë. Por poeti nuk ia dha. U mjaftua me tundjen e kokës. Ndërkaq, tjetra ia hodhi edhe çorapet e llastikut, që ishin nderur diku në cep për t' u tharë:

-Vishi edhe këto, që mos të të duken ato këmbë gjithë lesh.

Poeti i priti në dorë, por nuk i veshi menjëherë. Qaforen e njërës e vendosi pranë kofshës, ku kishte, në xhepin me zinxhir, çelësin e kabinës. Tjetrës i futi këmbën dhe kinse harroi e shtriu atë. Qaforja e çorapes qe ngjitur me brekët e tij të banjës te pjesa e zinxhirit, gjë që tregonte se ajo, kishte shirit magnetik, të cilin do të donte ta vinte atë në krye, por s' qe mjedisi as edhe koha. Veç kësaj, ai duhej vendosur në të djathtë të kokës, ku të vepronte në hemisferën përkatëse të trurit. Qe i bindur se aty aktivizohej një ndijim të cilin e kishte emërtuar si zona e *shqisës së gjashtë*. Nënshtrimi ndaj këtij arsyetimi, jo vetëm ishte moskundërshtues, por i qe kthyer në fiksion. Zërat që dëgjonte në distancë, sapo i shkonte mendja për një kundërshtar, falë kësaj qendre, përthithej sinjali. Këtë, sigurisht, s'guxonte ta diskutonte me kërkënd. Aq më pak me një psikolog, i cili do ta merrte për të çmendur. Kurrsesi me francezen.

Nuk u shty më tej. Futi këmbën edhe te kjo çorape 'mistike', do të thoshte për të, dhe u ngrit, kur e pa veten si të kompletuar, a si kompozitori para se të delte në skenë tha:

-Tani mungon vetëm Selieri, - dhe mendja i vajti sërish te përgjuesi. Cili të qe vallë? Palombari apo varkëtari? Se, fjalët e të dehurit, edhe pse të copëzuara, i dëgjoi edhe ai tek po kthehej për në breg. Dyshimi për daljen në skenë të palombarit, lëvizjes së varkës me të dhe drejtimit të kundërt me ndihmën e kërkuar, flisnin shumë për një të dehur e jo për një esëll.

Francezja moskuptuese ndaj shtjellës që kishte zaptuar mendjen e poetit, e merakosur deri në shqetësim, mbasi i hidhte, tinëz, vështrim portretit të tij, mbi të cilin, si të kishte vepruar teknika e mjegullimit, qe mbuluar i tëri me atë 'agun pranveror', me brymë.

-Merre edhe peshqirin e mamasë sime, që ta fshish fytyrën dhe ta fshehësh atë në rast dyshimi. Hutimi i sime mëje vazhdimisht vjen për të mirë.

-Pse? Ç'e shtyn atë të përumbet? Apo që të shpejtonte takimin tënd me mua?

Asgjë. Ajo ngutej dhe doli me burnuzin e banjës se do të takonte Skënderbeun në kalanë e tij në Krujë.

-Po më çudit, - tha poeti.

-S'ka asgjë për t'u habitur në këtë mes. Po të mos qemë pjekur bashkë, do të kisha vajtur edhe unë. Luftërat e tij kundër turqve dhe titulli i dhënë *Kalorësi i Krishterimit*, mamane e kanë tërhequr vazhdimisht edhe sepse është marrë gjithë jetën me të.

-Mos ndofta me fizikën e grimcave?

Francezja e pa me vëmendje. Qe tjetër befasim për të: -Si e gjetët kaq shpejt, pa folur fare për specialitetin e saj shkencor? Ju duhet të jeni falltar.

-Kurse ju, pirate. Lëreni mamane të mbërrijë në Kalanë e Krujës, të dëgjojë edhe më për luftërat e Skënderbeut se ju keni të bëni me Hamza Kastriotin.

-Cili na qenka Hamzai, që paska dhe mbiemrin Kastrioti?

-Nipi. Por unë duhet të jem katra-katra stërnipi, që kujtoj se argalisem me një turkeshë, kur më ka zënë rob një franceze nga Normandia me origjinë dhe që quhet Juliet dhe se do të më pëlqente ta thërrisja, mbase, midis nesh: **Xhulio**.

-Dakord! - tha ajo dhe hodhi vështrimin nga hyrja e hotelit. Holli ishte thuajse i mbushur. Kontrollonin listat nëse mund të shtohet dikush i kujtuar me vonesë. Në çdo punë, - iu drejtua poetit, - ka një fillim. I yni është tani. Ndiqmë pa vonesë, o Hamza i Kastriotëve, - ironizoi ajo, teksa bëri kryqin dhe doli nga çadra. Poeti mori pohimin-urdhër të sfidës dhe e braktisi tendën, gjithashtu.

Ajo, me një frymë, ngjiti shkallët dhe mbërriti në sheshin-pistë pa kthyer kryet pas. Vendosmëria e saj qe tejet nxitëse për poetin, që çuditërisht ato çaste 'dëgjoi zëra nga e ardhmja'.

O Zot! Qe vaji i mbytur i një shoku student. Me zë më të trashur. Më të dhimbshëm. Më të mplakur. Vargjet më poetikë që kish dëgjuar të shkruheshin deri tani në një çast dëshpërimi. Se do të kishte shkuar në Greqi ku jeta i qe bërë e vështirë ta përballonte duke mos ditur të bëjë tjetër gjë, veç të hedhë në letër këtë poezi:

Dikur,

krua fjalëmbël buzët e tua:

"Të dua!"

Tani të lutem,

më thuaj një gënjeshtër të bukur,

se më do edhe të varfër,

se më do edhe të plakur,

se më do edhe të përbuzur!

Çfarë do t'i rezervohet poetit tani, që kishte kaluar stadin e: Të deklasuarit? Të njeriut pa të drejtë botimi? Të përjashtuar nga mjediset letrare-artistike, deri në bezdisje për të mos thënë në përbuzje? Çfarë do t'i ishte

lënë mënjanë si hise tani që pranoi sfidën me diktaturën? Se qe në pozicion krejt të kundërt me rastin. Qe në ballafaqim me inkuizicionin.

Francezja e donte atë për vizionet e tij. Se kishte gjetur tek ai shpirtin e saj binjak. Poeti për të zotëronte dhunti ‘*Qiellore*’, do ta emërtonte ajo. Dhe e dinte se prirja e tij qe e papërpunuar dhe francezja planifikonte vënien e saj në baza shkencore. Por para së gjithash, ai duhej të studionte. Vegimet e tij të mos shiheshin si ëndërrime me sy hapur. Aspak. Ato duhej të ktheheshin në vizione të mirëfillta të mbështetura në ekuacione të vërtetuara, tanimë, e të pranuar botërisht nga institute famëmira të fushës... Në ‘bahçen’ e tij, lipsej së pari harrje e krasitje ...

Francezja e përshkoi, thujse plotësisht atë pistë përpara se të mbërrinte me ato lëvizjet e saj lozonjare dhe kinse rregullonte flokët me shtrydhje, me bisht syri, këqyri poetin. Ky me hapin e një gruaje serioze ecte rëndë-rëndë. Asaj i erdhi për të qeshur. Se dukej më shumë si... xhentëlmen-gej, sesa zonjë.

-Nxitojmë mama, - e nguti ajo dhe i doli gjysmë anash, duke i kthyer plotësisht shpinën sportelit të zhurmshëm. S’pritën ashensorin, por i ngjitën shkallët me rrëmbim e, madje, edhe dy nga dy.

Një kat më sipër qe dhoma 105 e francezes.

Ç’ironi, kjo shifër i kujtonte atij nëndetësen me të njëjtin numër. Një qesëndisje të tillë, sikur me qiri ta kërkoje, vështirë ta gjeje.

Në filmin “Ballë për ballë” ngjarjet e të cilit zhvilloheshin edhe mbi përkatësinë e kësaj nëndetëseje, ndesheshin dy botë që po ndaheshin e dy miqësi që po prisheshin.

Kurse në dhomën 105 të ‘Hotelit Adriatik’ në plazhin e Durrësit po futeshin një franceze (përfaqësuese e borgjezisë kapitaliste!!!) me një djalë shqiptar (tradhtar

i idealeve socialiste!!!). Dhe këta nuk u ndryjnë për të përplasur dy ideologji (që do të qe dinjitoze për poetin e realizmit socialist!!!). Por këta dy “tipa” u mbyllën për të shpurë pas hekurave përgjegjësit e hotelit që s’duhet të lejonin të kishte aferë të pamoralshme.

Edhe s’është, por edhe është për të qeshur. Se kur njeriu kapërcen me sukses zonën e rrezikshme, siç edhe bëri tanimë poeti ynë, nis edhe tallja me kundërshtarin, që në këtë rast, ishte diktatura në gjithë ngrehinën e saj shtypëse, por edhe groteske, po ashtu. Porta u mbyll nga brenda 105-ës, e cila nuk qe nëndetëse, por një dhomë e mobiluar këndshëm e me gusto “borgjeze” për një çift perëndimor, favorit. Krisma e bravës, e futur aq ëmbël në fole, fliste për privatësi, moskokëçarje dhe liri.

Poeti ishte i mbështetur me shpinë në portë dhe s’i besohej ende që gjithçka kishte shkuar kaq lehtë, kaq butë, kaq ëmbël.

Francezja e mënjanoi pak që t’i kalonte derës çelësin, kurse poeti ndiqte lëvizjet e saj, duke zgjatur kokën te qafa, te flokët, që duheshin çmbështjellë, për ta parë e ndier të tërën, ashtu si edhe iu shfaq me tiparet e megjulluara të *Perëndeshës Hipertermi* përpara dhe pas ndërkëmbimit të figurave. Dhe ndiente se kish kapërcyer etapat vetëm me këtë lëvizje, propozimi i së cilës s’që i tij. Aspak. O Zot! Po kjo bukuroshe vallë vërtet ishte e tij?

I dukej çmenduri ky hap ngaqë ishte i hipnotizuar. Dhe e themi kështu se e mëshirojmë këtë të ri të brezit të vet. Ngaqë s’duam ta pohojmë shkoqur të vërtetën për të mos e fyer.

Francezja ia kishte gjetur vendin çelësit të varur diku në një kremastar portmantoje, e rrotulloi kokën e atij mekanizmi të brendshëm që siguronte portën dhe iu kthye poetit.

Ky vazhdonte të qe i hutuar dhe nuk pondërgjegjësohej

ende në ishte: Peng? Rob? Shërbëtor? Apo skllav?

Dhe pa e kuptuar ende se në cilën nga këto përcmime bënte pjesë, ndjeu puthjen e fizikanës. Ose, më saktë gjuhën e saj brenda gojës, që kërkonte të tijën dhe kur ia mbërriti, atëherë, një refleks i brendshëm i kthjelloi shqim që të hiqte dorë nga fluturimet sindaktike-gjuhësore, por të shijonte këtë të puthur deri në dalldi. Dhe ashtu bëri. Edhe sikur ta varnin më pas te kali i Skënderbeut në Tiranë.

Gjithsesi do ta quante 'puthje franceze' kërleshjen e gjuhëve në gojë. Dhe do të bindej më vonë se ky përcaktim s'qe aspak hamendësim, por i njëmendtë. Dhe harroi që të dy ishin ende të kripur e kripotur si qefull dhe e ngriti hopa vajzën për ta shpurë në krevat. Tipar ky dallues e tipik i ne shqiptarëve në ngutjen tonë për të arritur mundësisht menjëherë finalen.

Francezja e përfshirë në të njëjtën dehje gjithashtu, në fillim, e nanuritur nga ëndrra, nuk u ndie, por kur pa se princi i saj i kaltër, po e ulte me një delikatesë pas së cilës fshihej një ngutje e ethshme tepër mashkullore, zgjodhi lajkatimin. I shtypi majën e hundës dhe me atë vështrim, me atë zë, po aq të ëmbël, kundërshtoi: - Budalla! dhe si zbriti nga duart e tij, përsëriti: - Budalla!

Poeti e ndjeu veten aspak budalla. Skllav, po.

-Shko një herë në banjë, pa ta tregoj unë atë çokollatën e gjoksit tënd, po s'ta hëngra, - i tha. -Po hiqe më parë kripën.

Poetit iu rikthye ndjenja e ... princit të kaltër! Veçse e trazuar me atë të Hamzait të thyer. Sepse femra që urdhëronte s'ishte turkeshë që kënaqte oficerët madhorë të taborëve. Ajo ishte franceze dhe s'kish asgjë të përbashkët me ta, ashtu si edhe poetin s'e lidhte asgjë me Hamzain. Prandaj i penduar edhe për krahasimin tejet të rëndomtë, tha.

-Unë robi yt jam. Do të bëj si të urdhërosh ti, zonjusha ime e mençur.

-E mençur?! - qe po ajo buzëqeshje tipike, e lehtë dhe e pakuptueshme, brenda së cilës lëvrinte, si gjuha në gojën e tij, kjo e panjohur, që mund ta quante dëshirë për të zhbiruar. Nuk e tepronte edhe po ta krahasonte me një zhguall të padepërtueshëm, ose të tjetërllotjtë, një mburojë po ashtu.

Poeti e la pa përgjigje pyetjen e saj dhe nxitoi të futej në banjë. Gjetiu ishte qëllimi i tij. Tashmë kërkohej bindje. Nënshtrim prej skllavi tani kërkohej. Se skllavopronaria qe ... hyjneshë. Iu kujtua poezia e 'delfinit' të diktaturës dhe e konvertoi në: *Jam skllav i kësaj hyjneshe! E, ç'të jem më shumë?*

Një hovëzim nisi t'ia pengojë frymëmarrjen. Qe një vrull i brendshëm që e bënte të ngatërrohej në veprimet e tij dhe në vend që të çelte rubinetin e ujit të ftohtë, hapi atë me ujë të nxehtë. Ishte një përcëllim i menjëhershëm në të gjithë trupin, ndonëse përavullimi edhe më i shpejtë i veshi qelqet opake, teksa ai me vështirësi mundi të ndryshojë shfrimin përvëltonjës.

Francezja sodiste linjat joshëse mashkullore dhe, për herë të parë, iu duk vetja marrake që e kishte shpërfillur kesisoj preken, por edhe ledhatimin e trupit të saj nga duar të tilla që shkumëzonin vrullshëm.

Më kot arsyetonte se: doktorata e kishte shkëputur nga çdolloj bashkëjetese tjetër. Aq më pak mashkullore. E ndodhur kaq pranë tundimit seksual e, sidomos të këtij burri tejet muskolor që, një Zot e di si aq shpejt i hyri në zemër, grimcëzat nënatomike iu dukën vërtet 'grimcëza' krahasuar me joshjen si nga vitrina, propozimin e ndonjë kolegu për pak minuta relaks në një mbrëmje përpara një gote verë, tani po e ndiente se kish bërë vërtet mirë që e kish refuzuar. Shkurt, një lloj flirtimi për të kishte

kohë që kundërshtoj.

Mbase mund të merrej edhe si qesharake, por qe e vërtetë që njeriu, me të cilin duhej të shkonte në krevat, qoftë edhe për dëshirë biologjike, duhet ta dashuronte. Ose, të paktën, ta pëlqente si... karakter. Por 'grimcat' nuk e linin që ta shikonin me këtë sy askënd. Aq më pak botën e tij të brendshme.

Partneri në banjë për të qe si një...'kalorës i përsosur'. Tek ai, më shumë se çdo gjë binte në sy zëri, fjala, gjuha. Kjo qe e ëmbël si cicërima e zogjve. Veç të tjerave, ajo kishte brenda sinqeritetin e përzier me naivitetin fëmijëror. Por edhe magjinë e theksit, që i kthyer në përshpejtues, nxiste dialogun. Se ajo e krahasonte me bisedat e kolegëve të saj që i dukeshin të ftohta si... shpëlarje akullnajore. Ndërsa te poeti asaj i dukej se pikërisht zanorja në rrënjën e foljes ndryshonte. Kjo **apofoni** e ngazëllente pa masë. Se e ndiente instinktivisht e në mënyrë të pavullnetshme... Tek mendonte këto, sytë e saj guxuan të zbrisnin edhe më poshtë, atëherë ndjeu një lëngëzim në gojë nga dëshira për t'u përpirë prej tij e për t'u bërë-një me këtë njeri. Nën të. E, mbase edhe e shtrënguar egërsisht prej tij. Si skllave. E shtrydhur nga ato duar të fuqishme dhe e thërrmuar deri në kockë: '*Itas i epitas*' - mendoi ato çaste.

Se ishte ai që kishte ëndërruar.

Se ishte ai që kishte pritur.

Se ishte 'Princi i saj i kaltër'.

Po.

Prandaj ishte e gatshme të binte nën thundrat e hamshorit të saj. Prandaj, me vështirësi, mbledhte të gjitha forcat për t'u përmbajtur sa të dilte nga ai dush, i cili, një Zot e di, sa shumë po zgjaste. Kushtrimi i së parës kishte mbërritur.

Dhe ai doli më në fund. Meraku i tij qe të disiplinonte

seksin, që e kishte ndryshuar frikshëm përmasën. Ndihej disi i turpëruar dhe mbante sytë ulur, kinse, rregullonte peshqirin. Por ato i vajtën te rrugica mbi parket, në këmbët e francezes. Ajo kishte mbetur, ashtu, si e ngrirë. Te shputat, të linjtat e saj tafta, qenë dëshmia se ajo mezi priste lirim e banjës, gjë që e vërtetonte edhe ky veprim i pakontrolluar.

Fizikania, thjesht, buzëqeshi. Nuk u merakos aspak për të paanat e saj që i kapërceu dhe, me një nxitim e ngutje për te banja, e kuptoi që peshqiri i gufuar së tepërmi në mes të shalëve të tij, me gjasë, qe shkaku i tromaksjes së saj. Se, si t'i kishte rënë ujë i valë, nxitoi të futet në dush. Apo mezi priste takimin me këtë element të frikshëm?

Poeti, ndërkaq, ndien shpërthimin e ujit pas qelqeve, ashtu siç edhe e kuptoi shpërfilljen e fizikanës për botën rreth saj. Gjurmët e një interesimi të beftë për këtë akt që po përgatitej, si dhe padurimin e saj, s'qe e vështirë t'i merrte vesh e t'i kuptonte edhe një sy e një vështrim i rëndomtë e jo më një poet, ku hollësitë qenë dhuntia e tij.

Kjo duhej të qe arsyeja, që ajo sapo doli nga dushi e fshirë, nxitimthi, dhe e pështjellur ngutshëm me peshqir, ngjasonte vërtet me një nimfë. Kurse flokët e tubuara e të ngritura përpjetë i shkonin tipit dhe sjelljes së saj, që e afronin dukshëm me një drenushë. Veçse e tradhtonte vështrimi. Ai qe tejet i trembur e i hutuar, gjithashtu. E, po ta shihje nën këtë fashë drite, ishte më pranë një fluturë të re, që për orientim të vetëm kishte instinktin e jo përvojën. Se nuk dinte të dallonte lulen nga gjembi ku do të duhej të ulej.

Nga kjo anë poeti ndihej më ndryshe. Stadet e përngjashme me... ngriva-shkriva, i kishte kaluar. Prandaj s'e kishte të vështirë ta pikaste hutimin apo marramendjen e natyrshme të saj. Poetin, tani, e kishte

lënë si pa gojë, diç tjetër. Ky kishte të bënte me freskinë. Ai s'po e kuptonte, që lakuriqësisë, nga beli e lart, i qe shtuar veprimi. Lëvizja e krahut të kësaj fluturë, që u zgjat e shtypi butonin e grilës. U krijua kështu, një mjedis më i përshtatshëm, që nxiste për joshje, jo vetëm trupat e tyre, por dhe gjuhën e një tjetër kodi gjenetik, me të cilin flasin shpirtrat.

Kësisoj, ndërsa ndriçimi nisi të hijesonte, një shenjë nxitëse e cingërisëse tek të dy e për të dy, nisi të fekste, t'u verbonte shikimin e t'u harbonte trupat....

Se kishin rënë të dy peshqirët që mbulonin kurmet e tyre nga beli e poshtë. Kaq mjaftoi, që reflektimi t'u ziente gjakun ndër deje.

Ai e rrëmbeu para duarve, me një lëvizje të vetme, si tigër, ndërsa ajo u mbështoll pranë gjoksit të tij, si mace, që diç bënte me gjuhën e saj në atë kraharror. Doemos, se, edhe macja thuhet, se nga tigri rrjedh. Dhe fizikania do të vinte shpatullat mbi krevat e, megjithëse mbi vete do të mbante trupin e poetit, mjaftueshëm djaloshar, do të ndiente mungesën e peshës, që pse të mos themi me fjalët e saj si atomiste: do të ndiente se graviteti ishte zero. Ajo lodronte në ajër si flutur e vërtetë. Gjembu dhe nektari ishin shndërruar në një dhe kjo emërtohej ndryshe tashmë: Ekstazë.

Pas dalldisë së parë poeti kërkonte një lloj shfuqizimi, për të rifilluar sërish dashuri. Kësaj here, mbase më poetike:

-Zonjushë! Nuk duhet të harroni se ju nuk jeni robina ime. Përkundrazi: princesha. Dhe unë, robi juaj i gatshëm t'iu përgjigjem dëshirave tuaja, siç edhe menduat kur unë isha në banjë: *e tan e epi tas*. Dhe në atë çast i buisën vargjet:

Dy hëna të plota mbi nënkresë takohen.

Por pas kësaj, në sytë e tij, figura e fizikanës u

ndërkëmbje me atë të *Perëndeshës Hipertermi*. Dhe e priste. Se ndjeu aromën e saj, si për t'u bindur se, vajza me të cilën po bënte dashuri, ishte e kësojbotshme. Madje, do të duhej që ajo të fliste dhe bindja t'i forcohej pas shprehjes greke të përkthyer në frëngjisht, që në shqip do të thotë: *Nën Shpatë*. Porosi kjo e nënave spartane, kur nisin djemtë në luftë dhe që kish kuptimin: *Ose mbi shpatë me fitore, ose nën të*. Dhe kjo nënkuptonte vdekjen jo disfatën.

Nën shpatë? - përsëriti francezja e fizikës së grimcave nënatomike. Por edhe pse poetit iu duk se graviteti i saj që i barabartë me një ... *grincëzë* e ngriti sërish nga krevati për ta riulur që ajo të mos ndiente humbjen, por fitoren. *Nën shpatë*, tani ishte ai. Kurse ajo..., triumfatore.

...Mjegullimi i figurës do të shkrihej mbas kryerjes së aktit. I gjithë veprimi, për të dy, ishte *galaktik* dhe ata jetonin ato çaste si në yllësi. Rëndesën brenda orbitës do ta ndiente, kur ajo pushoi së qeni *Perëndeshë Hipertermi*. Tashmë si një luaneshë qëndronte e futur në gjoksin e tij. Kurse ai s'reshtte së ledhatuari ata flokë, qafën, shpatullat dhe dora i rrëshqiste nëpër trup i kënaqur me dhuratën e zbritur nga yjet.

Se gjithë qenia e saj mbi atë çarçaf ngjyrëqielli sikur e dëshmonte zbritjen e saj prej tij. Përqasja me një meteor do të që i vetmi krahasim, që ai do të pranonte të bënte. Se ai e ndiente që kjo franceze kish trokitur në portën e zemrës së tij në fillim nga kërkshëria, apo më tepër nga dyshimi? Më pas, me përfillje, por dhe me dëshirën për ta njohur nga pranë. Dhe ai, sigurisht, nuk mund t'i dinte të gjitha stilet e saj, por e ndiente se ajo e kishte përthithur të gjithin brenda zemrës dhe vështirë, në mos krejt e pamundur, ta hiqte atë.

Po nga ana e poetit? Le të mundohemi, ndonëse me vështirësi të flasim me gjuhën poetike. Atëherë duhet

të themi se në veshë i buisnin edhe vargje të tilla që flisnin për dashurinë e tij deri në shkrihtërim e madje deri në pjalmim. Por s'mungonte edhe ndonjë varg që e krahasonte fizikanen me trëndafilin në rrërë. Se e gjithë hapësira rreth saj kundërmonte borzilok e sefergjen.

... Francezen do ta zinte gjumi dhe, ashtu, pranë atij gjoksi dhe poeti s'dinte ç'të bënte, derisa t'i shpëtonte trishtimit nga një zile telefoni mbi komodinën e saj. Ajo u zgjua, por ato çaste poetin e kishte kapërthyer tashmë gjumi. Ajo rrëmbeu dorezën e aparatit dhe e kuptoi se ishte kuzhina që pyeste nëse "dy zonjat e 105-ës" do të zbrisnin për të ngrënë apo parapëlqenin t'u servirej ushqimi në dhomë?

-Kjo e dyta, - u përgjigj ajo dhe shtoi, - menu të rëndë shqiptare.

Sido që nëpër gjumë u kujdes më shumë për poetin sesa për vete. Se pas dashurisë që gati edhe të rrinte fare pa ngrënë. U ngrit dhe u fut menjëherë në dush. Nuk donte ta shihte aspak pamjen e partnerit si të një luftëtari të mposhtur.

Pas freskimit, të parë, trupin e ndiente tejet të lehtë dhe me një uri gërryese. Gjithsesi nisi të marrë nën zë, pa fjalë, kolonën zanore të filmit francez: "*Heronjtë janë të lodhur*". Natyrisht e kuptonte pse i erdhi ndër mend pikërisht ky film dhe saktësisht muzika e tij. Mbase edhe për faktin që heroi i saj kridhej në një gjumë 'i lodhur'. Edhe sepse intriga e filmit zhvillohej në... bregdet, a plazh krejt të ndryshëm. Gjithsesi në rrënishte. A nuk nisi kështu edhe lidhja e tyre?

Francezja lahej duke kënduar si nën zë, por vërshimi i ujit do t'i përzihej me ëndrrën e poetit deri në blirimin në veshët e tij. Kjo e zgjoi menjëherë atë dhe zbriti me një kërcim të shpejtë nga krevati. Çuditërisht uji nuk dëgjohej më. Aq më pak buçitja e tij e cila që zëvendësuar

nga nxitja aq joshëse e një melodie të harruar. Vetja iu duk sikur ishte në një pyll, që ndiente vetëm zanën e malit, siluetën pas qelqeve, ende s'po e kuptonte në qe e njëmendtë apo e rrejshme? Ishte i zgjuar tanimë, apo vazhdonte të flinte?

I hodhi një sy vetes dhe e zuri paniku kur e kuptoi se ishte fare lakuriq. Nuk pati kohë të rrëmbejë as peshqirin e flakur tutje, kur francezja doli nga banja, gjithashtu e zhveshur, vetëm me flokët e mbledhur e të tufëzuar në peshqir. Sikur aty të ish boshti i vetë krenarisë personale për të cilën vëmendja e saj s'mungonte asnjëherë.

Gjithsesi djali që kollitur, sapo ndjeu se ajo po dilte nga banja për të mos e trembur kur të përballej. Por ai jo vetëm që s'e frigoi atë me figurën e tij prej dordoleci, por do të befasohej, kur francezja u nda dhe e tërhoqi për ta futur në dush. Aty nisi një përleshje e re dhe e njëmendtë. I pari filloi poeti sulmin. Ia hoqi peshqirin dhe e flaku atë tutje, duke mësyre kështu, kolonën e krenarisë së saj, flokët. Këto ishin edhe dobësia e tij. Kur ato i binin mbi fytyrë, të shpërndara shirita-shirita, atëherë puthja përmes tyre për të, arrinte kënaqësinë e asaj, që për këdo, thuhet me fjalët: *Qershia mbi tortë*; për veshët e tij sikur ndiente muzikën e një harpe.

Dhe nën ata tinguj do të shkrihej, por dhe do ta përndizte partneren dhe pse uji i ftohtë nga dushi mes tyre binte. Qelqet u avulluan nga nxehtësia e trupave dhe "heroi i lodhur" do të niste një tjetër seancë dashurie, të cilën ai do ta quante, me gjasë, të parën pas gjumit.

Por, ndërsa ndaloi vërshimin e ujit, i hodhi asaj peshqirin e madh dhe për vete mori të voglin, se tjetri që bërë qull, por s'pati kohë as të fshihet se trokiti dera dhe ai u rrëqeth.

Francezja, përkundrazi. Ajo nuk u shqetësua fare. Vuri gishtin e saj tregues midis atyre buzëve të saj të

fryra nga puthja dhe, me zë të ulët i tha:

-Është dreka. Ti mos lëviz. Unë po shkoj të marr karrocën, ta zbraz nga pjatat dhe ta nxjerr sërish jashtë. Dhe ajo ashtu bëri. S'e kishte për herë të parë që ushqimin ia sillnin në dhomë. Kamerieri e linte te porta karrocën të mbushur dhe vinte, pesë a dhjetë minuta më vonë për ta marrë të zbrazur. Francezja, e rifutur tashmë në lojën e dashurisë, të cilën po e pëlqente jashtë mase, pas një grumbullimi, por edhe ndrydhjeje dëshirash, tejet gjatë, i boshatisi nxitimthi pjatambajtësen dhe, si e nxori atë përjashta, iu rikthye pa vonesë vazhdimit të lojës së dushit... Por ...

Por tanimë, 'heroi' që jo vetëm i lodhur: Dyshimin për njëmendësinë e saj ajo e pikasi që nga trapeza ku e shihte me bisht të syrit, karakteristikë femërore kjo, por edhe e merrte me mend efektin e natyrshëm të trembjes. Gjithsesi do të bindej, kur me një lëvizje të shpejtë, i hoqi peshqirin.

-Mos u mërzit! - tha dhe lëshoi në fund të këmbëve atë copë të trashë që i kishte mbërthyer gjoksin dhe zbriste poshtë për të mbuluar gjithë trupin e saj të zhveshur.

Pamja e lakuriqtë si një skulpturë e gjallë, e ngrohtë dhe epshndjellëse, do të tundonte çdo mashkull të kësajbotshme e, madje, do ta trimëronte edhe më frikacakun. Dhe, si të mos mjaftonte pamja, nuk vonoi të gëlonte edhe provokimi me fjalët: - Cilin parapëlqen të bluash më parë: ushqimin apo.... Dhe ajo s'mundi dot të mbaronte fjalinë se duart e tij të riburrëruara e mbërthyen dhe e hodhën mbi krevat. Atë çast atij diç iu kujtua dhe ia plasi së qeshurës. Këtë nuancë e pikasi atomistja dhe kur ai kërceu edhe vetë, ajo bëri një rrotullim lojçak për të nxitur edhe më lojën galaktike të shkëputjes së materieve. Se e tillë dukej lëvizja e tyre mbi ata çarçafë bojëqielli...

Pas kësaj fjetën dy orë të mira. Në shpirt ndiheshin të kënaqur, tejet të përtërirë e të gjallëruar. Por kjo s'mund të thuhej edhe për trupat e tyre, që, përkundrazi, ishin tejet të rraskapitur. Energjitë e harxhuara duheshin zëvendësuar. Prandaj kërcitja e stomakut bëri që të zgjohen njëkohësisht dhe, si fëmijë, të garojnë kush të ulej më parë në trapezën me pjata të ftohta. Uria ishte, jo vetëm ngrohtësia, por edhe majdanozi edhe çdo erëz nga më të mirat për ato gjellë. Për fizikanen, menuja e ushqimit e porositur në mëngjes sipas stilit francez, qe zëvendësuar me atë shqiptar.

Për poetin, si bujtës, por edhe si fillestar në një drekë të tillë turistike, qe befasim dhe, siç ndodh rëndom në raste të tilla, s'mund të mos i pëlqente. Në trapez ishin supa, sallata e bollshme, në të cilën zbardhnin copat e djathit, ashtu siç binin në sy edhe ullinjë e mëdhenj të Beratit si dhe dramcat e peksimeteve nën të, si dhe dy pjata biftek me garniturë, ku s'mungonin vezët e ziera dhe të prera në formën e një gonxheje në shpërthim. Për të pirë: një shishe verë Narte.

Sa i përket volumeve, poeti do t'i quante *'ushqim kanarinash'*. Se edhe dy rriska shalqi, si për zogj ishin. Në një kupë të veçantë: dy vezë të tjera të paqëruara, me sa duket, llogaritur për pas gjumit të vapës. Gjithsesi supën e hëngrën të dy pa cicërirë. Kryet i ngritën kur e përfunduan atë njëherazi e pa marrë frymë. E para që hapi bisedën si zonja e shtëpisë ishte fizikania, ndërsa poeti po hidhte verën e Nartës në gotën e saj dhe pastaj edhe të tijën.

-Thuhet se zogu i uritur do të ndërtonte çerdhen e vet pranë shqiponjës.

Poeti, që tanimë gjithashtu i kishte hedhur verë edhe gotës së vet, me kujdesin që të mos kalonte një e katërta e kupës, u mat ta ngrinte, por u spraps:

-Në rastin tonë duhet të thoshit, *pranë skifterit*, zonjushë?

Ajo tundi kryet në një gjysmë miratimi, por edhe me një çerek mospajtimi dhe, si nguli pirunin në sallatë, nxori prej andej një copëz buke të thekur e të mbytur në vaj.

-Ti je tigër, por po aq edhe skifter...

-Fit e fit?

Ajo tundi kryet dhe ndjeu se buzët i qenë të lyera mjaftueshëm për të përmbushur një veprim. Prandaj u mat të ngrihej nga vendi, ndërsa poeti u nxitua të plotësojë: -Edhe langoi i uritur nuk e ka frikë luaneshën.

Asaj i doli në shteg përmbushja e qëllimit.

-Ashtu është, por ajo nga dashuria që ka për langoin, kafshon. Ndryshe është pickimi. Ai edhe kur bëhet me gishtërinj të argjenditë shpreh urrejtjen.

Ajo u çua nga karrigia, iu afrua poetit dhe i kërkoi ëmbëlsisht: -Ngrije pak kokën, i dashur!

Ai u bind pa kuptuar ç'i kish shkrepur. Ajo u përkul dhe i vendosi buzët si të donte të vuloste aktin e dashurisë në krahun e majtë, nën gushë, që doli në të vërtetë se ishte cerfitikimi i *dalldisë* në dashuri. - Ç'po bëni kështu, zonjushë? Nuk besoj se jeni dehur pa e puthitur ende gotën e verës në buzë, - u habit ai. Ajo nënqeshi:

-Aspak, *tartarini* im i dashur, që çdo thënie e merr në ligjëratë të drejtë.

-E keni fjalën për *Tartarinin e Taraskonit*?

-Ekzakt, i dashur.

Poeti, ende, s'po kuptonte se ku qëndronte përqasja e tij me këtë tip *Shvejku*... alla francez.

Ajo shpjegoi me ngut: - Nuk ishte puthje, i dashur.

-E kuptova, zemër. Qe vulosje, por më habiti papërshtshmëria e vendit.

-Ekzakt, se s'qe vulosje prandaj.

-Por çfarë qe në është se s'qe e vërtetë asnjëra e as tjetra?

-Ishte tamponi i dashur.

-Pse?

-Se luanesha nga dashuria i ka lënë kafshimin langoit për ta dalluar nga zagarët e tjerë në... rërë.

Ai qeshi dhe ngriti gotën.

Edhe fizikania e ulur, tanimë në vend, bëri të njëjtin gjë, çoi kupën dhe e përplasi me të tijën:

-Përse do të pimë?

-Për dashurinë e dy... 'Lëve'.

-Që do të thotë? - e hoqi veten të vagët ajo.

-Të luaneshës me langoin, - sqaroi ai.

Ajo e përplasi sërish qelqen dhe, si vuri në gojë një gllënjë, vërejti: kur langoi është i uritur. Apo jo?

-Kështu thuhet se kaq njohin njerëzit në ... përgjithësi për të. Se ata nuk janë thelluar të dinë më tepër se kërkesat trupore. Ato shpirtërore qëndrojnë më lart: mbase në majat e shqiponjës.

Të dy qeshën dhe nisën të fusin pirunët në sallatën e përbashkët, e cila ishte tejet voluminoze dhe ende e freskët, sigurisht.

Hanin dhe të dy kishin shumë përgjigje pa dhënë si edhe të dy kishin të tjera pyetje për t'i bërë njëri-tjetrit.

-Zhulietë! Më lejon të thërras si në shqip: Juljet.

-Me kënaqësi. Por jo në shumës. Në njëjës, ndonëse ti nuk je Romeo.

-Më mirë. Se unë po të kisha këtë emër, do ta kisha humbur, a do ta kisha harruar.

-Dhe cili do të preferojë të ishe?

-Mbase Hamleti.

-Kaq tragjik?

-Se mos Romeo ishte më pak, zonjushë?

-Pra: ma vendosët.

-Aspak. Ti, me këtë emër ke zbritur në këtë plazh.

-Ta zëmë se po. Dhe ç'di ti për të?

-Tani u bëre vajzë e mirë. Dëgjo!

-Me padurim, përveç kënaqësisë.

-Është e çuditshme.

-Cila?

-Se emri yt fillon me germën "J".

-Kjo është çudia?

-Jo. Këtu fillon çudia.

-Cili?

-Cila dhe jo cili.

-Po flisnim për çudinë.

-Po flisnim për emrin, - e korrigjoi ai.

-Ekzakt.

-Pra: emri yt nis me germën "J", pavarësisht se në frëngjisht lexohet "Zh". Ky është një fat të cilin do ta parapëlqente kushdo.

-Ta zëmë se ke të drejtë. Dhe në ç'gjë qëndron oguri se u dashka të xhelozohet kushdo për të dhe me siguri edhe të ndjekë me fanatizëm piketat e tij?

-E shikon? Pikërisht kjo, që sapo the, është vetia e germës së parë "J". Po të kishe një tjetër emër nuk do të shpreheshë kështu. Atë do ta printe një tjetër germë dhe një tjetër logjikë e të gjykuarit.

Sallata po përgjysmohej dhe ajo përpiqej të merrte një copë karote me pirun. Dhe e kuptonte se këtu flitej për *predestinatën* e emrit dhe ra disi në mendime. Jo se ishte një lëmë i panjohur, por mbase një *fushë grimcash*, në të cilën s'kishte pasur kohë të thellohej.

-"J"-ve nuk u pëlqen t'u thuhet se çfarë duhet të bëjnë.

-Pse, - tha ajo dhe e refuzoi një copë djathë që ia afroi poeti.

-Sepse nuk janë ndjekës natyralë.

-Po çfarë janë?

-Liderë.

-Tjetër? - dhe ajo sërish tentoi t'i ngulë pirunin karotës
kësaj here me sukses.

-Janë ambiciozë, gjithashtu.

-Domethënë egoistë.

-Nuk besoj.

-Se s'do të më pezmatosh?

-Aspak.

-(Me dinakëri) Domethënë se do.

Ai e ka kuptuar rrengun në lojën e fjalëve.

-E shikon? Edhe mënyra jote kundërpërgjigjëse është
një shteg disi i papërfillshëm për të tjerë, por që ti, je e
sigurt se do të mbërrish kicin.

-Po më këshillon duke më parë tinëzisht pëllëmbën e
dorës siç bëjnë fallxhoret?

Poeti qeshi:

-Kurrresi, e dashur. Germa jote e parë është si një
podium mbi të cilin qëndron ti dhe jam i bindur se aty
ke hipur me përpjekjet e tua. Por, zakonisht njerëzit
e... tribunave vështirë të pranojnë vërejtje. Aq më pak
këshilla. Assesi kritika. Paralele edhe mbase, por nga
poshtë, kurrresi. Absolutisht.

-Më bën të pagabueshme?

-Jo, se nuk duhet të ketë të tillë. Edhe pse ne shqiptarët
e kemi njohur më tepër se një, megjithatë.

Pas kësaj poeti vuri gishtin tregues midis buzëve
e, madje, bëri me nojma, që nënkuptonte përgjuesit e
fshehtë elektronikë.

-Kurse ti, zonjushë...

-Kurse unë?... Mos ndofta bëj përjashtim?

-Po.

-Pse?

-Nuk jam plotësisht i sigurt, por besoj se hyn në
kategorinë e atyre pak fatlumëve që zotërojnë shqisën e

gjashtë. Këtë *Dhunti Qiellore*.

Ajo befasohet.

-Po, po. Mos u çudit. Duhet të kesh një shqisë më tepër.

-Cilën?

-Të gjashtë, zonjusha e dashur Juljetë.

-Dhe ku na qenka kjo? - fizikania e la thikën mënjanë, me të cilën po priste biftেকun. Vuri gishtin tregues në ballë, me nojmën kur duam të flasim për brirë dhe tha:

- Këtu vallë?

-Po, - tha poeti, - por jo në cipë. Në thellësi.

-Mendja?

Ai tundi kryet. Edhe ajo, në mënyrë të tillë, kur duam të themi: çudi!

-Ta zëmë se është kështu.

-Jo "ta zëmë", por është saktësisht kështu.

-Mos ndofta ajo shfaqet në çastin dhe kohën e duhur?

-Ekzakt.

-Besoj se kjo të ka pëlqyer.

-Aspak ...dhe jashtëzakonisht shumë, po ashtu.

Fizikania u shkri së qeshuri.

-Më duket se vera të ka rënë në kokë, i dashur.

-Gaboresh.

-Mbase, por dhe dy përgjigje kundërthënëse në një fjali. Është stil ky për mënjanim, apo 'zhdukje fushe'?

-Mundet kjo e fundit.

-Pse?

-Sepse u gjenda në kohën e gabuar, në 'fushën' e gabuar. Figura jote m'u ndër këmbë me shumë se një herë me... *Perëndeshën Hipertermi*.

-Ç'është kjo perëndeshë hipertermi, se ti edhe emrat e hyjnive më duket se ke kurajën t'i pagëzosh vetë.

-S'ishte *pagëzim*, por *krezmim*. Dhe jo i asaj, por i atij përpara se të merrte udhën e qiellit. Dhe më në fund: jo

nga kjo, por nga motra e saj: *Perëndesha Hipotermi*.

-Paska qenë në Antarktidë?

-Ekzakt.

-Dhe?

-Paralajmërimi i saj doli.

-Nuk po të kuptoj. Për çfarë e ke fjalën.

-Për atë që je fizikane dhe se merresh me grimcat nënatomike.

-O Zot! Si është e mundur? Ti the një të vërtetë të pabesueshme, - dhe ajo piu një gllënjë verë që të përcillej nga sikleti që i dha copa e biftekut kaluar keq.

-Mund të habitet cilido, por jo ti, zonjushë e dashur.

-Pse?

-Se, si shkencëtare ke mendjemprehtësinë e duhur për sa i përket veprimit të natyrës.

-Po flet për principet e ligjit të...

-Ekzakt, zonjushë fizikane. Sa në *makrokozmo* (universi), aq dhe në *mikrokozmo* (njeriu dhe natyra).

Fizikanen e befasonte njohuria e këtij poeti në fusha të tilla, që në pamje të parë mund të mos quhen aspak poetike. Se ndryshe është të vëzhgosh fluturën se si lundron krahëhapur mbi lule. Apo ndalesën e një zogu, qoftë dhe mbi një fill telefoni dhe, krejt tjetër është vëzhgimi në mikroskop. Për të mos folur për durimin e atyre që me teleskop vrojtojnë yjet apo lëvizjen e meteorëve. Lëmë mënjatë këtu, poetikën e suksesit.

-Ku i ke mësuar të gjitha këto? Mos vallë në Universitetin tuaj studiohet fizika atomike e nënatomike dhe laboratorët tanë s'kanë dijeni ndaj arritjeve të tyre për shkaqe të një... vetizolimi nga ana juaj?

-Se ç'bëhet në Universitetin tonë, sigurisht që kam informacion. Por këto s'kanë të bëjnë aspak me kërkimet e mia.

-Laboratorike?

-Jo.

-Teorike?

Ai tundi kryet duke u mbllaçitur.

-Në ç'fushë?

-Nuk ishte "fushë", por dyqan rrangullinash, ku grumbullohen shishe, kavanoza e qelqe të ndryshme, si edhe libra e kartonë për riciklim.

-Dhe?

-Duke kërkuar autorë francezë në origjinal, me: "*Të mjerët*" e Viktor Hygoit, gjeta në frëngjisht dhe *Tetraktin e Pitagorës*.

Fizikanes i ra piruni mbi pjatë dhe, ngaqë ishte zgjatur për ta dëgjuar më mirë, u çikëlua. Poeti u ngrit, qe çasti për t'i kthyer shërbimin e 'melhemit në gushë', siç do ta quante ai. Se pikërisht atje i ra edhe njolla nga salca e saj.

-Mos lëviz, - i tha ai dhe u përkul ta puthte tamam te vendi i njollës. Por fizikania, pak më parë, kaloi pecetën mbi të dhe ai u ndal, për t'u ulur sërish. Veçse kësaj here, ajo pecetën e vuri në buzët e tij. Të dy qeshën dhe puthja u krye, por jo në gushë e as me buzë të... vajosura, por me buzë të fshira e *buzë më buzë* si për ta mbyllur kupitullin e puthjeve dhe për të hapur atë të një diskutimi... akademik. Por më parë ajo vuri re mënyrën se si e përdorte pirunin dhe sytë i mbetën te thonjtë e tij që ishin prerë aq bukur. "Detaji përbën përsosmërinë" - mendoi një shprehje të Leonardo da Vinçit. Ndonëse e dinte edhe se: përsosmëria s'është detaj.

Ti ke dijeni për "Tetraktin e Pitagorës?" - e pyeti ajo.

Ai tundi kryet.

-Pra: e di se njëshi përfaqëson çdo gjë?

-Po. Se është *ideja*, e cila duhet të kalojë detyrimisht në tri stade për të mbërritur te numri *katër*. Diçka që ka të bëjë edhe me mënyrën tonë krijuese në letërsi. Pas idesë vjen *fara*. Më pas lipset të rriten e të zhvillohen

personazhet. Prandaj *Pitagorianët* këtë stad e quanin thjesht: *Rritje*. Për të arritur në fund te *produkti*. Ky, sipas mendimit tim, nuk është e mundur të arrihet pa atë frymëzim të nevojshëm që pasuesit e *Pitagorës* e kanë quajtur me të drejtë: *Trinia* e shenjtë. Këtu duhet të futet jo vetëm fryma e trillimit artistik, por edhe trashëgimia gjenetike si dhe përgatitja e puna me gjuhën e fjalën.

-*Pitagorianët* kishin të drejtë sepse edhe Ajshtajni i mbështeste ata në atë që ekziston një lidhje midis *Zotit* dhe *numrave*.

-E ke fjalën për numrin katër?

-E kam fjalën për **Zotin dhe numrin katër**, - tha ai.

-Në frëngjisht thuhet: *Dieu*. Pra katër germa. Po kështu edhe gjermanisht: *Gott*. Skandinavët e quajnë: *Odin*. Egjiptianët: *Amun*. Latinët: *Deus*.

-Po në shqip? - e pyeti ajo.

-Shqipja që është e fqinjësuar me gjuhët latine. Prandaj si edhe ajo duhet patjetër të kishte një fjalë me katër germa: *Zoti*.

Të dy kishin ngrënë vezën e çarë në formë gongheje mbi pjatën e secilit. Por ishin dhe dy kokrra të tjera të skajuara në tryezë, të cilat, ndofta qenë sjellë për t'u ngrënë pas gjumit, se ato qëndronin në të njëjtën tabaka me dy çokollata.

-Më pëlqen që ndajmë të njëjtin mendim për këtë objekt, i cili në Francë, por edhe në botën tjetër akademike të Europës, është temë e ditës. Kurse tek ju informacione me kaq vlerë përfundojnë në vendet... e riciklimit. O Zoti im!

-Çdo e keqe e ka një të mirë, po ashtu. Se po të kish ndodhur ndryshe, unë i eturi i frëngjishtes do të isha dhe i zhurituri i shkencës së lashtësisë. Për mua librat, për atë që ka pasion dijen, duhet të jenë si syzet për një miop, që i nxjerr nga xhepi vetëm për të lexuar. Ato që të mos

jenë disa palë e në çdo kënd të shtëpisë, varen në gjoks. Pasioni për frëngjishten ma hodhi edhe dashurinë për shkencën që në adolehencë.

-Për shembull?

-Kur shikoja komedinë "*Nata e dymbëdhjetë*" të Shekspirit.

-Pse keni teatër dhe trupë që të luajë Shekspirin?

-Si s'kemi, e dashur. Janë luajtur, thuajse të gjitha tragjeditë kryesore, madje edhe komeditë si "*Zbutja e kryeneçes*". Por nuk e kisha fjalën për ty, se ti s'je... kryeneçe, - thumboi ai.

-Mbase s'jam deri në atë masë, por vurratën ta kam lënë. Jo aty ku do të dëshiroja unë, por gjithsesi në një pozicion të parapëlqyer, sigurisht. Po vazhdo të tregosh se më kënaq rrëfimi yt, ngaqë, ... si *muzikë sferash* po më duket.

-Mahnitëse! - tha poeti dhe bebëzat e syve të tij i zmadhuan përmasat. - Fantastike! Ti ma more fjalën nga goja, - përfundoi.

-Pse?

-Sepse pikërisht këtë desha të them. Është një moment që Viola thotë se: *si muzikë sferash do të më dukej*. Në këtë mes ishte ti që vibrove tek unë shprehjen. Besoj se për një gjë të tillë e kishe fjalën? Tani po bindem përherë e më shumë se ti e zotëron atë që thuhet se ekziston: *shqisa e gjashtë*.

-Vazhdo më poshtë, - tha ajo si për ta thjeshtëzuar në njëfarë mënyre vëzhgimin e tij më se të drejtë.

-Atë natë s'më ka zënë gjumi. Përse e kishte fjalën autori me këtë shprehje? Apo është përkthim i gabuar. Absolutisht jo. Se ai, qe bërë nga kolosi i gjuhëve të huaja, Fan S. Noli. Atëherë ç'ishin *sferat*?

-Ç'paske hequr!

-Po. Dhe do të kalonin vite e do të mësoja se *sferat*

ishin *Planetet*. Domethënë se ata lëshojnë tinguj. Për më tepër melodiozë. Madje-madje, Pitagora kishte llogaritur tonalitetin e planetëve sipas distancës së tyre me njëritjetrin. Arsyetimi i tij ishte se vibrimet krijojnë muzikë. Mbi të u mbështet pentagrami.

-Ke të drejtë. Tashmë u bë kohë që kjo logjikë është pranuar gjerësisht. Ke shkuar shumë larg e lart. Afrohu dhe ulu ca. Pse u ndodhët në kohën e gabuar e në vendin e gabuar?

-Sepse, zonjushë e fizikës, emri yt nis me germën "J".

-Dhe ç'del nga kjo?

-Me këtë germë fillon edhe fjala *Juridiksion*, ose drejtësi në shqip. Pra: takimi me ty, në shkelje të ligjit, më vë mua përballë tij.

-Nuk mbërrij të kuptoj. Kjo është metafizikë dhe ti këtë ia thua një njeriu që merret pikërisht me fizikë. Madje të grimcave nënatomike?

-Unë mund të mos jem plotësisht në gjendje ta shpjegoj shkakun, por ata të cilëve emri u fillon me "J", kanë një lëkundshmëri që ia kalon dyshimit në çdo gjë. Këtë e kam më se të qartë. Njohja me mua për ty kaloi në tri etapa: pirat-misterioz-falltar. E përbashkëta e tyre është *dyshimi*. Një takëm studiuesish këtë ia atribuojnë "J"-së. Dhe duan të thonë se edhe *Jul Qezari* u tradhtua nga shokët falë kësaj germe të lëkundur. Madje është e çuditshme, por edhe *Jezu Krishti* tradhtohet nga shoku i tij, emri i të cilit gjithashtu fillon me "J", *Juda*.

-Domethënë se unë jam e rrezikshme sipas kësaj trajtese?

-Jo, absolutisht jo. Jo dhe jo.

-Sepse s'e dëshiron ti?

-Edhe pse s'e dëshiroj unë. Por edhe sepse vetë emri ka në brendësi të tij një tjetër "J". Jo si një 'grimcë' për të prishur 'fushën', por si një brez antisizmik që mbron "J"-

në e parë nga lëkundjet. Pra: mbron 'fushën'.

Fizikanes i pëlqeu ky detaj dhe buzëqeshi:

-Arsyetim bindës, gjithmonë në kontekstin e trajtesës.

Por po flisnim për Shekspirin.

Edhe poeti qeshi. Harmonia për kalimin në një tjetër bisedë që fizikania e kishte të natyrshme e befasonte së tepërmi atë, i cili e shihte jo rrallë veten në një ngërç si në udhëkryq.

-Po. Te Shekspiri, e unë do të thosha edhe Njutoni. Të dy duhet të kenë zotëruar shqisën e gjashtë, por mendjemprehtësia jote dhe humori ma spostuan ëmbëlsisht.

-Sepse duhet të pohoj se... ti, ka shumë të ngjarë ta zotërosh atë dhe jo unë.

-Sigurisht, - pohoi ai me ironi, ndërsa nën zë mendoj, - se unë as duhet të jem i çmendur, ose duhet të kem aftësi të bëhem i padukshëm për të dalë, pa u përplasur me ligjin, nga kjo dhomë. Por shifra 105-së e portës më jep kurajë pas dëshirës që më shtyu në këtë ndërmarrje kaq të bukur.

Te 105-sa kishte ndërprerje dhe shkëputje pa kthim të marrëdhënieve. Unë shpresoj në vazhdimësi.

Ja ylli dhe shkëlqimi i tij, ja humbëtira dhe errësira e saj

Ato çaste kujtoi gomën e shpëtimit që prindi i fëmijës ia hodhi tjetrit të rrezikuar atë paradreke në det. Kaq mjaftoi që si në një ndërrim fotografik, të kaluar nga njëra dorë në tjetrën, iu ndërkëmbye figura. Skena e aktit të mbramë, tejet tragjike e ndodhur rreth pesë vite më parë, aty në pllajën Bergo, të atij plaku, falë të cilit, poeti ishte ende gjallë e, madje bënte dashuri... Po me kë, o Zot? Mos ndofta me të bijën e tij? Thua ta kishte këtë fat të zbritur nga Qielli? Një baba i dytë për të, jo vetëm e kishte risjellë në jetë pas atij aksidenti në atë pllajë, por duke i dhënë amanetin e tij në atë fletore shkruar në frëngjisht, i kish hapur qiejt. Ai kishte tanimë universin e tij: frëngjishten dhe... pjellën e saj: fizikanen me të cilën dashurohet me vështrim të parë. Poeti instinktivisht, si somnambul, mori njërën nga vezët dhe nisi ta ciflisë me nge aq shumë, sa fizikania tek e shihte ashtu, filloi të humbasë me të drejtë durimin.

Ajo që tejet e trazuar së brendshmi dhe vështrimi i që tretur në atë lëvozhgë që, cifla-cifla, sikur i gërryente zemrën. Edhe e artë të ishte ajo vezë, për të s'do të paraqiste asnjë interes.

Gjithsesi durimi firoi kur, si në çdo budallallëk,

veza ishte po aq e bardhë e zhveshur tanimë, sa edhe e paprekur më parë nga plogështia e atyre duarve. Prandaj ajo nxitoi të hapë me pult televizorin për të thyer atë heshtje të pakuptim e tejet torturuese. Zëri i spikerës nga kanali francez, në një dokumentar fliste për zgalemin. Këta shpendë deti oqeanik paskëshin qenë tri lloje: krahëgjatë - të furtunës - dhe kredharakë. E përbashkëta e tyre ishte se rrinin në fole si koloni dhe ushqimin e kërkonin së bashku duke formuar “trape” të mëdha mbi ujë... U dha muzikë e publicitet.

-Zgalemët fluturojnë përpara dhe gjatë stuhisë, - vazhdonte zëri i spikerës, - për ta thuhet se paralajmërojnë, në çdo rast, lëvizje a ngjarje të rëndësishme shoqërore. Fizikania e pa se partneri i saj qe shkëputur nga veza dhe po dëgjonte me vëmendje spikerin e atij kanali francez, e cila tanimë kishte ndërprerë programin për të dhënë një lajm të sapombërritur. Bëhej fjalë për ca terroristë që kishin rrëmbyer dy gazetarë.

-Prite atë vezë, - i tha ajo, - se e shndërrove në kusht lirim të pengjeve. Nëse është me dy të verdha i ke çliruar. Në të kundërt, do të flesh i hidhëruar. Por s'ka pse pendohesh derisa pranove kushtin. Terrorist!

Poeti i hodhi një vështrim para se ta ndante në dy gjysma atë vezë dhe mori buzëqeshjen e saj me të cilën ajo kishte shoqëruar epitetin ‘terrorist’. Dhe pati kujdes që thika të mos prekte asnjërën nga dy të verdhat, për të cilat, një bindje e verbër i thoshte se ishin. Në përfundim, gëzimi i tij qe i madh. Se shihte siç edhe janë poetët, simbolikën e lajmeve të mira. Se e lidhte këtë me shfaqjen e zgalemëve, qoftë edhe në një program televiziv në një vend të caktuar e, madje, edhe kohe të caktuar. **Zgalemët** për të ishin paralajmëtarët e një *Ere të Re*. Madje, *fortune*. E nisur në dhjetorin e shkuar dhe ishim në dy ditët e para të korrikut. Edhe fizikanës,

zemra sikur i ndiente diçka, të cilën nuk është se qe në gjendje ta shpjegonte se nga i vinte. Aq më pak të dinte origjinën. E, assesi ta parandalonte atë. Mbase edhe për faktin që zemra sikur i pëshpëriste me rrahjet e saj për të dy prindërit. Për të atin, të cilin s'e kishte parë kurrë. Sytë e tij i flisnin kaq ëmbëlsisht, por... vetëm nga fotografia. Kurse sytë e së ëmës ishin vetëm me lot, sa herë që atij i festonin ditëlindjen dhe i luteshin Zotit që ta mbronte e të bashkoheshin një ditë.

-Xhulio! - tha poeti dhe fizikanës iu drodh trupi deri në 'grimcëzën' e fundit të kurmit të saj. Se kishte një nuhatje të çuditshme instinktive. -Pse i tha Xhulio e jo Julietë?

Fizikania ia nguli vështrimin në sy atij, që të mos dredhonte dhe t'ia thoshte e të mos kursente, çdo kumt sado i trishtë që të qe: -Fol, Pet! Të dëgjoj. Ndonëse ke pritur gjatë që ta bësh një pyetje. Nga nëna kam mësuar se... në... *Kanunin e Lekës...*

-Të kujt Lekë? - e ndërpreu ai vrullshëm.

-Të Lekë Dukagjinit! - saktësoi ajo.

Poeti u drodh.

-Ti e njeh Lekë Dukagjinin?

-Po. Ai ka thënë se lajmësi nuk mban përgjegjësi për lajmin e keq që mund të sjellë.

-Dhe nga e ke mësuar këtë thënie brilante?

-Nga mamaja ime, madje dy ditë më parë.

Ai shtangu për një hop, para se të pyeste:

-Mos ndofta mamanë tënde e quajnë Marsejeza?

Befasimi qe i plotë. Pyetja, si e lëshuar nga një flakëdhës e përfshiu fizikanen në tërësinë e saj. Nuk e dogji. Por i ndezi plotësisht shpirtin e, bashkë me të, i zgjoi atë lloj premtimi që i kish bërë e ëma se, më në fund, do ta takonte babanë që s'e kishte parë kurrë. Shpresa e shpërgjumur i ngjiste besimit në sukses të një reaksioni

kimik pas përdorimit të reagentëve.

-Po, - tha nxitimthi dhe përgjonte me ankth lajmin e shumëpritur për të. A qe gjallë ai. Ku qe, në është se do të ketë dalë nga burgu? Por nuk mbërriti të bëjë asnjërën nga këto pyetje se televizioni francez ndërpreu sërish programin për një lajm urgjent të korrespondentit nga Tirana. Spikerja do të thoshte me triumf:

-Lirohen të gjithë të burgosurit politikë nga burgjet shqiptare.

Fizikania u çua në këmbë e ngadhënjyer.

Poeti s'lëvizi aspak nga vendi.

Asaj i ngriu buzëqeshja kur lexoi sytë e partnerit që flisnin për humbjen.

-Babai yt e dashur, mos ndofta quhej... Luan?-pyeti ai me një zë të shuar përmes lotësh.

-Po, - tha ajo dhe u ul si e shembur mbi ndenjësën e saj.

Poetin, ky çast, nuk e gjeti aspak të përgatitur, për ta përballuar. Qe një ballafaqim nga më të padëshiruarit, por edhe më i rëndësishmi për të kuptuar, a për të kapur tiparin e përbashkët, atë e bijë. Se në atë vështirësi të përqendruar banonte gjasa dhe e njëjlojta vendin aty e kish. Ai njohu portretin e atij plakut, që një Zot e di sa u ngjante vështirësi. Ndjeu atë pështjellim që do të trazonte edhe zemrën më të ngurtë. Se, zjarri që i lindi francezes për të atin, nuk mund të shuhej me prushin që ndrynte në gji poeti, që prej pesë vjetësh nga njohja për atë shpirt aq të madh.

Ja pse i rrodhën lotët. Skena e mbrame s'mund të mos i përtërihej: "Mar-selë, Mar-selë, Mar-selë! - më thërriste nga larg, - nisi të tregojë ai.

-Pse ku qe? - munda të pyesë fizikania përmes lotësh.
- Ku qe ai të cilin ti e kishe larg? Ku ishte babai im? Ku?

-Në shtëpinë e tij, rrëzë kodrës, me të cilin para disa

minutash isha ndarë dhe kisha zbritur në qytezë, e cila që në një pozicion si në gropë në krahasim me të, edhe pse ishte pllajë.

-Po, - tha fizikania, - pastaj? - dhe etja për të mësuar çdo detaj nga ky çast po ia bironte zemrën, regëtimin e së cilës e ndiente me frikën se mos ajo i çahet më dysh përpara se të merrte vesh edhe grimcëzën e fundit të jetës së tij.

-Përsëriti, tri herë radhazi, emrin e nënës tënde në gjininë mashkullore, që të mos kuptohej. Kështu, emrin Marsejezë e shqiptoi Marsel. Dhe ishte i bindur se unë e kuptoja se për kë bëhej fjalë. Ai më kishte shpjeguar kalvarin e vuajtjeve të tij. Por edhe ato vite të lumtura me mamanë tënde, që kur ishte në gjimnaz në Paris...

-Po, po. Pastaj, i dashur?

-Ishte pranë banesës së tij, flakën e së cilës e kishte vënë vetë. Dhe, ta dalloja se ku ishte, vërtiste me dorë pelerinën e tij, në mënyrë rrethore për të më tërhequr më shumë vëmendjen dhe thërriste: "Më dëgjoni?!" Unë i përgjigjesha: "Po, të dëgjoj, shpëtimtari im!" Dhe më pas thirrjet e tij: "*Zhëtemë Mar-selë, zhë-temë!*" Gjithashtu po me atë zë të ëmbël e plot dashuri: "*Zhëtemë, Xhulio! Zhëtemë, biri im!*" Dhe në këtë rast e kishte fjalën për ty. Ty të thërriste siç do të bënte po të ishte djalë: Xhulio e jo Julietë.

Fizikania kishte mbetur si e ngrirë. - Dhe? -pyeti më në fund, me pak zë, akoma edhe me më pak frymë që mbahej pezull dhe gjak të ngrirë në damarët e saj.

Ai nuk kishte pse ta fshihte:

-Dhe,... lajmësi, e dashur, nuk ka përgjegjësi për ogurin e keq që mund të sjellë.

-Pse çfarë bëri? - pyeti ajo me nxitim e tmerr, po ashtu.

-U hodh në flakë për t'i dhënë fund jetës së tij plot vuajtje e brenga. Se kish bërë njëzet e dy vjet burg e katër

të tjerë internim në një humbëtirë, pesë vjet të shkuar, afërsisht.

Poeti e zbrazti, pak e nga pak, të gjithë kupën e atij helmi. Atij iu duk se ajo e priti gjakftohtë e me një durueshmëri për t'u lavdëruar. Por kjo që vetëm ngrirja që të sjell befasimi. Si një objekt që përshkohet nga suferina përpara shtrëngatës. Por ajo s'që send. Aspak. Ishte shpirtshpresëplotë e i pastër si kristali. Prandaj edhe u thërrmua e u grimcëzua në ato dy a tre sekonda me klithmën:

-Joooo! Jo, o Shën Mëri e Parisit, jo. Pse ma more babanë tim, pse?!...

Dhe, me lot në sy nisi të godasë me grushta gjoksin e poetit që tanimë i kishte shkuar pranë si barrikadë, ku të shkarkonte gjithsesi dhimbjen e atij lajmi për fundin aq tragjik të babait të saj. Dhe u shkreh në vaj e dënësia. Ndërsa poeti i ledhatonte flokët.

Nga jashtë vinte zëri i ish-tenorit, që si në një profeci do të deklaronte:

Ja ylli dhe shkëlqimi i tij, ja dhe humbëtira dhe errësira e saj. Dhe, ndërsa fizikanen e mbytën lotët, poeti do të shtonte si vazhdim të asaj oratorioje të ish-tenorit: -Megjithatë zemra nuk e lëshoi asnjëherë. Atë, ai e kish të fortë. Se e mbante të gjallë dashuria për mamanë tënde dhe për ty, e dashur. Kjo ia bëri shpirtin sitë. Iu shpif tumori në mushkëri.

-E dinte? - ngriti ajo kryet.

-Po. Ia tha një shok fëmijërie, radiolog. Dhe fundin që ishte edhe të paktën dy vjet të tjerë larg, nuk kuptoj ç'e nguti që ta sillte aty. Për një kurajoz, si ai, ishte jashtë logjike t'i humbte befas, shpresat. Diçka e padurueshme, matanë 'shëndetësore' duhet të ketë ndikuar.

Guximi i tij, e dashur, më ka vlejtur në këta afro pesë vjet. Po të mos kishte qenë **ai qëndrim**, unë nuk do të

kisha pasur kurajën t'i afrohesha këtij hoteli. Aq më pak të ndryhesha në këtë dhomë me ty. **Falë atij, rilinda. Për shkak të tij** mësova frëngjishten dhe krijova universin tim. **Në saje të tij** u njohëm bashkë. Janë shumë gjëra, që i kushtohem babait tënd Xhulio, - përfundoi poeti.

Ndenjën një copë herë të gjatë pa këmbyer asnjë fjalë me shoshoqin. Derisa më në fund, fizikania, ngriti receptorin dhe porositi dy kafe ekspres, të cilat nuk vonuan të vijnë në tabaka mbi karrocë.

Ajo mbloodhi pjatat e boshatisura, i vuri në mbajtësen mbi rrota dhe, si i nxori në korridor, u ul së bashku me poetin të pinë kafënë.

-I paharruar kujtimi i babait tënd dhe mikut e shpëtimtarit tim.

-I paharruar! - përsëriti fizikania zëpaktë si të fliste me veten e saj. Dëshpërimi tek ajo i kishte rrokur gjithë qenien. E kishte mpirë atë. Shpresa se dikur do ta shihte të atin e saj, që rrëzuar dhe vendin ia kishte zënë zhgënjimi.

Ditën që morën vizat në ambasadë, ndryshe nga e ëma, fizikania që gëzuar jashtë mase. Dhe s'që altruizëm, as ndjenja se do të bënte pushime në një plazh, për të cilin thuhej se që i shkëlqyer. Jo. Gjithçka ishte lidhur me vendlindjen e të atit, Atdheun e tij. Dhe kjo hallkë iu këput siç ndodh me një varkë në stere nga një shtrëngatë e beftë. Ajo e ndiente veten të braktisur, brenda saj, në detin e hapur. E gjithë kjo, mbase edhe për atë se flakët që dogjën trupin e tij do t'ia përcëllonin shpirtin, sa herë që do ta kujtonte atë. Dhe ajo vështirë se kish për ta harruar lehtë babanë. Jo.

-Domethënë se im-atë ngeli edhe pa varr?

-Jo! - e kundërshtoi poeti. - Unë doja të qetësoheshe njëherë dhe në qoftë se ta zbus sadopak pikëllimin, kam ende edhe shumë gjëra për të rrëfyer.

-Po. Më trego. Dua të di sa më shumë për babanë tim.

-Ai mbrohej nga shoqëria e një langoi, se shtëpiza e tij (nuk tha kasollja) ishte lart mbi kodër dhe kjo rrëzë malit, ku mundësia e egërsirave ekzistonte. Nuhatja e qenit besnik jo vetëm e mbronte, por i bënte edhe shoqëri në jetën e tij të mënjanuar. Se rrinte vetëm, por nuk qe i vetmuar.

-Si ta kuptoj këtë?

-Shkruante kujtime.

-Ka lënë diçka të tillë?

-Po. Një fletore në frëngjisht.

-Në frëngjisht?!

-Po. Mos u habit. Ky qe edhe amaneti i tij.

-Që?

-Që fletorja të mbërrinte te nëna jote e sidomos tek ti. Të shikoje në rreshtat e saj dashurinë e tij për nënën tënde.

-E ke fletoren?

-Ui.

-Ku, në kabinën tënde?

-Ui.

-O Zot! Mezi pres ta marr e ta shoh. Ta lexoj se ç'ka shkruar e ta përfytyroj se në ç'gjendje ka qenë kur i ka hedhur ata rreshta. T'i dëgjoj zërin duke u nisur nga germat, shkrimi i tij. A ka qenë i bukur?

-Shumë.

-Nuk gënjen?

-Aspak. Nëna jote, së pari, është dashuruar me shkrimin e tij, kur ishin paramaturantë dhe kishte mbushur një faqe fletoreje me emrin e tij: Luan Majlindi. Dhe kur, rastësisht i ra në dorë babait tënd, tek bënë orën e matematikës, e pyeti për rezultatin e "x"-it. Ajo e hoqi veten sikur nuk e dinte.

Vajza u entuziazhua.

-Pastaj? Pastaj si vajti biseda? Tregomë të lutem, dua të di sa më shumë. Dua të di gjithçka për të. Gjithçka për babanë tim.

-Do të lexosh fletoren, e dashur. Unë, për të mësuar ç'thuhet në të, përvetësova frëngjishten. Por jo vetëm. Edhe për të shpënë në vend amanetin e tij. S'qe e domosdoshme të shkoja në rrugën "V. Hygo" të Parisit dhe të kërkoja dyqanet apo hotelet me tabelën "Fini", në bulevardin "Aragon".

-Ekzakt! - e ndërpreu ajo.

-Katër vitet e fundit që ishte në internim, mezi priste gjashtë majin t'i festonte ditëlindjen mamasë tënde. Merrte cylen dyjare dhe, bashkë me langoin e tij, hidhnin valle. Ai, me siguri, këtë do të bënte edhe në ditën tënde të lindjes, por nuk e dinte atë.

-Me se jetonte? - pyeti fizikania.

-Ingranazhi i kohës e kishte vënë përfund dhe ai që i detyruar të rrotullohej bashkë me të.

Fizikania tundi kryet, ashtu siç bëjmë kur duam të themi për dikë: I shkreti.

-Mos u çudit, - vazhdoi poeti, - ai kishte tri dele në mbarështimin e të cilave kishte gjetur zgjidhje individuale. Jo se mjelja e tyre do t'ia shëronte të keqen e grumbulluar në mushkëri, nga gjaku i shtypur e ankthi i mungesës së lirisë, por sidoqoftë. Po ta gërmoje, siç bëra dhe unë pyetjen tënde, ai do të përgjigjej se: e ndiente lulëzimin e trëndafilave në maj, se vinte ditëlindja e Marsejezës, po me atë dëshirë që mezi priste në dimër dy javët e para të marsit. Kur rritej bari dhe ai hiqte merakun e kullotjes së deleve me të cilat ushqejej. I shtoej siguria për dimrin e ardhshëm e mbase do të bezdisej më pak për zilet e vuajtjeve e të kujtesës së dhimbshme, po ashtu. Por a shtyej në këtë mënyrë kur fryma i zihej e paralajmërimi i fundit po i afrohej?

Disharmonia me shoqërinë e kish veçuar dhe sëmundja e bëri që të shpërfillë gjithçka. Edhe diçka tjetër. Një plak si ai, i zbardhur plotësisht e me mjekër, s'ëndërronte detin siç do të bënte një vajzë. As anijen siç do të zilepste një djalë. Trimëria dhe vendosmëria, që s'i mungonte, mund të krahasohet me kapitenin, të cilit i qe fundosur anija e tij. Prandaj duhej që edhe ai të përfundonte në gërmadhat e saj.

Një copë herë, siç ndodh në mort, nuk këmbyen fare. Vetëm ndihej gjerbja e kafesë së tyre dhe zëri i spikeres, tejet i ulur, si lutje kishe, a si pëshpërimë për shpirtin e të ndjerit.

-Ti më pyete për varrin. Kështu?

Fizikania pohoi me krye.

-Po. Ka një varr.

Atë natë që unë e kalova me të qara e pa vënë gjumë në sy, hëna ose ishte fshehur pas reve si një bukuroshe e turpëruar, që s'kishte mundur të ndalojë bëmën me hiret e saj, ose ishte zvogëluar derisa qe zhdukur fare dhe vendin ia kishte lënë një elementi tjetër natyror: shiut, i cili atë natë s'reshti për asnjë minutë. Mllefi i tij vazhdoi edhe të nesërmen. Tashmë kampingu qe vendosur në klasat e shkollës së fshatit dhe s'guxonte të dilte jashtë. Të gjithë ngrinin krye për të hetuar qiellin dhe ai, me sytë e tij, kërcënonte tokën, me vështrimin e një gjykatësi absolut. Herë-herë lëshonte nga një vetëtimë pas së cilës nuk vononte edhe bubullima me shpërthimet zemërake, seriozitetin e të cilave s'guxonte kush ta vinte në dyshim.

Shfletova ditarin e tij në frëngjisht se mos gjeja ndonjë shprehje, fjalë apo rrëfim në gjuhën amtare. Por jo. Më duhej të gëlltisja hidhërimin e paditurisë sime. Duhet të ketë qenë dita më e dhimbshme për mua edhe për këtë arsye, pas humbjes së atij njeriu me shpirt të madh. Nuk e dija që fati i jetës sime qe në varësi të këmbënguljes

e vendosmërisë së tij për t'i dorëzuar dikujt amanetin përpara se të linte këtë botë, ashtu siç nuk do të besoja që do ta plotësoja atë fare thjesht. Të përvetësoja gjuhën edhe të komunikonim së bashku, e dashur Xhuli. Po ti pyete për varrin. Po. Mund të të flas edhe për të. Se vetëm ditën e tretë, unë bashkë me dy shokë, arsimtarë dhe ata, por nga shkolla të tjera, me të cilët më njohu e bashkoi rastësia. Ngaqë m'u ndodhën pranë, kur unë iu përgjigja thirrjes së tij nga larg, si një britmë: Mar-selë! A më dëgjon? Ata, pra, më erdhën me vegla në duar e më thanë:

-Shkojmë tek ai. Eshtrat e atij njeriu duhen groposur siç e kërkon zakoni shqiptar. Kësisoj të tre, njëri më axhami se tjetri në këtë shërbesë, shkuam të kryejmë ritet e një varrimi.

Duhet të të them se langoi i tij, kur pa të zotin të hidhej mbi flakë, bëri disa rrotullime të çuditshme, ashtu siç edhe kërcente kur shikonte dhe dëgjonte të zotin e tij t'i binte cules dyjare e të lodronte bashkë me të. Dhe, në mos e mori për të tillë këtë veprim, për rrezik ai nuhati vetëflijimin. Prandaj, vrullshëm, s'vonoi të hidhet pas tij në flakë.

Era e mishit të djegur bashkuar me atë të leshit të përcëlluar mbuloi gjithë pllajën dhe sa më shumë i afroheshim vendit, aq më kundërmuese bëhej ajo dhe kur mbërritëm, hundët tona s'ndienin më asgjë. Shtëpia që rrafshuar e shkrumbëzuar me gjithçka, ashtu siç edhe e prisnim. Çuditërisht skeleti ishte me fytyrë nga qielli dhe e jashtëzakonshmja: qeni gjysmë i djegur dhe në grahmat e fundit, rënkonte pas të zotit. -E dija vetë, - tha lezhjani. - E pashë që rrekej për vrull dhe e mora me mend se hyri, por dhe e kaloi flakën, duke pritur që edhe i zoti ta bënte këtë veprim. Por u bind se nuk e pa matanë zjarrit. Dhe nuk e dalloj dot brenda saj se

përflakja s'reshtte pa djegur gjithçka. Atë nuk e shuan prushi, burra. Dhe lezhjani kishte të drejtë.

Gjurmët e zvarritjes së langoit dallonin mbi shkumbëzim. Por edhe më i pabesueshëm qe fakti se të tria delet, kur panë qenin të hidhej në zjarr, bënë të njëjtin veprim. Ky ishte dhe shkaku i atij kundërmimi që ndihej nga pllaja e që përzihej me erën e mishit të djegur. Lezhjani me njëfarë përvoje, por edhe si një orakull në këtë drejtim, na orientoi: -Çdo shpirt e shijon dekën e vet përpara se me dekë.

-Ç'do të thotë kjo? - pyeti tjetri.

-Kjo don me thanë se ai që vret veten e ka ndi atë përpara se me i ardhë deka dhe merr masat. O do të lejë ndonjë copë pusullë, o do të kërkojë t'i plotësohet ndonjë dëshirë, a merak.

Ne pamë njëri-tjetrin në sy, sa të befasuar aq edhe të trembur. Por lezhjani vazhdoi:

-Axha jem, merakli pas tualetit, atë natë që iu duk se qe e mbramja, kërkoi ujë të ngrohtë, pasqyrën dhe briskun që të hiqte mjekrën. E kreu me shumë qejf dhe pse ora qe një pas mesnate. Ne nesëre u gdhi i dekun. Sytë e tij ndrisnin si margaritarë në atë fytyrë të rruar si pëllumb. Qepallat e tyne ia uli axhesha dhe, fjala e parë që i erdhi në mend, kur lëshoi kujën, qe: **"Ku-ku, për bukuroshin e shpirtit tem, ku-ku"...**

Ne s'dinim ç'të bënim. Qeni duhej të jepte shpirt pastaj ta luanim nga vendi. Lezhjani i ra një rreth e qark bahçes, si për të gjetur dobësinë e merakun e atij burri dhe nuk vonoi të na thërrasë me një ton triumfues: -Ejani këtu, djelmosha! Shkuam dhe përpara se të mrekulloheshim nga ajo që pamë, përsëriti: -A, ju thashë, veta? Çdo shpirt shijon dekën përpara se me dekë. Axha jem dinte disa gjuhë të huaja. Edhe ky gjysh duhet të ketë ditë diçka.

-Sigurisht, - pohova unë. - Ai fliste frëngjisht se kishte

bërë të mesmen në Paris.

Shokët i habiti çfarë thashë.

Mua më befasoi ajo ç'ka pashë.

Ishte një arkivol i punuar duke i hequr zemrën drusë së lisit si ta kishe gërryer në prerjen tërthore të tij. Se dhe kapaku qe pjesë e së njëjtës lëndë. I gjithi, mbuluar me një fletë plastmas nën degë dushku të mënjanuara befas, që ta 'zbulonim' lehtë tabutin.

Unë, që dija ç'më kish shpjeguar, kuptova se vitin e fundit, sapo mori vesh diagnozën, ai i qe përveshur punës për aktin e tij final dhe ishte kujdesur, që ajo, e cila do të mbahej mend për zgjidhjen e këtij veprimi, të qe po aq dinjitoze sa edhe ky arkëmort origjinal. Dhe ai këtij qëllimi ia kishte mbërritur. Ne u kthyem për të nisur punën. Së pari hapëm një gropë, tutje, afërsisht një metër të gjatë e të thellë për qenin, rrëzë kodrës, njëzet-tridhjetë hapa larg vendit ku menduam për të çelur varrin. Pas kësaj gërmuam me mjaft dëshirë, më shumë se një metër thellë e dy të tjera gjatësi dhe futëm atë tabut me lëndë lisi dhe eshtrat e tij brenda. S'qe e vështirë të gjenim dy gurë të përshtatshëm për të cilët edhe këtu lezhjani do të tregonte praktikizmin e tij. Kësisoj nga çdo pozicion që ta shikoje, dukej se qe një varr, madje dhe me një kryq që ia jepte vendosja e gurëve si të qe në varrezat e katolikëve.

-Kaq? - pyeti fizikania, me merakun se kishin kaluar afërsisht pesë vjet dhe në atë humbëtitë, po të shikoje mund të mos gjeje asgjë.

-Jo kaq, e dashur Xhuli.

-Pse çfarë bëtë më vonë?

-Qe ende fillimi i muajit mars. Në vjeshtë kalova nga poliklinika. Tanimë e kisha të qartë se radiologun do ta gjeja patjetër atje. I thërrita si Luani vitin e shkuar, nga nënballkoni: "Thokët e mi". Pas dy-tri sekondash,

një burrë rreth të pesëdhjetave, i gjatë si dhe Luani, i shëndoshë e flokë-brun me kaçurrela, del aty dhe më hodhi një vështrim duke picërruar sytë. Nuk më njihte dhe s'bëri ndonjë përpjekje të pyeste se kush isha dhe ç'kërkoja. Atij i mjaftoi parulla e fëmijërisë së tij të largët dhe ma bëri me shenjë të ngjitesha lart:

-Sthu-den-th? - më pyeti.

-Po, - i thashë, - student jam. Më duhet një skopi për dokumentet e shkollës.

E kuptova që edhe atij i erdhi mirë përdorimi i kartës së studentit për t'u shërbyer jashtë radhe. Sapo më futi brenda i shpjegova se nga vija.

-Po?

-Na la në mars, - iu përgjigja pyetjes së tij: Ato katër fjalë ia zbrazë në vesh si katër pika vaji të nxehtë. Ai lëshoi një klithmë: "Mos, o Zot! Po ai kish-the edhe dy vjet kohë?! - dhe u shemb me dënësia në ndenjësen e tij. Edhe unë u përlota bashkë me të dhe pas një copë here, doktori u ngrit nga vendi dhe doli në ballkon. -Diçka psikologjike duhet të ketë ndikuar tek ai. Ndonjë shpifje për ta rifutur në burg. Ndryshe s'ka si shpjegohet ky vendim.

Pas një viti unë, sipas zakonit tonë, dëshiroja të shkoja pranë varrit për t'i shpurë një orkide. Kësisoj, javën e fundit të shkurtit praktikën mësimore kërkova ta jap në shkollën tetëvjeçare në Pllajën e Bergos. S'vihej në dyshim miratimi i kërkesës sime në një zonë të tillë kaq të thellë. Me këtë gëzim u paraqita te nënballkoni i kardiologut në shoqërinë e të cilit tanimë ndihesha i përfshirë si zëvendësi i Luanit, me të vetmin ndryshim se nuk merrja vesh fare nga kurthi në zënien e kunadheve.

-I shkreti ti që s'merr vesh fare, - e qesëndisi fizikania.
-Se të duket embrional çarku i ngritur me gjuhën frënge?

-Përkundrazi, - tha poeti, që i erdhi mirë se biseda qe

futur në një hulli të tillë, e cila, gjithsesi, e zbuste sadopak në mënyrë të beftë dhimbjen.

-Thuhet se kunadhet gjuajnë ketrit. Unë, në rolin e tij, rashë në grackën tënde. E pranoj, moj "kunadhja ime e grimcave shpërthyes".

Ajo nuk tha "do ta ha gjoksin", por thjeshtë, buzëqeshi hidhur... Dhe kjo e gëzoi poetin.

-Sapo të mbaroj detyrën e amanetit, do të jem nën urdhrat e tua me bindjen e një pengu, - tha ai tejet i kënaqur, që humori i fizikanës i qe rikthyer disi.

Ajo tundi kryet me atë buzëqeshjen karakteristike dhe në faqet e saj ai dalloj sërish se formoheshin dy gropëza të vogla që ia shtonin nurin.

O Zot! Si nuk e kishte qëmtuar më parë këtë tipar të saj fin? - tha, por gabohej. Hutimi e bënte ta harronte se **kishte vjelë atë frut.**

Radiologu, nga ana e tij, kish planifikuar të qe në krye të një ekipi sanitar përbërë nga tre infermierë për vaksinimin, jo vetëm të nxënësve, por edhe të banorëve, kundër një gripi, epidemia e të cilit po përhapej në gjithë vendin.

Kësisoj, me ambulancën sanitare, atë të shtunë, mbërritëm në mbrëmje. Të nesërmen ekipi nisi vaksinimin. Unë e mbajta frymën lart, në kodrën rrëzë malit, nëpër një rrugë ushtarake të hapur rishtas nga forcat e armatosura për të përforcuar një pikë strategjike. I gjithë vendi qe i rrethuar me kangjella dhe një brez gjineshtrash të prera si në një lulishte të vërtetë. Në krye të kësaj parcele dukej nga poshtë varri. E pabesueshmja qe se ai ishte i betonuar dhe me një mbishkrim dinjitoz. U ngrita me ngut. Atje pas kthesës së fundit, përpara se të mbërrija pashë se rreth tij ishin edhe dy varre të tjerë të moshuarish dhe tre-fëmijësh. "Prandaj radiologu ka nxituar të vijë për vaksinim në këtë vend", mendova ato

çaste. "Epidemia ka filluar të bëjë të vetën".

Por më e paharrueshmja për mua ishte se varri i babait tënd qe betonuar. Madje, përveç emrit, vitit të lindjes dhe atij të largimit nga kjo botë, kishte edhe një fotografi të emaluar. Poza, me siguri, do të ketë qenë një fotografi e dalë për diplomën e maturës në Paris. Mamaja jote kishte të drejtë të dashurohej me njeriun e futur në atë foto. Mashkull më simpatik zor se do të gjente në të gjithë Parisin. "Bel-Ami" i Mopasanit i merrte të keqen. Edhe unë, që njihja origjinalin e asaj fotoje, që kishte po atë vështrim të përqendruar e pak të qeshur, nuk do të bindesha se ishte njeriu që kam njohur dhe që e kishte emrin: Luan Majlindi.

-Kush e kishte bërë, pra?

-Po. Do të ta them. Por më parë dëgjo se ç'shkruhej në të:

*Diell,
ndriçoje këtë portret
se iku nga kjo botë
si kreshnik.*

Nga "Thokët e mi"

Kështu, e dashur! Babanë tënd unë e futa në dhe me dy shokë rastësorë sipas ritit shqiptar, ndonëse qemë profanë për atë punë. Por atij do t'ia kryente nderet e duhura komandanti i fëmijërisë së tij të skuadrës "Thokët e mi". Dhe jeton në zemrat e tyre dhe tonat, natyrisht.

Vajzës i erdhi mirë për këtë përkujdesje të shoqërisë fëmijërore të babait të saj. Kjo vëmendje, së brendshmi e bënte të ndiente lehtësim, ashtu siç edhe e pezmatonte dëshira e sidomos detyrimi për të atin që e shtypte në mushkëri e po i zinte frymën. Dhe kishte të drejtë në arsyetimin e saj. Ç'po bënte? Po rrinte në plazh dhe jetonte çaste relaksi e dashurie, kur së pari duhet të shkonte pranë tij e t'i vinte një buqetë me lule, ku të

derdhte dhe dy pika loti... Kjo bëri që të bashkonte dy vetullat nga një zemëratë e beftë për vetveten. Ndërkaq poeti u ngrit ta përkëdhelë disi nga flokët dhe ajo e kundërshtoi dorën e tij me një lëvizje tejet mospranuese e, madje, disi idhnake. Poeti u ul në ndenjësën e vet dhe nuk foli. Por edhe nuk u mërztit ngaqë e kuptonte fare mirë shkakun e këtij mospëlqimi edhe pse veprimi i tij i përkorë që miklim e aspak dëshirë mashkullore.

Dhe, është për të qeshur, por pikërisht shpërfillja nga kundërshtimi i saj e bënte dhe më kryeneçe, po ende dhe më nervoze francezen. Po cila ishte shtysa, që tek ajo, herë-herë, kalonte në trajta të tilla? Po ta pyesje në ato çaste për këtë atavizëm të trashëguar do të thoshte se ishte shqiptare dhe se nuk kujdesej aspak ta mënjanonte këtë dobësi.

-Kam dashur gjithmonë që im atë të krenohej me mua, qoftë edhe ashtu siç u gëzua iriqi, kur vuri dorën mbi fëmijët e vet dhe vërejtë se dhe ata të shponin.

Kështu thoshte ajo për të pohuar një nga karakteristikat tona kombëtare: gjaknxehtësinë. Shkurt, nga kjo anë ajo që një shqiptare e thekur. Ndryshe ishte poeti. Durimi nga natyra dhe kujdesi nga dashuria, shtoj këtyre çastin e dhimbshëm për të atin e Julietës, e bënin atë francez dhe evropian, pa dyshim. Ky e kuptonte se, për shkak të trashëgimisë, gjaku i fizikanës ziente.

Ai u ngrit sërish në një tentim për ta zbutur inatin, por dështimi që edhe më fatkeq e disi fyes.

Francezja, pak më parë, kishte kapur gotën me ujë, që çuditërisht, ishte e mbushur dhe ia hodhi në gjoks, ndonëse e mati për në fytyrë.

Poeti mbeti si i shtangur ngaqë edhe s'e priste. Më pas, me buzë në gaz dhe me zellin e një çiraku, tha: -Shpresoj që ato vetullat e puqura të të jenë shpërndarë pas këtij dushi në vendin tënd të parapëlqyer.

Ajo u ngrit, disi e penduar, dhe nisi ta puthë në buzë. Zbriti, ëmbëlsisht, në gjoksin e lagur dhe i ngjante një pate që llokoçiste duke e shtyrë drejt krevatit. Kurse ai e paralajmëronte për t'ia zbrapsur të puthurat:

-Boll se po luan me barutin (nuk tha zjarrin dhe për këtë pati shumë kujdes). Në të vërtetë ai ishte i dyzuar. E largonte dhe interpretonte mënjanimin. Jo vetëm sepse qeshte me të, por edhe pse u përgjigjej puthjeve e duke i kaluar duart, herë mbi flokët, që i pëlqenin pa masë dhe herë mbi shpinën e saj e, si pa dashje, edhe në gjoks. Se ajo i kish hipur sipër, në pjesën e krahavorit dhe ai mezi priste përmbysjen e këtij raporti. Atëherë vinte radha e tij të bënte me gjoksin e saj, të njëjtën gjë. Prandaj përsëriste si refren:

-Boll se po luan me barutin! - dhe ndonëse shpuza e dashurisë e avulloi plotësisht ujin në gjoksin e tij, raporti gati u anasoll. Por jo. Në fillim ai e më pas edhe ajo, u ngritën. Nuk qe aspak e pranueshme për të dy të fillonin një seancë të re dashurie.

-Kështu përfundoi grindja jonë e parë, moj kryeneçja ime, - tha ai dhe nuk e la të përgjigjej. E kapi lehtë dhe ëmbëlsisht me të dyja duart duke e mikluar nga faqet për ta puthur, po kaq butë, pa harruar t'i ledhatojë flokët e supet e brishta. Ato nisën një dridhje, pas së cilës paralajmërohej një ngashërim. Këtë ai e parandjeu.

O Zot! Ajo po kalonte në një gjendje të re shpirtërore e për pasojë edhe kujdesi i tij duhej shtuar. Dashuria duhej të ecte në po ato shina edhe pse stacioni i këtij mallëngjimi quhej: dënësë. Jo. Nuk është vetëm seksi që i bashkon dy njerëz që duhen. Absolutisht. Janë zemrat, së pari, që japin e marrin me njëra-tjetrën për të drejtuar e detyruar tipin, karakterin dhe mençurinë e mashkullit për të kuptuar femrën. Veprimet e saj mund të ishin të rrëmujshme. A nuk erdhën me vrull edhe stadet e kësaj

dashurie? Po ato ishin logjike në tërësinë e tyre, po ashtu. Se po përballonte çastin më të dhimbshëm në jetën e saj: lajmin se babai, të cilin aq fort besonte se do ta takonte edhe pas tri dekadave, iu shua. Kaq mjaftonte për këdo të shpërthente me kujë. Po. Edhe pse ajo s'e kishte parë kurrë prindin e saj dhe e kishte përpunuar në mendje fotografinë e tij dhe tregimet e së ëmës. Se e përfytyronte përherë në lëvizje atë. Të shkonte në shkollë e ta merrte për dore, që së bashku të ktheheshin në shtëpi. Ta koloviste në atë shilarësin e vogël në verandë. Ta ndihmonte, më pas, në vitet e së mesmes, për zgjidhjen e ushtrimeve të matematikës, sepse... shpjegimet e së ëmës ishin në një nivel tejet të përparuar, për të cilat shkolla kishte vërejtje, pasi zvogëlonin veprimet dhe *'digjnin etapat'*.

Edhe kur sëmurej nga gripi, në fëmijëri, mjekja ishte shumë e mirë, por vajza do të përfytyronte babanë i cili tanimë kishte dalë doktor dhe me stetoskopin e tij i kontrollonte funksionimin e mushkërive... Oh! Po ç'them, o njerëz!? Mos vallë nuk lexohej dhimbja e saj? Nuk vërehej shpresëshuarja që solli zhgënjimi? Po revolta, kjo fqinjë rebele, që u shfaq aq butë vetëm me zbrazjen e një gote-uji dhe kaq? Sepse ishte në të drejtën e saj dhe të ulërinte, siç do të mund të bënte axhesha e atij lezhjanit: ku-ku! Për babanë tem, ku-ku!

Ç'duhej më tepër që poeti ta kuptonte se zemra që ai dashuronte po kalonte një krizë të fortë vuajtjeje e dhimbjeje? Prandaj dhe ai s'ngurroi ta mbulojë me ledhe, miklime e të puthura, në të gjithë fytyrën e saj të ndritur, si të kishte të bënte me një ikonë të madhështisë dhe donte diç të merrte nga rrezatimi i saj. Por edhe diç t'i jepte për ta qetësuar.

Dhe vërtet. Portreti i fizikanës që kthyer në një brerore dhe poeti patjetër që të puthurat do t'i përfundonte në qendrën e kësaj ikone: në buzë. Por tejet i vëmendshëm.

Në fillim fare lehtë, që ajo të kishte të drejtën ta prapësonte atë. Mbase jo me përbuzje, por gjithsesi mund të shmangej, gjë që s'ndodhi. Përkundrazi. Ngjau e kundërta. Ajo ndjeu dëshirën e partnerit dhe me gjuhën e saj kërkoi të tijën. Ky qe i gatshëm ta ndiqte këtë lojçakëri dhe u bind se ndodhej nën një aurolë, atë të Hënës, ku gjithçka fliste si të qe puthja e parë.

Kur u shkëput, francezja vendosi kryet në gjoksin e poetit. Sytë i kishte me lot. Ky i ledhatonte flokët e supet dhe ajo, përmes dënesave, tha:

-Oh, Pet! Dashuria që bëmë deri tani, mbeti shumë larg, krahasuar me këtë puthje mbështetjeje që më dhe. Faleminderit!

Poeti u prek, po ashtu: - Ç'thua, Julietë!

(Nuk tha Xhulio, që ta largonte disi nga ajo si do ta thërriste i ati, gjë që iu duk se edhe asaj i pëlqeu.) -Ti je zemra ime. Vuajtja jote është edhe e imja, gjithashtu.

Ndërkaq francezja mbështeti kryet mbi gjoksin e tij për të shpërthyer në dënesje të re. Djali e ndjeu atë çast se për të s'që më "**Princi i kaltër**". Po. Absolutisht, po. Diç tjetër ai duhet të ish. Ata lot tejkalonin kufijtë e logjikës në atë parzëm rinor. Ishe si një shpërthesë në kraharorin e babait të munguar. E, mbase edhe të përfytyruar. Nuk qe ritrupëzim. Aspak. Qe një tejbartje. Shkurt: na duhet të pranojmë se tek dy njerëz që duhen, në çaste të tejskajshme sinjalesh të dhimbshme, mund të ndodhë ajo që thuhet për tejndritshmërinë...

Prandaj fizikania, më në fund, resiti lotët nga sytë dhe tha:

-Qe si një shaka galaktike për nga papërsëritshmë-ria. Të dua, Pet! Të dua deri në përjetësi!

"O ti që dashuron Lejlanë!
Në Qiell ka vetëm një Zot... Në Tokë..."

Mund të themi se ishte 'djallëzore' ajo që bëri poeti. Zbriti bashkë me vajzën, i veshur me burnuzin e së ëmës dhe, sigurisht edhe parukën e saj. Por ai harroi që të mbathte edhe çorapet e llastikut. Kur u kujtua, tek zbriste shkallët, qe vonë. Kthimi do t'i bënte më shumë përshtypje, atij të 'postbllokut' ku duhej patjetër të kalonte. Këmbët, këto elemente, që edhe shejtani (dhe për këtë djallëzi e kishim fjalën aty më lart) kur donte të bëhej njeri, s'mund t'i drejtonte, edhe poeti që desh të shtirej si grua, s'e kishte në dorë t'u hiqte këmbëve leshin, po ende tepër të zi. E përbashkëta; si këmbët edhe tradhtia. Prandaj djallëzia e poetit-mama, qe e njollosur për të mos thënë e dështuar. Duhej bërë diçka. Thuhet se llumi lahet me llum, ashtu si gozhda nxirret me gozhdë. Lipsej përlyer 'banaku'.

Poeti, gati në panik, ia kapi dorën fizikanës dhe ia tërhoqi pas vetes me pëshpërimën: *borbuar*.

Vështrimi i tij, kryeulur, bëri që ajo ta kuptonte hallin, po ashtu ndonëse djersa që i lagu pëllëmbën vajzës e bënte më të lexueshme atë.

'Poeti-mama' vazhdonte të ecte si ndonjë damë e vërtetë dhe sillej si i tillë në rast se njeriu në banak ishte

‘mendje’ përpara se të qe ‘trup’, por... ai qe komplet trap. Ky ishte shkaku i moshapjes së gojës nga poeti. Të paktën të mos e tradhtonte zëri tejet mashkullor e bariton, sidoqoftë. Vajza, që e kishte marrë sinjalin, e ndiente se problemi ishte i të dyve. Zgjidhja qe e njërit. Pra vetëm e saj. Ajo iu afrua banakut fare e qetë. Po ende me një buzëqeshje, sa të shtirur aq edhe të singertë. Sepse për të shkelja s’qe kushedi se çfarë. Gjykim ky perëndimor i një bote e një shoqërie të lirë.

Kësisoj, siç e kanë zakon të gjitha gratë, pavarësisht krahut perëndim-lindje, kur hapin çantën, ose çantëzën e tualetit, si në rastin në fjalë, ku s’ishte kollaj të merrej vesh vendi i të hollave. Gërmimi për t’i gjetur ato e pastaj për t’i nxjerrë është arkeologji më vete. Aq më shumë nga një franceze e cila mund të konkurronte edhe një gjirokastrite. Në rastin tonë kjo bënte që nëpunësi i postbllokut të merrej kinse me regjistrat e tij për të mos pasur mendjen në ‘thesaret’ e turistes.

Kaq duhej, që poeti-mama, t’i largohej rrezikut të vështrimit nga syri i atij ruajtësi të “traut imagjinar”. Sepse zhveshjen e burnuzit ai nisi ta bëjë sapo vajza u ndal përpara banakut të çelësave dhe për ta detyruar nëpunësin e shërbimit të kthejë kryet gjetiu e të humbasë “vigjilencën”. Ai qe i vjetër në moshë dhe burrë tejet i nderuar dhe namusqar. Kësisoj poeti-mama i mbulonte edhe këmbët duke e mbajtur sa para prapa tyre atë mantel në ato pak, fare pak sekonda. Për më tepër se shkëlqimi i diellit futej i gjithi brenda nga ajo hapësirë e qelqtë e çelur tej e tej dhe poetit iu lëbyrën sytë. Një arsye më shumë kjo, që t’i ulej ai tension rrëqethës, sikur po dilte nga shpella e Polifemit.

Çadra e parafundit e priste atë si brerorja strategun. Por ai s’qe i tillë. Se nuk kthehej aty nga lufta edhe pse si në një betejë i duhej të kalonte atë ‘front’. Të tillë e

kishte bërë diktatura bujtinën e njerëzve që vinin nga perëndimi, domethënë nga liria.

Gjithsesi ai gjuhës ia kushtonte edhe këtë 'betejë' të fituar për lirinë, por edhe për dashurinë, në mënyrë të beftë e të menjëhershme.

Qe kthyer kështu në pikën ku u nis. Ajo tendë, në piskun e asaj vape, i dukej si një oaz.

Njerëzit përqark numëroheshin si me kokrra. Të nxirrte vetëm dorën jashtë tendës, poetit i dukej se do të humbiste ndonjë gisht nga ajo, prandaj duhej t'i numëronte kur ta fuste pëllëmbën në hije. Se digjnin njëlloj: si dielli edhe postblloku. Gjithsesi ai palosi atë mantel mbi shezlong, ku dielli i fortë e kishte përfshirë gjysmën e tij dhe i shëmbëllente japanxhës që veshin gratë e besimit katolik, vetëm se qe e bardhë e jo e kuqe.

Prandaj, me nxitim, i tërhoqi të dy këto 'mantele katolike' dhe atë çast ia mbërriti francezja e cila me humor i tha: -E di sa më kushtoi kalimi i kufirit pa pasaportë për ty?

Poeti ngriti supet.

-Dhjetë dollarë, - tha ajo, - se s'kisha të vogla.

Ai e falënderoi dhe qeshi: -Po të mendosh se në atë '*vijë kufiri*' varej lirimi im, pagesa e dhjetë dollarëve do ta zhvlerësonte së tepërmi personalitetin tim edhe pse e pranoj që jam skllavi yt, - dhe sërish vështroi hijeshinë e atyre dy gropëzave në faqe.

-Sepse nuk besoj që: në Marok apo Algjeri, me kaq para një damë apo zonjushë, siç edhe jeni ju, mund të lirojë nga thonjtë e piratëve qoftë edhe vetëm përkthyesin e saj me ngjyrë. Aq më pak një francez. Mos, o Zot, një franceze!

Ajo u bë serioze. Vendosi menjëherë shumësin: -Ç'thoni kështu? - por ai shtoi: - Zonjushë e dashur! Dua të them se keni paguar shumë. Se ju nuk e dini piacën

që në një rast të ngjashëm jeta e kujtdo që shkelte deri më sot kalimin e 'kufirit pa pasaportë' e paguante atë gjysmë leku.

-Që do të thotë?

-Me pushkatim.

-Mos e dhëntë Zoti!

Fizikania e kapi nga supet dhe e puthi lehtë. Ato çaste, megjithatë, ai seriozisht mendoi: "Kujt t'i ketë ngjarë në këtë dorështrënguarje? Mos ndofta të atit, origjina e të cilit ishte nga brigjet e Vjosës? Gjithsesi vetëm prejardhja, ama. Se bujarinë edhe ndjenjën e sakrificës unë ia njoha atij njeriu fisnik. Apo nënës? Zonjës Marsejezë? Koha që vërtet shterpë për diskutime të tilla beronje.

Për Marsejezën, me aq sa e kishte njohur poeti, qoftë nga ç'i kish treguar Luani, apo edhe nga ajo sa kish lexuar fletoren për të, tipin dhe karakterin e saj e përfytyronte si një ngrehinë të qetë, të cilën, që mëkat ta "qëlloje me gurë".

Prandaj poeti u kujtua ta rifalënderonte me vonesë Julietën për të ëmën dha t'ia kthejë të puthurën me një afsh, burimi i të cilit, kësaj here, s'kish së pari dashurinë, por mirënjohjen dhe mirëkuptimin... Kish ardhur çasti të shkëputeshin. Asnjëri nuk e donte, por të dy e kuptonin shkolisjen vetëm për pak: Një ose dy orë. Kohë, që mund të kthehej Marsejeza.

Poeti, duhej të hynte, së pari, në det, pastaj të nisej për në kabinën e tij. Por, fillimisht, fizikania duhet të shkonte në banak dhe të porosiste t'i sillnin nga bufeja ngjitur dy akullore me kupa qelqi. Gjë që mund ta bënte edhe vetë sportelisti dhe ajo ta priste në banak. Edhe sepse tashmë që zhveshur. Dhe funksionoi. Kur hotelieri plak u nis të plotësonte kërkesën, ajo u kthye me front nga tenda për t'i dhënë shenjën se që i lirë të përbishtej për në det larg syve vëzhgues të personelit në shërbim. Ai u

nis nxitimthi drejt bregut. Ecja e tij mbi rërën e zhuritur e bënte qesharak. Se një provë zjarrduruese po kalonte, në një ecje si 'trehapësh'.

Fizikania, ato çaste, si të ndiente ndezullimin e poetit se tani ata sikur kishin një shpirt të përbashkët, me të ardhur kupat me akulllore, mori një lugë dhe e futi menjëherë në gojë, ku ndjeu shijen freskuese dhe një lehtësim të brendshëm. Poeti, i zhytur tashmë në ujërat e detit, flladitej jo pak, gjithashtu. Ai tani, provonte përtëritjen në trup dhe në shpirt: **Ishte** i dashuruar.

Kishte trokitur, ashtu si me drojë portën e dashurisë dhe ajo i qe hapur dykanatëshe. *Kishte* gjetur shpirtin e tij binjak. Po ta pyesje ato çaste djalosin mbi krijimtarinë e tij poetike, do të pohonte se të gjitha vargjet e shkruara deri tani për të s'ishin veçse fluturime tejet rinore, apo vargëzime, ku në rastin më të mirë, spikaste mendimi dhe teknika e vargut, por i mungonte ndjenja e vërtetë. Pikërisht ajo që e bënte tani me krah. Të dilte nga uji e të shkonte pranë saj. Të kapeshin dorazi e të zhyteshin në shkumën e detit së bashku deri në shpërbërje e grimcëzim për t'u ngjitur në univers. Dhe të vazhdonte kjo gjatë e të mos reshte deri në rraskapitje si dy delfinë të vërtetë. Të shkonte në shkollë, ku jepte mësim e t'u fliste nxënësve për bukurinë e jetës, kur njeriu është i dashuruar. Se ata ishin në shkollën e mesme. Në moshën më të mirë, të pastër, të singertë... të...

Dhe ai e ndjeu se e kishte dehur dashuria dhe i tha vetes: "*Pije detin, Ksanth!*" Pije deri në pikën e fundit të tij...

Dukej se poeti qe i dalldisur nga dashuria. Dhe pak rëndësi kishte se ç'mendonte të bënte ai tash e mbrapa për të ardhmen. As se si do të ngrysej nata, me hënë apo jo. E, kurrresi do të gdhihej e nesërmja. Vlerë për të merrte vetëm e sotmja: poleni i një gruaje. Ardhja në

kabinën e tij e të dashurës Julieta për të marrë fletorëzën e të atit.

Dhe ai u nis drejt kthinës së tij.

Tenori do të deklamonte në atë zheg-vape:

-Në qiell ka vetëm një Zot. O ti që dashuron Lejlanë! Në tokë ka vetëm një dashuri, - dhe tundte kryet si të dinte hallin e poetit, të vetmit që ecte mbi rrë, ato çaste duke bërë kërcimet e trehapëshit.

Dashurinë tenori e barazonte me një zbritje nga qielli të një bekimi hyjnor. Ashtu qoftë. Amin.

Polen gruaje

Kësisoj me atë ndjenjë tronditëse për dashurinë ndaj francezes, u kthye në kabinë, ku heshtja absolute e gjumit të vapës që sundonte gjithë vargun e këtyre kuvlive pushuese, jo vetëm e grishte, por edhe e detyronte atë.

Poeti, ndryshe nga fizikania, që e dashuronte, si çdo femër vetëm me zemër, ai e vlerësonte si të zbritur nga Qiejt. Dhe s'gabohej aspak: Në krye të herës dashuroi Francën dhe gjuhën e saj si kult. Më pas, përparimi gjatë të mësuarit e ktheu në ideal. Dhe, sa më pranë i qasej kësaj drite, si mjegullnajë, aq më fort merrte formë e shquheshin konturet e një perëndeshe. Aq më shumë rritej edhe adhurimi për të si kult.

Kish gjetur, kështu dhe që zhytur i tëri në një rrjedhshmëri të re jetësore. Ky ndërkëmbim dhe kjo tjetërsueshmëri gjallimi i kish ndryshuar jo vetëm qëllimin në përdorshmërinë e saj, por edhe gjithë ngrehinën e tij shpirtërore, po ashtu. Hovëzimi në rritje nga dita në ditë, këtë burim kishte, natyrisht. Si ndriçimi, shkëlqimin e tij vazhdimisht shfaq.

Dhe kjo që plotësisht e njëmendtë me atë që s'i kujtohej se cili skulptor në lashtësi, me përfytyrim ngriti shtatoren e një femre të bukur, kur e përfundoi e kuptonte se që dashuruar aq fort pas saj sa gdhihej e ngrysej pa harruar, për një çast, t'i lutej Zotit ta bënte të

vërtetë atë. T'i jepte jetë. Dhe, siç e kemi cekur pak në krye të këtij libri, lutja e tij në fund bindi fuqiplothin dhe ajo statujë u shndërrua në një grua prej mishi e gjaku. Në këto ujëra notonte dhe poeti ynë.

Prandaj Zoti i zbriti në Adriatik një franceze, e cila plotësonte, me gjasë, tiparet e skalitura të idhullit të tij. Jo për të qeshur, jo dhe aq e rrallë si dhe jo edhe e pangjarë, ajo që ai, çdo mëngjes, kur hapte librin e gjuhës, në fillim me shaka e më pas me seriozitet të plotë, do të thoshte: - Hajde, e dashur! Më ndihmo të mësoj anatominë tënde. Si funksionojnë gjërat tek ti?

Ose: -Të pëlqen përkëdhelja që u bëj lakimeve të emrave? Po zgjedhimit të foljeve?

Apo: -Të lutem mos më shaj për intonimin? Se kjo që një nga gjërat bazë që pëlqejë tek ti, e dashur. Mos më tall në qoftë se për mua tingëllimi ishte shkaku që unë ktheva kryet për të parë sytë e tu. Që ky bukurzanor që më bëri të magjepsem në vështrimin tënd yllësor. E di, jam më se i ndërgjegjshëm se kur të kem mësuar të gjitha të fshehtat e lejueshme të tua, do të kem kuptuar se kam zbuluar një univers të ri. Ashtu siç jam i bindur se kjo ndërmarrje për mua nuk është aspak një aventurë sharlatanësh e bataçinësh, kur nxjerrin nga goja shprehje ngrehalucësh për të treguar "kulturë" që vetëm e tillë s'mund të jetë.

Për mua, e dashur, kjo nismë është mision. Nuk më beson? Për shpirt të dy prindërve që dhanë jetën në ngritjen e një shkolle. Pra, për kulturën. Për atë që kërkoj unë të marr nga ti.

Ky meditim e shoqëronte edhe atë ditë, tek ndiente të shihte përmbushjen e ëndrrës së tij.

Se mendonte e fliste vetëm frëngjisht.

Kësisoj, teksa po e kapiste gjumi, mbërriti të ndizte ajërftohësen, e cila freskonte të gjithë atë dhomëzë dhe zhurma e njëtrajtshme, që zakonisht kthehet në mërzi,

atë, përkundrazi, e nanuriste si të qe buzë një përroi.

Ishte ky, që do të shndërrohej dalëngadalë në shumësi rrëkesh e do të rridhte e guronte, duke kaluar vështirësi të ndryshme në kërlshjet me degë, shkurre, për t'u përfshirë në një lumë të rrjedhshëm, i cili do të përfundonte në një liqenth. Por edhe këtu u desh të futet në nëntokë për të dalë një pjesë e tij si burim.

Saktësisht, në fillim e pa veten si goja e mermertë, skalitur për atë burim, që shushurit ujin e freskët të filtruar nga shtresat e nëntruallit të atij rrëzë-mali si te kasollja e Luan Majlindit.

Uji ishte kristal dhe në vaskën e tij, goxha të madhe, dukeshin guaska si ato të detit.

Dhe poeti, që herë ishte gurra dhe herë njeriu, i cili qëmtonte thesaret e saj, i mbliidhte me përzgjedhje ato, që t'ia dhuronte të zbriturës nga Qiejt, Julietës. Por kjo paska ardhur edhe me dikë tjetër, që po i thoshte: *Bonzhu! Bonzhu, mësje!*

Ishte ende në gjumë, tek dëgjonte, së pari zërin e butë të Julietës e më pas të së ëmës, të cilën ende s'po e dallonte. Veçse ishte po ai zë, nga i cili i kishte mbetur ajo pakënaqësia e fillimit, ku brenda tij dhe pas bukurisë së frazës, fshihej, njëherazi, qortimi.

Gjithsesi, fjala *Bonzhu*: kësaj here, e dalë nga goja e kësaj zonje, tregonte fisnikëri e pse të mos e pranonte, edhe kujdes.

Kaq duhej që ai të zgjohej dhe të hidhej përpjetë. Gjithçka që kishte të bënte me pakënaqësinë qe zhdukur nga kujtesa, vetëm nga bukurtingëllimi i këtij zëri. Përgjithmonë.

Ai kishte një amanet për të dorëzuar. Dhe kjo mjaftonte për të. Se ia kishte premtuar Luanit. Ky, pas disa çastesh, me vagullinë e këtij portreti i kishte dhënë fund jetës së tij. Shpënia e amanetit në duart përkatëse,

do t'ia shtonte dritën në udhën e gjatë drejt pavdekësisë së Luanit dhe pamja e poetit, jo vetëm që do të nuratohej, por ajo do të vishej me koracën simbolike për mbajtjen e fjalës së dhënë.

Dhe rasti kish ardhur, ashtu, befasisht, siç di të vijë ai dhe i gjen të papërgatitur edhe njerëz që kanë 'pirë detin' dhe s'kapërdijnë dot një rrëke.

Dikush po trokiste, por atij i ngjante se kishte punë me një poçe për t'ia dorëzuar një vegështari. U ngrit ndenjor, me mëndje të fiksuara gjetiu: -Kam vetëm një poçe me margaritarë për ta dorëzuar, por asnjëra nga ju s'është e pajisur me kulluese.

Dukej që fliste nëpër gjumë dhe ndiqte tragjen e një ëndrrë. Lavdi Zotit, gjuha e folur ishte shqip. Po kush po trokiste në "portën" e hapur pas perdes-rrjetë e shtyrë tej?

Për komshinjtë e kabinave qenë vetëm dy zonja franceze. Atyre, që për çastin s'kishin qëlluar jashtë kabinave të tyre dhe s'ua kishte 'parë syri', ua kishte ndier hunda. Se rrobat e tyre kundërmonin aromë gruaje, të cilën e ndihmonte edhe një fllad i lehtë, si për ta bërë më joshëse dukurinë, a më përthithës polenin e zonjave.

Veç kësaj, vogëlushja e kthinës fqinjë të poetit, Marcela, s'reshhte së thirruri si në lojërat fëmijërore, syllambylla, me refrenin "mos hap, mos hap". Se ajo donte ta befasonte me të papriturën e ardhjes së këtyre tetave të huaja. Pyetja e tyre, me nojma dhe më pas, shqiptimi i fjalëve: **Ku është xhaxhi 'ekzakt'?**, bëri që vogëlushja, të kuptojë se çfarë kërkonin ato dhe vogëlushja, nën përkthesën mikluese 'mos hap'... t'i shpinte francezet në kabinën e tij.

Të huajat ishin një zonjë e një zonjushë.

Për lexuesin tonë, kuptohet se ishte zonja Marsejezë me të bijën, zonjushën e ëmbël, Julietë. Marsejeza kishte

veshur një fustan dekolte, bojëqielli me ca ngjyra, ose degëza të bardha, që nisin nga lart për t'u sfumuar poshtë. Në sup kishte hedhur një shportë si dantellë, në formë kove me ngjyrë kashte. Ndryshe ishte e bija, zonjusha Julietë. Ajo kish veshur një bluzë me ngjyrë të bardhë, me tirande, që i binte deri në kërthizë e cila mbetej zbuluar. Gjithashtu, një palë pantallona xhinse me thekë. Në sup kish hedhur dylbitë e vogla. Të dyja kishin mbathur pantofla. Zonja Marsejezë i kishte ortopedike, ngjyrë bezhë, ndërsa zonjusha Julietë, të sheshta, bojëqielli dhe me gisht. Julieta e kuptoi se truri i tij ende flinte, ashtu siç edhe ia rrokte mendja dhe për shkakun e ... '*rraskapitjes*'. Arsye kjo e qëndrueshme e tejet e kapshme edhe nga lexuesi ynë i vëmendshëm, prandaj u nda te kana me ujë, mbi trapez. Me buzëqeshjen e saj lojcake dhe nën vështrimin kureshtar të vogëlushes Marcelë, si për të provuar se '*heroi*' i saj kishte zgjedhur kohën më të papërshtatshme për të pushuar, njomi pëllëmbën dhe e lagu në fytyrë.

Vogëlushes i mbeti në gojë refreni '*mos hap*', dhe ia plasi gazit.

Poeti hapi sytë dhe dalloi 'mjeshtren e stërpikjes'.

-Prapë ti?! - tha sërish në shqip dhe u befasua që perdja ishte mënjanuar tërësisht, gjë që tregonte se "porta" ishte katërcipërisht e hapur.

Për të s'qe befasues vetëm fakti që francezja ia kish gjetur kthinën e tij modeste, vetëm me ato pak gjëra që ai vetë i kish shpjeguar për komshinjtë në të majtë e në të djathtë e, sidomos, për vogëlushen Marcelë, por ardhja e së ëmës e habiste dhe mrekullonte njëkohësisht. Ndaj u ngrit dhe, s'mbërriti të fliste frëngjisht e të përsëriste pyetjen mikluese: "prapë ti?", se dëgjoji vogëlushen që tha:

-Xhaxhi Ekzakt, këto tetat franceze trokitën te

parmakët e kabinës sonë dhe unë u dola përpara dhe i solla tek ti. Se edhe ato ta thoshin emrin “Xhaxhi Ekzakt”, megjithëse janë teta për vete.

Poeti si dhe të tjerët e pranishëm, qeshën.

Ai u shpjegoi të porsaardhurave me një kënaqësi dyfishe, se në njëfarë mënyre për këtë ‘mblesëri’, a ‘kumbari’ ishte vogëlushja Marcelë.

-Por unë, - nisi vajza me ton ankues, - nuk desha që ato të të lagnin se dhe babait tim nuk i pëlqen kjo gjë...

Poeti e përkëdheli Marcelën. Ai ishte me mbathje plazhi, që ngjasonin me pantallona të shkurtra. Kështu, përmes të qeshurave, doli në parakthinë dhe u përshëndet me to.

Marsejezës i zgjati dorën, ia mori të sajën dhe ia puthi. Me Julietën s’dinte ç’të bënte. Prandaj i zgjati edhe asaj dorën, por ajo, me një lëvizje lojcake, duke bërë një hap në drejtim të tij, e puthi lehtë në buzë, si të donte t’i thoshte tjetër gjë veç dashurisë. A, si t’i kujtonte se vetëm një orë kish kaluar nga ndarja e tyre dhe ajo ndiente mall. Po mamaja që pret me vite diçka nga burri i saj? “Ja ngutja që e solla atë.” Dhe poeti do ta kuptonte edhe me simbolet e veta. Po ta pyesje atë çast, ai do të thoshte: brimat në veshët e kësaj zonje kanë dekada të hapura. Ato presin të varen vëthët e ndritur, që ka jeta e kësajbotshme, apo kopsat e zeza të dëshpërimit në udhëtimin tek tjetra, e përtejma dhe e pakthyeshmja?

Prandaj, poeti, u hutua dhe më shumë sesa e gëzoi kjo puthje që vinte pas paralajmërimit të vogëlushes Marcela: “mos hap!”... ‘mos hap’, e shushati atë. Dhe pikërisht në këtë vjeggë u kap ai për të shkarkuar tensionin e rritur nga... një puthje. Kësisoj, kur poeti ua përktheu damave fjalët e miturakes, nuk harroi të thotë edhe emrin e saj: Marcela. Atëherë, Marsejeza e mori atë në duar dhe e puthi ëmbëlsisht. Pranë tavolinës

ishte vetëm një karrige. Komshiu, në krahun e majtë, e ngriti menjëherë sipër kangjellave ndarëse një ndenjësë dhe kur u përgatit edhe për të dytën, u treguan më të shpejta tri 'buallicat' për të afruar dy kashtoret e veta. Ky u prek nga gatishmëria e tyre e beftë dhe nga hutimi, tha në frëngjisht: *Mersi madmazelë!* - dhe kur e kuptoi, shtoi me sinqeritet: -Më falni, vajza, por gjesti juaj fisnik meritonte edhe një falënderim disi të veçantë. Gjithsesi, me shqipen, faleminderit, s'ka të krahasuar. - Ju jam shumë mirënjohës.

'Buallicat' nuk folën. Në vend të tyre ndërhyri tiranasja e kabinës ngjitur me to: -Far gjoje, or çun... Far gjoje!

Tri buallicat' qeshën me shpërthim. Tiranasja vazhdoi: -Vërej punën tina e sajdisi ato damat e Parisit. Se ajo e reja qenka si sapuni venus i kyçun në arkë e fort po të vika anës. Moma jote, vetëm në filma i ka pa e kaq afër, asiterë. Dhe, fale momën të ta them edhe një llaf, se dro s'më bi mo siraja.

Poeti e pa me vëmendje, por edhe i buzëqeshur. Ai e merrte me mend, pak a shumë se ku do të dilte ajo grua e pranueshme me dialektin e saj, deri në tepri, se ishte e sinqertë:

-Siç ia sheh syni momës, e siç ma do edhe zemra, se qenka si llokum, ajo e reja, fort po u tundka me ty. T'i paska ngul sytë e më duket se s'ka ardhë kot na si koti, me momën e vet, qi edhe kjo nuk po më duket kundra. Se e di si shkoni?! **Si fiku me arrën, a si arra me palën.**

Shpërthyen të qeshurat se në këtë 'pritje' s'ishin të pranishëm vetëm pushuesit e kthinave të afërta, por edhe ata të përtejmit.

Kurioziteti, tek ne shqiptarët përhapet mbase më shpejt dhe më gicilues se poleni i këtyre damave të Francës.

Poeti ndodhej në pozitën e furrxhiut. Përpara kishte zjarrin e oxhakut dhe prapa kureshtinë e njerëzve, që e prisnin si bukën qëndrimin e tij. Gjithsesi duhej ushqyer ajo:

-Këshilla jote, mom', ka fisnikërinë e flokut tuaj të argjendtë, mom'. Prandaj edhe syu juaj, më parë ka pikasur me..., parandjenjë atë që unë e quaj se i kam hyrë një pune nga e cila s'kam aspak ndër mend ta le në mes. Dhe ne do të shtonim: Kurrsesi të hiqte dorë.

Poeti, ndërkaq, shtoi: - Edhe diçka tjetër, mom': Syni juaj s'ka gabu. Se momë e bijë janë. Por puna me gocën pret për një orë të mirë e të gëzuar, pasi të kenë kalu sahatin e lig që ato mezi e presin të përballen.

-Mos ia dhëntë Zoti as hasmit, o çun! - tha e moshuara tiranase dhe, fill mbas saj, u dëgjua zëri i këngëtarit të dehur, që si të këndonte një copëz nga ariet e operave, ku ai kishte interpretuar, citoi fjalët e Hygoit, por me vokalisimo dhe frëngjisht:

"Turmë e madhe, njerëz të vegjël: hio-la-la.

Për të vazhduar më pas, si te "Figaro":

"Njerëz të ve-gjël, njerëz të ve-gjël, njerëz të ve-gjël, hio-la-la... hio-la-la, hio-la-la"

Qe heshtje, ose u bë e tillë nga zëri i tenorit dhe ndërsa të gjithë e menduan se ishte një nga ato këngët e tij të mallit për skenën e braktisur, damat e bashkë me to, poeti, kuptuan se ku drejtoheshin shigjetat e tij dhe vunë buzën në gaz, në pamundësi të shpërthenin ëmbëlsinë e mjaltit të këtij pickimi si nga bleta e jo nga grerëza, që vinte në të tërën si buqetë lulesh mbi tryezë.

Pas një pauze, tenori, nën melodinë e "Rigoletos" do të thoshte kësaj here në shqip:

-Shpër-ndahu-ni, o nje-rëz të mi-rë, shpër-ndahuni!

Përsëritja që i bënte fjalës 'shpërndahuni' gjithsesi e dha efektin e vet.

Të ardhurit nga kabinat e largëta, ose kalimtarët e rastit u spostuan në det e më kureshtarët, nën çadrat e braktisura në rërë.

Kurse komshinjtë, edhe këta të tërhequr në kabinat e tyre, por me një qetësi të plotë, si spektatorët në një dramë, me veshët e ngrehur, se kurioziteti e vapa kërkonin filladitje. Njëra me informacion e tjetra me ujë. Të dyja: freskinë. Ndërsa te zonja Marsejezë një hijezim linte të nëpërdukej merak plotësisht i lexueshëm që paralajmëronte lot. Se vështrimi flet edhe kur goja nuk hapet. Aq më pak gjuha e shndërruar në një copë dru. Kurrresi mendja përherë e ngritur në fiksim. Ky tjetërsim fliste mbi gjithçka edhe pse me fjalë s'thoshte asgjë.

-Më gëzon fakti, që e gjetët kthinën time modeste, 'Xhulio', - dhe poeti, kësaj here, ia ndërroi emrin Julietës, asaj që momës tiranase iu duk se 'fort po tundej'. Por ai kishte shkak, disi të largët në kohë: për t'i kujtuar, në njëfarë mënyre copëzën nga intimiteti i bisedave të tyre tri dekada më parë, midis prindërve të saj.

Përshtypja që e menjëhershme.

Marsejezës iu drodh buza e iu njomën sytë. Që kontakti i parë ky, me një njeri, i cili të bindte se ishte takuar me Luanin, burrin e saj. Ndërsa, vetë Xhulio, e kishte kaluar këtë çast tejet të trishtë. Poeti, për ta zbutur ca pikëllimin, shpotiti:

-Zonjë! Më vjen mirë që erdhët, por më çudit kthimi juaj i beftë nga Kalaja e Krujës. Mos ndofta ju dolën përpara turqit, që s'dinin nga shkonin se i ndiqte nga pas Skënderbeu?

Qëllimit iu mbërrit. Marsejeza fshiu lotët me cepin e shamisë dhe buzëqeshi.

-Në të vërtetë, diçka e tillë ndodhi. Por ata s'i ndiqte Skënderbeu dhe as ishin turq. Të rinj shqiptarë, që ndesheshin me forcat e rendit, se nuk lejoheshin të

kalonin atë pikë si qytezë, që më duhej se quhej 'Varri'.

-Ju kuptova, zonjë. Jeni sprapsur në vendin e quajtur "Vorë", - tha poeti. Dhe buzëqeshi pak, se kjo franceze pohonte në këtë 'lapsus', një të vërtetë të pamohueshme. I gjithë vendi që kthyer në një gropë të madhe për këdo. Por sidomos për të rinjtë, që bërë fare e padurueshme: Ferr... ose varr!

Ky duhej të ishte shkaku, që gjysmat e kabinave qenë boshatisur. Po, ende, dikush, nga ngutja s'kishte denjuar të shkonte as për të marrë paret e çelësit. Kish mbyllur portën dhe e kish flakur kyçin në rërë.

Qenë, me sa duket, orët e para të "revoltës së madhe". Sidoqoftë, poetit i pëlqente që bisedën ta bënte në një rrafsh sa më personal, gjithsesi.

-Kabinën si e gjetët? - iu drejtua Xhulios, jo gjithaq nga kërshtëria, sesa për të shmangur rrjedhën.

-Të ndoqa me dylbi sa u ktheve nga deti. Por më vlejti edhe përshkrimi që më kishe bërë. Sidomos komshija e vogël, Marcela, që të thoshte "Xhaxhi ekzakt".

Poetin e befaso i gjitha kjo, por sidomos ndjekja me dylbi. Ai ngriti baluket, siç bënte zakonisht, kur donte të tërhiqte vëmendjen e tjetrit, tek ato, që të mos shihte vetullat e tij të ndera përpjetë nga befasimi dhe habia. Por që i vonuar. Se ajo e kapi këtë gjest si gjuetari dhelprën e cila bën kinse fle, por bishtin e ka mbi kotecin e pulave.

Rolin e dhelprës ai s'e luante dot. Prandaj buzëqeshi kur i shkoi nëpër mend ky krahasim.

Ndërkaq Xhulio iu drejtua Marcelës, që ishte ende në prehrin e zonjës Marsejezë. Ia bëri me nojma, ashti siç edhe pak më parë, e kish pyetur duke thënë në shqip: Ku është 'xhaxhi ekzakti'?

Vogëlushja bëri me gisht nga poeti. 'Ky', - tha.

-Dhe ju u mrekulluat nga shpejtësia me të cilën gjetët kthinën?

-Natyrisht, - pohoi Marsejeza.

-Gëzimi është i juaji, zonjë. Dhurata është për vogëlushen Marcela, - tha poeti, ndonëse s'qe e domosdoshme se në çast zonjusha Xhulio kish nxjerrë, nga një çantëzë me thekë, një goxha çokollatë për vogëlushen.

Miturakja ngurroi për një çast.

Xhulio këmbënguli:

-Thuaji të mos e kthejë se unë e kam marrë enkas nga frigoriferi përpara se të niseshim dhe është e freskët.

Por Marcela e donte nga dora e xhaxhi ekzaktit dhe këtë e shprehte me një vështrim të veçantë të ky që, më në fund e kuptoi se i pëlqente ajo. Se ata që duhen gjithmonë kanë një gjuhë të përbashkët edhe pa folur. Dhe s'u gabua. Poeti mori çokollatën nga dora e Xhulio-Julietës dhe, pa shumë katikule ia dha vajzës, e cila e pranoi me kënaqësi pa harruar ta falënderojë tetën franceze. Në çastin që zbriti nga prehri i zonjës Marsejezë, Xhulio e ndali. Ajo hoqi nga supi dylbitë dhe ia vendosi në sup miturakes:

-Kjo është dhurata ime për të, - tha e drejtuar nga poeti.

-Oh! Ju lutem, zonjushë, - ishte mamaja e saj që foli nga tavolina matanë ndarjes. - Kjo qe e tepërt, na bëtë borxhli me të.

Kur poeti i përktheu fjalët "na bëtë borxhli", Xhulio-Julieta, u përgjigj:

-Zonjë! Nuk i kam dhënë vajzës suaj një jastëk, që gjumi mbi tuajin t'u iki nga sytë *natën*. I kam falur një mjet që të kënaqeni familjarisht me shikimin e largët, *ditën*.

Pas kësaj u duk e përfunduar biseda dhe Marcela e vogël kaloi 'gardhin' për te të vetët.

Xhulio-Julieta vazhdoi:

-Na kanë thënë që nesër është mirë të largohemi se priten trazira, sidomos në këtë vend, në plazh.

Poeti u gëzua, por edhe u trondit njëkohësisht.

Ai u kënaq se trazirat gjithmonë bëheshin kundër qeverisë. Pra, tek ne në Diktaturë ato ngazëllenin këdo. Por njerëzit mund të mos e kuptonin se ç'qe në gjendje të bënte ajo tani që ndiente se toka po i dridhej nën këmbë. Grahmat e fundit, s'është lehtë të mbahen nën fre. Dhe përplasja me revoltuesit sjell vetëm viktime: gjak e lot.

Gjithsesi, ai duhet ta kishte nuhatur, që kur mori vesh faktin se në Vorë, mjeti i Albaturizmit, nisur nga Tirana për në Krujë, u drejtua për në plazh. Pengesa në Vorë duhej të lexohej si postbllok mësymjes së Tiranës dhe qyteteve nga Veriu i vendit drejt... detit. Që do të thoshte, as më pak e as më shumë, por mësymjes së turmave drejt anijeve. Pritej pushtimi i tyre.

Kishim dëgjuar për zaptime fortesash, kalash, kodrash, qytetesh e, madje edhe shtetesh. Por këto bëheshin me armë, avionë, tanke e, mbi të gjitha, me ushtarë të stërvitur e plane strategësh ushtarakë. Por, pushtim anijesh, jo. Rrëmbim edhe na kishin kapur veshët, të bëra nga piratë. Një veçanti e tillë si shumë gjëra në diktaturë, nga barcaleta nën zë, qenë kthyer në komedi, qe rezervuar edhe kjo e largimeve biblike siç do të hynin në analet e historisë.

Largim! Po nga kush? Nga vendi. Pse, mos kishte rënë mortaja dhe njerëzit braktisnin gjithçka vetëm të iknin? Jo. As mortaja e as kolera, por ende as epidemi e këtyre natyrave që në mesjetë kanë bërë kërdrinë, s'kishin rënë. E, megjithatë po viheshin postblloqe për të penguar pushtimin e anijeve. Mjetit të braktisjeve të vendit. Pikërisht kjo e tronditi poetin. Një gjë e tillë mund të qe me pasoja. Anija konsiderohej kufi dhe hipja në të ruhej me një ushtar, a policë të armatosur. Shkelja

e këtij kufiri' pa pasaportë mund të mos zbatohej me masë disiplinore, siç edhe dëgjoi poeti se kish vendosur diktatura. Por a do të përmbushej vërtet kjo pikë, apo do të derdhej gjaku lumë si në sheshin Tienanmen?

O, Zot! Po përgatitej katastrofa e cila në mos do të ndodhte në stere, patjetër që do të zhvillohej në det të hapur se nga të gjitha çmenduritë, kolektivja është më e paparashikuara.

Grahmat e fundit të diktaturës dhe çmenduria kolektive qenë ulur në anë të kundërta të balancës. Dhe do të fitonte ai që kishte moralin më të lartë. Për këtë bënte fjalë edhe anekdota e fundit e nxjerrë në Shkodër:

-Po ndiej erë të keqe, - pyet lezhjani-shkodranin.

-Është era e randë e puplave të *shqiponjës**, që ashtë kthye në sorrë, se iu hoq e drejta me hangër krye njerëzish dhe guen këрма, -përgjigjet shkodrani...

Le t'i kthehemi tregimit tonë: Poeti kishte trokitur në portën e dashurisë, disi me druajtje, por lehtëshëm dhe po kaq kollaj e kish përqafuar atë. Dhe ja tani i thuhej se do të ndaheshin.

Pse kaq e lehtë është, o mik-xhani? - do t'i thoshte poetit një koleg që jepte matematikë dhe që i '*rekomandohej nga partia*' të hiqte dorë nga ajo, për shkak të 'luftës së klasave', vitin e shkuar.

Dhe ja në pozicion aspak të pëlqyeshëm ndodhej poeti. Ai kish bërë dashuri vërtet me 'një krijesë Qiellore', siç edhe e quante. Por ajo me praktikizmin e zhdërvjelltësinë e saj i qe dukur më se e kësajbotshme. Po ende sikur e kishte shtëpinë diku te zona mbi 'Vollgën' e hershme e tejet të pëlqyer. Mbase pikërisht për këtë, horizonti i saj qe tejet i pranueshëm. Dashur padashur qe futur në hollësi, që për momentin e bënin të parehatshme mendësinë, por

* Shqiponja - kështu i quante diktatura punonjësit e sigurimit.

edhe të padobishme e, madje të bezdisshme atë. Nga ana tjetër, ardhja me ngut e zonjës Marsejezë i përjashtonte arsyetime të tilla, si dallga-leshterikun e detit gjatë natës. Se tjetër valë pritej.

Dhe ajo i trembej së tepërmi ndonjë tallazi. Kjo qetësi e shpërfillje nga pushuesit, ndaj asaj që ajo mendonte se që në prag, ishte e frikshme për të, për të mos thënë e panikoste atë.

Dhe kishte të drejtë. Nuk donte të përjetonte tjetër brengë. Aq më pak për vajzën.

Zonja Marsejezë kishte pritur plot tri dekada dhe nuk është se malli shkoi tek ajo e ta shuante, edhe pse u dogj për të. Kuptohet: Jo për faj të saj, as edhe të partnerit. Tani që iu dha mundësia kish ardhur ajo te malli.

Dhe priste nga burri i saj, me etje në shpirt edhe pse sapo binte në kontakt me diçka të tij a për të, buza i niste atë dridhjen që trupi e zemra ndienin para se veshi të dëgjonte lajmin e hidhur.

Kish ardhur në Shqipëri pa ndonjë ftesë. Thjesht si turiste. Me qëllimin më të natyrshëm. Të dinte për fatin e burrit të saj për të cilin besonte se tri dekada më parë e kishin futur në burg, pa asnjë faj. Vetëm se kishte dashuruar një të huaj. Kaq. Asgjë më shumë. Një pakuptueshmëri që zhvlerësonte çdo marrëzi dhe turpëronte inkuizicionin mesjetar.

Zonja Marsejezë kishte marrë me vete edhe vajzën e saj, frytin e dashurisë së tyre. Dhe, me të drejtën e fëmijës, ndonëse të rritur, të takojë të atin e saj.

Shpresa se në Krujë do të haste dajën e të shoqit, sikur të që nisur me karrocë mesjetare, ra në kalldrëme si potkonjtë e kuajve dhe ajo u kthye mbrapsht, me vendosmërinë e gruas, që kërkon jo vetëm burrin, por edhe babanë e krijesës së tyre nga një dashuri e pastër.

Vitet e dekadat, jo vetëm s'e kishin zbehur, por përkundrazi e kishin rritur ndriçueshmërinë nga nxehja e madhe. Pikërisht kësaj i trembej e, mbase kjo mund të sillte atë që edhe u ndodh llambave të tilla: djegien dhe shuarjen e shpresës. Në prag të saj ajo qe. Poeti, natyrisht, i kuptonte këto shtigje e zgafella të shpirtit të një gruaje. Po, ende edhe se qe në të drejtën e saj të merrte 'pusullën' nga këmbët e pëllumbit, ku e kishte vënë dora e burrit të saj. Dhe... dëshira që ta shihte e ta lexonte sa më parë atë rritej tek ajo si drita në tunel, kur i afrohem i pishtarit tek i cili jemi drejtuar. Po ta pyesje zonjën Marsejezë se ç'gjë karakteristike kishte si edhe atëherë, kur në ato vite të gjimnazit ra në dashuri për herë të parë me Luanin, ajo do të thoshte: Parfumin që hidhte në fundjavë, marka e të cilit ishte monopoli i ungjit të saj në Paris dhe që shqiptari ynë aq shumë joshej prej saj. Se e ndiente si lulja pjalmin.

Poeti u ngrit dhe shkoi brenda kabinës për të marrë fletoren e Luanit. Era e trëndelinës mund të mos dilte mbi aromën e damave franceze, gjithsesi ndihej si për të treguar ekzistencën e saj. Zonjën Marsejezë edhe kjo aromë e mallëngjeu, disi. Poeti solli fletoren edhe ia dha në dorë zonjës, të cilën nuk e la të ngrihej në këmbë, me gjithë orvatjen e saj se e dinte: ballafaqimi me këtë porosi i kalonte caqet e një amaneti dhe ai druhej se në mos do t'i binte të fikët, patjetër do t'i merreshin mendtë nga trazimi i beftë. Po ende kishte edhe një tjetër shkak. Pas hapjes së kapakut, poeti kishte vënë fletën e zverdhur nga koha prej dy dekadash, mbajtur në ruajtje nga radiologu, komandanti i skuadrës së fëmijërisë së hershme të Luanit: 'Thokët e mi, kthu-kthu-kthu'. Dhe dekadën e fundit qe kujdesur për të si për sytë e ballit, Luani, e pas tij, poeti. Ishte ajo fletë e shkëputur, që në ato kohë, Marsejeza, ende adoleshente, e kishte mbushur

gjithë faqen me emrin e njeriut që kishte në bankën e saj dhe se për të kish filluar t'i rrihte zemra për herë të parë, ndryshe.

Zonja Marsejezë e hapi kapakun e fletores, jo si Pandora në mitologjinë greke e dërguar nga Zeusi, si ndëshkim për krimin e Prometeut që u vodhi zjarrin Perëndive. Aspak. Vërtet, zonja Marsejezë mund të qe e para grua mbërritur në këtë tokën tonë të veçantë, të drobitur e bërë mosmëkeq, o Zot, nga një diktaturë e pashembullt, por ajo s'do të qe as e para e as e fundit. Kurrresi e vetme. Jo. Se qindra gra do të ndiqnin rrugën e saj. Aspak të dërguara nga Zeusi në qiell. Por nga diçka krejt tokësore që kishin të përbashkët mbrojtjen e dashurisë. Kësaj ndjenje, që zbret vërtet nga yjet dhe zë vend në zemrat tona. Por a kishte diçka të përbashkët me Pandorën, zonja Marsejezë? Po. Hapjen e kutisë dhe daljen nga ajo të të gjitha të këqijave. Me një ndryshim tepër thelbësor.

Te Pandora ato do ta ligështonin njerëzimin. Te zonja Marsejezë do ta lehtësonin atë. Se bëmat, sido që të pandodhura e të pashembullta gjetiu, i përkisnin tashmë së shkuarës dhe i thërrisnin kujtesës për mos-harrim e syçeltësinë tejet shpërfillëse e të munguar nga populli ynë, si një kampanë e dëshpëruar për veshë të shurdhër.

Por le t'i kthehemi tregimit tonë.

Zonja Marsejezë e hapi kapakun e fletores dhe në faqen e parë njohu fletëzën me shkrimin e saj, me një bukurshkrim tejet lakmues: *Luan Majlindi, Luan Majlindi, Luan Majlindi*.

Iu drodh jo vetëm buza, por gjithë trupi njëherësh. Nuk i ra të fikët se e përballoi prishjen e baraspeshës që sjell rëndom befasia. Por nuk mund të bënte të njëjtën gjë edhe me vrullin e lotëve, që po i zinin grykën dhe i mbushën sytë.

Prandaj hoqi syzet për t'i fshirë me shami dhe mënjanoi, disi, fletoren të mos e spërkaste atë me margaritarët e lotëve. Kur u sigurua, i hodhi sërish vështrimin fletës, si nën një tjetër shkëlqim dhe provoi një ndjenjë të shumëfishtë. Diç e ngjashme me burimet që, për arsye nga më të ndryshmet janë shtuposur dhe befaz zhvulosen.

Uji ka ndryshuar drejtim dhe papritur i hiqet taposja. Pas kësaj shpërthen me vrull.

Edhe brenga, kjo vuajtje e rëndë shpirtërore është rrokullisur, brenda saj, si një shtjellë që gërryen vetveten, më keq se dëshira për ushqim e një barku që brehet nga uria e të pangrënit. Trishtimi ka përhapur, gjithkund, hidhësinë e tij. Megjithatë koha, dashur padashur, e ka taposur atë. Por është diçka që nis me të kundërtën e ortekut. Pikëllimi nuk zmadhohet në rrungajën e tij si orteku. Përkundrazi: zvogëlohet. Ai shndërrohet diku në merak e gjetiu në peng. Por nuk çudit aspak kërkënd, që rikthimi t'i ngjajë ortekut. Marsejeza, kjo zonjë tejet dinjitoze, vuante pikërisht këtë.

Pas saj zonjusha Xhulio-Lulietë, me lot në sy, gjithashtu, e kthen fletën për të shfletuar të mezipriturin, ditarin. Ja si niste ai:

"E dashur Marsejezë!

Fletoresjellësi më ka takuar mua përpara se t'i jap fund jetës sime të trishtë e plot vuajtje.

Besoji atij, se cilido qoftë, unë i kam shpëtuar jetën dhe veç kësaj ai do ta mbante amanetin se mua s'më gabon lehtë mendja.

Të kam dashur, o drita e kohës sime më të bukur!

Si në ditën e parë dhe të fundit të jetës sime!

Si atëherë që dora jote shkruante emrin tim dhe të dyve na kalamendte rezultati i iksit.

Të qeshurat tona do të kujtohen këtë çast, që ti po njihesh me përfundimin dhe do ta errësojnë vështrimin. Por jepma fjalën se do të mbahesh fort, që unë të preh i qetë eshtrat e mia. Se trupin do t'ia dorëzoj, me vullnetin tim, flakëve.

Ka shumë rrugë për ta lënë këtë botë të padrejtë. Unë zgjodha më të rëndën. Se të tillë e kisha edhe jetën. Nuk mund të prisja në jatakun tim metastazat e përbindëshit në mushkëri.

Në qiell do të jem i barabartë me të tjerët. Edhe me inkuizitorët e mi. Shën Pjetri le ta bëjë ndarjen: Parajsë apo Ferr.

Ma dëgjon zërin?

Është i plakur e fryma po më zihet, por sytë e mendjes janë të përqendruar vetëm mbi portretin tënd. O ikonë e dashurisë sime fatkeqe!

Të kam dashur si yllin që ndriçoi vitet e pakta të jetës sonë të përbashkët rinore.

Të kam dashur, kur netëve në llozhën e shtëpisë, pranë bulevardit të shkrimtarit Aragon, aty në katin e gjashtë, prisje ardhjen time dhe, kur unë hyja brenda, diç do të mbodhiste që njëri nga ne të pengohet. Ose mua në shtrojsen e këpucëve në prag, ose ty në portmandonë që do ta tundje me zhurmë, pas së cilës do të plasnin të qeshurat:

Babai yt do të shfaqej në korridor. Ai do të ndukte cepin e mustaqes së majtë dhe do të ngrinte edhe vetullën e djathtë përtpjetë kur të përsëriste refrenin e tij të pëlqyer:

-Moj grua! Të ka ngjarë ty vajza, apo më shëmbëllen mua shoku i saj?

-Është dashuri, or burrë. Apo harrove sa herë e ke përplasar ti kokën te porta përpara se ti bije ziles nga ngutja dhe s'e shihje fare goxha shtrojse në prag, kur vije tek unë.

-Po, moj, po. Si mund ta shuaj nga kujtesa sa herë të është djegur gjella në zjarr ngaqë e kishe mendjen tek unë?

-Uuu! Pika! Unë... Mua sa më kanë parë sytë...

Dhe niste një dialog që ne na bënte të shkriheshim..

Unë edhe shfajësohesha. Atëherë hëna matej të dilte dhe te unë niste një rihutim. Ngaqë të shihja ty.

Pamja jote tregonte një vëzhgim në kupën e qiellit. Shkonte lart e zbriste poshtë, si xhelozia që hynte në llozhë e fliste në përfytyrimin tim, me zërin tënd që thoshte:

-Moj hënë bukuroshe! Do të dalësh apo të dal? Nuk sheh? Ka ardhur Luani. Bëji dritë!

Dhe dilje si hënë e plotë. E ndritur. Të betohem për Vjosën time, malli për të cilën më djeg sa edhe dashuria për ty ngaqë jam i internuar dhe e kam më larg se Parisin.

Ndriçoje hapësirën tonë, tek luanim me yjet dhe na befasonin meteorët. Na trembte shkarja apo dhe shkëputja e tyre. Ndiqnim kultin tonë: atë të 'pamjes së largët'.

Ndodhte që ëndërronim edhe symbyllur. Bashkërisht, por edhe veç e veç. Dhe qëllonte që na zinte gjumi në prehrin e njëri-tjetrit.

Ndonëse isha prej gjashtë vitesh në Paris dhe shëtitjet tona, dendur qenë buzë Senës, ëndrrat e mia, gjithmonë e vazhdimisht, nuk largoheshin nga Vjosa e fëmijërisë sime. Skuadra e emërtuar: "Thokët e mi. Kthu-kthu-kthu" të kishte bërë pjesëtare edhe ty...

Po, o ironi e fatit!

Një ditë të zymtë më shkëputën nga Ti.

Po të më thoshin se shtatë qiejt e galaktikës sonë do të ndaheshin, se kështu qe dëshira e Zeusit, edhe mund ta besoja. Por se do të më shqisnin nga ti, kurrën e kurrës. Aq më tepër se do të më akuzonin për tradhti ndaj Atdheut.

O kohë, o moral!

Dhe isha vetëm njëzet e dy vjeç për të marrë një dënim shkuar marrëzisë: njëzet e dy vjet burg. Për një krim edhe më absurd: të dashurova Ty...

Atë ditë, e dashur, m'u zbardhën plotësisht flokët dhe, tani që po shkruaj këto radhë, mjekra ime sikur është futur në garë me argjendin e tyre.

Të dashurova ty dhe fitova lirinë e shpirtit, për të cilën jo vetëm se nuk ndiej pendesë, por do ta bëja sërish edhe sikur të kisha një jetë tjetër të lirë e të shëndetshme.

Zhëtem, Marsejezë!

Zhëtem, Xhulio që s'të njoha dot, por që të adhurova që në embrion. Qofsh djalë apo vajzë. Zhëtem!

Adio!"

Nënë e bijë u përlotën dhe pasoi një heshtje mortu. Që zgjidhur kështu e fshehta: rron apo s'rron? Çdo dyshim e mëdyshje që bërë fir si bubullima kur davarit retë dhe i shndërron ato në shi. Aspak për rastësi, tamam atë çast babai i vogëlushes Marcelë që ishte shkëputur bashkë me të birin dymbëdhjetëvjeçar, u kthye nga turizmi. Në dorë mbanin, secili, nga një tabaka. Njëri kishte shtatë kupa me akullore frutash. Në tabakanë e tjetrit po aq edhe gota me ujë në akull. Damat mënjantuan fletoren dhe aty u vendosën tri akullore dhe tri gota ujë. Pa shumë ceremonira komshiu ua vuri përpara dhe tha: -Mikeshat e tua, miku ynë, janë edhe tonat. Këto dama të huaja na i kanë zbukuruar kabinat me ardhjen e tyre. Sa për të qerasmen është detyra jonë, ashtu siç është e jotja t'i mbash në ... kuvend.

Poeti, thjesht e falënderoi. Veprimi i komshiut që shumë fisnik. Sjellja e tij freskonte po aq sa edhe fjala dhe e linte, ku e ku, gostitjen. Se qerasja ishte gjëja më e domosdoshme dhe në kohën e duhur. Po ende këtë nuk mund ta bënte tjetërkush. Se ishte favor të të shërbehej nga një lokal i cili punonte vetëm për të huajt. Fqinji i poetit, kuptohet, kishte lidhje-pune me turizmin. Gjithsesi, përpara se të freskoheshin damat, poeti mendoi se nuk do t'i rëndonte më tepër ato. Përkundrazi, do t'i flladiste po t'u sillte një 'relikt' të së shkuarës.

Ndaj u ngrit e shkoi në kabinë për t'u kthyer me

beretën e hershme të zonjës Marsejezë.

Kishte të drejtë. Ajo kapele, thjesht tip marinari, i sillte një kujtim të dyfishtë: adoleshencën e saj dhe ndërmendjen e të atit i cili nuk jetonte më. Se atë send e kishte dhuratë të tij dhe se ndiente kënaqësi që u gjet.

Për poetin ky qe amaneti i fundit dhe dorëzimi i saj e shpengonte atë nga çdo detyrim tjetër 'moral'. Prandaj ai i grishi damat të freskonin dhimbjen e sidomos mallin për të shkuarën që i digjte edhe pse qe i bindur se një akulllore mund të shuante sëmbimin sa forca e një qiriri për të ndriçuar një tunel.

Nuk vonoi dhe 'moma e Tironës' afroi një tabaka me kafe, era e pjekjes në qebap e së cilës e kish pushtuar hapësirën e kabinave, por askush s'e kishte mendjen ta nuhaste atë. Aq më pak të shihnin se 'buallicat' ishin vënë në radhë, kush e kush t'ia bluante sa më shpejt kokrrat e kafesë. Se s'qe e domosdoshme të dije frëngjisht që të kuptoje se damat e Francës po ballafaqoheshin me lajmin e humbjes së njeriut të tyre. Ashtu siç nuk qe aspak rastësor solidariteti për to. Kumti i hidhur për këto zonja të Parisit kish rënë pranë pragut të tyre. Kaq mjaftoi që ato të shpërvishen dhe të tregojnë botën e tyre të brendshme po kaq të madhe sa edhe gjerësia e kurmit të tyre.

Trupi i atyre 'buallicave' të gjithëve iu duk mjaft sensual e ... tejet joshës, pas kësaj.

Shkëputja e parë

Me dritën e një qiriu si dhe me kurajën e një frëngjishtfolësi, poeti ishte ndër të parët që pati hyrë në ambasadë, të sigurate një vizë udhëtimi për në Paris. Natyrisht, një rol të rëndësishëm për këtë patën edhe dy francezet: zonja Marsejezë dhe zonjusha e ëmbël Julietë.

Të tre, para se të niseshin për në Paris, do të udhëtonin me një taksi deri në Pllajën Bergo. Ku do të vendosnin një orkide mbi varrin e Luan Majlindit. Saktësisht tri të tilla, nga një secili, me premtimin se do të ktheheshin sërish në mars, kur edhe mbusheshin pesë vjet nga dita e largimit të tij nga kjo botë...

Shkëputja e dytë

Dhe marsi erdhi.

Zonja Marsejezë vinte të shihte në këtë përvjetor edhe një herë vendin ku preheshin eshtrat e burrit të saj. Zonjusha Julietë, të babait të saj, të cilin nuk e njohu dot. Kurse poeti, të shpëtimtarit e mikut të tij, bujar e fisnik. Të tre e dinin se ai i priste. Prandaj dhe erdhën në Shqipëri tri ditë përpara. Çifti i ri: Julieta dhe poeti, kishin shkuar menjëherë në “Hotel Adriatik”, te plazhi i Durrësit. Madje kishin zënë dhomën 105, ashtu si gjashtë a shtatë muaj më parë. Zonja Marsejezë këto ditë kishte ndenjur në “Hotel Dajti” në Tiranë. Asaj i pëlqente të shpërmallej me ato çka sillte ndër mend në tregimet e Luanit mbi këtë qytet të cilin ai e adhuronte. Brenga, sido që tejet e lehtësuar, sërish i rëndonte si një gur të cilin kudo që të shkonte, do ta merrte përherë me vete. Në Tiranë ndjesinë e kishte të ndryshme: herë i ngjante se i shtoej dhe herë e humbiste rëndesën e saj.

Tjetërsoj ishin Julieta dhe Poeti.

Takimin e parë dhe kryesorin e bënë në plazh dhe aty kujtonin batutat fillestare. Stadet nëpër të cilat kish kaluar njohja e tyre. Ajo më shumë ngjante me vetëtimat për një dashuri me vështirësi të parë. Shpërgjumjen e poetit dhe hovëzimin e Julietës. Drithërimat e tyre. Edhe plazhi nuk ishte i shkretë siç kujtonin ata se do

ta gjenin. Përkundrazi. Shumë të rinj e të reja, grupe-grupe, gjezdisnin në rrëzë si të qe korrik. Veçse me një ndryshim të madh: se jo vetëm që s'ishin të zhveshur, por të mbështjellë dhe mbi shpinë mbanin çanta apo qese hedhur krahëve. Përgatitjen e tyre për udhë e tregonte edhe mobilizimi i policisë me shkopinj gome, që bënte përpjekje të dëshpëruara për të shpërndarë turmat. Se e dinin, këto grumbullime i shtynte një shpresë për t'u larguar nga një jetë nën shtypje e diktaturë. Nuk ishin banda keqbërësish. Jo. Julieta i ndiqte të gjitha këto zhvillime nga lozha me një palë dylbi teatri dhe i copëtohej zemra, kur shihte se në atë mori njerëzish kishte sa burra, po aq edhe gra. Po ende fare të reja e me fëmijë-gjiri në gjoks. Një *eksod* rrëqethës. Egërsia policore s'i kursente as ato. Veçse kjo do të zemëronte keqas turmën, forca e së cilës qe e papërmbajtur. Shkopinj të gomës ranë në duart e saj dhe njerëzit e diktaturës u thyen për të ardhur keq. "Mushkonjat" e shtypjes po batonin diktaturën.

-Po sulmojnë anijet, - tha Poeti. - Tani gjithçka e kanë në dorë të revoltuarit. - Ata me uniformë, të tërhequr mënjanë, jepnin e merrnin me aparatet e radiove dhe strukeshin në ndonjë rrugicë kabine. Në veshët e poetit rinisi aftësia e tij të kapte fjalët e thëna në këto mjete:

-I lini të ikin. Le të thyejnë zverkun. Ushqim për peshqit do të bëhen të gjithë!

* * *

Muzgu sapo kishte rënë. Urdhrat kapitullues nga njeriu i rendit i dëgjonte edhe doktor Fotjani. Përballë tij qe, mbase për të fundit herë, polemisti, doktor Kreshtani. Të dy po gjerbnin kafën në barin e hotelit. Ishte e para herë që s'kuptonin pse ndodheshin këtu dhe pse të dy.

Fusha e tyre qe psikiatria. Edhe debati i përjetshëm për të bëhej. Asnjëri s'tërhiqej nga mendësia e tij nëse kishte të bënim me 'pacientë' apo 'klientë' të punës së tyre për kronikët.

Befas, në banak afrohet ish-këngëtari i dikurshëm i operës për të marrë një paketë cigare, atë muzg marsi.

Një kamerier, më shumë për t'u tallur, siç ndodhte rëndom me të, u shkëput nga biseda me një grumbull nga personeli i shërbimit dhe tha:

-Ja të pyesim tenorin tonë se ç'mendim ka për gjithë këtë zallamahi.

-Më jep njëherë një "Partizani" pastaj të të them se ç'mendoj.

Tenori, kur futi paketën në xhep, tha:

-Dasma bëhet në 'Hunin', festa në 'Xhenin'.

Dhe doli nën melodinë e një opere me fjalët e një psalmi:

"Gëzohu, gëzohu, gëzohu, o 'Palestinë'..."

Kamerierët ngritën supet. Edhe personeli tjetër. Por jo doktor Fotjani. Ky e kapi nëntekstin e tenorit.

Dasma bëhet në 'Hunin, festa në 'Xhenin'

I dashur koleg. Më thershin mua ato turma, që sulmuan anijet, në kuptoi gjë ajo tufë amorfe që shteti ynë i ka ushqyer me bukë dhe që zgërdhihen me fjalët e ... atij farë tenori.

-Pse? Çfarë tha, unë nuk e kisha mendjen se nga dritarja pashë një grua të re me fëmijë shtrënguar në gjoks, që shpejtonte e zbathur të mbërrinte turmën, përmes errësirës që po vjen.

-Dhe?

-Dhe... ndjeva dhimbje, koleg. Jemi humanë apo ç'jemi, koleg?

-Po. Humanë jemi. Po ajo ç'do në atë katrahurë, apo ta shqyejë kopeja e egërsuar?!

-Nuk më ngjan kështu, koleg. Qëllimi i saj, të paktën, është i drejtë. I duket se gjetiu mund të bëjë një jetë më të mirë fëmija i saj. Po më trego çfarë tha ai tenori?

Doktor Fotjani e dinte se kolegu i tij qe liberal dhe se edhe komunizmi për të kish një tjetër kuptim, por s'qe koha për të shpalosur këtu këto koncepte se, diç të mjegullt duhej të shpjegonte. -Atë 'tenorin' dikur e kam pasur pacient, - tha doktor Fotjani. -Goditja që pësoi, kur për shkaqe të *background*-it familjar i duhet të ndahej nga

opera, të cilën e kishte pasion, e bëri më të mençur. Jo më budalla, siç ndodh rëndom.

-Dhe?

-Kam dëgjuar për të, të thonë se nxjerr përherë nga goja sentenca filozofike, të cilat kopeja nuk i përtyp. Prandaj gajaset.

-Interesant! - tha doktor Kreshtani. - Dhe ç'tha pikërisht tani ky 'tenori-filozof'?

-Dasma bëhet në 'Hunin', festa në 'Xhenin'! dhe më pas me melodi operistike për ta veshur me petk operistik, përsëriti: *Gëzohu, gëzohu, gëzohu, o Palestinë!*

Doktor Kreshtani buzëqeshi.

-Vërtet, koleg. Si të paska shpëtuar ky njeri pa e kyçur pas hekurave të Spaçit?! - ironizoi ai.

-Për hir të popullit.

-Pse?

-Se i duhet një gaztor. Edhe mbretërit e donin këtë prandaj mbanin palaço, madje në oborrin e tyre. Kjo e freskon... (nuk tha diktaturën), mbajtjen nën kontroll të turmës.

-Pra, atje lart... bëjnë dasmë? Kështu?

-Po.

-Ndërsa këtu, në rërë festojnë se do të marrin anijet për 'botën e lirë'. Kështu, koleg?

-Po. Dhe bëmë mirë që e drejtuam luzmën nga deti, - tha doktor Fotjani.

Tjetri shqeu sytë: -E thua me të vërtetë?

-Po.

-Dhe kujt i shërben kjo?

-Të zotit të dasmës që është në... 'Hunin'.

Doktor Kreshtanit nuk i besohej që e gjithë kjo që lëvizje shtetërore, ku viheshin në lojë, me gjakftohtësi, jetët e mijëra njerëzve. -Në Tenianmen u vranë mijëra. Tek ne, asnjë.

-Dhe këtë ta këtë bërë shteti?

-Pse jo, koleg. Madje me propozimin e ne psikiatërve.

-Unë s'kam gisht në këtë punë, sigurisht.

-Ashtu duket, por firmën në fletëzën e hodhe, ashtu me ngut, muajin e shkuar, apo harrove?

-Nuk e dija. Ne sapo hymë në konsultë dhe një orë më pas do të takoheshim me njerëzit e udhëheqjes.

-Nuk ka pse pezmatohesh. Ideja ishte imja. Për këtë jam krenar. Unë shpëtova Palestinën.

-Ti shpëtove 'Huninin' (nuk tha shtypjen as diktaturën). Palestina sërish do të ketë probleme.

-Po. Por ato do të jenë më të buta. Valvola është hapur. Ena nën presion ka shpëtuar.

Doktor Fotjani bëri me shenjë dhe kamerieri, si t'i kishte gati, i solli shumë shpejt dy uiski.

-Aty më parë, përdora fjalën *luzmë*, se ky është pohimi i duhur. Kështu quhen bletët kur mësyjnë. Po njerëzit? Po revoltat e tyre? Një turmë e çmendur nuk është e mundur të ndalohet me mjete të sofistikuara. Ato u përkasin misionëve sekrete, ose luftërave.

Revoltave u duhet ndryshuar drejtimi kur janë të paorganizuara dhe u duhen marrë frenat për t'u zëvendësuar pikëpamjet, kur organizohen.

"Njerëzit kanë pushtuar anijet. Të paktën në dy raste. Më të rinjtë e të vonuarit po ngjiten nga litarët. Më të fortët edhe te direktët. Parashikohen trazira brenda bordit. Jetët e njerëzve rrezikohen." Dhe doktor Fotjani e fiku radion si për t'u prerë vrullin të revoltuarve.

-Për çfarë po flisnim, koleg?

-Për ndryshimin e drejtimit të revoltave. Kaq është e vërtetë ajo që me metodat tradicionale nuk mund të operohet kudo, sa duket e pabesueshme, por e njëmendtë ajo që thuhet se "*kur s'shkon Muhameti te mali, vete mali te Muhameti*".

-Po. Është një profeci bektashiane.

-Ajo për të cilën do të flas tani s'ka të bëjë fare me fatthënësin. Përkundrazi. Me një praktikizëm çudibërës. Mbase këtu mund të qëndrojë edhe profecia e tij.

-Po. Dhe cila na qenka?

-Javën e shkuar, koleg, u ndodha për rastësi, në urgjencën e spitalit ushtarak.

Doktor Kreshtanin e digjte kërshtëria me çfarë do ta krahasonte doktor Fotjani ndryshimin e drejtimit. Prandaj gjithë veshë, u përqendrua ta dëgjonte, ndonëse kokën e ndiente pak të rënduar, atë prag errësire.

Doktor Fotjani vazhdoi:

-Në pavijonin e urgjencës, kishte shërbimin doktor Kopovola, për të cilin të gjithë kemi mendimin se zë kreun e kirurgjisë shqiptare.

Befas vjen doktor Dobe, me një paciente. Për doktor Doben, e gjithë doktoratura e pranon për të fantaksur, sigurisht. Për momentin, kirurgu që i lirë dhe pas përshëndetjeve të rastit, e pyeti doktor Doben se ç'e mirë e solli. Ky vuri kapelën e republikës në portmando dhe tha: - Jo e mira, sigurisht, doktor. Halli. Dhe ky s'është i imi, por i kësaj zonjushës së re. - Pse? Nga se vuan? -Tani për tani nuk vuan nga asgjë ngaqë është e kujdesshme për shëndetin e saj. Ndien një si të cimbisur në regjionin rrëzë kofshës. - Ashtu? -Po, doktor. Dhe unë mendoj se është tumor, të cilin nuk kam dyshim se mund ta operoni. Por më parë u duhet të bindeni se është. Pra, ekziston si tumor. Doktor Kapovola e shtriu pacienten në krevatin klinikal dhe si kontrolloi pozicionin e diktuar nga i fandaksuri, Dobe, tha: - Nuk shoh asgjë.

I fantaksuri i përmendi të gjithë muskujt e regjionit, emrat e të cilit s'i kam ditur as kur isha student, prandaj edhe s'u bëra kirurg. Por edhe kirurgun nuk e ndihmoi njohuria e tyre.

Atëherë, i fantaksuri, Dobe, u ngrit e i vajti afër: -Koleg i dashur, - i tha. - Jo çdo zonë në trupin e njeriut kontrollohet duke e shtrirë pacientin,- dhe iu drejtua të resë. - Çohu, zonjushë!

Ajo u ngrit. - Hip mbi këmbësen e drurit dhe sille trupin përmbys mbi shtratin klinik, ashtu siç bëre me mua, - i tha asaj. Nga ana tjetër, mori pëllëmbën e kirurgut dhe e vendosi në mënyrë të tillë, që gishti i tij tregues, apo i dyti, ta prekte atë. - Palpoje lehtë, - i tha kirurgut. - E ndien?

Tjetri u përgjigj, pasi e palpoi (preku) dy a tri herë. - Po. Ke të drejtë. Është një tumor sa një lajthi. I fantaksuri, Dobe, u drejtua në portmanto dhe, si mori kapelën, e vuri në kokë, përshëndeti: -Prit, - i tha kirurgu. - Me zonjushën çfarë do të bëhet? -Atë do ta operoni, doktor. Ju jeni kirurg, jo unë. Ndihma ime ishte vetëm ta diagnostikoj. Kaq. Dhe doli. Iku, i dashur koleg."

Këtu e përfundoi këtë rrëfim doktor Fotjani dhe shtoi: -Edhe detyra ime përpara udhëheqjes, koleg i dashur, ishte të dianostikoj çmendurinë kolektive. Pandërgjegjshmërinë e tyre. Kaq.

Doktor Kreshtani mbeti pa gojë.

Doktor Fotjani thirri kamerierin dhe, si pagoi, u mat të dilte. Kolegu Kreshtani i tha:

-Ku do të shkosh?

-Te pacientët e mi, - dhe bëri me krye nga deti.

-Në anije?

Ai nuk foli, por tundi kryet, gjë që linte të nënkuptohet dhe doli jashtë.

Doktor Kreshtani piu dhe një gllënjë të fundit dhe la bufenë për ta ndjekur nga pas, pa qenë i bindur as vetë. Në çast, i lindi ideja se ç'shkruhej në kartelën e spitalit për tenorin-filozof.

E gjithë rëra e plazhit thuajse qe boshatisur.

Në mes të pistës verore të turizmit, shkurt në prag të qelqerisë, ish këngëtari i operës, tek shihet dy doktorët, që ecnin, njëri pas tjetrit, deklamoi:

-Njëri e ka futur gishtin brenda në zjarr, rastësisht dhe mund të digjet. Tjetri e ka këmbëzën në yzengji të kalit dhe mund t'ia mbathë me të vërtetë e jo me gjasme.

Nga lokali dolën kamerierët dhe personeli i shërbimit. -Ç'llomotit kjo fantazmë kështu? Për kë e ke fjalën, o birbo, - e pyeti duke iu afruar pranë, njëri syresh.

-Për shtegtarët që bëjnë tregti me rruzare, ndërsa turma është nisur për në Mekë.

Pas këtyre fjalëve që askush s'i kuptonte, ai do të merrte një melodi të njohur nga ariet e tij të parapëlqyera.

- Gëzohu, gëzohu, gëzohu, o Palestinë.

Për të rifilluar një tjetër uverturë se, me sa duket parapërgatiste me një seriozitet e përkushtim tejet, po tejet nxitës e po aq frymëzues.

- Finalja, finalja, finalja, ende luajtur s'është: luajtur s'është, lojtur ende s'është,... Lojtur s'është, lojtur s'është, ende, endeeeee...

Tre njerëz dhe kukulla në mes

Në breg sërish nxinte varka e pranë saj edhe varkëtari plak. Në behar pushuesit, ndonëse rrallë, bënin edhe ndonjë xhiro me të. Kurse tani, në këtë stinë, dukej e pakuptimtë shfaqja e saj. Veçse më i keqkuptuar qe fakti se njerëzit nuk guxonin të kërkonin atë t'i shpinte te tragei edhe pse qe logjik një shërbim i tillë.

Gjithsesi dy njerëz vraponin në drejtim të saj. Ose më mirë, dikush po ndiqte dikë. Dhe, nga mënyra e ngarendjes, kuptohej se njëri ishte i ndjekuri dhe tjetri ishte ndjekësi. Aspak një dyshe. Madje qenë dy kundërshtarë. Ikanaku herë pas here kthente kryet prapa sikur po e ndiqte ariu në pyll e jo një njeri në rërë. Në qoftë se i pari qe vala, i dyti ishte era e kjo frynte në drejtim të duhur edhe pse varka s'qe me pëlhurë lundrimi. Mosha e të dyve qe e njëjtë: në prag të pleqërisë. E, mbase e tillë edhe armiqësia midis njëri-tjetrit. Ikanaku do të shkëputej në çastin që ndjekësi do të pengohej në një kukull e do të binte. Kukulla qe një kokonë, që nën dritën e shtyllës, dukej edhe më bukuroshe, e cila e bëri ndjekësin të humbasë ca sekonda të vlefshme dhe t'i ndërmendet diçka tronditëse në një anë, po edhe si një ogur i mirë në anën tjetër. Se qe dhurata e tij, bërë të birit, njëzet e pesë vite më parë, kur fëmija ishte vetëm pesë vjeç. Një gjë e tillë s'mund të merrej për një ngjashmëri.

Aq më pak përkesë rastësore. Por mbase enigma ka për mbulesë lëkurën e qepës. Po ku qe ajo? Se ai drejt varkës po shkonte, e cila nxinte më tepër në muzg. Zemra nisi t'i rrahë me forcë dhe kjo parandiente se qe patjetër në prag të një befasimi. Edhe pse ai një ish i burgosur qe dhe po ndiqte ish-inkuizitorin e tij. Prandaj e futi në xhep të xhakëtës së vjetër atë kukull, gjysma e së cilës varej jashtë saj, mbushi të dyja duart me rërë dhe u nis më me ngut të kapte ikanakun. Kur mbërriti duke gulçuar shqiptoi: njëzet e pesë. Kjo shifër përkonte plotësisht me vitet e tij të burgut. Ndaj lëvizi kryet majtas në një gjest sa besëtyt aq edhe qesharak.

Varkëtari plak, në një pozicion ushtarak e me dorë në cepin e djathtë të kasketës e nderoi të ndjekurin si të qe eprori i tij. Ky u hodh menjëherë mbi varkë dhe i kërkoi me forcë plakut lopatat. Paniku e kishte përfshirë të tërin, kurse tjetri, ende s'e kuptonte, po vazhdonte nderimet e temenatë, sikur ishin në sallat ku këto përbënin alfën e gjërave dhe jo sikur bëhej fjalë për kokën e aspak për 'kapelën'.

Prandaj, duke iu marrë fryma, ardhësi me një ton prej padroni e assesi prej bashkëpunëtori, iu çorr plakut: - Lopatat, djalosh! Ç'pret?

Ky, me bindjen e një ushtari dhe me shkathtësinë e një djali njëzetepesëvjeçar, u kërrus nën varkë, ku edhe i kishte fshehur lopatat dhe u ngrit me njërën nga ato në duar. S'kishte kohë ta çonte kasketën që mbeti në rërë se u përkul dhe, sa hap e mbyll sytë, ndjekësi mbërriti.

Gjurmuesi pa e bërë të gjatë luajti, kinse, njeriun që po e linte frymëmarrja, që në të vërtetë qe tejet e shpejtuar dhe me një nishan aspak të nevojshëm, ia hodhi grushtin me rërë surratit inkuizitorit të tij, i cili qe gati të nisej edhe me një lopatë. Plaku kërcëu ta ndihmonte eprorin. Ky qe çuar në këmbë dhe, ashtu, marramendës, u nda të

mbahej tek ai dhe i vuri dorën te flokët.

Varka, nga lëkundja, bëri që dora e ikanakut ta tërhiqte plakun nga leshrat, të cilat ishin false, pra parukë, dhe t'i zbulohej fytyra e një të riu, tridhjetëvjeçar. Ky ishte agjenti i sigurimit të shtetit dhe hetuesi "Ortep".

Ikanaku qe shefi i tij, Petro. Emrat e tyre ishin antonimi ose kundërvënës.

Shefi Petro ulëriu me sa kishte në kokë.

-Ortep! Qëlloje! Është babai yt që ka dalë nga burgu dhe vjen të na vrasë. Apo harrove se ti e ke denoncuar?

Ortepi e kishte nxjerrë tashmë, revolen e cila, prej kohësh fishekun e mbante në gojë. Se deri tani, me dhjetëra qenë rastet e tentimit, sidomos nga të rinjtë për të rrëmbyer varkën, gryka e armës, me ftohtësinë e saj i kishte sprapsur ata paqësisht.

Ortepi i hodhi sytë ndjekësit që po i merrej fryma dhe vështrimi i tij s'iu duk aspak kërcënues. Përkundrazi. Ai njohu babanë e tij, si në fëmijëri. Vetëm nga ai kundrim ledhatues që i bënte nënës së tij. Ndaj vendosi të mos i fliste atëherë. Interesimi i tyre për të kërkuar arsien në doktorë e nevríkoste dhe shpesh e egërsonte atë.

Tani i dukej i çuditshëm ky vështrim. Se nëna nuk ishte më. Pra, ajo dritësi, tejet atërore s'linte shteg për të besuar se tjetri kish ardhur për hakmarrje. Jo. Përkundrazi. Babai quhej Ilir dhe, që në krye të herës, e kishte gati grushtin tjetër me rërë. Sekonda i ndau kur i biri s'qe akoma djali i tij Ortep, por një plak me kasketë. Dhe që t'i jepte të kuptonte të birit se sigurimsi epror Petro gënjente, ia hodhi atij në fytyrë grushtin tjetër me rërë për ta riverbuar e asnjansuar plotësisht edhe nga helmi i gojës. Se revolen e tij, në momentin kur inkuizitori Petro kërkonte ta përdorte, ia kapi dhe ia flaku tutje. Se nuk donte ta vriste. Dontë ta mbyste.

Petro s'kishte aspak guxim të zbriste nga varka, ndaj

përkulej të merrte ujë me grushte dhe të hiqte rërën.

-Sytë edhe mund t'i lash, por krimet dhe zemrën ti nuk do të mundesh kurrë ta pastrosh, o pusht e bir pushti i fëlliqur!

-Qëlloje, ç'pret! – i ulëriu kumbari Petro Ortepit.

-Po, - tha i ati. Le të më qëllojë, por më parë le të lexojë se ç'i shkruan motrës së vet ajo femër e ndershme, që unë e kisha grua dhe im bir-nënë. Se që të dy e adhuronim, secili sipas ligjësive që na i ka caktuar Fuqiploti. Mua me të drejtën e burrit, tim biri me privilegjin e fëmijës që pi qumështin nga gjoksi i saj.

Pas këtyre fjalëve, i ati i Ortepit, sërish me atë gjestin besëtyt të lëvizjes së kokës me të cilën sikur donte ta shpotiste tjetrin, nxori nga kraharoni letrën dhe ia tregoi të birit.

Ortepi, nën dritën e zbehtë të shtyllës, tejet larg, lexoi:

"Motër e dashur! Kumbari Petro kërkon nderin tim. Por unë s'e tradhtoj burrin të cilin e dua si jetën. Tani që mora vesh arrestimin e tim shoqi po pres damarët se ... s'kam rrugë tjetër. Ai do të më përdorë.

*Motra jote
Lira"*

Ortepi ende s'e kishte mbaruar së lexuari letrën kur ndjeu se shefi i tij, Petro, ashtu siç e kishte udhëzuar në shkollën e Ministrisë së Punëve të Brendshme, se duhet të shfrytëzohen mjetet rrethimore për të dalë nga kurthi, kish gjetur rastin të heqë lopatën nga vendi i mbërthyer. Veçse Ortepi, vërtet ishte nxënës i tij, por shquhej për tinzëri e po ende edhe për nuhatës se ishte nga natyra frikacak, prandaj dhe e ndjeu se shefi, tashmë gruari, Petro, ishte bërë gati ta godiste ashtu 'kuturimthi' të atin e tij. Prandaj, pa i kthyer kryet nga ai, gjithashtu

kuturimthi, drejtoi armën dhe me një mllef të dyfishtë, e zbrazti mbi të. Nuk u dëgjua krismë, por një zhurmë e mbytur sepse arma, tytën e kishte të gjatë që e heshte rrapëllimën.

Tjetri lëshoi një klithmë të fortë dhimbjeje si për të zëvendësuar zhurmën e munguar të plumbit që ia kishte përshkuar aq lehtësisht kraharonin. Se plaga që vdekjeprurëse. Prandaj trupi iu drodh dhe ai, përmes gulçimeve, ndonëse mbase ende në këmbë, mundi të thotë me vështirësi, por dhe i 'kënaqur' për ngjashmërinë:

-Tinëzar... si dhe ...unë. Më vrave, bir.

Ortepi i ra letra e së ëmës nga dora. Befasimi kishte ardhur me shpejtësinë e fishekut të dalë nga arma grykëgjatë. E, mbase edhe me atë të rrufesë në qiellin e kthjellët. Dhe, si të mos mjaftonte e gjithë kjo, sigurimsi Petro, përpara se të këputej e të plandosej mbi varkë përmes gulçimave, përsëriti zëmbël:

-Ortep... bir! Mëso të vërtetën. Unë jam babai yt.

Zëri doli tejet i dhimbshëm. I tillë ai mbërriti edhe në veshët e djalit. Më tingëllues e i kthjellët se ajo predhë e hedhur tinëzisht e 'kuturu' që tejshpoi sigurimsin Petro. Madje ai zë kish brenda tij klithmën që del nga njeriu në çastin e mbramë të jetës së tij. Ai zë ishte zëri i **babait biologjik**, ndonëse jo ligjor.

Pas kësaj tek Ortepi u mbart dhimbja. Krejt e ndryshme nga ajo e '**babait biologjik**'. Ishte dhimbja e një plage pa gjak. Por ndofta me vrer. E ky, për nga hidhtësia, ia kalonte helmit të disa gjarpërinjve njëherësh. Dhe mund të dukej se nga një fole e tillë doli ndonëse ishte një zë prindëror. Po. Mirë e lexuat. Se këtu duhet kërkuar shkaku që iu helmua i gjithë kurmi.

Atij i qe rrushkulluar edhe goja, gjithashtu. Ndaj u drodh i tëri dhe i ra arma nga dora.

Oh! Po ai s'ishte një lajm dosido, miqtë e mi!

Natyrisht. As kumt i thjeshtë ai s'qe. Vërtet predha çau hapësirën me shpejtësi, por sapo u ndesh me trupin e njeriut, atë çast, sipas ca ligjeve shkencore, të cilat ende s'i dimë, mund të ketë përcjellë, '**mbisipërfaqen valore**' një '**kundrakumt**' (le ta quajmë kështu) e mbase një '**kundratingull**' (le ta emërtojmë në këtë mënyrë, po ashtu). Se ky duhet të përcjellë **mallkimin**. Stadin më të lartë të pezmit, dhimbjes, dëshpërimit. Dhe dihet se përherë e vazhdimisht, ofshama ka brenda saj, lutjen. Drejtimi është **qiellor** dhe kërcënon me... gjëmë. Ndryshe nga pendimi që është **tokësor**. Ky do vendin e tij të shfaqjes, ashtu si kohën e tij, ai do. Dhe sigurimsi Petro parapëlqeu t'i lërë lamtumirën kësaj bote i penduar, por jo edhe i hidhëruar. Prandaj në atë zë instinktivisht qenë ngjeshur me nota që: në mos përgjëruese, lutëse ato ishin. Dhe nga djali, natyrisht, ato nota diç kërkonin. Si përkthesa e një kënge vaji. A si rekuem për një prind ku: **njohja me** të të njëjtën ditë ka, ashtu si **ndarja me të të njëjtin çast mba**. Sepse, te sigurimsi Petro kishte ardhur fqinji i tij i munguar, 'shpirti'. Dhe ky, siç edhe kemi hamendësuar dikur, kish mbërritur në çastin e fundit të jetës së tij, përpara se të dalë.

Gjithsesi Ortepi, kryet majtas hepoi. Në rërë, në një palëvizshmëri statuje, qe kallkanosur '**prindi i tij ligjor**'. Ai, që për shkak të tij kishte bërë njëzet e pesë vjet burg. Dhe ja: ky kumt i shemrit të tij, në mos e llogariste jashtë kësaj bote, si leshterikun që nxjerr errësira në bregdet dhe ne e shohim kur hapet dita, me vdekje ai e kish dënuar atë. Kjo lexohej në sytë e tij. Egërsimi i tyre qe i frikshëm. Atë vështrim mund ta qetësonte vetëm shpagimi. Por kundër kujt?

Një sekondë ishte ajo në këtë kthim koke të Ortepit. Kaq mjaftoi që diç tjetër të përfytyronte në atë hapësirë tejet të shkurtër kohore. E kjo lidhej me fëmijërinë e tij

të largët: njëzetepesëvjeçare. Atëherë, kur i ati i tij ligjor i hidhte ca vështrime të ëmbla nënës së tij përpara se ta puthte atë. Po ende edhe kur me vrull, si të donte ta përpinte e ndrynte në dhomën e gjumit për të bërë dashuri. Zakoni i Ortepit për të shikuar nga brima e çelësit, atë çast iu duk neveritës. Një sekondë iu desh të rikujtojë këtë skenë nga prindi i tij ligjor. Ishte kjo shëmbëlltyrë që e ndante birin nga i ati.

Sekonda tjetër atë e hodhi menjëherë në varkë: te prindi i tij i dytë, jo ligjor. Pra te **ati biologjik**. Dhe e gjeti ende me frymë. Ai kishte rënë me fytyrë nga qielli. E ky qe i errët e pa yje si natë tradhtie.

-Baba! - thirri Ortepi i përlotur. Dhe duke iu marrë goja u ngut të thoshte, - Të vrava me dorën time.

Tjetri vuri pak buzën në gaz. Me gjasë ky gjest mund të shprehte falënderimin që i biri e quajti me emrin e vërtetë **baba**. Se pas këtij mirëkuptimi, heshtazi, ai mezi shqiptoi edhe vetëm dy fjalë: "**Ga-bu-am... bir!**"

Një fjalë, një dhe e vetme (**bir**) se s'kish jetë për më shumë. Ndoshta do të dëshironte që bashkë me pendimin të shprehte edhe kënaqësinë që i biri - Ortepi - e pranoi për baba. Qe mbase një përputhje ADN-je që solli këtë harmonizim. Se një ndërsjelltësi ajo qe. Ky faktor ndërveprues bëri që sigurimi Petro, tanimë i vrarë, të kthejë pak kryet mënjanë dhe të largohet përfundimisht nga kjo botë i kënaqur... Ai kishte dëgjuar me gjallje: fjalën bukurtingëlluese: **B a b a!**

Ortepi në këtë sekondë të tretë ia uli qepallat e syve për të kujtuar vitet e shkuara. Interesimin e tij të vazhdueshëm në shtëpinë e fëmijës. Por edhe më pas në stadet e tjera. Sidomos në Shkollën e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Dhe nuk i kish shkuar kurrë ndër mend pse e bënte ai këtë. Edhe atëherë kur ai ia kishte shkallëzuar emrin. Në fillim vogëlush. Pastaj - djalë

dhe në vazhdim: biri im. Të gjitha këto Ortepi i kishte parë në natyrshmërinë e gjuhës së kumbarit. Se duhet të pranojmë që, nën këtë petk, ai i vishte ato epitete. E pse të mos themi: ato dhele prindërore?

Përfundimisht: sigurimsi Petro kishte qenë babai i tij i njëmendtë. Si, qysh? Në ç'mënyrë?... Në këtë sekondë të katërt, tek rrekej të zhbironte të fshehtën, dëgjoji zhurmën e mbytur të armës së tij grykëgjatë. Ktheu nxitimthi kryet dhe pa me tmerr se **babai i tij ligjor** u këput e ra përmbys mbi rërë.

Ortepi u hodh nga varka dhe u ndal pranë tij. E anasolli dhe pa me lemeri gjëmën. Armën ai e kishte zbrazur në gojë dhe ajo i qe mbushur me gjak. Në gjoks ishte kukulla njëzetepesëvjeçare që, të gjakosur, ia dha Ortepit. Themi kështu ngaqë s'duam të pranojmë atë flakje me neveri. Se plaku çuditërisht tejet i pashkëputshëm kësaj bote, mbante ndër dhëmbë shpirtin që diç t'i shprehte Ortepit, por pa i folur atij në një përpjekje mbinjerëzore. Sytë i kishte ende të hapur. Vështrimin shpotitës. Ortepi pa ditur se çfarë t'i thotë, shqiptoi: "Pse ...baba?!" Dhe mori si përgjigje një pështymë gjaku. Ai mbylli sytë. Po. Absolutisht, po. Mbylli sytë. Këtë e bëri vetë përpara se të jepte shpirt. Dhe ky përfundim fliste për një karakter skajshëm krenar për të këmbyer qoftë edhe dy fjalë lamtumire me atë që ai e kishte njohur për djalë pesë vitet e para të jetës së tij bashkëshortore. Dhe që, njëzet e pesë vjet të tjerë në burg e kishte si njeriun e vetëm në këtë botë që mezi priste ta takonte. Dhe tani ndihej si në bregun tjetër të një deti edhe pse s'ishte më larg se disa centrimetra të atij që e quante djalë: Ortepit. Ky përjashtim nga rregulli tejçonte skajshëm largësinë si në dy pole të kundërta, njëherazi. Se shpirti te ky njeri i kishte rezistuar burgut dhe s'doli. Fyerja e shkëputi nga trupi brenda katër sekondave.

Ortepit i mbeti në dorë ajo kukull e gjakosur e cila vetëm pak minuta më parë i kishte rënë teksa ndiqte ca të rinj që kërkonin ta rrëmbenin varkën për të shkuar në traget. Ishte kjo shpërfillje që babait të tij ligjor t'i lindte shpresa se diku aty pranë e mbase tutje asaj errësire do të qe i biri. Ndaj ai gjithsesi u ngazëllye përpara se të provonte shpresëshuarjen dhe të bëhej njësh me të.

Tutje, nga Hotel "Adriatiku", ish-tenori, çuditërisht tanimë, me një kitarë, kish marrë me mallëngjim këngën arbëreshe: "**Moj e bukura More**". Dhimbjen nga braktisja e vendit e bartte vala e detit që e përcillte në drejtim të anijeve në port ngarkuar me ikanakë. Kjo braktisje masive e vendlindjes do të emërohej: EKSODI I MADH për të bërë xhiron e BOTËS.

"Moj e bukura More"

Qe përsëritja e një EKSODI të pesë shekujve më parë. Atëherë kur vdiq Skënderbeu, ky 'Kalorës i Krishterimit'. Populli i tij, për t'i shpëtuar ndëshkimit të barbarëve otomanë, drejtohet nga miqtë perëndimorë. Qe radha e tyre t'u jepnin truall për të ngritur fshatrat-kampe e vendbanimet e domosdoshme.

*"Moj e bukura More,
Si të lashë e më s'të pashë?
Si të lashë, si të lashë?
Atje kam unë zotën At,
Atje kam unë zonjën Mëmë,
Atje kam dhe tim vëlla
gjithë mbuluar,
të gjithë mbuluar,
të gjithë mbuluar nën dhe.
Ah, e bukura More!*

Oh! Çdo largim e sidomos ai i detyruari, shoqërohet me keqardhje, dhimbje, lot e trishtim. Por ai i braktisjes së Atdheut është më i rëndi. E ky nuk mund të vijë kurrë

pa një acarim. Aq më pak pezm. Kurrsesi pa trazim të brendshëm. Këtu nis vuajtja shpirtërore. Tatëpjeta e saj fillesën aty e ka.

Moj e bukura More...

Ti këndon e shpirti të qan. Se e beson që fjalët e tua nëpër natë përpihen nga dallgët. Po ku i dihet, o bard i gjithë shqiptarëve? Këtë çast, mijëra nëna të atyre djemve e vajzave e po aq të tjerëve, që kanë mbetur si të lënë e të papërfillur, nuk bëjnë të njëjtën gjë? Jo me kitarë e mbase as me çifteli. Aq më pak me këngë. Po me lot, me vaje e madje me kujë. Se iku ajka e kombit. Aq sa edhe malet u drodhën nga kjo gjëmë që i ndodhi kësaj bashkësie. Se kishte hipur në ato anije lundruese, që do ta shpinin drejt së panjohurës, e gjithë rinia. Qe një hemorragji tejet e përvajshme.

Moj... (oh) e bu(oh)kura... More!

Që të çlirohet ky vend nga këto ankthe do të duhet mbase një kometë të kalojë në galaktikë dhe t'i përthithë si avuj. Ajo me emrin Hallej, do dhe gjysmë shekulli të përvijojë qiellin mbi planet. Duro dhe ti "Moj e bukura More"! Duro si edhe ne... që mbetëm pa Atdhe!

Meraku i lulishtarit dhe ... shtangia e tij

Zbritën në Hotel “Adriatiku”, në pjesën e pasme, që në të vërtetë ishte ana e përparme e tij se projektimi s’u ngjante maskave të mesjetës që paraqiteshin njëlloj si përpara dhe prapa, me ndryshimin se e pasmja të grishte për freskim në behar, me të njëjtin vrull që të zymtësonte e përparmja e tij në dimër. Kjo mospërputhje e jashtme nuk e vështirësonte aspak përshtypjen e brendshme.

Poeti dhe francezja Julietë iu afruan mikrobusit ndërsa turistët e tjerë të paktë në numër për në Tiranë, i kishin sistemuar valixhet.

Ndërkaq lulishtari-plak, që e kishte njohur poetin, për drojë se mos gabonte, qe bërë të flasë me vete teksa ai shkonte e vinte sa në një anë të mjetit, në tjetrin. “Të jetë ky djali, që beharin e kaluar i jepja çdo ditë nga një degë karafil, apo më bëjnë sytë?”

Në këto e sipër, poeti ktheu kryet.

Mbase nga mimika e me gjasë edhe ngase ai në të vërtetë lëvizte buzët, por pa zë, ia lexoi mendimin lulishtarit.

-Unë jam, xhajë. Sytë i ke pipër e hiç mos dysho!

-E, pra, mo! - u çlirua më në fund plaku. -Thashë dhe u! Se dro gabohet xhaja.

-Fol, xhajë! Se në rrethin e Durrësit kam qenë arsimtar dhe ina tanët, - i dha kurajë i riu në dialektin e plakut.

-Vërej këtu, or çun! Gratë kanë shumë dëshirë të tregojnë qëndismat e veta. E, nga kjo nahije dhe ne lulishtarët, ina ma keq se ato. Imamin e kina te buqeta e luleve.

Atë çast tjetri mendoi: edhe ne poetët vuajmë nga kjo mani. Kemi shumë zell të flasim për vargjet tona edhe kur ato u ngjajnë më shumë bejteve dhe rrallë ose aspak poezisë së vërtetë.

-E, ta pata llafin, kam shumë dëshirë të të jap një tufë me lule për atë francezen që të rrikërka sa para-prapa. Se, o lule e lulja shko te lulja, o çun dhe zbukuroni edhe të qeshmen e saj qi, ia boka atë faqe me gropa si filxhan kafeje.

Poeti qeshi.

-Ta dish! Do t'ia them, xhajë! Nuk dua të skuqesh kur të bindesh se e ka marrë vesh mendimin tand!

-Ani, s'ka gajle. Xhajës i bëhet zemra mol në ksi rastesh.

-Mirë, - tha poeti. - Mirë edhe për lulet. Në qoftë se s'të prish punë boje një buqetë të vogël.

-Far' gjoje, o çun. Far' gjoje. Se u për ju i kom. Domethënë për turistët. E këtu hyn edhe ajo francezja jote, zaten edhe ti tani, o çun.

Poeti qeshi dhe s'priti gjatë. Se plaku e kish përgatitur tufën e luleve. Kjo bëri që atij t'i vetojë mendimi se tjetri diç kishte. Se duart po i dridheshin ashtu si dhe buza përpara se të thoshte rrëmujshtëm:

-E kishte xhaja një llaf.

-Fol! - i dha zemër poeti.

-Ma baj kabull një ... vasijet.

-Amanet!

Xhaja tundi kryet: -Amanet, - tha. Kjo fjalë, ndonëse

turbullt, s'kishte se si të mos i kujtonte relievën e asaj pllaje e siluetën e atij burri me emrin Luan Majlindi. Dhe ja tani, një tjetër thujse moshatar me të, i kërkonte një shërbim, një *vasijet*. -Thuaje, xhajë!

-Që kur nipi im pesëmbëdhjetë vjeç, vuri këmbën në ambasadën e Francës në Tironë, o çun', unë s'mund të ul kokën në jastëk. Se mendja më rri po te çuni, o çun! Kam nisë të harroj edhe emrat e luleve dhe po më del fiqiri vendit.

Pas këtyre fjalëve i ranë lotët mbi buqetën e luleve e, mbase edhe te ajo letër, që fekste midis trëndafilash. Nuk nxori dot asnjë fjalë. Asnjë germë dhe u shndërrua në një sfinks.

Poeti nga ana e tij e kuptonte se te lulishtari, diç tjetër e bënte të pazbërthyer më tutje gojën e tij. Prandaj, në heshtje, pranoi cilado të qe kjo porosi. Se para se të ishte një detyrim a një përfshirje në një punë me kokëçarje, ajo përbënte zotim, se do të merrte udhë të mbarë një brengë. E këtë ai duhet patjetër ta kryente.

Prandaj me zë të ulët i tha:

-E marr përsipër detyrën, xhajë.

Uli vështimin mbi letrën, të cilën e hoqi nga tufa me lehtësinë e këputjes së një petaleje dhe e vuri në xhep.

Plaku i puthi duart të riut, si të përcillte një kalorës fisnik në një mision humanitar. Se kish shkarkuar, në njëfarë mënyre, brengën e, mbase, atë natë do ta zinte gjumi kur të vinte kryet në jastëk. Por nga ana tjetër qe ngarkuar me një barrë falënderimi të cilën s'dinte si ta zhbartte përveç me puthjen e duarve. E, kjo mund ta linte sërish pa gjumë, po ashtu.

Sikleti i lulishtarit për të shprehur lëngimin, që e mundonte, lotimi mbi buqetën e luleve dhe, sidomos, qashtërsia e vështimit të tij, kur dorëzoi 'amanetin', nuk do t'i ndahej poetit gjatë gjithë rrugës për në

Tiranë. Madje, flatrimi do ta shoqëronte deri te porta e “Hotel Dajtit”, ku Julieta e njohur tashmë plotësisht me historinë e mësymjes së ambasadave në përgjithësi, ku qe përfshirë edhe adoleshenti, si shumë moshatarë të tij, do t’i propozonte poetit më të papërfytyrueshmen për nipin e lulishtarit: ta merrnin në shtëpinë e tyre dhe të vazhdonte shkollën e mesme tek ata.

-Ti, sigurisht, nuk kërkon të bësh shaka? - vërejti poeti më shumë për t’u siguruar në e kish dëgjuar mirë idenë.

-Absolutisht!

Befasia e zgjidhjes, ku brenda ishte fisnikëria prej kalorësi, e bënte dukshëm të pabesueshme kërkesën. Se prekte idealen. Sepse një sjellje e tillë, pranë përsosmërisë, e vinte në dyshim njëmendësinë e saj.

Poetit, në çast, i vetëtuan kësaj here, katër vargje, të cilat mund të merreshin edhe për sentencë, a pyetje retorike.

*Ashtu si dija vjen nga shkolla
dhe mendësia nga familja dhe mjedisi vjen,
pse vendimet ngjasin tejte të përkora,
kur pranvera degën me lule shpërthen?*

-S’ke pse habitesh, - tha francezja si të donte të mbështeste pikërisht atë çka atij i ndriti: - Përveç shtetit shumë familje franceze do ta bëjnë një gjest të tillë human. Pse të mos jemi edhe ne? Madje ndër të parët?

Kjo zbrazje e atypëratyshme e atij angazhimi për lulishtarin plak ishte njëherësh pak të thuhej, që i solli pranë kënaqësinë e atij jeshili, aromën e bubuqepsjes së gonxheve të porsaçeluara dhe qashtërsinë e vështirimit të lulërritësit.

Poetin, pas kësaj, e kaploi të tërin një gjallëri po aq e beftë, saqë i skajonte kufijtë e të zakonshmes. Nuk do ta tepronim po të thoshim se brenda tij ndriste një diell, që francezja s’mund ta shihte edhe pse ishte ajo burimi i

asaj drite të brendshme, që ndriçonte shpirtin e partnerit të saj. E, kjo dritë e ky ndriçim ushqej nga një fjalë, një ide të cilën e kanë krahasuar me brilantin. E tillë ajo mbërriti deri në recepsion.

Aty poeti vuri re se dikush po këmbente frëngjisht me zonjën Marsejezë. Kur u afrua, dalloi vërsnikun e tij të fëmijërisë, Ortepin.

-Ti flet frëngjisht?

-Po, - gjegji tjetri.

-Po më çudit.

-Mësimin e saj duhet ta kemi nisur njëkohësisht të dy. Që atje në Pllajën Bergo. Te ai i çmenduri që dogji veten.

Poeti ndjeu neveri për fjalët që tha në adresë të Luan Majlindit, të cilit i përkiste pika e referimit për frëngjishten. Por ky sigurims e harroi këtë si arusha shpellën.

-Mendësi pylli, - shprehu ai, por tjetri as që e kuptoi. Thjesht buzëqeshi si guak.

Pas kësaj, poetin do ta ngushëllonte disi ajo, që kjo shëmbëlltyrë përçmimin e shprehu në shqip. Me këtë poeti kuptoi se ai s'dinte asgjë për Luan Majlindin. Aq më pak për Marsejezën, që ishte e shoqja dhe assesi për të bijën Julietë. Absolutisht për ditarin. Sa për gjuhën do t'i përmendte një varg poetik, ku brenda do të kishte pafytyrësinë tinëzare në rrugën e përvetësimit edhe të një gjuhe të bukur si frëngjishtja. Se për vete kishte ecur në sipërfaqe, në dritë. Tjetri *underground*. Si e gjithë veprimtaria e tij në sigurim, nën rrogë.

Poeti gjeti një shkak dhe e tërhoqi mënjane zonjën Marsejezë, e cila e mori çelësin e dhomës dhe, së bashku me Julietën, zbritën me valixhet personale. Bënë pagesën në holl për të shlyer të gjitha detyrimet dhe dolën të tre.

Taksia përpara "Dajtit", pas dy minutave i shpuri në hotelin pesëmbëdhjetëkatësh, "Tirana".

U sistemuan në një dhomë suitë dhe e para gjë që bëri poeti, ishte t'i telefononte lulishtarit te... "Adriatiku i plazhit".

Sportelisti e thirri lulerritësin, ndërsa ai po përgatiste nga një buqetë për vazot e odave të hotelit; ky la menjëherë punën. Por kur mori vesh se dikush nga hotel-pesëmbëdhjetëkatëshi donte të fliste me të, nisi t'i zihej fryma. Veç kësaj, dora filloi t'i dridhej, teksa mori dorezën e aparatit.

Gjithsesi, sapo dëgjoi zërin e njeriut, të cilit një orë më parë i kishte dhënë tufën me lule, bashkë me të edhe porosinë për nipin, në vend që të qetësohej, rrëmbimi i përzier me turbullimin iu kthye në panik. Se ishte fjala për nipin e tij. Për djalin e djalit të tij. Mjaltin e mjaltit. Po ç'them dhe unë, o njerëz! Ai ishte margaritari pas tre vajzave, si buqetë trëndafili.

Për atë që ai e kishte rritur vetë, katër vjet duke e mbajtur në prehër për ta tajisur. Po ende kish pasur kujdes edhe të luante me të, afërsisht dhjetë vite, por që me të vetëm një vit kishte punuar për ta edukuar me punën e kopshtarit, kur mendonte se duheshin tre të tillë, që ai t'ia merrte dorën asaj pune dhe të qe i gatshëm për të dalë në jetë. Dhe... Befas vjen mësymja në ambasada. Pas saj, kjo telefonatë. O Zot, ç'të ketë vallë?

-Ç'ka bërë, o bir e shkuar birit, - iu përgjigj me zë të dridhur telefonuesit.

-Far gjoje, o xhajë. Far' gjoje. Thjesht duhet një certifikatë.

Në këtë mënyrë poeti, me dialektin e tij u mundua ta qetësonte kopshtarin.

-Certifikata duhet, që kur të shkoj në Ambasadën e Francës, të kem një dokument për të. E, në mundsha të bëj atë që mendoj, do të flasim prapë bashkë.

-Qi ta kuptojë mirë xhaja. Certifikatën e do me emrin

e Gazmendit? Kështu?

-Po.

-Po familjare?

-Edhe atë mirë është ta marrësh.

Lulishtarit i kishte shkruar ajo ngrirja e trazimi i fillimit. Portreti i tij, si një gjethe e zverdhur, ishte jeshiluar pas flladitjes nga ky lajm i mirë, si uji për bimët. Edhe zëri i kishte tjetër tingëllimë.

-Bafsh hajër, o çun e t'u bëftë udha dritë kudo që të shkosh!

Pas këtij urimi, zëri i plakut nisi sërish të dridhej. Veçse për një shkak të gëzuar, tanimë. Se një kumt të tillë ai jo vetëm që s'e kish pritur, por as e kish ëndërruar. Për më tepër, kaq shpejt. Ndaj me fanitjen ajo ngjiste.

Zemra nisi t'i rrahë me nxitim. Qe parandjenja që këmbët e tij duhej të fluturonin. Të linte mënjane therjen e gjunjëve, të cilat tani nuk i quante fare, krahasuar me cimbisjen e zemrës se i dukeshin pranë ditët e lumtura për 'Gazmendin e gjyshit'. -E, kur e do certifikatën, o çun?

-Ora është dhjetë, më dymbëdhjetë të kesh ardhur te pesëmbëdhjetëkatëshi.

Plakut i ranë djersë të ftohta. Gjunjët iu prenë. Sportelisti, që po e ndiqte bisedën dhe e dinte edhe dobësinë e kopshtarit për nipin, se ai kishte një vit që vinte bashkë me të pasditeve në lulishten e hotelit, me gërsërët e krasitjes, i afroi një karrige të ulej dhe aparatin telefonik ia vuri në prehër. -Në qoftë shaka, kjo që më the, o çun, mua më solli gëzim e ma mbushi zemrën. Po me se të vijë xhaja, brena dy orësh, o çun?

-Me taksi, xhajë, me taksi. Paret ia paguaj unë taksisë, kur të mbërrini këtu.

Lulishtarin kjo e hutoi tejet: e trullosi. Se kështu bie te njeriu i pastër coha e lumturisë: rëndë, edhe pse ajo

është e lehtë-pendë. Atij iu kujtua se kur martoi djaln, taksinë e kish porositur një javë përpara. Vite e vite të shkuara, në Shijak. Dhe, ja tani, një arsimtar nga rrethi i Durrësit i thotë se taksia u gjetka kollaj. *Tubestrafkulla*, o çun! Trazimi qe i skajshëm.

Mospërgjigjja nga ana tjetër e telit e bëri poetin të kuptojë se plaku qe trullosur plotësisht.

-Mos u huto, xhajë.

-Të dëgjoj, o fisniku i xhajës! O bir e shkuar birit që po më del, o çun. Po ku ta gjejë xhaja taksinë, o bir?!

Lulishtarit tanimë po i zinte ngashërimi grykën dhe lotët sytë. Megjithatë e përmbloodhi veten dhe tha me ton të pastër: -Të dëgjoj, o bir.

Ndërsa poeti, nga ana tjetër e telit, po shpjegonte:

-I thuaj sportelistit se ke nevojë të ngutshme për të shkuar në Tiranë. Me këtë rast i merr edhe leje.

-S'është nevoja, o çun. Unë kam dy vjet që kam dalë në pension dhe vij se e kam merak lulishten e s'mund të rri pa punë.

-Mirë fort. Atëherë sportelisti di ta kërkojë taksinë dhe ta sjellë në hotel. Hipi asaj dhe shko në zyrën e gjendjes civile të lagjes. Merr certifikatat dhe eja tek unë. Sa për shpenzimet mos ki merak. Unë do të pres te sporteli i hotelit.

Lulishtari plak nuk e kundërshtoi. Ai e falënderoi poetin, por në mend i shkrepri një tjetër ide. Pas certifikatave të shkonte në shtëpi. Ta ndante gëzimin me plakën dhe... t'i kërkonte ... 'Ato'.

Me 'Ato' nënkuptonte tremijëlekshin e vjetër. Qe një zakon po aq i kahershëm që Bashkimet Profesionale iu jepnin të gjithë punonjësve ditën kur dilnin në pension.

'Ato, për këdo quheshin paret për të kryer ceremoninë e varrimit. Kishte vite që kjo kuotë kishte marrë këtë... status. Ashtu siç kishte kohë që

shumëkush, më kot e kërkonte këtë 'kuotë' për të mbyllur pesëmbëdhjetëditëshin, edhe pse që i bindur se ajo askujt nuk i qe mundësuar me gjallje.

'Ato' ishin një kuotë si edhe 'lekët e çelësit', që iu ktheheshin pushuesve në plazh. Përvoja kishte treguar se 'beharuesve' u mbaroheshin të hollat dhe që ta lironin kabinën, u merrej paradhënie, treqind lekë, të mjaftueshme për t'u kthyer në shtëpi. Këto u dorëzoheshin në këmbim të çelësit të kabinës. Prandaj dhe kishin ... statusin e 'çelësit'.

S'kishte shkuar ende ora dymbëdhjetë, kur portieri te "Hotel Tirana vërejti mbërritjen e taksisë me targat e Durrësit. Bakshishi i parathënë nga poeti bëri që ai ta rrisë 'vigjilencën' dhe të mos e lejojë lulishtarin e vjetër që t'i përdorë... 'Ato'. Se ai e dinte që 'Ato' nuk i ishin dhënë askujt dy herë. Prandaj dhe s'duheshin shpenzuar.

Portieri dinte, gjithashtu, shumë mirë t'i ulte këta 'vizitorë provincialë' në hollin e hotelit, apo sallonin e pritjes. Madje t'u jepte nga një kafe, të cilën shkoj dhe e porositi vetë. Dhe, ndërsa ende s'e kishin mbaruar atë, mbërriti edhe poeti me një tjetër taksì të hotelit pesëmbëdhjetëkatësh. Befasia do të qe mahnitëse aq edhe prekëse, kur në holl, përpara poetit, do të hynte pesëmbëdhjetëvjeçari, nipi i lulishtarit, Gazmendi.

Francezja Marsejezë, personalitet shkencor në fushën e fizikës së grimcave, s'e pati të vështirë ta merrte me vete adoleshentin Gazmend dhe së bashku me lulishtarin plak të shkonin në Drejtorinë e Punëve të Brendshme për nxjerrjen e pasaportës.

Këmbëngulja e poetit, që gjithçka të kryhej brenda ditës, ngjante me atë që kur hidhen reagentët, procesi s'duhet të ndërpritet.

Për të mënjanuar ndonjë lot të tepërt nga lexuesi e shmangëm dhe anashkaluam të gjithë skenën, tejprekëse

të nipit me gjyshin, ashtu dhe kënaqësinë e brisqpavënit në faqe, kur në dyqanin e diplomatëve iu blenë rroba të përshtatshme dhe këpucë "Adidas".

Nuk do të flasim as për dhimbjen e trungut për shkëputjen e një krah, a degëze, sepse nuk duam të përsërisim asnjë nga ato skenat, sa dramatike po aq edhe groteske dhënë me denduri nga ekrani i njëanshëm e i vetëm televiziv shtetëror i diktaturës. Kur pikësynimi qe i ndryshëm e në një ujdi të ndyrë me qëllimin: demagogji e propagandë. I denjë për komedinë groteske klasike.

Mund të themi se u shpenzuan ca para për të strukturuar pamjen e një moshatari në Paris, të sigurt për adoleshentin Gazmend.

Një takim i pazakontë

T ë nesërmen, në një taksi të pajtuar, Marsejeza, Julieta dhe poeti u nisën në Pllajën Bergo. Ishte ditë-pune dhe poeti kuturisi të ndalej së pari në lokalitetin e qytezës. Aty pyeti për radiologun dhe i thanë se “një urgjencë” e kishte shpënë në fshatin Bergo. Kënaqësia e poetit qe e jashtëzakonshme:

-Do të kem shoqëri kur të mbërrijmë te vendi, - u tha dy damave.

-Shoqëri si ajo e “Hotel Dajtit”? - pyeti zonja Marsejezë.

-Jo. Se ndryshe nuk do të isha i gëzuar. Gjithmonë kam menduar se kujtesa është dhe takim. Është shoqëria e komandantit të skuadrës së Luanit, kur ky ishte i vogël.

Marsejeza e befasuar skajshëm, tha plot gëzim në shqip: -**Thokët e mi?**

-Po.

-Radiologu? - pyeti Julieta.

-Ekzakt, - tha poeti. Dhe vërtet, në pllajën Bergo, me autoambulancë kishte mbërritur “një rrugë e dy punë” radiologu, vetë i tretë. I kishte bashkuar kujtimi për shokun e fëmijërisë, i cili ishte aq i fortë, sa do t’i kishte tubuar gjithsesi, kudo e ngado që të ndodheshin.

E veçanta e kësaj shoqërie qe se Adriani kishte bërë pesë vjet burg vetëm se në sallën e gjyqit, i kish thënë Luanit me zë të lartë: “Mbahu!” Ky kish mësuar frëngjisht në burgun

e Spaçit. Kështu që së bashku me radiologun bëheshin dy frëngjishtfolës që komunikonin lirshëm me damat e Francës. I treti ishte Qemali. Rrobaqepës dhe, në drekën e shtruar nga francezet, këmbënguli të paguante trapezën si kompensim për atë që të tjerët, herë njëri e herë tjetri, ishin të detyruar të përkthenin në shqip bisedat. Sqima dhe kujdesi në veshje, tek ai, binte në sy në çdo gjë. Edhe në atë që sapo u ulën, ai kërkoi të pastroheshin karriget e atij lokali provincial, se ishin me pluhur duhani.

Për rrobaqepësin Qemal qe rasti të shpaloste përkushtimin e tij profesional si lulishtari buqetën e luleve.

-E bëj kostumin për merak dhe i hekuros me kujdesin e sedëtarit dhe ia vesh klientit përpara se ta marrë. Dua që ai të kënaqet dhe unë të këndellem me punën time. Por...

-Por? - pyetën të gjithë të pranishmit. Edhe damat e Francës, kur dëgjuan përkthimin.

-Por të nesërmen, e gjithë lumturia ime shndërrohet në hidhërim deri në skandal. - Pse? -thanë shokët. -Pse? - pyeti poeti. - Pse? - thanë njëherësh francezet pas përkthimit. Dhe Qemalin të gjithë e shikuan në gojë:

-Sepse klienti është ulur me kostum mbi trotuar, - tha shkoqur ai.

Të qeshurat, si një ciklon, shpërthyen nga ky vëzhgim tejet i gjetur, profesional dhe etik. Portretet e të pranishmëve, që deri tani ishin ende të trishtuara nga lotët e derdhur mbi varrin e Luanit, befasisht ndryshuan. Kur iu përkthye zonjës Marsejezë, ajo do të thoshte:

-Kur fresku i gazit tuaj erdhi tek unë, kaloi si bishti i kometës për ta shpënë lart në Kozmos trishtimin e për të lënë të qeshura fytyrat tona. "Një rrugë e dy punë". Nuk thuhet kështu në shqip.

-Qe e domosdoshme, mama, ndërhyrja e një

rrobaqepësi. A nuk të kujton kjo atë që thuhet për Njutonin dhe kolegun e tij gjerman, Liebel! Që të dy mëtonin, secili veç e veç, se ishte autor i integraleve, ndërsa dihej gjithashtu se së pari ajo që ideja e një rrobaqepësi. Praktikizmi i tij. I lumtë, zotit Qemal!

Radiologu 'Thokët e mi' frëngjishten e fliste më mirë se shqipen, se nuk e pengonte germa "t". Prandaj, kur të gjithë përsëritën 'i lumtë', ai tha 'bravo zoo... Qemo!

Megjithatë, shprehja 'zoo Qemo', ndonëse e thënë kaq pa djallëzi nga 'Thokët e mi', solli një tjetër gaz e një tjetër shpërthim nga ato të beftët, që vijnë me lot, se të gjithë e dimë që parashtesa 'zoo' nënkuptonte botën shtazore. Kjo, sigurisht ia hiqte aureolën rrobaqepësit, që zonjusha Julietë ia vendosi pak më parë.

* * *

Lexuesi e bashkë me të edhe ne e ndjemë se mbase duhej të flitej pak më shumë për çastin e përshpirtjes për Luan Majlindin. Për momentin e përsiatjes mbi vendprehjen e eshtrave të tij. Dhe, pikërisht, ky çast e jo prirja e anashkalimit e as ajo e harresës (si ilaç për kujtimet e hidhura), na bëri që ta veçojmë (jo për ta izoluar), por për të dalluar një detaj shumë domethënës. Ky hedh dritë edhe mbi shkakun e vërtetë që Luan Majlindi i dha fund jetës së tij me atë vendim aq të tmerrshëm.

Më qartësisht.

Sapo hynë në parcelën e rrethuar me gjineshtra, zonjat e Francës, Poeti, Radiologu dhe dy anëtarë të skuadrës "Thokët e mi", vunë re se një dyzetyjeçar, që përfundoi përshpirtjet mbi varrin e fëmijës së tij bashkë me të shoqen, e la këtë atje dhe u shkëput me një orkidelule, në dorë e njëjtë me atë të vendosur mbi betonin e dhimbjes së familjes së tij dhe e mbështeti mbi mermerin e Luan Majlindit. Bëri kryqin, si një ortodoks i mirë e

pastaj iu drejtua grupit që sapo mbërriti dhe e shihte me hutim këtë të panjohur fisnik në gjestin e tij, i cili tek matej të largohej tha:

-Dritë i pastë shpirti këtij *trimi* dhe *profeti* të veçantë. Them kështu ngaqë profetët përgjithësisht thonë çfarë do të ndodhë. Ky njeri ta lexonte në ballë çfarë ke thënë në mungesë të tij për të dhe, pa frikë, ta thoshte në sy ç'mendonte.

Qe disi i turbulluar siç edhe rëndom njeriut i ndryshon bota e brendshme në atë mjedis ku shpirti, në mos pastrohet, flladitet e shkundet nga pluhuri. -Ka pesë vjet që yjet e morën pranë vetes dritën e syve të mi. Dhe unë, sa herë do të vij këtu, dhe s'do të mungoj sa të kem frymën, bashkë me time shoqe, do të sjell gjithmonë edhe një buqetë me lule për njeriun tuaj.

-Keni ndonjë arsye, o njeri i mirë? - e ndërpreu poeti ngaqë ende s'ishin prezantuar.

-Po. Kam. I tërë fshati e dinte se ai kishte bërë shumë vite burg dhe e merrnin për të rrjedhur. Por na tha të gjithëve ne të tjerëve, se ishte i mençur e ne, ca budallenj të pandreqshëm. Po. Se shumë nga gratë tona i shpinin te doktori në lokalitet t'u jepte recetë për qumësht. Po. Për qumësht se s'ngopnin dot pjellat anemike. Po ashtu dhe pleqtë që vuanin nga stomaku dhe kërkonin recetë për bukë gruri.

Pas kësaj u mat të largohej. Por poeti, me shumë butësi, e ndaloi.

-Më falni, shok, dhe ngushëllime për fëmijën tuaj, por duam të dimë, siç edhe vetë e kuptoni, diçka më shumë jo vetëm për rrethanat...

-Atij zjarri dhe vetëdjegies së tij? - e ndërpreu ky bujar i panjohur në gjestin e tij.

-Ekzakt, edhe të atij zjarri e asaj vetëdjegieje.

Tjetri, një portret brun me ca leshra të zeza dhe i

parruar, me ca sy të futur në zgavrat e tyre nën drizat e vetullave të trasha, lëshoi një fasho nga vështimi i tij mbi gjithë grupin para se të pyeste:

-Ajo zonja e madhe mos është gjë franceze?

-Ekzakt.

Dhe ajo tjetra mos është gjë e bija?

-Ekzakt.

-Domethënë Marsejeza dhe Xhulio.

-Ekzakt, miku im. Po ju nga i dini emrat e tyre?

-Nga i di! Ato i di i gjithë fshati. Tjetër gjë se frika i ka kthyer në gur. Fjalët "Zhëtem, Marsejezë! Zhëtem, Xhulio!" i dëgjuan të gjithë se panë flakën dhe dolën jashtë me panik.

Pas kësaj ai u përcoll se e mori vaji.

-U hodh në zjarr, u hodh, ... për shpirt të atij vogëlushi, që ka mbërritur në qiell dhe s'do ta takoj më as atje. Se për këtë isha vetë fajtor.

-Ç'thoni kështu, o njeri i... (nuk tha i çuditshëm, por), i mirë.

-Nuk jam njeri i mirë. Se po të isha nuk do të ma merrte zoti fëmijën.

-Po pse, ç'bëtë, o njeri?

-Ç'bëra. Ajo që ditë votimesh.

-Ekzakt.

-Një ditë më parë, operativi i sigurimit më porositi dhe, unë budallai, bëra si më tha.

-Pse, ç'ju tha?

-Çoi fjalë atij 'të çmendurit' më tha pushti, se nesër janë votimet.

-Dhe?

-I thuaj të mos vonohet, por të vijë që më shtatë dhe votën ta hedhë për Partinë se ndryshe do të kthehet prapë në Spaç.

-Po pastaj?

-Ai më hodhi një vështrim që s'do ta harroj sa të kem jetën, para se të më thoshte:

"Kur të kthehet operativi yt nga kënaqësia e trupit të tij të ndyrë, se ku i dihet, mund të hajë ndonjë sfurk e t'i bëhen zorrët kukurec, unë do ta kem çliruar shpirtin nga kjo baltovinë. Se liria më mban gjallë".

Kështu tha se e dinte.

-Çfarë dinte?

-Atë që do të ndodhte pas votimit të tij.

-Pse, çfarë ndodhi?

-Më e pabesueshmja. Ishte vënë kutia e vogël, ajo që u çohet në shtëpi të sëmurëve dhe i thanë ta hidhte aty votën. Trimi, jo se nuk e kuptoi, por tamam se e pikasi hilenë, pa iu dridhur qerpiku, e hodhi aty fletën e votimit. Atë fletë e panë të gjithë sapo ai doli jashtë. Kryetari i Frontit, e hapi dhe, si e pa, na i tregoi të gjithëve.-Ja armiku. Nesër do të lajmërojmë prokurorinë të lëshojë fletë-arrestin dhe ta dërgojmë në Spaç. Të shpëtojmë nga ky pleh. Dhe... prokurori erdhi atë mbrëmje. E kishin lajmëruar njerëzit e fshatit Bishtajë, se duke u kthyer për në fshatin tonë operativi i zonës ishte gjetur i vrarë me barkun e çarë e...'zorrët kukurec', siç edhe e parashikoi ky trim, që zgjodhi lirinë e shpirtit. Nuk e hodhi votën për Partinë dhe nuk pranoi ta rikthenin në burg. Se i keqi iku, por të këqijtë mbetën.

-Po faji juaj, o njeri i mirë, ku është?

-Në atë, që fëmijën tim (dhe tjetri sërish u lotua), unë e lashë me temperaturë para se të shkoja në kodër e të çoja kërcënimin e atij palo-operativi. Kur u ktheva, lebetitjet e sime shoqeje nuk i jepnin dot jetë engjëllit tim...

Po nuk ishte koha e engjëjve. Ishte ajo e djajve dhe e përkuljes ndaj tyre. Luan Majlindi nuk e pranoi këtë dhe bëri zgjedhjen më të tmerrshme.

O ju që ecni mbi dy këmbë!
Nuk e dini çfarë fati po ju pret,
Qoftë të martë, a qoftë të premtë,
unë po shkoj në Luvër këtë të enjte

Një javë më pas, në aeroportin e Rinasit, në mes të dy damave franceze, Gazmendi tërhoqte një valixhe me rrota, të blerë në Dyqanin e Diplomatëve. Kurse poeti, i shkëputur, paksa, për të marrë gazetën “Koha jonë”, nxitonte dhe ai të ndahej me lulishtarin plak, prindërit e Gazmendit dhe tri motrat e tij: tetëmbëdhjetë, njëzet e njëzet e dy vjeçe. Kuptohet, kjo radhitje fliste për këmbënguljen e ardhjes së një djali.

Një vogëlushe e shkëputur, ia preu udhën poetit, kur ajo duhej të bashkohej me të ëmën e cila po nxirrte nga çanta biletat e avionit. Poetit, atë çast, i buisi sërish një varg, të cilin sapo të ulej në ndenjësën e avionit, do ta hidhte si një ogur të mirë. Dhe kishte të drejtë. Miturakja ngjiste, herë si flutur e herë si pëllumbeshë. Gëzimi i braktisjes së vendit e kishte përfshirë edhe atë. Por në vargun e poetit do të rritej mosha e saj dhe do të thoshte:

*Për martesë,
unë në vendin tim
do të kthehem
megjithatë.*

Befas dëgjohej mbi gjithë gumëzhitjet zëri i ish-tenorit të operës, i cili duke tundur biletën në dorë, iu kthye turmës së mbetur te gardhi, ku ishin ndarë nga njerëzit e tyre, që do të fluturonin:

*O ju që ecni mbi dy këmbë!
Nuk e dini çfarë fati po ju pret,
Qoftë të martë, a qoftë të premtë,
unë po shkoj në Luvër këtë të enjte.*

Dikush edhe buzëqeshi, ashtu si shumëkush, ngriti supet për pakuptueshmërinë e fjalëve. Por jo edhe poeti. Ky e kishte nxjerrë përfundimin për ish-tenorin. Njëmend që fjalët e tij dukeshin si të çartura. Por ato shpesh përbënin sentenca filozofike. Po ende sikur parathoshin atë çfarë: në mos kishte ndodhur, do të ngjiste. Madje shumë shpejt. Ishte si një Kasandër e fundshekullit të njëzetë.

Poetit iu ndërmend paralajmërimi aty në breg të rërës kur deklaroi:

“Nuk ka rëndësi sa pengesa janë deri te shtëpia e Lejlasë. Vendors hapi i parë që është i çmendur”.

A nuk qe vërtet e tillë vajtja e Poetit në dhomën e francezes? Për më tepër, i maskuar si grua me parukë dhe me burnuz?...

Poeti u sistemua në holl së bashku me francezet dhe Gazmendin, të cilit i vinte gjumë. Doemos. Ai e kishte gdhirë natën e shkuar në familjen e tij në Durrës. Qe mbledhur i tërë fisi, siç është zakon kur përcillet djali i shtëpisë-ushtar....

Eh! Askujt nuk i shkoi ndër mend ta pyeste se çfarë shkruhej në atë tatuazhin e tij, qe si e kopjuar nga ajo që thuhet se natyra ka qëndisur në krahët e trumcakut, vizatimet e të cilave me gjuhën e njerëzve lexohen:

“Nuk e mbaj dot veten pa fluturuar për atë që dua!”

Dhe kjo ide, në qoftë se ishte e Gazmendit, në daç edhe për ta qëmtuar, do të mjaftonte që Pitagora ta për zgjidhte në shkollën e tij. Nuk është për t’u habitur që Gazmendi fluturonte për në Francë, ku do të bënte shkollën e mesme, pse ishte djali pas tre vajzave radhazi. Por dihet, tanimë, se ndërsa gjyshi dhe gjithë familja e shihte si karafilin në kopsht, ai e kuptonte se qe zog, që do të fluturonte për në Francë dhe quhej Gazmend Farka.

Marsejeza ndihej tepër, po tepër e lumtur me këtë ndërmarrje. S’qe aspak për të vënia në shina vetëm e merakut të një lulerritësi. Jo. Një zë i brendshëm i pëshpëriste se nevojitej të bënte diç madhore për shpirtin e ish-burrit të saj. Eshtrat e tij preheshin aty, në Pllajën Bergo. Edhe falë ca njerëzve të panjohur, por që do të ktheheshin më pas në miqtë e saj më të mirë.

Vërtet, pas ca bubullimave do të shpërthejë shiu, por koha do të hapet e do të duket në qiell dielli. Dhe ky s’del për vete. Por për të tjerët. Aq më tepër për ata që kanë nevojë për ngrohjen e tij.

Poetin e tërhoqi titulli i një shkrimi, po aq sa portreti i një të moshuari. Dhe, ndërsa bëhej gati që diku në një cep të hidhte vargun, që i lindi aty përjashta, kur ia preu rrugën vogëlushja, stilografi i mbeti në dorë. Dhe ndonëse ishte tejet e çuditshme, por e njëmendtë, njeriu që shihte në gazetë: një burrë i moshuar me mustaqe të prera spic, me kostum si të viteve tridhjetë, dopio-petë dhe me një borsalinë, si të kishte dalë nga faqet e një tjetër gazete të njëjtë “Koha jonë”, hapur këtu e aty nga udhëtarët, u afrua pranë tyre.

Nuk kërkoi të hynte në ballesën e gazetës së tij. Jo. Ai thjesht hoqi borsalinën dhe, si futi në gojë një karamелеmente, me një frëngjishte për t’u admiruar, shprehu: -Më

falni, zonja të nderuara dhe ju zotni gjithashtu i nderuar. Por dëgjova të flisnit frëngjisht, gjuhën me të cilën kam mësuar në rininë time, kur studioja për mjekësi në Paris. Dhe ja tani, pas gjysmë shekulli më takoi që në këtë udhëtimin tim nostalgjik të dëgjoj të flitet kjo gjuhë e bukur dhe mendova t'i shtoj edhe zërin tim si një violinë e paakorduar në kuartetin tuaj kaq harmonik të të artikuluarit.

U përcoll pak dhe vërtet, si i dalë nga një kujtesë gjysmëshekullore, përsëriti:

-Më falni në qoftë bezdi tek ju prania ime, se... e ndiej që ylli im është shuar me dekada, tashmë.

-Aspak! - gjegji e para zonja Marsejezë dhe u ngrit në këmbë. Tjetri zgjati dorën dhe tha emrin:

-Jam doktor Kreshtani. Kështu më njohin në Tiranë dhe në të gjitha... (ai u mendua pak përpara se të thoshte) sallonet mjekësore të vendit.

Poetit iu kujtua se diku në një revistë periodike, për mjekësinë, kishte lexuar një debat mes shumë të tjerëve, mbi problemet psikiatrike dhe përplasjet midis dy shkollave, a dy mendësive: nëse duhet të quheshin 'pacientë' apo 'klientë' vuajtësit kronikë të një patologjie psikike. Dinte gjithashtu se doktor Kreshtani kish përpunuar teorinë e Frojdit e të Jungut mbi *Libidon*, këtë energji psikike që ndodhet te *idi* dhe që furnizon motivacionin (shtysën).

Po ende ai kish mësuar njëkohësisht se ku ndahej doktor Kreshtani nga kjo teori, e cila përpiqet të shpjegojë atë që sapo ka ndodhur dhe jo të parashikojë sjelljen. Gjithsesi, doktor Kreshtani, si gjithë plejada pas-Frojdiane, vlerësonte lart modelin e hershëm të konceptit *impuls*. Krejt ndryshe nga doktor Fotjani dhe metodat e tij në përshtatje me diktaturën dhe represionin për të cilat lexuesin s'ka pse ta lodhim me përsëritjen e tyre

diktuar nga praktika sadiste të “shkollës ruse”.

U prezantuan të dyja palët dhe poetit iu desh të shpjegonte se kish dijeni për polemikat në fushën e mjekësisë, pasi në bibliotekën e qytetit do të shkonte, të paktën një herë në javë, për t’u hedhur një sy periodikëve si: “Studime mjekësore”, “Pedagogjike”, “Studime juridike”, “Studime historike” e të tjera. Të gjitha këtyre ai, në artikuj të rëndësishëm, mundohej t’u bënte edhe një *lexim* të dytë në frëngjisht, njëkohësisht.

Pas bisedave të para të karakterit paraqitës dhe etik, poeti tha diçka lidhur me ato çka përmendëm dhe veç të tjerave nënvizoi, se kishte dijeni për diskutimet e tij me doktor Fotjanin, por, posaçërisht, ashtu siç janë poetët, ai do ta befasonte doktor Kreshtanin me përfytyrimin që i krijonte doktor Fotjani. Atij iu desh ta thotë këtë në shqip se druhej mos gabonte me fantazinë e tij.

-Dhe si ju është dukur në debat?

-Sikur e mban cigaren në gojë dhe ajo, ndonëse është zvogëluar tejet, ai nuk shqetësohet mos ia përvëlön gojën, sepse kapuçi me siguri që është ngjitur në pjesën e jashtme, e cila e lejon të vazhdojë ligjërimin, shoqëruar me lëvizje duarsh. Pamje më komike s’ke ku gjen.

Kaq mjaftoi që doktor Kreshtani të shpërthente në një të qeshur me lot, pa mundur dot të thoshte plotësisht fjalët:

-Fantastike, e pabesueshme! Por plotësisht e vërtetë. I keni rënë pikës. Si është e mundur me përfytyrim të keni kaq saktësi për t’iu afruar gati përsosmërisht-tipit? - Dhe doktor Kreshtani para se të priste përgjigjen e poetit, iu drejtua zonjave franceze:

-Të na falni se bashkatdhetari im po më befason me një vëzhgim të cilin edhe pse kam gjysmë shekulli në psikiatri, po mahnitem nga përfundimet e përfytyrimet e tij vetëm me *lexim*.

Pastaj u kthye nga poeti dhe i bëri një pyetje të dytë:

-Për çfarë keni mbaruar?

Poeti nënqeshi:

-Mos e kërkonte te shkollimi formimin tim, doktor, se kam kryer vetëm Institutin Pedagogjik në Shkodër. Nuk e di, mbase kjo vjen nga dhuntia për të kapur të veçantën në rrëmujën e tipareve vetjake. Për doktor Fotjanin, me gjasë, duhet të ketë ndikuar dhe emri i tij: Fotjan, që unë do ta gjykoja se tipi i tij i zjarrtë duhet t'i përgjigjet asaj për të cilët ithtarët e predestinatës teçojnë teorinë e tyre.

Doktor Kreshtani ndofta do t'i shtonte kësaj diçka tjetër, por në fortafolës u dëgjua zëri nga qendra e informacionit se "Air-Francë" do të vonohej edhe të paktën tridhjetë minuta. Prandaj atij iu desh të kthente në frëngjisht dialogun me poetin.

-**"Predestinata"**! - përsëriti doktor Kreshtani si me vete, - edhe në rininë time flitej për të.

Madje me zell të tepruar lexohej nga adoleshentët që ngatërrojnë prirjet e tyre me emrin, pjesa më e madhe e të cilëve, qe trashëgimi. Ndryshe nga prona për të cilën ndiqej praktika e rrobaqepësit, "*mat dhjetë herë e prit një herë*".

-Si e gjithë bota e krishterë, lidhur me trashëgiminë e emrit. Krejt ndryshe është bota islame, doktor.

*Predestinata: Për shkaqe financiare, ky libër u la gjatë të hidhej në kompjuter dhe, si çdo pengesë thuhet se vjen për të mirë; autori tek po ndiqte "Koncertin tradicional të Vjenës" më një janar, në televizionin shtetëror shqiptar, dëgjoi spikerin tonë të thotë se solisti balerin që luante në këtë trupë si pjesëtar i filarmonisë së Vjenës, ishte shqiptari ynë Eno Peçi. Madje në orkestrën e madhe të saj, ai njohu edhe bashkëkombësin tonë të quajtur Shkëlzen (mbiemri nuk u dëgjua mirë për të cilin kërkojmë falje). Si Eno e po ashtu edhe Shkëlzeni a nuk flasin për predestinatën e emrit që mbajtësit e tyre kanë prekur majat? Po Vaçe Zela, këngëtarja jonë e madhe? VAÇE&VOICE BARAS ME ZË, tingull. A nuk flet kjo për paracaktimin a për të parathënë?

-Po?

-Ata i udhëheq një filozofi tjetër, sipas së cilës: *Mos e trashëgo emrin tënd sepse ke për ta humbur shpejt atë.*

-Djalosh, po më befasoni me horizontin tuaj.

Ai nuk e fshihte kënaqësinë që po bisedonte me një të ri niveli i të cilit, jo vetëm i ngjante universal, por i mirinformuar me krenajat.

-Nuk mund të di si është jetëgjatësia e njëres palë, krahasuar me palën tjetër, për të vërtetuar këtë... sentencë, doktor. Por apriori, them se ka po aq gravitet sa edhe **predestinata**.

-Varet se ç'kuptojmë me nocionin *humbje*, - ndërhyri zonja Marsejezë në bisedë. - Në qoftë fjala për emrin, nëse zbehet kur ky trashëgohet, është një diskutim, por edhe për këtë sërish kërkohen statistika. E, pa dyshim edhe studime. Fjala vjen: Aleksandër Dyma (Ati), nuk besoj se humbi vlerën e emrit të tij edhe pse i biri, me të njëjtin emër, shkrimtar gjithashtu, nisi të botojë drama dhe komedi me përmbajtje sociale. Kujtoj këtu "Zonja me kamelje". Verdi do të shkruante pas saj "Traviatën", i cili për mua e tejkaloi babanë. Por a do të thoshin të njëjtën admiruesit e romaneve historike të të atit, si: "Tre musketierët" apo "Konti i Monte-Kristos"? Sa i përket jetëgjatësisë nuk më duket se ha diskutim.

-Në raste analoge, mama, ka edhe qesëndisje që s'ka të bëjë me emrin, por sidoqoftë përfshihet në atë që mund të inkludohet në 'duelin' e vazhdueshëm 'etër-bij'.

Doktor Kreshtanit i doli në shteg 'Kompleksi i Edipit', tema e tij e parapëlqyer, dhe priste me durim që zonjusha Julietë të përfundonte. Por poeti e spostoi pak kur tha: -Sa i përket doktor Fotjanit, në diskutimet për të ju jeni shprehur se: s'mund të hidhet tjetri në rrugë si një **kapuç cigareje**. Kjo do të thotë shumë për një njeri të letrave. Aq më tepër për atë që njeh **Algoritmin** dhe

heuristikën.

Doktor Kreshtani ishte pak të thuhej se u ribefasua. Ai u patak kur tha: - Ti ke dijeni për **programin IDEAL** për zgjidhjen e problemeve propozuar nga Bransford dhe...

-Stein, - plotësoi poeti.

-Ekzakt, - tha doktor Kreshtani dhe shtoi: -Janë studimet në pesëvjeçarin e fundit dhe kjo i bën nder inteligjencës suaj. Por, po shoh se keni në duar gazetën "**Koha jonë**".

Poeti shfletoi dhe në një cep ishte edhe portreti i Dr. Kreshtanit me borsalinë si ta kishin fotografuar pak para se të futej në këtë holl aviacioni.

-Qenkeni shprehur dhe ju për ngjarjen në "Hotel Dajti", doktor?

-Po, - tha Dr. Kreshtani, - e para se rastësisht u ndodha në vendngjarje dhe e dyta, kur mora vesh cili ishte, në njëfarë mënyre... e prisja që t'i ndodhte një gjë e tillë. Dhe s'mund të mos prononcohesha.

-Pse, doktor, kishit ndonjë arsye?

Ai tundi kryet dhe tha:

-Për shkak të asaj që folët edhe ju për 'predestinatën', djalosh. Aspak shkencore nuk duket? Njësoj mendoj edhe unë. E tillë ngjan. E veçantë se, përjashtimore ka qenë jeta e atij djali, që në moshën pesë vjeç. Afeksioni për nënën, vuri në shënjestër babanë. Natyrisht, pa e kuptuar se ç'bënte, e denoncoi atë për 'Tradhti ndaj Atdheut'.

Por edhe këtu mund të hapim një parantezë. Lëmë mënjane moshën fëmijërore. 'Thirrja e gjakut' duhet ta frenonte. Ajo nuk veproi fare. Arsyeja ishte se ky nuk qe '**babai biologjik**'. Kthimi mbrapsht i emrit **Ortep**, na sugjeron këtë për ta gjetur e lexuar **Petro**.

Ndërroi temë:

-Zoti më shpuri në vendin e ngjarjes si të isha prokuror

dhe pashë në hotel “Dajti” vërsniken e tij. Edhe pse ky i propozoi dashuri. Ajo, me sa duket i kujtoi deviacionin e tij pësuar në fëmijëri, ngaqë kishte qenë komshie me të. Valvola e autoklavës shpërtheu.

Qe një vetëvrasje, së pari në ndërgjegje. E çuditshme pas kaq vitesh. Por edhe më i jashtëzakonshëm mjeti. Ai rrëmbeu shishen me acid, a lëndë abrazive, që përdorte shërbyesja për të zbardhur mermerët (edhe tani që po hedhim këto radhë kujtojmë gjakftohtësinë e tij në përmbushjen e urdhrave të diktaturës, kaluar ftohtësisë së mermerëve, derisa ishte i pajisur me armë heshtëse), dhe spërkati sytë e tij për t’i ‘argumentuar’ vajzës dashurinë. (Dhe ne, sërish, veçojmë se ai ishte ‘qorruar’, së pari nga zbatimi i urdhrave të diktaturës nën këmbët e së cilës jetoi dhe tani, një shërbyese, moshatare, ia hoqi thonjëzat fjalës “qorrim”. Që, vetëm për një deqikë të shohë me sytë e tij vetveten e ta njohë atë. Pas kësaj s’kishin ç’i duheshin sytë. Aq më pak vështrimi. Kurrsesi drita e tyre.

-Për të na dhënë neve të fushës, - do të vazhdonte Dr. Kreshtani, - të shihnim rastin e pastër mbi “kompleksin e Edipit”.

Këtu, doktor Kreshtani, kishte të drejtë. Se ashtu siç edhe është i njohur tashmë lexuesi me faktin që Ortepi pa e ditur e vret të **atin biologjik** Petro, nën një zhbalancim të çastit si te “Kompleksi i Edipit”.

Pas kësaj Dr. Kreshtani nuk foli më. Mbi të pranishmit u end një tis i trishtë e hijerëndë. Nën këtë ngrysje, në mos ulëritëse, vajtimtare, Gazmendi i vogël hapi sytë, tejet i befasuar.

Dr. Kreshtani pa se adoleshentit iu duk krejtësisht i ftohtë e tejet i huaj mjedisi, pas së cilës vjen malli për të tutë. Po ende, jo në pak raste edhe pendesa, që tashmë në mënyrë të pakthyeshme barazohej me zero.

Doktori e ndjeu se ishte ai me bisedën e tij shkaktari i kësaj rëndese tejet shtypëse prandaj iu kthye në shqip poetit për ta ndryshuar e diç ëmbëlsuar klimën:

-Pak më parë dhatë përshtypjet tuaja nga leximi i polemikave me kolegun Dr. Fotjani.

-Po.

-Por... sikur më kursyet mua në përfytyrimet tuaja. Apo për shkak të groteskut, nuk e patë të udhës t'i tregoni?

Poeti buzëqeshi ëmbël. Qe nga ato buzëqeshje, mbase të huazuara nga zonjusha Julietë, që fshihte mendimin e vërtetë ku sheqerosej gjykimi.

-Më duket se e keni kuptuar doktor, se është kjo e mbramja: fundja, përfytyrimi është vetjak dhe... një fanitje.

Sidoqoftë doktori ishte psikolog dhe s'mund t'i kaloje me një përkufizim të këtij lloji.

-Pse është i tillë, - tha ai në frëngjisht, - s'keni pse të nguroni. Përshtypjet s'janë... diagnoza, - e nxiti ai.

-Doktor Kreshtani, - nisi poeti një arsyetim të një lloji ndryshe, - kur diskutoja me një njohës të greqishtes këta muajt e fundit mbi '**komunistët idealistë**', ku besoj hyni dhe ju, përderisa latë Parisin e bukur dhe erdhët këtu të bënit hipnozuesin në çetat partizane. E kam mirë?

-Ekzakt! - pohoi doktori.

-Njohësi i greqishtes më tha fjalën greke: '**alotrop**'. Përkthimi fjalë për fjalë i kësaj thënieje të huton.

-Pa dyshim, - tha doktori, që e zotëronte gjuhën.

-Por kur shfletoi Larusin anglisht, një miku im, edhe pse botimi i viteve '30-të, gjeti shpjegimin se: '**alotrop**' është secila nga format e ndryshme që mund të ekzistojë një element. Dhe merr si shembull *karbonin*, i cili ka tre '**alotrope**', grafitin, diamantin dhe qymyrin amorf... Pas kësaj bindesh.

Dr. Kreshtani, disi i hutuar tha:

-Ku hyn këtu '*komunisti ideal*'?

Zonjat franceze buzëqeshën njëkohësisht dhe ngjashmërisht. Fizikania Julietë ndërhyri edhe për të zbutur 'ironinë':

-Hyn, doktor, hyn. Madje mund të them se është gjetja më e përafërt që i shkon se... dihet, çdo krahasim çalon.

-Ekzakt.

-Më lejoni, doktor, t'ju them se është shembulli më tipik mbi... **d ë s h t i m i n**.

-Pse?

-Sepse të dy elementet që merren në analizë janë qymyr amorf. Njëri donte të bëhej *diamant* dhe u zhgënjye edhe vetë.

-Po, - tha doktor Kreshtani. - Ky është *komunisti idealist*, që kujtoi se do të hante me lugë floriri.

-Fizikania, - tha poeti, - si të kish lexuar bindjen time, shpjegoi pikërisht atë çka mendoja. Se ju, i dashur doktor, tentuat **diamantin** dhe përfunduat në **qymyr amorf**. Për pasojë, nuk shkruat aspak histori, mbase historirëza. Atë e bënë kolegët tuaj që e treguan veten se qenë **grafit** dhe shkruan **historinë më të zezë** të këtij vendi.

U bë një lloj heshtjeje. Por Dr. Kreshtani, sërish, iu drejtua poetit:

-Gjithsesi përshtypjet tuaja për mua ende s'i kam dëgjuar.

-Pas kësaj, por edhe atij përshkrimi tejet rrëqethës që i bëtë ngjarjes në "Hotel Dajti", në vagullitë e mia do të shfaqeni, Dr. Kreshtani, si një shëmbëllesë e dalë nga arkivi i Marubit, me vlera, natyrisht, për historinë...

Në fortafolës u dëgjua zëri nga qendra e informacionit, që thoshte se: pasagjerët për në Paris duhet të përgatiten. "Air-France" ka mbërritur në aeroportin e Rinasit.

Poeti e vinte në dyshim shpjegimin e Dr. Kreshtanit.

Akuza që Dr. Fotjani i kishte bërë për liberalizëm s'ishte pa gjë. Riparaqitja e saj vetëm ironizonte. Në një cep, një gazetar hidhte dritë në një këndvështrim krejt tjetër. Për një motërzim të ri ai fliste.:

Shishen me acid, a lëndë abrazive e kishte në duar vërsnikja e Ortepit. Ky me siguri ka tentuar ta puthë dhe ajo, për t'u mbrojtur, ia ka hedhur në surrat me neveri.

Është tjetër gjë përkesa e këtij veprimi me *"kompleksin e Edipit"*. Ashtu siç është tjetër gjë, që: liberali **komunisto-idealist**, Dr. Kreshtani, pa e kuptuar as vetë, në kushte të caktuara, si **qymyri amorf, tenton diamantin**, për të shpëtuar një vajzë të re nga një sigurims i destinuar për ndëshkim, bëri më në fund një gjest... **të diamanttë**.

Në bordin e avionit, Dr. Kreshtanit, tek sistemonte çantën, në rreshtin tjetër të mesores, iu kujtua, plotësisht, diçka nga vegjëlja e poetit dhe në shqip, që të mos dëgjonin parizienet, i pëshpëriti:

-Në fëmijërinë tuaj, mos ndofta të kanë mbetur të dy prindërit në gurore dhe pësuar një goditje psikike pas kësaj?

Poetin nuk e befasoj dhe aq pyetja sesa kujtesa e këtij doktori, tejet pasionant dhe, ndonëse pohoi me krye, menjëherë iu ndërkëmbye figura, teksa dëgjonte vazhdimin e pyetjes së Dr. Kreshtanit dhe shihte siluetën e tij njëzet e pesë vjeç më të ri:

-Dhe keni qenë te pediatri me nofkën "Gjinkalla" bashkë me gjyshen tuaj?

Poeti tanimë dëgjonte tjetër zë dhe shihte tjetër njeri. Atë që ishte ulur pranë Dr. "Gjinkallës" dhe e hiqte veten si shok i tij, ndërsa gjyshja e poetit shpjegonte se vogëlushi i saj, domethënë poeti i ardhshëm, tmerrohej kur binte nata.

-Shtëpia juaj ishte me gurë dhe ajo çka u ndodhi prindërve tuaj ju solli fobi nga gurët. Ishte një tronditje

e madhe dhe një nga arsyet që duhet patjetër të ndërroje mjedis. Në pamundësi për një zgjedhje më të mirë familjare, unë firmosa që ju të shkonit në “Shtëpinë e Fëmijëve”.

Poeti pohoi me krye.

Doktor Kreshtani përfundoi:

-Ajo tronditje tek ju, djalosh, ka ardhur për mirë.

Ju ka zgjuar atë që thuhet për ‘**shqisë e gjashtë**’.

Poeti hapi sytë.

-Po, po! Inteligjenca juaj e tregon këtë.

Dr. Kreshtani e kish vendosur çantën sipër ndenjësve.

Poeti u ul pranë damave të Francës.

Avioni filloi ngjitjen me rrapëllimë, zhurma e të cilit u zëvendësua më pas me një uturimë disi më të pranueshme, kjo, se ishte e njëtrajtshme. Hija e tij mbi tokë qe tretur së bashku me ngjarjet e së shkuarës, të cilat e ardhmja do t’i arkivojë si “Fototeka Marubi”. Veçse, jo për t’u krenuar me to, por për të mos u turpëruar prej tyre.

Mbi tokë nuk dallohej më asgjë, veçse mugëtirë. Ajo që nuk shquhet lehtë, nëse është ag, pas të cilit vjen drita, apo muzg, pas të cilit errësohet e vjen nata.

Athinë, tetor 2012 - 14 shkurt 2013

Një shtesë aspak për t'u shmangur

E mbarova romanin deri në redaktimin e fundit. Madje, rishkrova në një faqe të re kopertinën e parë (se titullin më ishte dashur ta ndryshoja më shumë se një herë). Por diçka e patrazuar dhe mbase e nyjtëzuar me temën që trajtova më shtrëngonte e më sillte jo vetëm një lloj pakënaqësie e pezmi, por edhe më mbante si të mbërthyer e të palëvizur mbi të. S'qe magnetizëm. As vetëhipnozë ajo s'qe. Megjithatë, si i shtangur, ndieja në damarët e mi një pulsime, skajshëm përthithës. Diçka që më tërhiqte si të ishte ky i ngjashëm me një frymor që këmbëngulte t'i përmendej emri në një apel virtual, ose, të paktën, t'i cekej kalimthi dhe, si rastësisht, sepse për këtë edhe thërriste.

Po çfarë?

Atë çast, në dhomën time të punës hyri ime shoqe të cilën nuk e ndjeva. Vështrimin tim të gozhduar mbi kopertinë (saktësisht mbi titullin e dyfishtë) ajo do ta zhbënte me leximin pak më ndryshe të tij. Po. Mos u çudisni! Se kjo karakteristikë, mbase vetëm femërore, nuk është aspak tipar i panjohur, miqtë e mi. Prandaj, ajo, me një refleks të vetvetishëm, shprehu:

-Më pëlqen kaligrafia me të cilën sikur **e ke qëndisur atë titull "dytehësh"**.

-Dytësor, - e korrigjova unë. Por ajo e shpërfilli

ndreqjen time dhe vazhdoi:

-E di që ato germa ngjajnë të njëjshme me të miat?

Unë jo se nuk e dija dhe as se më befasonte kjo vëmendje pas diç më shumë se katër dekada martese, por, për t'i dhënë një shtysë të re fantazisë së saj (*duhet ta pranoj, ia kalon dhe e lë ku e ku trillin tek unë*) i dhashë një letër të bardhë dhe stilolapsin:

-Provoje! – i thashë.

Ky qe çasti që më kujtoi se ç'ditë ishte dhe menjëherë e fantazova se ç'do të shkruante.

Ajo u ul në ndenjësën time edhe sepse unë korrigjimet i bëj, gjithmonë, në divanin ngjitur. Aty mbështetem mirë dhe ndihem më rehat ngaqë nuk përkulem.

Ajo shkroi një fjali dhe, përpara se të ma tregonte, shpjegoi:

-Bukurshkrimin e kam mësuar nga zonjusha që na jepte rusisht. E kishte mjaft tërheqës. Por tejet, ama. Sidomos germën “Ja”. Pas kësaj, më la në dorë fletën në të cilën shkruhej me një **kaligrafi dhe germa të njëjta me të miat**. Madje si të qëndisura të atij titulli “dytehësh”. Po. Nuk gaboj. Ato ishin si germat e mia, ashtu siç ai shkrim, si imi qe.

O Zot! Mos unë kisha hedhur në roman, pa e kuptuar as vetë, detaje autentike të miat? Apo kjo përkese ishte karakteristikë e kohës që dashuria të vinte me këmbime të tilla të shkruara?

Cilado qoftë fjalia që ka hedhur, mendova në atë çast, ajo **ka të bëjë me 14 shkurtin**, ditën e të dashuruarve. Dhe s'u gabova. Se e tillë ajo qe edhe pse “dytehëshe” ajo dukej. Lexojeni!

“**Ja lubju tibja zhiznë!**”^{*} tha dhe më pa në sy.

Qe vërtet diçka prekëse. Ime shoqe mbase kishte

* Unë të dua ty jetë (Rus).

lëkundur deri në dridhje mendimin tim, apo e kundërta? Rikumbimi i saj kish sjellë tek unë atë tingullsi dhe atë jehonë që kërkonte fjalia? Se truri im rithithi kuptimin, prandaj u ngrita me sy të njomur dhe e putha.

Vështrimi i saj, disi i pakuptueshëm aty më parë, u bë më i gjallërishtëm e u mbush me jetë. **Sepse ishte 14 shkurti! Ishte Dita e të Dashuruarve.**

Atë çast mendova:

Ishte shkrimi im që e kishte tërhequr së pari atë, apo kaligrafia e saj që më kishte joshur mua tek ajo? A sepse gjithçka e saj tek unë qe mirakëndëse dhe e bukur?

Sidoqoftë, e parë në hapësirën kohore të dekadave, ajo ia kalonte një tabloje të soditur nga larg, ku sfumimi i ngjyrave dhe dritëhijeve harmonizohen me njëra-tjetrën. Dhe nuk mund të flitet ku nis njëra dhe ku përmbillet tjetra. Aq më pak të shprehesh për shigjetat e dashurisë. Por mbase diç duhet thënë për rusishten?

Ja dhe shpjegimi:

Në kohën kur Luan Majlindi bënte dashuri në Paris me Marsejezën, ne, bashkëkombësit e tij, kishim korrespondencë me vajza ruse. Një e tillë me emrin Tatjana, letrat e saj, mbasi shkëmbyem fotografitë e moshës, i fillonte me fjalën Millij* dhe më pas vinte emri im. Që koha kur të tjerë Luanë krijuan edhe familje me vajzat ruse. Dhe kur marrëdhëniet ndërshtetërore njohën dramën e prishjes, ato familje provuan tragjedinë e ndarjes. Një shok i fëmijërisë sime, dukshëm më i madh, nuk pranoi ta shkurorëzonte bashkëshorten ruse dhe e ndoqi fati i zi si i Luan Majlindit. Që tejet i papërkulshëm. Ndaj pësoi kalvarin e tij. Doemos, derisa ai e quante pabesi shkëputjen. Ndarja ishte karakteristikë aspak shqiptare. Aq më pak kur kjo vjen pa një shkak

* I ëmbël (Rus)

moral. Dhe zgjodhi zinxhirët për të shpëtuar shpirtin.

Në fillim të viteve nëntëdhjetë, ky njeri skajshëm i palakueshëm dhe zjarrdurues i pashoq, doli nga burgu i petëzuar. Gjëja e parë që bëri, kërkoi të holla nga shokët e vjetër të rinisë së djegur nga **socializmi** për t'i bërë një telegram gruas së tij në Moskë.

E shkroi tekstin rusisht, por me shkronja latine. Për lexuesin e përcjellim shqip:

Millaja Natasha!

Dashuria për ty dhe për djalin tonë, Skënderin, më mbajti gjallë. Jam i Lirë, por..., në mes të katër RRUGËVE.

I yti, Gjergji

Priti me ankth përgjigjen. Dhe ajo erdhi edhe më shpejt seç vajti.

Kush ka parë portretin e një skllavi të çliruar nga prangat e tij, kupton se ç'është LIRIA. Për rastësi, atë çast u ndodha pranë tij. Ai ngjante me një Ezop shqiptar që thërriste:

-Jam "I LIRË, I LIRË, I LIRË".

Kishte të drejtë.

E shoqja, Natasha, i dërgoi menjëherë biletën e avionit si dhe një shumë të hollash për të blerë veshjen e përshtatshme. Kujdesi i saj i ngjante vëmendjes së parisianes, znj. Marsejezë, për Gazmendin, nipin e lulërritësit.

Sa çifte të tjera kanë jetuar këtë akt tragjik dhe pezmi i ka bërë ta presin biletën pa kthim!

Ky largim na ndoqi edhe ne, si mallkim.

Ja çfarë më mbante si të mbërthyer e të pezmatuar porsa mbarova së shkruari këtë roman. Sepse ndihesha i zhvendosur, i shkurajuar dhe vuaja si ai me "kompleksin e zemrës së thyer".

